

KDU 28(05)



FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME I PRISHTINËS

REVISTË HULUMTUJESË, FETARE, SHKENCORE

SCIENTIFIC RELIGIOUS JOURNAL

vëllimi 8, nr. 1 / volume 8, no.1 / 2024

# BULETINI

 [www.fsi-edu.net](http://www.fsi-edu.net)

 [buletini@fsi.edu.net](mailto:buletini@fsi.edu.net)

 [buletini FSI](#)

Prishtinë, 2024

# BULETINI

REVISTË HULUMTUESE, FETARE, SHKENCORE  
vëllimi 8, nr. 1

SCIENTIFIC RELIGIOUS JOURNAL  
volume 8, no.1 / 2024

## **Boton: Fakulteti i Studimeve Islame**

### **Dekani**

Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani

### **Redaktor**

Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma

### **Redaksia**

Prof. Dr. Fahrush Rexhepi  
Prof. Ass. Dr. Zija Abdullahu  
Prof. Ass. Dr. Musa Vila  
Dr. hfz. Safet Hoxha

### **Sekretar i redaksisë**

Mr. Vedat Shabani

### **Redaktor gjuhësor**

Phd (c) Besnik Jaha

### **Redaktor teknik dhe ballina**

Nuhi Simnica

### **Shtypi**

“Printing press”- Prishtinë

### **Adresa**

@ Fakulteti i Studimeve Islame  
Rr.Bajram Kelmendi Nr.174, P.O.Box.10000, Prishtinë  
Tel dhe Fax: 038-243-887

[www.buletini.net](http://www.buletini.net).

[buletini@info.net](mailto:buletini@info.net)

[facebook.com/buletiniFSI](https://facebook.com/buletiniFSI)



FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME I PRISHTINËS

# BULETINI

REVISTË HULUMTUESE, FETARE, SHKENCORE  
vëllimi 8, nr. 1

SCIENTIFIC RELIGIOUS JOURNAL  
volume 8, no.1 / 2024

Prishtinë  
2024

# Përmbajtja

---

## EDITORIALI

Përmbushja e objektivave 9

## ARTIKUJT

Filozofia e edukimit islam (Rasti i Kosovës) 17  
*Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani*

Arti i shkencës drejtuese (orientuese) mbi leximet kuranore  
Përkufizimi, emrat, termat, burimet lidhja me shkencat islame 29  
*Dr. Hfz. Safet Hoxha*

Koncepti i shkencave kuranore në aspektin historik 53  
*Dr. Valmire Batatina-Krasniqi*

Koncepti peygamberik ndaj “tjetrit” 73  
*Prof. Ass. Dr. Zija Abdullahu*

Veshja e mëndafshit mes të ndaluarës dhe të lejuarës 103  
*Dr. Ilmije Kuçi*

Mësimet (derset) si formë e diskursit në dave 117  
*Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma*

Metoda e tretë e thirrjes 131  
*Prof. Ass. Dr. Musa Vila*

Modeli i qeverisjes së mirë sipas sures El Bekare 151  
*Prof. Ass. Dr. Lulzim Esati*

Vlera e të mësuarit përgjatë tërë jetës sipas koncepteve islame  
(Perspektiva e Fakultetit të Studimeve Islame ndaj këtij koncepti) 163  
*Mr. Vedat Shabani*

---

Fenomeni i zëvendësimit të një tingulli me një tingull tjetër në gjuhën arabe <i>Mr. Besim Mehmeti</i>	187
Narracioni i fshehur i historisë së letërsisë shqipe <i>Besnik Jaha PhD (c)</i>	209
<b>RECENSIONE</b>	<b>233</b>
Libri shkenca Ilmul Kelami – parimet bazë, studim i nevojshëm për trojet tona <i>Dr. Bahri Hoxha</i>	235



# EDITORIALI





## Përmbushja e objektivave

Revista ndërkombëtare fetare, shkencore “Buletini” është organ i Fakultetit të Studimeve Islame, ndërsa është botuar një herë në vit, mirëpo gjithherë me synimin që të botohet dy herë në vit. Numri i parë është botuar më 2010 (KDU 28(05), ndërsa deri më tani janë publikuar shtatë numra. Revista “Buletini” po vazhdon me misionin dhe qëllimin e themelimit të kësaj medie e komuniteti shkencor. Kujtojmë se revista ofron gamë të gjerë kërkimesh shkencore mbi të gjitha aspektet e Islamit dhe shoqërisë, në shumë disiplina të studimeve islame, duke përfshirë këtu: Kuranin, Hadithin, Tefsirin, Siren, Ilmul Kelamin, Jurisprudencën, Fikhun, religjionin, ekonominë, gjuhësinë, historinë, kulturën, filozofinë, antropologjinë, metafizikën, psikologjinë, sociologjinë, studimet bashkëkohore, spirualitetin, artin, shkencën, teknologjinë etj.

Revista “Buletini” synon ta vendos Islamin dhe traditën islame si fokus të sajin qendror në kërkimin akademik, duke e inkurajuar shqyrtimin gjithëpërfshirës të shumë segmenteve të tij, si dhe të ofrojë një forum për studimin e Islamit dhe të shoqërive islame në kontekstin dhe rrethanat globale.

\*\*\*

Ky numër i Revistës përfshin 12 artikuj kërkimorë kryesorë, secili duke hedhur dritë mbi mënyrat e ndryshme në të cilat tradita ligjore dhe teologjike islame është formësuar dhe ndërthurur me shoqëritë paramoderne dhe moderne. Punimi i parë është “Filozofia e edukimit islam (Rasti i Kosovës)” i përgatitur prej Prof. Asoc. Dr. Islam Hasanit, i cili në këtë punim shkencor flet se arsimin islam është një koncept universal i ndërtuar dhe portretizuar në procesin e mësimin, e që i referohet zhvillimit të çështjeve universale. Filozofia e edukimit duhet të reflektojë çështje të përgjithshme dhe integruese, shpirtërore dhe fizike, dhe gjithashtu çësh-

tje që kanë të bëjnë me botën tjetër. Përkufizimi i konceptit të edukimit duhet të shpjegohet nga perspektiva e natyrës së njeriut dhe rolit të tij në gjithësi, si dhe fatit të tij në përgjithësi. Prandaj, ky punim synon t'i sjellë disa koncepte filozofike që ndërlidhen me edukimin dhe synimet e edukimit në përgjithësi, duke ofruar shembuj të edukimit dhe të arsimit islam në Kosovë. Më konkretisht, flet rreth sistemit të edukimit islam në Kosovë, historisë, organizimit dhe të arriturave të tij gjatë shekujve.

Punimi i dytë, me titull “Arti i shkencës drejtuese (orientuese) mbi leximet kuranore”, i profesorit Dr. Hfz. Safet Hoxhës, flet për konceptin e shkencës së drejtimit, origjinën e saj dhe dallimin midis saj dhe shkencës së leximeve, që doli nga ajo, si dhe raportin midis shkencës së drejtimit dhe shkencave të Sheriatit, dhe arabishtes në veçanti, duke paraqitur shembuj praktikë të leximeve të ndryshme kuranore për çështje nga ato shkenca, si dhe ndikimin e tyre në rregulla dhe dispozita. Në vijim kemi artikullin “Koncepti i shkencave kuranore në aspektin historik”, prej autores Dr. Valmire Batatina-Krasniqi, e cila me mjaft argumente sqaron se veprat e para të sistemuara veçanërisht mbi tematikën “Ulumul Kuran” filluan të shkruhen në fund të shek. III h. Këto vepra u shkruan duke i mbledhur studimet e mëhershme të natyrës së Ulumul Kuranit. Në vazhdim kemi punimin “Koncepti pejgamberik ndaj “tjetrit”, të autorit Prof. Ass. Dr. Zija Abdullahu, në të cilin ofrohen fakte rreth sjelljes së Pejgamberit, a.s., me njerëzit, para së gjithash, se sjellja e tij, a.s., ishte mbi baza të dinjitetit njerëzor, e jo mbi baza të fesë, kombit apo racës. Madje, në Medine i trajtoi Ithtarët e Librit sikurse myslimanët, e posaçërisht e shohim këtë nderim të tyre në Kartën e Medinesë, në të cilën i bëri shtet-formues me të gjitha të drejtat që i takojnë një qytetari me ligjet moderne. Në vazhdim kemi paraqitur punimin e radhës, “Veshja e mëndafshit mes të ndaluarës dhe të lejuarës”, prej autores Dr. Ilmije Kuçi, ku bindshëm elaborohen pjesë nga legjislacioni islam, i cili i lejon që burrat dhe gratë të zbukurohen, veçanërisht me veshje, mirëpo njëkohësisht i ka bërë edhe disa kufizime, duke e përfshirë ndalimin e disa llojeve të veshjeve, si për burrat, ashtu edhe për gratë, e në mënyrë specifike,

disa sosh, vetëm për burrat, gjithnjë si shenjë përkushtimi ndaj Zotit. Në vijim kemi punimin “Mësimet (derset) si formë e diskursit në dave”, të autorit Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma, që ka bërë një studim të kësaj tematike, duke vlerësuar se mësimet konsiderohen si mjetet më të suksesshme në komunikimin e da'ves, duke u bazuar në faktin se ato përmbajnë apo kanë lidhje të fuqishme dhe të drejtpërdrejtë mes folësit dhe dëgjuesit, sikurse edhe përmbajnë lëndë të dijes. Po ashtu, ato njëkohësisht konsiderohen edhe lidhje besnike mes daiut dhe të thirrurit, si dhe shpirt i qëndrueshëm mes tyre, e që i heq të gjitha dilemat dhe pengesat ndaj mësimet të çdo gjëje të re dhe me interes për masën. Autori Prof. Ass. Dr. Musa Vila në këtë numër të revistës vjen me punimin “Metodat e thirrjes”. Kjo temë ka të bëjë me një metodë specifike të thirrjes, e që në fjalorin islam njihet si hytbe, dhe që në gjuhën shqipe do të thotë: kur një person (imami), në ditën e xhuma, i drejtohet masës me një fjalim, për ta dhënë një mesazh rreth ngjarjeve që zhvillohen në atë vend dhe më gjerë. Imami, në petkun e hatibit, do të mundohet që për një kohë të shkurtër të japë gjëra të mëdha, pavarësisht se a kanë të bëjnë me inkurajim, apo me frikësim.

Në vijim Prof. Ass. Dr. Lulzim Esati vjen me punimin “Modeli i qeverisjes së mirë sipas sures El Bekare”, i cili hedh dritë mbi Islam, që ofroi rregullimin total të shoqërisë përmes legjislacionit penal, dispozitave të adhurimit, dispozitave të trashëgimisë dhe sistemit ekonomik e financiar, e që e ka synim zhvillimin dhe jo rritjen e kamatës e të interesit.

Autori Mr. Vedat Shabani e shtjellon punimin “Vlera e të mësuarit përgjatë tërë jetës, sipas koncepteve islame (Perspektiva e Fakultetit të Studimeve Islame ndaj këtij koncepti”, ku argumenton vlerat e të mësuarit përgjatë tërë jetës, sipas koncepteve islame, sidomos perspektivën e Fakultetit të Studimeve Islame ndaj këtij koncepti. Ai me këtë rast nënvizon se me këtë punim kemi për synim sqarimin e vlerës dhe të rëndësisë së të mësuarit përgjatë tërë jetës, si dhe praktikatat që i ofron FSI-ja në fushën e studimeve teologjike në Kosovë dhe më gjerë. Në vazhdim sjellim shkrimin: “Fenomeni i zëvendësimit të një tingulli me një tingull tjetër në gjuhën arabe”, prej autorit Mr. Besim Mehmeti, i cili shtjellon,

në fakt, ndryshimin e dialekteve nga një rajon në tjetrin, e që nuk është një fenomen i kohëve të fundit, por është një fenomen i lashtë, dhe që është identifikuar prej studiuesve dhe është kodifikuar qyshkur arabët filluan të shkruanin për dispozitat e gjuhës “gramatikën - sintaksën” dhe dallimin në dialekte nga një fis në tjetrin. Çdo dialekt ndryshon nga thetëri në bazë të veçorive gjuhësore që përfshin, sikurse është ndryshimi i një shkronje në një vend tjetër, ose shtimi i një shkronje shtesë, deri të ndryshimi rrënjësor i fjalës ose i foljes.

“Narracioni i fshehur i historisë së letërsisë shqipe”, i autorit Besnik Jaha PhD (c) në vazhdim hedh një sy më të thellë mbi historitë më të njohura të letërsisë shqipe, që nga inicimet e para e deri te projektet e mëdha institucionale, ndërsa vërehen elemente tepër me rëndësi për historinë e pashkruar të letërsisë shqipe! Këtu paraqet një studim serioz dhe shumë të nevojshëm në lëmin historisë së kulturës dhe letërsisë shqipe, e cila është shkruar pa e përfshirë komunitetin islam të shekujve të parë të identifikimit të kulturës letrare shqiptare.

Në fund sjellim recensionin e përgatitur prej Dr. Bahri Hoxhës, për librin “Shkenca e Ilmul Kelamit – parimet”, me autor myftiu Naim ef. Tërnavë. Ai më tej thotë se autori e ndan librin në katër kapituj, dhe secili nga kapitujt përfshin një studim të tematikave që historikisht janë studiuar dhe interpretuar prej dijetarëve islamë në shkencën e besimit, apo, siç quhet në origjinal, Ilmul Kelam. Struktura e kapitujve në libër paraprihet nga një hyrje mjaft e thellë, në të cilën shpjegohet qëllimi dhe përmbajtja tematike e librit.

#### *Lexues të nderuar!*

Dua të jem mirënjohës ndaj redaksive paraprake të “Buletinit”, të cilat në kuadër të mandateve kanë dhënë angazhimin e tyre për botimin e revistës, për çka edhe meritojnë mirënjohje dhe respekt. Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit të Studimeve Islame, bazuar në kompetencat që ka, tashmë e ka përzgjedhur dhe emëruar përbërjen e re të redaksisë, e cila nga ky numër do ta bartë mbi supet e saj organizimin dhe botimin e kësaj reviste. Ky besim më shumë i bënë përgjegjës për detyrën me të

cilën janë obliguar, para Allahut së pari, KMSH-së dhe opinionit shkencor pastaj. Po ashtu dihet se deri më tani revistën e kanë drejtuar këta kryeredaktorë, e që janë dëshmuar në komunitetin shkencor: Mr. Qemajl Morina - e drejtoi numrin 1; Prof. Dr. Qazim Qazimi - nga nr. 2-4, Prof. Dr. Fahrush Rexhepi, nga nr. 4-7, Dr. Ajni Sinani si dhe prej këtij numri është Prof.Ass.Dr.Rexhep Suma.

Edhe pse epoka në të cilën jetojmë tani ka një krizë të madhe të leximit të revistave, mendojmë dhe shpresojmë se në numrin tetë të revistës se do të ketë mekanizëm nxitës dhe frymëzues, meqë kuadri akademik dhe studiues do të kenë mundësi t'i shfaqin hulumtimet dhe studimet e tyre shkencore. Po ashtu, revista "Buletini" synon që në një të ardhme të afërt ta gjejë vetën në mesin e platformën e revistave të indeksuara e me kredibilitet të lartë ndërkombëtar.

Redaksia e "Buletinit" jo domosdo pajtohet me opinionet e autorëve të shkrimeve që botohen. Mbesim të përkushtuar ta bëjmë zgjerimin dhe krijimin e hapësirave për studiuesit e rinj, duke ofruar kontribute në disiplinat e përfaqësuara në avancimin e teorive, epistemologjisë, pedagogjisë dhe metodave. Sigurisht se nuk mungon edhe falënderimi për të gjithë bashkëpunëtorët dhe anëtarët e redaksisë, të cilët e ofruan mbështetjen dhe ndihmën e tyre në përgatitjen e këtij numri për lexuesit tanë, ndonëse me një fizionomi dhe synim të ri, si dhe kuadër të përmbajtjes të freskuar, po gjithmonë duke e ruajtur frymën e traditës së themelimit dhe të objektivave së saj.

Në fund, e lusim Allahun Fuqiptotë që të na japë forcë e vizion, që amanetin e marrë mbi supet tona ta kryejmë me përgjegjësi të plotë.

Prishtinë, dhjetor 2023

**REXHEP SUMA**

PROFESOR NË FAKULTETIN E STUDIMEVE ISLAME

REDAKTOR I "BULETIN"-it.



**ARTIKUJT**





# Filozofia e edukimit islam (Rasti i Kosovës)

Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani

## Abstrakt

Arsimi islam është një koncept universal, i cili është ndërtuar dhe portretizuar në procesin e mësimin që i referohet zhvillimit të çështjeve universale. Filozofia e edukimit duhet të reflektojë çështje të përgjithshme dhe integrale, shpirtërore dhe fizike, dhe gjithashtu çështje që kanë të bëjnë me botën tjetër. Përkufizimi i konceptit të edukimit duhet të shpjegohet nga perspektiva e natyrës së njeriut dhe rolit të tij në gjithësi, si dhe fatit të tij në përgjithësi. Prandaj, ky punim synon t'i sjellë disa koncepte filozofike që ndërlidhen me edukimin dhe synimet e edukimit në përgjithësi, duke ofruar shembuj të edukimit dhe arsimit islam në Kosovë. Më konkretisht rreth sistemit të edukimit islam në Kosovë, historisë, organizimin dhe të arriturave të tij gjatë shekujve.

**Fjalët kyçe:** edukimi islam, koncepte, filozofi, Kosovë, shpirtërore.

## Abstract

Islamic Education is a universal concept that is developed and portrayed into the learning process that refers to the development of the universal matters. Its philosophy should reflect the integrative universal worldly issues (physical and spiritual) as well as the issues referring to the hereafter. The conceptualization of the concept of education should be explained from the perspective of the nature of man and his role in the universe and his destiny. The method used in this research is quantitative method in the form of content analyses towards the works published in the field of Islamic education. Therefore, this paper aims at bringing some philosophical concepts related to education by bringing the examples of Islamic education in Kosovo. The Islamic education system in Kosovo, its history organization and achievement.

**Keywords:** Islamic education, concepts, philosophy, Kosovo, spirituality

## Hyrje

Koncepti dhe filozofia e edukimit ka filluar që nga kohët e hershme të civilizimit islam. Atëherë sistemi i edukimit ishte fetar, sipas natyrës që kërkimin e diturisë e kishte inkurajuar dhe konsideruar adhurim dhe përkushtim ndaj Zotit. Gjithsesi se ekzistojnë shume ajete në Kuranin e shenjtë, si dhe shumë thënie të Pejgamberit, a.s., që flasin për rëndësinë e kërkimit të diturisë. Suksesi në edukim është i lidhur ngushtë me zhvillimin e mënyrave dhe të mjeteve, si dhe me adaptimin e koncepteve dhe të paradigmave të reja. I njëjti rregull vlen edhe në edukimin islam gjatë adaptimit të paradigmave adekuate, duke u siguruar se janë në ujdi edhe me rregullat e përgjithshme islame. Kërkimi i metodave të reja asnjëherë nuk ndalet në edukimin islam, sepse kjo kërkohet që gjithmonë

të jetë në harmoni me zhvillimet e reja dhe bashkëkohore, të cilat edhe ndryshojnë dhe zhvillohen në vazhdimësi. Sigurisht se ekzistojnë lëmenj që kërkojnë ndryshim dhe hulumtim, për të qenë në gjendje që të ofrojnë përgjigje për nevojat dhe zhvillimet në shoqëri, dhe që këto risi të jenë në harmoni me mësimet islame.

Sipas asaj që u përmend më lart, ky punim synon diskutimin e koncepteve bazë të edukimit, si dhe domethënien, qëllimin dhe filozofinë e edukimit islam. Më tutje, punimi diskuton edhe historinë dhe zhvillimin e edukimit islam në Kosovë, deri në ditët e sotme, si dhe parashikimet për zhvillimin e tij më tutje.

## Koncepti dhe kuptimi i edukimit islam

Koncepti i edukimit dhe i arsimit si koncept dhe kuptim është diskutuar gjerësisht prej shumë studiuesve të vendeve dhe epokave të ndryshme, për shkak të rëndësisë që ka. Ky punim e ka të pamundur t'i përfshijë të gjithë në këtë hapësirë të ngushtë, mirëpo do t'i sjellë disa prej tyre. Sipas shpjegimit të profesor Syed Muhammad Naquib Al Attas,<sup>1</sup> është një proces që i ka tri elemente kryesore që e përbëjnë edukimin: procesi, përmbajtja dhe pranuesi. Njeriu është pranuesi i procesit dhe i përmbajtjes, prandaj që të dyja, procesi i mësimit dhe përmbajtja e mësimit, duhet të jenë në harmoni me mësimet islame.<sup>2</sup> Megjithatë, edukimi duhet të jetë i lidhur shumë ngushtë me edebin, (rregullin moral) karshi diturisë. Kjo pasi edebi konsiderohet elementi më i rëndësishëm në edukim, dhe i referohet të tre elementeve të përmendur më lart. Prandaj, prodhimi apo përgatitja e njeriut të mirë duhet patjetër të jetë qëllim kryesor

---

<sup>1</sup> Prof. Syed Muhammad Nequib Al Attas (nga Malajzia) është njeri prej hulumtuesve më me ndikim në lëmin e civilizimit dhe të edukimit, përveç fushave të tjera, sikurse, p.sh., shekullarizim dhe islamizimi i diturisë. Ai është themeluesi i institutit ISTAC (International Institute of Islamic Thought and Civilization) në Kuala Lumpur.

<sup>2</sup> Muhammad Ardinsyah and Didin Hafidhudin, "The Concept of Adab by Syed Muhammad Naquib al-Attas and its relevance to education in Indonesia", *Ibn Khaldun Journal of Social Sciences*, Vol. 1. No.1 2019, p. 55-56.

në procesin e edukimit. Një njeri i mirë cilësohet të jetë ai që i plotëson përgjegjësitë e tij në raport me Zotin e vet, njeri që e kupton dhe e synon drejtësinë në vetvete dhe te të tjerët në shoqëri, njeri që me sjelljet e tij në mënyrë të vazhdueshme e ushqen veten me ndjenjën e plotësimit me vlera morale dhe perfeksionim.<sup>3</sup>

Kuptimi dhe qëllimi i edukimit janë dy aspekte të ndërlidhura, me të cilat aspekte edhe janë marrë filozofët dhe shkollarët për një kohë të gjatë. E para, pozicionimi me orientim shoqëror në të cilin edukimi pranohet kryesisht si një mjet për të përgatitur qytetarë të mirë, pa marrë parasysh se a synohet nga shoqëritë demokratike, oligarkike apo monarkitë. E dyta, pozicionimi me orientim, kur personi është në qendër të vëmendjes; kjo kryesisht i ka për qëllim nevojat, kapacitetet dhe interesat e individit. Shkollimi i vazhdueshëm apo shkolla e transmetimit kulturor përfshihet në këtë kategori.<sup>4</sup>

Edukimi duhet t'i shërbejë qëllimit dhe natyrës së krijimit të njeriut, dhe kur njeriu, i shtyrë nga ky edukim, arrin ta kuptojë rolin e tij në shoqëri dhe të edukohet të jetë një qytetar i mirë, duke i kryer obligimet e veta ndaj Krijuesit dhe ndaj rrethit ku jeton, mund të konsiderohet se edukimi e ka arritur qëllimin e tij kryesor. Për të gjithë të zotët e mendjes është obligim të kërkohet dituri në emër të Krijuesit, duke e shpërndarë atë dituri te të tjerët.

## Filozofia e edukimit islam dhe sfidat e saj

Qëllimi dhe koncepti i zhvillimit duhet të bazohet në konceptin e edukimit islam, në të cilin koncept nuk ka ndarje ndërmjet shkencës dhe fesë. Ato duhet të jenë të ndërvarura në njëra-tjetrën duke ia shtuar edhe anën morale dhe racionale në zhvillimin e lidërshipt dhe të shkencës.

---

<sup>3</sup> Syed Muhammad Naquib al-Attas, *Islamic and Secularism* (Kuala Lumpur: International Institute of Islamic Thought and Civilization, 1993), p. 149-150.

<sup>4</sup> Wan Mohd Nor Wan Daud, *The Educational Philosophy and Practice of Syed Muhammad Naquib Al-Attas: An exposition of the Original Islamization*, (Kuala Lumpur, ISTAC: 1998), p. 121.

Zhvillimi është një angazhim i vazhdueshëm në koncept dhe aktivitet për ta themeluar modelin e edukimit, të shkencës dhe të vlerave shpirtërore të synuar si shoqëri dhe civilizim.

Për ta kuptuar më mirë historinë e edukimit dhe të institucioneve arsimore, patjetër duhet ta kuptojmë rëndësinë dhe historinë e edukimit islam në të kaluarën.<sup>5</sup> Që në ditët e hershme, kur Islami ishte duke u përhapur në mënyrë graduale, në të njëjtën mënyrë ishte përhapur edhe sistemi i edukimit. Ky sistem kishte filluar brenda xhamisë, e nga aty edhe në institucionet e tjera të edukimit që janë zhvilluar në atë kohë, siç ishin: *Mejtepi*, *Bejtul Hikmeh*, *Darul Ulum* etj. Këto institucione edukative, të cilat janë të njohura në shumë vende të botës, dhe në shumë vende ende janë në funksionim, në forma të ndryshme, ishin strukturë shumë e suksesshme e sistemit të edukimit. Përveç kësaj, edhe shkenca e mjekësisë dhe e astronomisë ishin zhvilluar mjaft shumë, dhe ishin ndërtuar spitale dhe përkujdesje të ndryshme qysh në atë kohë.

Me përhapjen dhe me shtrirjen e Islamit nëpër vende dhe rajone të ndryshme, dëshira për të kërkuar dituri çdoherë ka qenë e inkurajuar, dhe si rezultat numri i kërkuesve të diturisë ishte rritur gradualisht. Prandaj, studime të fokusuara në jurisprudencë dhe bazat e besimit u zhvilluan hovshëm, sa shpesh edhe në fillimin e disiplinave të reja shkencore. Shkencat e ndërlydhura me këto disiplina të reja nuk kanë mundur të mbahen në xhamia, për shkaqe praktike, sepse kanë kërkuar kushte dhe mjete të veçanta, si dhe kohë të veçantë për diskutime dhe debate në vendin dhe kohën kur është dashur të mbahen ritualet e adhurimit. Disiplinat e reja dhe kushtet që nevojiteshin për avancimin e këtyre disiplinave bënë që studimet në *halkah* (rrethet e studimit), që mbaheshin brenda xhamisë, të nisnin e të vendosen në vende të tjera afër xhamisë, e që më vonë u quajtën Medrese.<sup>6</sup> Me kalimin e kohës shkenca u zhvillua

---

<sup>5</sup> Mesut Idriz, 'Educational Traditions of Ijazah in Islamic History with Reference to the Persian Milieu', *Journal of Islamic Thought and Civilization (JITC)*, Vol.12 Issue 2 2022, p. 181

<sup>6</sup> Mesut Idriz, p. 182.

shumë më shumë, e edhe dëshira për dituri u zhvillua gjithashtu. Nevoja për të themeluar institucione të larta arsimore filloi të zërë vend në vende të ndryshme të botës. Prandaj, historia mund të dëshmojë se dëshira dhe motivi për dituri dhe kontribut në zhvillimin e institucioneve të arsimit shpiu në themelimin e universiteteve të para në nivel botëror, siç janë: Universiteti Marok, Egjipt dhe Tunis.

## Zhvillimi i edukimit islam në Kosovë

Me ardhjen e Perandorisë Osmane në Ballkan dhe me themelimin e administratës së tyre në shekullin e 14-të dhe të 15-të, popullsia e Kosovës e pranoi Islamit me shumicë. Ashtu siç edhe dihet nga historia, osmanët sollën me vete shumë parime të rëndësishme për organizimin e administratës dhe organizimin e jetës në përgjithësi, e që mendohet se ishin praktika dhe mësimet të popujve të lashtë persianë dhe arabë<sup>7</sup>. Nga gjërat e rëndësishme që ata i sollën në vendin tonë ishte edhe themelimi i shkollave të niveleve të ndryshme, *mejtepe* dhe *medrese*, të cilat ishin evidente shumë shpejt pas vendosjes së osmanëve në rajon. Në të vërtetë, gjurmët e para të institucioneve arsimore islame në Kosovë datojnë që nga koha kur popullsia shqiptare e pranoi Islamit dhe filloi të organizohej si një shoqëri me dimension të ri fetar, tani islam. Ky aktivitet fillimisht është bërë në xhami apo afër xhamisë, ashtu siç ishte rasti edhe me vendet e tjera. Për këtë arsye historia e zhvillimit të arsimit islam dhe e ndërtimit të qytetërimit është e lidhur ngushtë me ndërtimin xhamive në rajon.<sup>8</sup>

Historikisht xhamia ka luajtur një rol të rëndësishëm. Roli i saj është shumë më i gjerë sesa vetëm të shërbejë për lutje. Që nga fillimi, xhamia ka qenë një institucion bazë, që e ka koordinuar jetën fetare në të gjitha aspektet: aspektin kulturor, edukativ, politik dhe shoqëror, për gjithë ko-

---

<sup>7</sup> Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucionet studimore-shkencore dhe arsimore osmane*, në: Historia e Shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman, vëll. II, AIITC, Tiranë, 2009, p. 366.

<sup>8</sup> Sadik Mehmeti, "Shkollat e Mesme (Mektebet Rushdije) në Kosovë, me vështrim të veçantë Rushdija e Prizrenit dhe e Prishtinës", *TAKVIMI* 2021, p. 210

munitetin. Me kalimin e kohës afër xhamisë filluan të themelohen shkollat fillore, *mejtepet*, në numër mjaft të madh, sa gati secila xhami ka pasur një shkollë të këtij lloji afër vetes. Pas *mejtepeve*, si institucione klasike arsimore që e kanë dhënë një kontribute shumë të madh në arsim konsiderohen edhe medresetë, themelimi i tyre, që filloi të zërë vend si vazhdimësi e zhvillimit të arsimit. Ato e ofronin nivelin e edukimit që përgatiste nivel më të avancuar të dijetarëve, duke qenë në harmoni me kërkesat e vendit dhe të shoqërisë në çështjet shkencore dhe fetare të kohës. Këto medrese financoheshin nga institucionet e vakëfit, dhe për nga aspekti financiar ishin të pavarura nga shteti. Mirëpo, përkundër faktit të pavarësisë së tyre financiare, zyrtarët që kanë studiuar dhe punuar në këto shkolla (kadiu, myftiu, myderrizët dhe imamët), kanë pasur ndikim të madh në shoqëri. Për këtë arsye shteti e ka respektuar dhe vlerësuar rolin e medreseve dhe të strukturës së tyre organizative. Megjithatë, roli i këtij niveli të shkollave ka qenë zhvillimi apo përgatitja e besimtarëve të arsimuar dhe të ditur, që të jenë në gjendje për ta mbrojtur besimin e tyre dhe që t'u bëjnë ballë sfidave të kohës në të cilën kanë jetuar.<sup>9</sup>

## Medresetë e para

Bazuar në *vakifnamet* dhe burimet e tjera të publikuara dhe të qasshme për këtë studim, mund të dëshmohet se medresetë e para në tokat shqiptare janë themeluar në shekullin 15. Medreseja e parë është themeluar në vitin 1411, në Shkup, medreseja Is'hak Beu. Medreseja e parë e themeluar në territorin e Kosovës së tanishme ishte medreseja Gazi Ali Beu, në vitin 1444, në qytetin e Vushtrrisë, e pastaj janë themeluar edhe medresetë në qytetin e Pejës, në vitin 1516, në Prizren, në vitin 1537, dhe kjo ka vazhduar me radhë edhe në qytet e tjera, në mënyrë graduale. Sipas udhëpërshkruesit të famshëm Evlija Çelebiu, në shekullin 18-të, kur e ka bërë përshkrimin e territorit të Kosovës, në shkrimet e tij ai ka

---

<sup>9</sup> Ibid.



përmendur se në secilin qytet ka pasur të paktën një medrese, mirëpo ka pasur qytete që kanë pasur edhe më shumë se një të tillë<sup>10</sup>.

### a. Lëndët mësimore të ofruara në medrese

Programi i mëimit dhe lëndët që janë ligjruar në medrese kanë qenë të planifikuara mirë dhe të dizajnuara për t'i shërbyer qëllimit të themelimit.

Nga kriteret që janë kërkuar për t'u kualifikuar për regjistrim në Medrese, si kusht ka qenë që nxënësit apo studentët ta kenë të mbaruar shkollën fillore. Studentët e suksesshëm, që kanë arritur ta mbarojnë nivelin e medresesë, janë pajisur me *ixhazet* apo *ixhazetname*, me certifikatë, e cila ka konfirmuar se studenti në fjalë e ka mbaruar shkollimin. Me këtë certifikatë i diplomuari është konsideruar kompetent dhe i certifikuar për t'i mësuar të tjerët. Sigurisht se ka pasur më shumë se një lloj të *ixhazetit*, duke filluar nga lloji i tyre i përgjithshëm (ixhaza amme) deri tek ato specifike apo të veçanta (ixhaza hassa), për shembull, certifikatë për ta mësuar leximin e Kuranit, lëndën e Akaidit, Hadithit, Fizikës, Medicinën etj.<sup>11</sup>

Termi *ixhazeh* në Pedagogji ka pasur për qëllim “licencim për t'i mësuar të tjerët”, apo “autorizim për transmetim”, dhe më saktësisht i referohet certifikatës të lëshuar prej një profesori apo institucioni të lartë mësimor. Një student i caktuar, pasi t'i ketë ndjekur ligjëratat e caktuara në fusha dhe lëmi të caktuara, si dhe t'i ketë plotësuar kriteret e profesorit të asaj shkence, pajiset me certifikatë, e që e kualifikon për ta ligjruar të njëjtën shkencë te studentët e tjerë.<sup>12</sup>

Zakonisht, në traditën e *ixhazetit*, në kohën kur studenti i ka plotësuar kriteret dhe pritët të pajiset me certifikatë, në certifikatën e tij është shkruar gjerësisht për karakteristikat e tij si student. Përveçqë është

---

<sup>10</sup> Ibid.

<sup>11</sup> Sadik Mehmeti, “Mektebi i Tahir Llukës – Vatër e kultivimit të dashurisë për gjuhën shqipe”, *TAKVIMI* 2023, p. 179.

<sup>12</sup> Idriz, 182.

shkruar për notat, e që e tregojnë suksesin në mësimnxënie apo kapacitetin intelektual, aty është shkruar edhe për vlerat morale, fetare dhe aspektin shoqëror të studentit. Me një fjalë, certifikata ka dëshmuar edhe për aspektin njerëzor dhe fetar, përveç aspektit intelektual të studentit.

*Myderrizët* apo profesorët që kanë qenë mësimdhënës në këto medrese, kanë qenë të pajisur me dituri të fushave të ndryshme, duke qenë specialistë të fushave të veçanta. Lëndët që janë ligjëruar në medresetë e Kosovës ishin të njëjta me lëndët e ofruara në medresetë e nivelit të njëjtë përbrenda kufijve të Perandorisë Osmane.<sup>13</sup>

## b. Sistemi vakëfnor i funksionimit të medreseve

Medresetë e Kosovës janë ndërtuar në baza vullnetare, si institucione të vakëfit, nga populli i Kosovës, të cilët ishin të motivuar nga ana shpirtërore. Një shembull i këtij lloji është edhe “Medreseja Alauddin” e Prishtinës, e cila e mban emrin e personit që e dhuroi tokën e tij për ta ndërtuar xhaminë dhe “Medresenë Alauddin”. Për ta siguruar vazhdimësinë dhe mirëqenien e këtyre shkollave, si dhe funksionin e synuar në shërbim të popullit, besimtarët kanë dhuruar edhe institucione ekonomike e financiare, në emër të këtyre shkollave, sikurse, për shembull: toka, dyqane, mullinj dhe të ngjashme, në mënyrë që të krijojnë të hyra, dhe ato të hyra të jenë të destinuara për mirëmbajtje e medreseve. Fondet që kanë ardhur nga këto vakëfe janë përdorur sipas porosisë së vakëflënësit, sikurse, për shembull: mirëmbajtja e shkollës, ushqim dhe qëndrim për studentet, si dhe disa duke u siguruar edhe bursa për studime.

Tani në Kosovë medresetë janë pjesërisht të financuara nga shteti, dhe pjesërisht nga Bashkësia Islame e Kosovës, dhe numri i tyre si shkollla të mesme të larta ka arritur në 6 sosh, të shpërndara në tre qytete. Nga dy në Prishtinë, në Prizren dhe në Gjiilan. Gjithashtu, në kuadër të institucioneve arsimore të kësaj natyre, që i takon arsimit të lartë në studime islame, është edhe Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, që

---

<sup>13</sup> Mehmeti, 2023, p. 180.

nga viti 1992, i cili ofron studime të nivelit bachelor dhe master, dhe tani, në vitin e fundit ka filluar bashkëpunimin me universitete të tjera, dhe ka filluar të ofrojë edhe studime të doktoratës, si program të përbashkët me universitetet jashtë vendit. Krahas këtyre institucioneve akademike, Bashkësia Islame e Kosovës ka nën ombrellën e vet edhe tri shkolla të hivzit (mësimi përmendsh të Kuranit), e që janë aktive në tre qytet të vendit.

Përderisa në Kosovë mungon lënda fetare në shkollat publike dhe universitetet publike, nevoja për të shtuar edhe më shumë degë apo shkolla të llojit të medreseve është në rritje, për ta plotësuar zbrazëtinë për mësim dhe vetëdijesim fetar në Kosovë. Medreseja njihet si një shkollë e mesme e lartë nga shteti, gjë që ua mundëson të diplomuarve në medrese për të studiuar në universitete të ndryshme dhe fusha të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, dhe kjo është një përparësi e madhe për ta mbaruar shkollimin e lartë në medresetë e vendit, dhe të diplomuarit të pajisen me dituri fetare dhe kombëtare, e pastaj të vazhdojnë në profesione të ndryshme.

## Përfundim

Në përfundim të këtij hulumtimi mund të theksojmë se filozofia dhe kuptimi i edukimit islam ka për qëllim edukimin, udhëzimin dhe përparimin në drejtim të moralit dhe formim të qenies njerëzore, si dhe të shoqërisë në përgjithësi. Gjithashtu, do të thotë zhvillim në të gjitha aspektet e jetës njerëzore dhe të shoqërisë, shkencërisht dhe shpirtërisht, dhe ofrim të njerëzve më afër udhëzimit të Zotit të Madhërishëm.

Roli më i rëndësishëm dhe bazik i edukimit islam është që njerëzit ta kuptojnë rëndësinë e unifikimit të aspektit fizik, intelektual dhe shpirtëror të një individi brenda shoqërisë. Në rastin e edukimit islam në Kosovë, mund të konstatojmë se medresetë e kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në edukimin e shoqërisë, si dhe kanë qenë pjesë e pandashme e jetës publike. Në strukturë, medresetë kanë qenë pjesë e sistemit të vakëfit, e financiarisht kanë qenë të pavarura në funksionimin e tyre nga

shteti, megjithëse kanë pasur bashkëpunim dhe mbikëqyrje nga shteti, në ofrimin e licencimit dhe të ngjashme. Dhe, kështu kanë vazhduar të funksionojnë për shumë shekuj, dhe ende po vazhdojnë të funksionojnë po në atë mënyrë.

Megjithatë, institucionet edukative islame në Kosove kanë nevojë të zhvillohen në vazhdimësi, për të qenë në gjendje të ofrojnë përgjigje për nevojat e shoqërisë. Gjithashtu ka nevojë për zhvillim apo themelim të fushave të reja të studimeve dhe të specializimeve të reja brenda institucioneve të arsimit të lartë ekzistues, apo edhe themelim të institucioneve të reja. Kjo do të ndihmonte në përgatitjen e burimeve njerëzore: staf administrativ, profesorë dhe imamë për nevojat e Bashkësisë Islame etj. Dhe, kjo do të ndodhte brenda vendit, në gjuhën amtare, në kulturën e vendit, duke e ruajtur traditën dhe logjikën e vendit, si dhe realitetin ku jetojmë.

Për shkak se studimet fetare janë shumë të veçanta, dhe brenda vetes e përmbajnë edhe anën e traditës së popullit, duke e konsideruar pjesë të legjislacionit islam, është shumë e rëndësishme që këto të jetësohen në vend, duke e kuptuar realitetin dhe specifikat e vendit ku jetojmë, mentalitetin e popullit, sistemin ligjorë e politik, si dhe ambientin se ku do të ofrohen shërbimet.



# Arti i shkencës drejtuese (orientuese) mbi leximet kuranore

Përkufizimi, emrat, termat, burimet lidhja me shkencat islame

Dr. Hfz. Safet Hoxha

## Abstrakt

Çështja e shkencës së drejtimit të leximeve kuranore është një nga studimet më të rëndësishme shkencore që ka zënë vend në mendjet e studiuesve të këtij arti, pasi është një shkencë që na orienton, në format e leximeve për nga gjuha, kuptimi, argumentimi dhe arsyet e tjera bazë. Pra, është një shkencë që kërkon hulumtime nga aspektet fonetike, morfologjike, retorike dhe semantike. Studiuesve të hershëm dhe atyre bashkëkohorë u interesuan për të, prandaj edhe kanë shkruar dhe shkruajnë vepra dhe trajtesa të ndryshme. Qëllimi i këtij hulumtimi është sqarimi i koncepteve, terminologjisë, veprave të shkencës së drejtimit të leximeve, roli i saj në sqarimin e kuptimeve të leximeve të ndryshme, si dhe lidhja e saj me shkencat e tjera. Duke prekur aspektet e mundshme në të cilat ndodh lloji i leximit kuranor në vendet e tij në një ajet, qofshin këto forma të transmetimeve apo të natyrave të tjera, kjo ka qenë edhe pika e interesimit të dijetarëve për këtë art, të cilët edhe e kanë sqaruar konceptin, i emërtuan emrat e saj dhe e kategorizuan lëndën dhe studimet në të.

Dhe, sot u bë shkencë e pavarur, për hir të vlerës që ka dhe përpjekjeve të dijetarëve për ta zgjeruar fushën e përfshirjes të saj në disa shkenca.

**Fjalët kyçe:** Tevxhah, el ihtixhaxh, el ihtijar, lexim kuranor, retorike.

## ABSTRACT

The issue of the science of guiding Quranic readings is one of the most important scientific studies that has taken place in the minds of researchers of this art, as it is a science that guides us, in the forms of readings in terms of language, meaning, argumentation and other basic reasons. So, it's a science that requires research from phonetic, morphological, rhetorical and semantic aspects. Early and contemporary scholars were interested in it, so they have written various works. The purpose of this research is to clarify concepts, terminology, works of the science of reading direction, it's role in the clarification of meanings of different readings, as well as it's connection with other sciences. Touching possible aspects in which the type of Quranic reading occurs in its places in a verse, be it these forms of transmissions or of other natures, has been the point of interest of scholars for this art, who clarified the concept, named it, and categorized the subject and the studies within it. And today, it became an independent science, for the sake of the value it has and the efforts that the scholars made, in order to expand the field of its inclusion in some sciences.

**Key words:** Tawdjih, al ihtijajh, al ihtiyar, Quranic reading, rhetoric.

## Hyrje

Një nga shkencat më të rëndësishme të leximit, është shkenca e drejtimit të leximeve, e cila e shfaq dhe e zbulon artin e strukturës gjuhësore nga aspektet e shumëllojshmërisë së leximeve të Kuranit dhe përputhshmërisë me rregullat e gramatikës arabe.

Rëndësia e temës dhe arsytet për ta hulumtuar janë sikurse në vijim:

- Lidhja e saj me Librin e Zotit të Madhëruar.
- Ajo i përfshin lloje të ndryshme shkencash, sikurse Tefsiri (interpretimi), Fikhu (jurisprudenca) dhe gramatika arabe etj.

Koncepti i drejtimit të leximeve është një manual që sillet rreth sqarimit të formës së leximit, duke prekur aspektet përmes të cilave jepen informacione themelore dhe të hollësishme për një temë të caktuar, dhe gjithashtu një shpjegim i rregullt se si të jepet kjo njohuri e kuptimeve në të cilat ndodh variacioni kuranor nëpër ajete.

## Si është përkufizuar kjo shkencë?

Kuptimi gjuhësor: Rrënja e fjalës v, xh, h, vjen me dy kuptime:

1. Një anë e gjësë d.m.th.: e ka lënë atë në një anë, siç ka ardhur në ajete: **أَيْنَمَا يُوجِّهُهُ لَا يَأْتِ بِخَيْرٍ** “...kudo që ai e drejton, ajo nuk ia sjell ndonjë të mirë”<sup>1</sup>.
2. Drejton, orienton gjënë d.m.th., sqarimi i drejtimit të tij, ose bërjes së tij me imazh, çdo argument, fakt dhe provë, dhe ata thonë: Për fjalët tuaja: “Kanë peshë, janë të vlefshme”<sup>2</sup>. Ky sqarim më shumë vlen për gjuhen arabe, dhe ne nuk po zgjerohemi më tepër.

<sup>1</sup> En-Nahl, 76.

<sup>2</sup> Lisan El Arab, Xhemal Ed Din Ebu El Fadl bin Mansur, vëll. XIII, f. 555. Dar El Athar El Arabijetu Bejrut, Liban, botimi i dytë, 1411 hixhrij



## Përkufizimi i shkencës së drejtimit të leximeve nga aspekti terminologjik

Koncepti i drejtimit të leximeve sillet rreth sqarimit të formës së transmetuar të leximit, ose duke prekur aspektet e mundshme në të cilat ndodh variacioni kuranor në vendet e tij, nëse këto forma ishin transmetime ose mendime për t'i dhënë shpjegimet e duhura rreth atij ndryshimi në lexim.

Për shkencën e drejtimit të leximeve në aspektin terminologjik kemi disa përkufizime, si:

- *“Kuptohet madhështia dhe lavdia e kuptimeve kuranore”<sup>3</sup>.*
- *“Shpjegimi i formës së leximit në aspektin gjuhësor dhe kuptimor”<sup>4</sup>.*
- *“Mjetet me të cilat zbulohen kuptimet, argumentet dhe arsyet e leximeve me prova mbështetëse”<sup>5</sup>.*
- *“Art madhështor përmes të cilit njihen kuptimet, Imamët (e kiraeteve), që u kujdesën për të dhe u veçuan me studime”<sup>6</sup>.*
- *“Kërkohen kuptimet e leximeve dhe zbulimi i formave të tyre”<sup>7</sup>.*
- *“Metodë me të cilën zbulohen kuptimet, argumentet dhe arsyet e leximeve, me prova mbështetëse”<sup>8</sup>.*
- *“Shkencë në të cilën kërkohet forma e çdo leximi dhe arsyet për të, me shpjegimin e kuptimit të tij dhe gjuhën e tij”<sup>9</sup>.*

<sup>3</sup> El Muvedah fi Vuxhuh el Kiraat ve Ileliha” - prej Nasir bin Ali El Farsin, i njohur si Ibën Ebi Merjem (vd. 565 Heixhrij afërsish) v.1, f. 64.

<sup>4</sup> Mevsuati El Kuraniyeti El Mutehasiseti, Mexhmua minel El esatidheti vel ulemai.v III, f. 337. Mevsuati El Kuraniyeti El, Egjipt, 1972.

<sup>5</sup> Fenu tevxihih El kiraat, Fejaz Muhamed el Harazi, f. 3 Darul Fikr, Bejrut, 1980.

<sup>6</sup> El kiraat ve etheruha fi tefsir vel ehkam”, Hassan Salem Habshan, Mektebetul Ilmije, Bejrut, 1981, f. 115.

<sup>7</sup> Mevsuati El Kuraniyeti el mutehasiseti, Mexhmua minel El esatidheti vel ulemai, v III, f. 338.

<sup>8</sup> El Keshf an kiraat s-seb’a ve ileliha ve huxhexhiha, Ebu Muhamed Mekij bin Ebi Talib El Kajsi, v. I, Muesesetu risaleti, Bejrut, 1977, f. 3.

<sup>9</sup> El kiraat ve etheruha fi tefsir vel ehkam, Muhamed bin Omer Bazmul, v. I, Bejrut, 1987, f. 308.

- “Hulumtim mbi leximet nga aspekti fonetik dhe morfologjik i tyre, njohuri retorike, semantike”<sup>10</sup> etj.

*Imamët e kiraeteve i kushtuan rëndësi të madhe, dhe për atë u veçuan në interesimin e tyre në gjetjen e kuptimeve të leximeve, duke zbuluar format e tyre, përmes mënyrave nga të cilat zbulohen kuptimet, argumentet dhe arsyet e leximeve me prova mbështetëse.*

Në dritën e këtyre përkufizimeve, mund të themi se drejtimi i leximeve është një shkencë që e bën shpjegimin e leximeve në aspektin e gjuhës, sintaksës, kuptimit dhe anëve të tjera të tij.

Qëllimi i drejtimit është t’i shpjegojë aspektet e ndryshme të leximeve kuranore, si dhe ta njohë bazën e tyre, atë që lidhet me plotësimin e kushteve të pranimit të leximeve, sikurse: ai i mutevatirrit, i resmit uthmanij dhe i gjuhës arabe, qoftë edhe pjesërisht.

Nga kjo bëhet e ditur se leximet kuranore janë një nga llojet e mrekullive të Kuranit, pasi çdo lexim është si një ajet, dhe shumësia e leximeve e zë vendin e shumë ajeteve. D.m.th., nëse në një ajet janë dy lexime të ndryshme ato janë sikur dy ajete, dhe pavarësisht numrit të tyre, nuk çojnë në kontradiktë dhe kundërthënieje. Kjo dëshmon bindshëm se Kurani është fjala e Zotit të Madhërishëm, dhe po ashtu dëshmon për sinqeritetin e të Dërguari të Zotit – Muhamedit, a.s., i cili e solli atë.

## Emrat e shkencës së drejtimit (orientimit) të leximeve

Dijetarët e shtjelluan këtë shkencë të ndritur, dhe e përkufizuan me shumë emra, nga të cilët:

1. التوجيه drejtues, është emërtimi më i dalluar. Ndër veprat e shkruara me këtë emërtim janë: “El Xhemu ve Tevxhihu lima Inferede Imam Jakub”, prej Shuraih bin Muhamed El Rainit (t 539 hixhrij), redaktuar prej Dr. Ganem Kadduri El Hamad; “El Kiraat Esh Shadhetu ve Tevxhihuha fi Lugatil Arab”, prej Abdel Fah El Kadi (v. 1403 hixhrij); Talaia El Beshher fil Kiraat El Ashr”, prej Shejh Mu-

<sup>10</sup> Kitabi Tearif, El Manevij, v.1, Darul Kutub El Ilmijeti, Bejrut, 2002, f. 170.

hamed Sadik Kamhavi... “El Mugni fi Tarixh El Kiraat El Mitevatire”, prej Dr. Muhamed Muhamed Salem Muhajsin (v. 1422 hixhrij)<sup>11</sup>.

2. **حجج القراءة** (argumentimi, ose **حجة القراءة** mbështetja e leximeve). Kjo është një nga termat e përhapur dhe më të përdorura. Në kuadrin e studimeve gjuhësore, sikurse, për shembull:: “El Huxhetu li Ibni El Halavijehi”. “EL Huxhetu lil Kurrai Es Sebaati”, prej Ebi Ali El Hassan bin Abdul Gaffar El Farisi (v. 366 hixhrij)<sup>12</sup>.
3. **وجوه القراءة** (Mënyrat e leximeve). Ndër veprat më të njohura me këtë kuptim janë: “El Muhtesib fi tebjin shuvadhil el kiraa at vel idah anha”, prej Ebu El Feth Othman bin Xhinni (v. 312 hixhrij). Dhe “El Keshf an vuxhuh el Kiraat e sebatu”, prej Ebi Muhamed Makki bin Ebi Talib El Kaisi<sup>13</sup>.
4. **معاني القراءة** (Kuptimi i leximeve). “El Ibana 'an Ma'ani El Kiraat”, prej Mekki Bin Ebi Talib Hamush El Kaisi (vdiq më 436 hixhrij). Dhe: “El Ibanetu an meani El Kiraat”, prej Muhamed bin Ahmed Ebi Mensur (vdiq më 370 hixhrij).
5. **إعراب القراءة** – Analiza e leximeve. Ndër librat më të njohur në këtë fushë janë: “Ierab el Kiraat e-shevadhu”, prej Ebu El Baka' El Akberi (v. 616 hixhrij). Abdullah El Hussein bin Ahmed bin Halavih El Hamadhani El Nahvi (v. 364 hixhrij).
6. **نكات القراءة** – Të adresuarit e leximeve (Nofkat e leximeve). Ndër librat më të njohur mbi këtë emërim janë: “Nuket el meani ala ajati el methani” Ali Bin El Hassan El Majashi (v. 461 hixhrij) “El Keshf an Nukat el meani ve irab ve ilel El Kiraat”, prej Ebu El Hasan Ali Bin El Hussein –Bakuli (T 543 hixhrij; vdiq në Bagdad).

<sup>11</sup> Tibetu En Neshr fi'l-Kiraati'l-Ashr, Mektebetu ibni El Xhezeri, Damask, 2002, f. 2.

<sup>12</sup> Gajetu Nihajeti, Ibni'l-Xhezeri.v.1 f. 206, Bejrut, 1997.

<sup>13</sup> Illel el kiraat, Ebi Mensur Muhamed bin Ahmed el Ez'herij, Ebi Darul Kalem, Bejrut, 1982.

7. الانتصار للقراءات . (Triumfi i leximeve) me këtë emërim u shkruan: “El Intisar lil Kurani” prej Muhamed ibn al-Tajib. Ebu Bekr El Bakalani (v. 442 hixhrij), dhe “Kiraat lil Imam Ibën Amir vel intisar leha”. Profesor Dr. Sami Abdel Fattah Hilal.
8. تعلييل القراءات Shpjegimi i leximeve. Ndër librat më të njohur në këtë fushë janë: “El Kiraat ve ilelel nahvijjne fiha” prej Ebu Mansur Muhamed bin Ahmed El Azhari (vd. t 370 hixhrij), redaktuar prej Dr. Naval El Hilveh, dhe “Talil lil Kiraat Es Shadhetu”, prej Ebi Al Baka El Akbari(v. 717 hixhrij)<sup>14</sup>.
9. تخریج القراءات – Përcjellja e leximeve. Përfshinë: “El Mustenir fi Tahrixh el Kiraat el Mutevatire” prej Dr. Muhamed Salem Muhajsin (v. 1422 hixhrij) Dhe “Tahrixh el Kiraat Fethu el kadir”, prej Dr. Ihab Fikri<sup>15</sup>.

## Shfaqja e shkencës së drejtimit të leximeve

Ky art filloi në formën e vëzhgimeve paraprake të transmetuara prej disa sahabëve, tabiinjeve, dhe kurrave, e që janë të ashtuquajturat përmbledhje individuale të disa mus’hafeve. Në këto përmbledhje gjendeshin sqarime individuale e specifike që e interpretonin një lexim mbi një thetër, për shkak të ngjashmërisë midis tyre, qoftë në shqiptim, që ishte i ndryshëm në lexim, ose disa analiza dhe interpretime të tjera. Për Umer bin El Hatabin (V: 23 hixhrij) transmetohet se e lexoi: “Harexhen” ﴿حَرَ جَا﴾ me zanoren E, ndërsa disa sahabë e kanë lexuar me zanore I. Në ajetin ku i Lartësuari thotë:

وَمَنْ يُرِدْ أَنْ يُضِلَّهُ يَجْعَلْ صَدْرَهُ ضَيِّقًا حَرَجًا كَأْتَمَّا يَصْعَدُ فِي السَّمَاءِ

“...ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje (ia mbyll zemrën) i shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngritur në qiell...”<sup>16</sup>

<sup>14</sup> El Mustenir fi tahrixh el kiraat el mutevatire, Dr. Muhamed Muhamed Salem Muhajsin Shtëpia e Ringjalljes së Trashëgimisë Arabe, Bejrut, Liban.

<sup>15</sup> “El Huxhetu fi El Kiraat Es Seba”, që i atribohet Ibn Halevejh (vdiç 370 HIXHRIJ) Redaktuar nga Dr. Abdel Aal Salem Makram. Darul Kalem.Bejrut, 1997.

<sup>16</sup> El En’am, 125.

Atëherë ai kërkoi që t'ia sillnin një person nga fisi Kenan, dhe ai të jetë nga Benu Mudij, për ta pyetur për këtë dallim. Kur erdhi tek Omeri, r.a., i tha: “Djalosh, më trego se çka është (El Harexhetu) te ju!”. Ai i tha: “Ajo te ne është lis mes lisave, tek i cili nuk arrijnë as barinjte, as kafshët, dhe as askush tjetër.”. Omeri, r.a., i tha: “Kështu është zemra e dyfytreshit, tek ajo nuk arrin asnjë e mirë.”<sup>17</sup>.

Pastaj, prej Ibën Abasit - Allahu qoftë i kënaqur me të - (v. 68 hixhrij), është transmetuar se ai e lexoi: **Nunshiruha** (نُنشِرُهَا) “i ringjallim ato”: (në vend të **Nunshizuha**” i tubojmë ato <sup>18</sup>نُنشِرُهَا), në ajetin:

وَأَنْظُرْ إِلَى الْعِظَامِ كَيْفَ نُنشِرُهَا ثُمَّ نَكْسُوها حَمًا

“...dhe shikoj shtrirat se si i tubojmë, e pastaj i veshim me mish!”<sup>19</sup>, si në suren Abse (إِذَا شَاءَ أَنْشَرَهُ) ensherah), dhe mandej kur të dojë Ai i ringjall”<sup>20</sup>.

Po ashtu, prej Ibën Abasit është transmetuar gjithashtu në ajetin:

حَتَّى إِذَا اسْتَيْسَرَ الرُّسُلُ وَظَنُّوا أَنَّهُمْ قَدْ كُذِّبُوا

Pa dyfishim të dha-unit.

**“të dërguarit menduan se do të shpallen gënjeshtarë për atë që premtuan. Kështu ata u dobësuan dhe menduan se kishin dështuar”**<sup>21</sup> me dyfishim قَدْ كُذِّبُوا të dha-unit e ka kuptimin: “...menduan se kanë gënjyer në atë që premtuan...”.

Arsyeja e parë për themelimin e kësaj shkence dhe përkujdesjen ndaj saj ishte interpretimi i Kuranit dhe zbulimi i sekreteve të tij gjuhësore. Më pas, pasi u rregulluan rregullat gramatikore dhe morfologjike, disa gjuhëtarë filluan t'i gjykojnë leximet sipas atyre rregullave, dhe kështu u paraqit nevoja e studiueseve të Kuranit, për ta mbrojtur atë dhe për ta

<sup>17</sup> Es Sbatu fil kiraat, Ebi Beker Ahmed Musa ibi Muxhahid, f. 268 botimi dytë, Kajro 1400h.

<sup>18</sup> El-Bekare, nga ajeti i 259-të.

<sup>19</sup> El-Bekare, nga ajeti i 259-të.

<sup>20</sup> Abese, 22.

<sup>21</sup> Jusuf, 110.

sqaruar rëndësinë e leximeve nga ana gjuhësore, dhe këto ishin nga arsyet më kryesore.

Një çështje që duhet të vihet re dhe të paralajmërohet është se drejtimi e pason konfirmimin e leximit dhe është një degë e tij, dhe në përputhje me rrethanat, detyra e drejtimit është t'i gjejë interpretimet gjuhësore të leximeve autentike pasi ato të jenë vërtetuar dhe, bazuar në këtë, disa drejtime (sqarime të leximeve) ndonjëherë mund të jenë diskrecionale ose jo bindëse, të ndikuara nga ai lexim apo ky lexim, dhe assesi nuk e ulin besueshmërinë dhe pranimin e tij si lexim.

Shkenca e “drejtueseve të leximeve” dëshmoi një kërcim cilësor në shekullin e katërt hixhrij. Kjo sepse përpjekjet e studiuesve, shkrimet e të cilëve dolën dhe u përhapën me të madhe, siç ishin dy dijetarët e mëdhenj, Imam Ibën Xherir Et Tabari (vdiq: 310 hixhrij), i cili konsiderohej si njëri prej ekzegetëve të parë që i ndoqi leximet kuranore si drejtime – udhëzime, dhe kjo është përmes interpretimit të tij në “Xhami El Bejan”, ku ai, Allahu e mëshiroftë, i përmendi dallimet e leximeve dhe i bëri sqarimet në aspektin e drejtimit të tyre, dhe pas tij vjen Ibën Muxhahidi (vdiq: 324 hixhrij), i cili i zgjodhi shtatë lexime për shtatë prej lexuesve të famshëm të provincave të ndryshme, të përfshirë në librin e tij “Es Sebatu fil Kiraat”, sipas të cilit shkrimet u përhapën në drejtimin e leximeve dhe argumentimin për to. “El Huxhetu”, prej Ibën Halavejhi (vdiq: 370 hixhrij) dhe “El Huxhetu”, prej Ebi Ali El Farisit (vdiq: 377 hixhrij), “El Muhtasib”, prej Ibën Xhinniut (vdiq: 392 hixhrij) dhe “El Keshf”, prej Meki Ibën Ebi Talib El Kajsit (T. 437 hixhrij), si dhe “Sherh El Hedaja”, prej “El Mahdevi” (T. 440 hixhrij), po edhe të tjerë, e nxorën artin e drejtimit në skenë, si dhe e pavarësuan atë si lëndë më vete.

## Ndryshimi midis shkencës së drejtimit dhe shkencës së leximit (kiraeteve)

Shkenca e drejtimit të leximeve ishte një formë interpretimi dhe verifikimi për leximet deri në përafrimin e kuptimeve të fjalëve të saj, dhe si e tillë kjo shkencë është një shpjegim se si të shqiptohen dhe të artiku-

lohen fjalët e Kuranit mbi ndryshueshërinë e tyre, siç janë transmetuar me gjuhën e pastër arabe, dhe studiuesit e kanë sqaruar këtë dallim mes dy shkencave. Prej dijetarëve kishte edhe të atillë që dallimin mes tyre e sqaronin me titullin “Drejtimit e Leximeve (Tevxhihul Kiraati)”; ata e bënë temën e shkencës së drejtimit lëndë të të kuptuarit dhe të dijës, dhe e bënë temën e shkencës së leximeve temë të dëgjimit, bartjes dhe transmetimit, dhe meqë transmetimi është kryesisht në shkencat e Sheriatit, ata e bënë të parën degë, e të dytën origjinë.

Kiraetet janë leximi i Kuranit në disa mënyra – origjinale, të cilat u transmetuan dhe u lexuan ashtu, ndërsa shkenca e drejtimit, si degë e saj, është një interpretim që u quajt shkencë e drejtimit të leximeve, d.m.th. çdo interpretim i këtyre aspekteve të leximeve i takonte kësaj shkence.

Drejtimi i leximeve ndryshon sipas shumëllojshmërisë së vetë leximeve - sipas asaj që u paraqit në shkenca të ndryshme, i duke përfshirë udhëzimet në: sintaksën *توجيه بالنحو*, morfologjinë *توجيه بالصرف*, retorikën *توجيه بالبلاغة*, orientimin në dialekte të ndryshme arabe, semantikën *توجيه بتعدد المعاني*, udhëzimet në jurisprudencën islame *توجيه بالفقه* dhe udhëzimet për interpretim *توجيه بالتفسير*.

## Dallimi midis drejtimit të leximeve dhe dhënies së përparësisë disave ndaj të tjerave

Dihet se leximet ndahen në dy pjesë kryesore: Leximet *mutevatire*, që janë dhjetë leximet<sup>22</sup>, dhe leximet *shadhe*, të cilat janë katër të tjera. Sa i përket krahasimit ndërmjet leximeve *mutevatire* dhe *shadhe*, njëri është i gabuar, sidomos pasi leximet *mutevatire* janë të besueshme dhe dallohen nga leximet e tjerat sepse të gjitha janë të ardhura prej Pejgamberit, a.s., kështu që, ata që bëjnë dallime mes tyre, gabojnë. Dallimi i lexuesve

<sup>22</sup> Sipas disa dijetarëve, sepse shumica i pranojnë vetëm shtatë lexime *mutevatire*, e tri të tjerat si *ahade*.

është absolutisht i formave të shpallura të leximeve, si ai i ndonjë prej sahabëve që e ka përzgjedhur leximin mbi lexim.

Sipas Ibën Haxher El Hajtemit, të cilin e citon Nurudin Atir, në librin “Et Terxhih bejne El Kiraat ahkamuhu ve Mevkif El Mufesirine” thotë: “Ndër gjërat që studiuesi duhet të udhëzohet në drejtimin e leximeve është që ta drejtojë secilin lexim pa u ekspozuar ndaj dobësimit të një leximi ndaj tjetrit.”<sup>23</sup>

## Librat më të shquara në këtë shkencë, e që shërbejnë si burime të saj

Librat më të shquara në këtë shkencë, e që shërbejnë si burime të saj, janë:

1. “El Kiraat ve Ilelel Nahvijine Fiha”, prej Ebu Mensur Muhamed bin Ahmed El Az’hari (v. 370 hixhrij), redaktuar prej Dr. Naval El Hilveh.
2. “Iërab El Kiraat Es Seba ve Ileliha”, prej Ibën Halevejh (v. 370 v.), redaktuar prej Dr. Abdul Rahman El Uhejmin.
3. “El Huxhetu lil Kurra Es sabeati eimeti el'emsar bil Hixhaz vel Irak ve Shami eledhine dhekerehu ibn Muxhahid”, të cilin Ibn Muxhahidi ia përmend Ebu Aliu prej Hassan bin Abdul Gaffar El Farisi (v. 377 hixhrij).
4. “Huxhetul El Kiraat”, prej Ebu Zara'a Abd al-Rahman ibn Muhamed ibn Zanjla (në shekullin e katër hixhrij), reduktuar prej Shejh Seid El Afgani.
5. “El Keshf an Vuxhuh El Kiraat Es Seba’ ve ileliha ve huxhexhiha”, prej Makki Bin Ebi Ali bin El Kaijsi (v. 437 hixhrij) Redaktuar prej Dr. Muhjiddin Ramadan.

---

<sup>23</sup> Et Terxhih El Kiraat ahkamuhu ve Mevkif El Mufesirine, Nurudin Atir, Darul Kalem, Bejrut, 1988, f. 7.



6. "Sherhu el Hidaje fi el Kiraat e-Sebati "Ebu El Abbas El Mahdevi Ahmed bin Ammar (v. 440 hixhrij) i redaktuar prej Dr. Hazem Seid Hajder El Karmi.
7. "El Huxhetu fi el Kiraat Es Sebati", që i atribuohet Ibn Halevejhit (v. 370 hixhrij) Redakuar prej Dr. Abde Es Selam Makrem.
8. "El Muvedah fi vuxhuh el Kiraat ve ileliha", prej Nasr bin Ali El Farisi, i njohur si Ibën Ebi Merjem (v. 565 hixhrij) redaktuar prej Dr. Omer Hamdan El Kubajsi.
9. "El Muhtesib fi Tebjin Shuvadhil el Kiraat vel idah anha", prej Ebu El Feh Ibn Xhini (v. 392 hixhrij) redaktuar prej Ali En Nexhdi Nasif, prej Abdul Halim En Nexhari dhe Abdul-Fetah Shelebi.
10. "T'erab el Kiraat esh-Shevadhu" prej Ebu El Baka' El Ukberi (v. 616 hixhrij). Redakuar prej Muhamed Azuz.
11. "El Xhemu ve Tevxhihu lima inferede imam Jakub", prej Shurajih bin Muhamed El Ra'ini (v. 539 hixhrij). Redakuar prej Dr. Ganem Kaduri El Hamad.
12. "El Mustenir fi Tahrihx El Kiraat El Mutevatire", prej Shejh Dr. Muhamed Muhamed Salem Muhajisin (v. 1422 hixhrij).
13. "El Kiraat esh-Shadhetu ve Tevxhihuha fi lugatil Arab", prej Abdel Fah El Kadi (v. 1403 hixhrij).
14. "Talailu El Beshher fil Kiraatil Ashr", prej Shejh Muhamed Es Sadik Kamhavit.

## Shkencat e lidhura me këtë shkencë

Shkenca e drejtimit të leximeve është e lidhur me një sërë shkencash, veçanërisht me gjuhën arabe, pasi ajo është origjina dhe burimi nga sqarohen shkencat e tjera, dhe po ashtu edhe shkenca e Tefsirit-komentimit, ngase drejtimi i leximeve është një lloj komentimi i Kuranit, dhe çdo komentim që nuk i merr parasysh kuptimet e ndryshme të leximeve, ai edhe është i mangët, përkundrazi ka komentuar disa nga ajetet dhe ka lënë të tjerat. Në shumë tefsire e gjejmë interpretimin si bazë për një nu-

mër shkencash të tjera islame, siç është: Akaidi-besimi, Fikhu- jurisprudenca, Resmul Kuran-shkrimi i Kuranit famëlartë etj.

## Lidhshmëria e drejtimit të leximeve me Tefsirin

Leximet kanë një ndikim të thellë në komentimin e Librit të Zotit të Madhëruar dhe nxjerrjen e kuptimeve të reja dhe zgjerimin e tyre, pasi çdo lexim e qartëson dhe e sqaron një kuptim të ri, e që nuk u zbulua nga leximi i mëparshëm. Ibën El Xhezariu ka thënë: “Ne i kemi shqyrtuar dallimet në të gjitha leximet, dhe kemi gjetur se nuk janë pa tri raste”:

1. Shqiptimi është i ndryshëm, kuptimi është i njëjtë;
2. Dallojnë në shqiptim dhe kuptim, mirëpo kanë një element që i bashkon, dhe;
3. Dallojnë në të gjitha, dhe nuk kanë elemente që të bashkohen në një gjë, por më tepër bien dakord në një aspekt tjetër, i cili aspekt nuk çon në kontradiktë.

Sa i përket të parit, është dallimi në “**Kuds**”, dhe “**Kudus**”, “**Usr**” “**Usur**”, e kështu me radhë, të cilat quhen vetëm gjuhë (dialekte).

Sa i përket të dytit: ndaj (**Melik** مَلِك , dhe **Malik** مَالِك) në El Fatiha, sepse ajo që nënkuptohet në të dy leximet është Zoti i Madhëruar, sepse Ai është pronari i Ditës së Gjykimit dhe Sunduesi i saj.

Sa i përket të tretit: është lexuar pa dyfishim të dha-unit (**أَنَّهُمْ قَدْ كَذَبُوا**)... “dhe ata menduan se ishin gënjer” (prej besimtarëve)..., ndërsa leximi me dyfishim të dha-unit, është dyshimi i popullit të tyre, se të dërguarit në lajmet e tyre e gënjyen popullin, dhe tre përemrat e adresuar janë për të dërguarit.”<sup>24</sup> Nga sa u tha më sipër, është e qartë se studiuesit i kanë ndarë leximet për sa i përket ndikimit të tyre në interpretim, dhe kjo ndarje është bërë në dy pjesë:

Pjesa e parë: Leximet që kanë ndikim në interpretim:

Ashtu sikurse dallimet e imamëve në shkronjat e fjalëve si (Malik - Pronari Ditës së Gjykimit) dhe (Melik-Sunduesi i Ditës së Gjykimit) El Fatiha dhe dallimet e tyre në lëvizjet me të cilat kuptimi i foljes ndry-

<sup>24</sup> En Neshr fil Kiraatil Ashere, pjesa I, Darul Fikër, Bejrut, 2002, f. 50.

shon, sikurse, për shembull: (يَصِدُّونَ) bllokujnë dhe (zmbrops يَصِدُّونَ), ndryshim ky në lexime që ka ndikim në interpretimin dhe dhënie të kuptimeve të reja. Dhe, kjo pjesë është dy llojesh:

- Fjala dhe kuptimi i tij nuk ndryshojnë, dhe;
- Formulimi dhe kuptimi janë të ndryshëm, mirëpo pajtohen nga një aspekt tjetër që nuk ka kundërthënie.

Pjesa e dytë: Leximet që nuk ndikojnë në interpretim, ashtu sikurse dallimet e imamëve në aspektin e shqiptimit të shkronjave dhe vokaleve, sasive të zgjatjes, dyfishimit e mosdyfishimit, lehtësimit të hemzes, shqiptimit të qartë dhe jo të qartë, këndimit hundorë, fshehjes, dhe ky dallim në lexime, sipas mendimit të tyre, nuk ka efekt në kuptime të reja të ajetit, por më tepër është për t'i lehtësuar vështirësitë e leximit.

Duke parë ndarjet e përmendura prej dijetarëve, vihet re se ata i ndan një pjesë e leximeve kuranore që nuk kishin të bënin fare me kuptimin, dhe ia atribuonin atë gjuhëve (dialekteve) të ndryshme, ose formave të ndryshme të shqiptimit në shkronja dhe vokaleve, apo shumëfishimi i shprehjeve, dhe arsyeve të tjetra që kishin ndikim në kuptime, dhe kjo u sqarua prej tyre.

## Modele të aplikuara mbi ndryshimet në lexime dhe ndikimi i tyre në interpretim

Dallimet në leximet kuranore që kanë ndikuar për t'i zgjeruar kuptimet në ajetin kuranor dhe për t'i arritur qëllimet e Zotit të Madhëruar, duke ofruar më shumë se një kuptim në një ajet të vetëm, ose duke shtuar tregues të tjerë, nga konteksti në fjalë, do të kufizohen në përmendjen e shembujve të aplikuar të leximeve të aspekteve të ndryshme në këndim, mirëpo jo si kufizim.

Së pari: Dallimi në lexime, si:

I Plotfuqishmi tha:

وَمَا أَصَابَكُمْ مِنْ مُصِيبَةٍ فِيمَا كَسَبَتْ أَيْدِيكُمْ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ

*“Dhe çfarëdo fatkeqësie që ju godet, ajo është për shkak të asaj që keni fituar me duart tuaja, dhe Ai fal shumë.”<sup>25</sup>*

#### **Leximet:**

1. Ebu Xhaferi, Nafiu dhe Ibën Amiri lexuan **بِمَا كَسَبَتْ** me atë që fitove) pa e përmbushur atë.
2. Pjesa tjetër e lexonin (**فِيمَا كَسَبَتْ**) për atë që fitoi në “fa”.

#### **Kuptimi i leximeve:**

Fitimi: ajo që një person kërkon të fitojë dobi dhe të fitojë një pasuri, siç është fitimi i parave, dhe mund të përdoret për atë që njeriu mendon se do të sjellë dobi, dhe pastaj të sjellë dëm me të.<sup>26</sup>

Shpjegim: në këtë ajet fisnik Zoti i Madhëruar i lajmëron njerëzit për fatkeqësitë që u ndodhin atyre në vetvete, apo në familje, e ky është mjerimi që i godet për shkak të mëkateve që i kanë fituar me duart e tyre, megjithëse Zoti i Madhëruar, në mëshirën e Tij tejkalon shumë mëkate dhe nuk i dënon për to.

Bazuar në sa u tha më sipër, nuk mund të jemi të sigurt se nuk ka asnjë efekt në interpretimin e këtij lloji të dallimit në lexime. Me hulumtime dhe eksplorime të mëtejshme në kuptimet e leximeve dhe implikimet e tyre, studiuesit mund të arrijnë dallime edhe në kuptimet ndërmjet këtyre leximeve, e që kanë një ndikim të thellë në interpretimin e Librit të Zotit të Madhëruar.

Me pak fjalë shumësia e leximeve kuranore dhe dallimet e tyre kanë përfitime të mëdha dhe efekte të mëdha në interpretimin e Librit të Zotit të Madhëruar, nxjerrjen e kuptimeve të reja dhe zgjerimin e tyre, mirëpo pa kontradiktë në kuptime apo mospërputhje mes tyre. Dallimi i këtyre shtatë shkronjave (harfeve) të përcaktuara prej Pejgamberit, a.s., dhe

<sup>25</sup> Sureja Esh Shura (30)

<sup>26</sup> Et Tahrir ve Tenvir libri Ashur, v.I, Daru En Nesher Tunis, 1984, f. 51-56.

dobia e tij, është një dallim diversiteti dhe kontrasti, e jo një dallim kundërshtie dhe kontradikte, sepse kjo e fundit është e pamundur të jetë në Fjalën e Zotit të Madhëruar. Allahu, xh.sh., tha:

أَفَلَا يَتَذَبَّرُونَ الْقُرْآنَ وَلَوْ كَانَ مِنْ عِنْدِ غَيْرِ اللَّهِ لَوَجَدُوا فِيهِ اخْتِلَافًا كَثِيرًا

*“A nuk e konsiderojnë ata Kuranin?! E sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç Zotit, në të do të gjenin shumë dallime.”<sup>27</sup>*

Sipas dallimeve në lexime, janë paraqitur edhe ndryshimet në dispozita. Mbi këtë edhe është ndërtuar drejtimi i leximeve dhe argumentet e juristëve në nxjerrjen e dispozitave juridike të Sheriatit. Kjo ka ndodhur edhe në kohën e Pejgamberit, a.s., kur një numër i sahabëve ishin në gjendje që të jepnin fetva për mesele të ndryshme, siç ishte ajo se kush duhet të prijë në namaz, e që hadithi udhëzonte kah lexuesi më i dalluar. Mirëpo, kjo mund të kuptohej edhe si njohësi më i mirë i fesë. Pra, fjala “Akra uhum” - **Më i dituri**. Kështu, edhe fukahatë më vonë patën konsideratë edhe për lexuesit e Kuranit me rivajete, për shkak se në to gjenin shtjellime dhe argumente për mesele të ndryshme, përveçse lexim të bukur prej tyre.

Një numër shumë i madh i mufesirëve dhe fukahave ka qenë që janë marrë me drejtimin e leximeve, për shkak të lidhshmërisë së kësaj dijeje me ato shkenca. Prej dijetarëve të mëdhenj ishin Imam Shafiu (204 hixhrij), me librin e tij “Risale”, Ibën Xherir Et Taberiu, me tefsirin e tij “Xhamiu El Bejan an Tevil El Kuran”, pastaj Ibën Atije El Endulesi, (542 hixhrij) El Muharrer El Vexhiz, Ebu Abdullah e Kurtubi (671 hixhrij) me “El Xhamiu li Ahkam El Kuran”, Shevkaniu (1250 hixhrij) me “Fetul Kadir” etj. Këta dijetarë, po edhe shumë të tjerë, u morën me drejtimin e leximeve aty ku gjendeshin nëpër ajete.<sup>28</sup>

<sup>27</sup> En Nisa, 82.

<sup>28</sup> “El Muhtesib fi Tebjin Shuvadhil el Kiraat vel idah anha” Ebu El Feh Ibn Xhini, v.I, Darul Ihja Turath El Arabij, Bejrut, 1412 h., f. 8.

## Lidhshmëria e drejtimit të leximeve me shkencën e Fikhut

Juristët e mëdhenj, me statusin e lartë të diturisë që posedonin, i respektuan imamët e kiraeteve, siç kuptojmë nga thënia e Ebu Hanifes (vdiq në vitin 150 hixhrij), i cili e vlerësoi Imam Hamza bin Habib Ez Zajatin (v. 220 hixhrij), një nga shtatë Imamët, kur tha: “Dy janë gjërat mbi të cilat ne ia dolëm dhe nuk polemizojmë me ju për Kuranin dhe dispozitat e trashëgimisë”<sup>29</sup>, domethënë ia pranoi kompetencën e të drejtës që ai shquhej si imam i kiraetit.

Kur Imam Maliku (vdiq në vitin 179 hixhrij) u pyet për vendimin e leximit të Basmeles gjatë namazit, ai tha: “Pyeti imamët, se çdo dituri merret prej njerëzve të saj, dhe Nafiu është Imami i njerëzve në lexim!”<sup>30</sup>.

Shembujt janë të shumtë në ajetet e Kuranit fisnik, pra që tregojnë qartë për dobinë e drejtimit të leximeve dhe ndikimit të atij udhëzimi në sqarimin e vendimeve juridike ndaj të cilave ekspozohen dijetarët, fukahatë dhe komentuesit gjatë shkrimit të librave të tyre. Për shembull, është dallimi i tyre në mendimin për marrëdhëniet me bashkëshorten me menstruacione, gjatë pastrimit të saj nga gjaku, mirëpo para se të lahet; kjo ka rrjedhur sipas drejtimit të kiraeteve në fjalën, “Jetaharne <sup>31</sup> حتى يَطَّهَّرْنَ” pa dyfishim (pa teshdid), dhe me dyfishim (me teshdid). Shumica e kanë lexuar pa teshdid, ndërsa Shube, Hamze, Kisaiu dhe Halefi e kanë lexuar me teshdid.<sup>32</sup>

Kështu, Ebu Hanife ka thënë për leximin e parë, pa teshdid, se është ndërprerja e gjakut, dhe kjo do të thotë se i lejohet burrit të saj që të

<sup>29</sup> “El Mustenir fi Tahririh El Kiraat El Mutevatire”, Shejh Dr. Muhamed Muhamed Salem Muhajsin, f. 178.

<sup>30</sup> “El Xhemu ve Tevxhihu lima inferede imam Jakub, prej Shuraih bin Muhamed El Ra'ini (v. 539 hixhrij) Redakuar prej Dr. Ganem Kaddouri Al Hamad, Darul Ihja Turath El Arabij, Bejrut, 1412 h.

<sup>31</sup> Sureja El Bekare, nga ajeti i 222-të.

<sup>32</sup> En Neshr fil Kiraatil Ashere, pjesa I, Darul Fikr, Bejrut, 2002, f. 54.

kryejë marrëdhënie para se të lahet gruaja, pasi t'i ketë mbaruar gjaku. Ebu Hanife<sup>33</sup> e kufizoi këtë në tri gjëra:

*E para:* Nëse gjakderdhja ndalet në pjesën më të madhe të periudhës së menstruacioneve, që është dhjetë ditë për të;

*E dyta:* Nëse gruas me menstruacione i ka pushuar gjakderdhja para kalimit të dhjetë ditëve, i lejohet vetëm të marrë gusël, dhe t'i falë namazet ditore, dhe;

Mendimi i shumicës së juristëve sikurse: Imam Maliku, Hanbeli, Sha-fiu, është se nuk lejohet kryerja e marrëdhënieve para se të lahet gruaja me ujë ose tejemum, dhe kjo mbështetet nga fakti se femrës me menstruacione, derisa t'i ndalet gjakderdhja dhe të bëhet pastrimi i plotë, nuk është e pastër, e pastrimi i plotë i grave nga menstruacionet, sipas tyre, është gusli. Pra, këtu i kemi dy vendime, siç nxirren nga dy leximet: njëri prej tyre është ndalimi i gjakut, dhe tjetri pastrimi nga ai, dhe; vendimi tjetër e përfshin shtimin e gjakut.

Shembulli tjetër është edhe dallimi i tyre për larje apo fshirje të këmbëve në marrjen e abdesit. Ky është ndryshimi që rrjedh sipas leximeve dhe kuptimit në drejtimin e tyre.

Dy leximet në fjalën "Ershulikum":

وَأَرْجُلِكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ<sup>34</sup> me fet'ha të lamit e lexuan: Nafiu, Ibën Amiri, Hafsi, Kisaiu dhe Jakubi, dhe; me kesre të lamit e lexuan: Ibën Kethiri, Ebu Amri, Shube, Hamze, Ebu Xhaferi dhe Halefi.

(وَأَرْجُلِكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ) Kush e ka lexuar me fet'ha, në rasën kallëzore, domethënë, këmba lahet sikur që lahet fytyra dhe duart, ndërsa leximi me kesre, në rasën gjinore, kthehet te koka, që domethënë se i jepet mes'h, apo vetëm preket me dorë të lagur.<sup>35</sup>

<sup>33</sup> "Ahkamul Kuran", Ebu Bekër Ahmed bin Alij El Xhasas, v. II, Darul Ihja Turath El Arabij, Bejrut, 1412 h., f. 35.

<sup>34</sup> El Maide, 6.

<sup>35</sup> Muhamed bin Jusaf Ebu Hajan, "El Bahrul Muhit", Mektebetu Hatinxhi, Egjipt, 1992, v. VII, f. 335.

Të gjithë fukahatë kanë thënë se është obligim larja e këmbeve kur janë të zbathura, mirëpo, nëse ka veshur meste, i lejohet mes'hi mbi këmbë. Kjo u kuptua nga praktika e Pejgamberit, a.s., i cili i lante këmbët vetëm nëse nuk kishte veshur meste, e kur kishte veshur, atëherë u jepte mes'h. Kështu rrjedhin dispozitat sipas dy leximeve: në njërin larja, e në tjetrin mes'hi, mirëpo ky i dyti kushtëzohet me meste, sipas praktikës së Pejgamberit, a.s.

*E treta.* Në suren En Nisa kemi dy lexime në fjalën: “**laamestum**”; “**Lemestum**”. Pa elif<sup>36</sup> (لَمَسْتُمُ النِّسَاءِ) e lexuan Hamze dhe Kisaiu, dhe sipas këtij leximi kuptohen prekja në përgjithësi.

Dhe, leximin me elif, pas lamit (لَامَسْتُمُ النِّسَاءِ), e lexuan të gjithë të tjerët. Sipas këtij leximi kuptohet marrëdhënia me gruan.

Në bazë të këtyre dallimeve në lexime ndryshuan edhe mendimet e fukahave: Ebu Hanifja dhe të tjerët në medh'heb, përveç Muhamedit, mendojnë se me prekje nuk priset abdesi, qoftë me epsh apo pa të. Imam Maliku thotë se, nëse është me epsh, priset abdesi, e nëse jo, atëherë nuk e prish. Imam Shafi'u thotë se në të dy rastet e prish, me epsh dhe pa të.<sup>37</sup>

## Lidhshmëria e drejtimit të leximeve me gjuhën arabe

Lidhshmëria me gjuhën arabe e drejtimit të leximeve është se ajo merret me interpretimin e aspekteve të ndryshme të leximeve kuranore, sipas rregullave të gjuhës arabe. Me gramatikë arabe nënkuptojmë atë që përfshin trupin e gjuhës, gramatikën, morfologjinë dhe retorikën. Në përkufizimin e mëparshëm, kjo shkencë është një interpretim në gjuhën arabe i leximeve kuranore dhe, rrjedhimisht ajo rrjedh nga gjuha dhe burimet e saj. Mirëpo, edhe vetë rregullat e gjuhës arabe janë marrë nga burimet e mëposhtme:

<sup>36</sup> En-Nisa, 43.

<sup>37</sup> Ebu Beker Ahmed bin Alij El Xhasas, Ahkamul Kuran, v. II, f. 39.



Nga Kurani famëlartë, i cili është burimi më i rëndësishëm i gjuhës arabe; leximet ishin si argumentime të gjuhëtarëve për disa qëndrime të tyre. Po ashtu edhe Hadithi, që e kishte një rol të rëndësishëm. Pastaj edhe poezia arabe para vitit 180 hixhrij. Këto ishin burimet në të cilat mbështetshin gjahtarët për rregullat e gramatikës arabe.

Fryti i përgjithshëm i kësaj njohurie është mbrojtja e leximeve kuratore nga pikëpamja gjuhësore, duke përfshirë: besimin në korrektësinë e leximeve, pajtimin e tyre me kushtin gjuhësor, si dhe shtimin e kuptimeve të një vargu-ajeti, duke e lexuar në disa mënyra, secila nga të cilat do ta kishte kuptim e vet. Këtu vlen të përmendet edhe identifikimi i aspekteve të ndryshme të mrekullisë retorike të Kuranit, si dhe njohja me shumë dialekte arabe, që ndihmonin për reflektim të hulumtuesit, me një shumëllojshmëri të shkencave gjuhësore etj.

Shembujt e leximeve sipas të cilave gjuhëtarët u ndanë në mendime janë edhe ato që, për shembull, i ka lexuar Hafsi dhe Hamze, si në ajetin:

إِنَّا زَيْنَّا السَّمَاءَ الدُّنْيَا بِزِينَةِ الْكَوَاكِبِ

*“Ne me të vërtet e kemi stolitur qiellin e kësaj bote me shkëlqimin e yjeve”<sup>38</sup>*

Me tenvin (**bizinetin**), në rasën gjinore të “**El Kevakibi**”, ndërsa Shube me tenvin të **zinetin**, dhe në kallxore të “**El Kevakibe**”; të tjerët pa tenvin “**bi zineti**”.<sup>39</sup>

Drejtimi i leximeve në aspektin gjuhësor:

I pari lexim është zëvendësim i “**zines**”. Këtë mendim e kanë pasur:

El Ferai, El Aëmeshi, El Ukberi dhe Ebu Hajani, domethënë: “Ne e kemi zbukuruar qiellin me yje ndriçuese”, vetëm yjet paraqesin zbukurim më vete për ata që e shikojnë qiellin.

I dyti lexim është “**pasues i zines**”, këtë e ka përmendur Alusi, në “**Ruhul El Meani**”<sup>40</sup>.

<sup>38</sup> Es-Saffat, 6.

<sup>39</sup> En Nesher, v. II. f. 356.

<sup>40</sup> Ruhul El Meani, El Alusi, v. XXIII, Darul Kutub EL Ilmijeti, Bejrut, 1398 h., f. 101.

I treti lexim: “El Kevakibe”, që është kundrinor i **zineti**. Këtë mendim e kanë En Nehhas, Ebu Hajan, El Ferrai dhe disa të tjerë.<sup>41</sup>

Shembulli i dytë, ajeti:

وَاحِبٌ ذُو الْعَصْفِ وَالرَّيْحَانُ<sup>42</sup>  
 “...drithëra me gjethe me erë të mirë”.

### **Leximet<sup>43</sup>:**

Ibën Amiri, tre emrat i ka lexuar me fet’ha, në rasën kallëzore. Hamze, Kisaiu dhe Halefi dy emrat e parë i kanë lexuar me dame, në rasën emërore, dhe emrin e tretë me kesre, në rasën gjinore. Dhe, leximi i të tjerëve, prej dhjetë imamëve, është me dame, në rasën emërore, në të tre emrat<sup>44</sup>.

### **Drejtimi i leximeve:**

*Leximi i parë* kthehet tek ajeti وَالْأَرْضَ وَصَعَهَا لِلْأَنَامِ<sup>45</sup> - “...Tokën e ka bërë (shtruar) për krijesa”.

Kuptimi: “...Tokën e ka krijuar për kafshë dhe drithërat me gjethe dhe erë të mirë”.

*Leximi i dytë* kthehet tek ajeti وَالنَّخْلُ ذَاتُ الْأَكْمَامِ<sup>46</sup>... - “...dhe hurma me fruta...”.

Kuptimi: “...në të ka pemë hurma, dhe po ashtu drithëra me gjethe me erë të mirë...”.

*Leximi i tretë:* kthehet te fillimi i ajetit فِيهَا فَاكِهَةٌ<sup>47</sup> - “...në të ka pemë...”, domethënë, janë këto gjëra që i shijoni, siç janë pemët dhe drithërat me gjethe, dhe që hani nga to, siç hani hurma dhe fruta.

<sup>41</sup> El Bahrul Muhit, Ebu Hajan, v. VII, Egjipt, 1992, f. 338.

<sup>42</sup> Err-Rrahman, 12.

<sup>43</sup> El Keshf Mekij, v. II. f. 299.

<sup>44</sup> Mushkil Eërabul Kuran, Mekij, Pjesa II, Darul Kutub El Ilmijeti, Bejrut, 2001, f. 343.

<sup>45</sup> Err Rrahman, 10.

<sup>46</sup> Err Rrahman, 11.

<sup>47</sup> Err Rrahman, 11.

Këta janë pak shembuj, sipas të cilëve kuptohet se si erdhi deri të ndarja e mendimeve mes mufesirëve, fukahave apo gjuhëtarëve për një çështje-mesele. Për shkak të natyrës së këtij trajtimi dhe kufizimit të hapësirës u mjaftuam me këta shembuj nga leximet, për të lënë mundësi edhe për një qasje më të gjerë në të ardhmen.

### **Rekomandime:**

1. U rekomandojmë studentëve të shkencave islame që të marrin njohuri për leximet kuranore dhe t'u kushtojnë vëmendje atyre në mësimin dhe leximin e tyre, dhe të përfitojnë nga kjo dije në nxjerrjen e kuptimeve!
2. U rekomandojmë specialistëve të shkencës së leximit dhe interpretimit që të mbajnë kurse të leximit të Kuranit dhe ndikimit të leximeve në interpretim dhe vendime!
3. U rekomandojmë specialistëve dhe studiuesve me shumë interes për kërkimin e sekreteve të leximeve të Kuranit dhe ndikimin e tyre në interpretim, veçanërisht ato që studiuesit nuk i trajtuan, goftë në origjinë, apo edhe në përmbajtje!

## **Konkluzione**

Falënderimi i goftë Zotit të Madhërishëm! Vetëm me lejen e Tij realizohen veprat e mira! Si përfundim, pas këtij trajtimi të drejtimit të leximeve, arritëm ta sqarojmë konceptin e shkencës së drejtimit, origjinën e saj dhe ndryshimin midis saj dhe shkencës së leximeve, që doli nga ajo, si dhe raportin midis shkencës së drejtimit dhe shkencave të Sheriatit, dhe arabishtes në veçanti, duke paraqitur shembuj praktikë të leximeve të ndryshme kuranore për çështje nga ato shkenca, si dhe ndikimin e tyre në rregulla dhe dispozita. Me këtë rast edhe erdhëm në përfundime e konkluzione që çojnë në rezultatet e mëposhtme:

1. Leximet fillimisht janë shfaqur në kuptimin e kodifikimit në ekzegezë, më pas u bënë të arta, pra, drejtimi është një lloj interpretimi dhe një variant i tij.

2. Librat dhe shkrimet në këtë fushë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në drejtimin e kuptimit ekzegetik.
3. Një nga rezultatet e drejtimit të leximeve kuranore - në mënyrat e tyre të ndryshme – vjen qoftë duke e sqaruar apo duke e zgjeruar kuptimin e ajetit, ose duke e larguar problemin, gjë që na u bë e qartë në hulumtim, në efektet e leximeve në interpretime të ndryshme, për sa i përket shkencës së interpretimit, jurisprudencës, gramatikës etj.
4. Në shembujt e përmendur në hulumtim, të cilat treguan për rëndësinë e shkencës së drejtimit të leximeve, dhe lidhja me shkencat islame dhe arabe.



# Koncepti i shkencave kuranore në aspektin historik

---

Dr. Valmire Batatina-Krasniqi

## Abstrakt

Kurani i Madhërishëm është libër hyjnor në të cilin përfshihen një sërë disiplinash si: Shpallja e tij nga Allahu i Plotfuqishëm, shpjegimi i tij nga Pejgamberi, a.s, veçoritë e tij gjuhësore, shkrimi dhe tubimi e tij ndërmjet dy kopertinave, kodifikimi dhe interpretimi i tij në periudhat e mëvonshme etj. Këto shkenca, të përmbledhura brenda nocionit “Ulumul Kuran”, rrjedhin nga vetë Kurani dhe shërbejnë për ta kuptuar atë. Në këtë studim synojmë të trajtojmë të shquarit në shkencat kuranore në kuadrin e arsyeve të shfaqjes së tyre dhe t’i qasemi shkurtimisht historikut dhe literaturës në këtë fushë.

**Fjalë kyçe:** Kuran, Ulumul Kuran, Sahabe, Tabiin, Et Tbau tabiin.

## Abstract

The Magnificent Qur'an is a divine book that encompasses various sciences. These sciences include the revelation of the Qur'an by Almighty Allah, its interpretation by the Prophet (peace be upon him), its linguistic features, the process of its writing, its compilation during the time of the companions, its transcription, and its subsequent meaning and interpretation in later periods. These sciences, collectively known as Ulumu'l-Qur'an, are derived from the Qur'an itself and aid in its comprehension. This study aims to explore the notable aspects of Qur'anic sciences, examining their origins and briefly touching upon the history and literature associated with Ulumu'l-Qur'an

**Keywords:** Quran, Ulumul Quran, Sahaba, Tabiin, Tabi'al-tabiin.

## Hyrje

Shprehja arabe علوم القرآن – “*Ulumul Kuran*” është një frazë e përbërë nga dy komponentë. E para, علوم – “*ulum*” që është shumësi i fjalës علم – “*Ilm*”, dhe në leksik ka kuptim të dijes dhe konceptimit.<sup>1</sup> Ndërsa në kuptimin terminologjik do të thotë të kuptosh çështjet me thelbin ose atributet e tyre.<sup>2</sup> E dyta, fjala Kuran e cila në formën infinitive përmban kuptimin “të lexosh” në aspektin terminologjik shpreh: “Fjalën e Allahut të Madhërishëm, e cila i është zbritur pejgamberit (a.s) me rrugën e zbulësës (vahjit) me ndërmjetësinë e engjëllit Xhibril (a.s.), është shkruar në formë libri, është përcjellë me miratim të përgjithshëm (tevatür), leximi i së cilës është adhurim dhe e cila përmban veçori të posaçme.”<sup>3</sup> Në kuadër të

<sup>1</sup> Isfahani, Ragib, *El Mufredat fi Garibi'l-Kuran*, Bejrut: Daru'l-Kalem, 1412/1991, f. 580.

<sup>2</sup> Firuzabadi, Mexhdudin, *El Kamusu'l-Muhit*, Bejrut: Mektebu Tahkiki't-Turath fi Mueseti'r-Risale, 1426/2005, f. 49.

<sup>3</sup> Zurkani, Muhamed Abduladhim, *Menahilu'l-Irfan fi Ulumi'l-Kuran*, Bejrut: Daru'l-Kitabu'l-Arabi, 1415/1995, I, f. 19.

këtyre përkufizimeve, “Ulumul Kuran” është emri i përgjithshëm i disiplinave si shpallja, shkrimi, leximi, mbledhja, kodifikimi dhe shumëzimi, recitimi, mrekullia, nasih-mensuh (derogimi) dhe i’rabi i shpalljes. Secila prej tyre është një koleksion shkencash që trajtojnë veçori të ndryshme të Kuranit.<sup>4</sup> Sipas një përkufizimi tjetër, shkencat që bazohen në Kuran quhen Ulumul Kuran.<sup>5</sup>

Sipas tefsirologut Sabuni me frazën “Ulumul Kuran” janë për qëllim një sërë shkencash si: zbritja e Kuranit, shkrimi, leximi, mbledhja, kodifikimi dhe shumëzimi, shkaqet e zbritjes, nasih-mensuh (derrogimi), ajetet e paqarta etj.<sup>6</sup> Ndërsa Sujuti (v. 911/1506) e zgjeroi më shumë fushën e shkencave kuranore duke përfshirë edhe shkencat moderne si astronomia, gjeometria dhe mjekësia në shkencat e cekura.<sup>7</sup> Në kuadër të kësaj, shkencat që ndihmojnë në të kuptuarit e drejtë të Kuranit mund të klasifikohen në katër tituj kryesorë: (1) procesi i shpalljes së Kuranit, (2) historia e tekstualizimit të Kuranit, (3) gjuha, stili, retorika dhe recitimi, (4) çështje të ndryshme që lidhen me të kuptuarit dhe interpretimin e Kuranit.<sup>8</sup> Nga e gjithë kjo mund të themi se nocioni “Ulumul Kuran” përfshin shkenca që lidhen drejtpërdrejt me Kurantin siç janë shpallja e tij, renditja, shkrimi, tubimi i tij etj.

---

<sup>4</sup> Birshik, Abdulhamit, “Ulumu’l-Kuran”, Stamboll: Anseklopedia Islame e Dijanetit të Turqisë, XLII, 132.

<sup>5</sup> Turgut, Ali, *Tefsir Usulu ve Kajnaklari*, Stamboll: Universiteti i Marmaras Fakulteti i Ilahijatit, 1991, f. 2.

<sup>6</sup> Es Sabuni, Nureddin, *et-Tibjan*, Stamboll: Siraç, 2019, f. 12.

<sup>7</sup> Es Sujuti, Ebu’l-Fazl Xhelaludin Abdurrahman bin Ebi Bekr, *El Itkan fi ulumi’l-Kuran*, Egjipt: 1370/1951, II, f. 162.

<sup>8</sup> Mennau’l-Kattan, *Kuran Ilimleri’nin Tarifi, Ortaja Çikishi ve Gelishmesi*, Përkthyes: Erdogan Pazarbashi, Ibrahim Gorener, Kajseri: Universiteti i Erxhijesit Revista e Fakultetit të Ilahijatit, 1998, nr: 10, f. 192.



## I. Zanafilla e Konceptit të Ulumul Kuranit dhe Literatura e Parë

Pa dyshim që koha e shfaqjes për herë të parë e konceptit “Ulumul Kuran” zgjoi vëmendjen e shumë tefsirologëve dhe dijetarëve. Në lidhje me këtë, Zerkani thekson se ekziston një mendim i përhapur në mesin e dijetarëve të tefsirit se koncepti “Ulumul Kuran” u shfaq për herë të parë në shekullin e shtatë Hixhëri, megjithatë shpreh se zanafilla e këtij nocióni është më e hershme ngase në bibliotekën egjiptiane rastisi në një kopje dorëshkrimi të quajtur *El Burhan fi Ulumi'l-Kuran* të shkruar nga Ali bin Ibrahim bin Said El Hufi (v. 430/1038).<sup>9</sup> Subhi Salihu, nga ana tjetër, shprehet se personi i parë që shkroi një vepër duke përdorur këtë koncept ishte Ibën Merzuban (v. 309/921).<sup>10</sup> Me këtë pikëpamje pajtohet edhe Mennaul Kattan dhe pohon se në shekullin e katërt Hixhëri janë shkruar këto vepra: Muhammed bin Halaf bin El Merzuban (v. 309/921) *El Havi fi Ulumi'l-Kuran* dhe Ebu Bekr Muhamed bin El Enbari (vd.328/939) *Axhaibu Ulumi'l-Kuran*.<sup>11</sup>

Vepra e shkruar nga El Hufi mund të konsiderohet si një vepër që bashkon shumicën e shkencave kuranore.<sup>12</sup> Në këtë vepër, El Hufi trajtoi vargjet e Kuranit sipas renditjes në Mus'haf, çdo teme i dha një emër të ndryshëm, solli ajetet përkatëse dhe sqaroi shkencat kuranore duke dhënë një pasqyrë të përgjithshme të ajeteve me shprehjen *القول في قوله تعالى El Kavlu fi Kavlihi Teala'*.<sup>13</sup>

Krahas këtyre veprat e Mahmud bin Ali El Kerexhi (v. 360/970) *Nuketu'l-Kuran*, dhe Muhamed bin Ali El Udfuvi (v. 388/998) *El Istigna/Istifta fi Ulumi'l-Kuran*, janë nga veprat e shkruara me qëllim të përpilimit të

<sup>9</sup> Zurkani, *Menahilu'l-Irfan fi Ulumi'l-Kuran*, I, 34-35.

<sup>10</sup> Ibën Nedim, Muhamed bin Ishak, *El Fihrist*, Bejrut: Daru'l-Ma'rife, 1417/1997, f. 114, 183.

<sup>11</sup> Mennau'l-Kattan, vepër e cituar, f. 190.

<sup>12</sup> Mennau'l-Kattan, vepër e cituar, f. 190-191.

<sup>13</sup> Po aty.

shkencave kuranore.<sup>14</sup> Në shekullin e pestë Hixhëri, shohim veprën e shkruar nga Ebu Davud Sulejman bin Nexhah (v. 496/1103) *El Bejanu'l-Xhami' li Ulumi'l-Kuran*.<sup>15</sup> Këtë rrugëtim e ndoqën edhe dijetarët Ibën El Xhevzi (v. 597/1200) me veprën e tij *Fununu'l-Efnan fi Axhaibi Ulum'i-l-Kuran* dhe Bedruddin Ez Zerkeshi (v. 794/1392) me veprën *El Burhan fi Ulumi'l-Kuran*.<sup>16</sup> Vepra *Manahilu'l-Irfan* e Ez Zerkaniut dhe *Mebahith fi Ulumi'l-Kuran* e Subhi Salihut janë shembuj të spikatur të kësaj fushe në kohërat moderne.<sup>17</sup>

Shkenca e “Ulumul Kuranit” përfshin një sërë shkencash thelbësore në kuptimin dhe interpretimin e saktë të Kuranit. Edhe pse përmendet shekulli i katërt dhe i pestë si periudhë e sistemimit të këtyre shkencave, zanafilla e tyre mund të gjurmohet që nga periudha e sahabëve. Ndonëse nuk janë trajtuar sistematikisht, për këto shkenca është folur që në kohët e hershme të Islamit dhe janë arritur shumë rezultate. Megjithëse përdorimi i gjerë i këtij koncepti fillon në shekullin e tetë, shohim se njohuri të hollësishme rreth shkencave të Kuranit zënë vend në hyrjen e shumë tefsireve.<sup>18</sup> Ndërsa në literaturën islame i pari që përdori termin “Ilmu'l-Kuran” pra me shprehjen “ilm/dituri” përmendet Ebu Abdilal Muhamed bin Omer El Vakidi (v. 207/822). Edhe pse nuk ka shumë njohuri rreth përmbajtjes së këtij libri emri i veprës së tij është *Er Ragib fi Ilmi'l-Kuran ve Galati'r-Rixhal*.<sup>19</sup>

<sup>14</sup> Birishik, vepër e cituar, XLII, 133.

<sup>15</sup> Mennau'l-Kattan, vepër e cituar, f. 191.

<sup>16</sup> Rumi, Fehd bin Abdirrahman bin Sulejman, *Dirasatun fi Ulumi'l-Kuran*, 1424/2003, f. 42-43.

<sup>17</sup> Birishik, vepër e cituar, XLII, 134.

<sup>18</sup> Taberi, Muhamed bin Xherir, *Xhamiu'l-Bejan fi Te'vili Aji'l-Kuran*, Rijad: Musssetu'r-Risale, 1420/2000, I, 3-111; Kurtubi, Ebu Abdillal Muhammed bin Ahmed, *El Xhami' li Ahkami'l-Kuran*, Egjipt: Daru'l-Kutubu'l-Misrije, 1384/1964, I, 80.

<sup>19</sup> Deliser, Bilal, *Ez Zerkeshi ve Kuran Ilimlerindeki Jeri*, Ankara: Universiteti Gymyshhane, 2012, f. 20-40.

## II. Koncepti i Ulumul Kuranit në periudhën e Pejgamberit a.s

Kurani i shenjtë është unik jo vetëm për nga kuptimi dhe mesazhi i tij, por edhe nga forma, intonacioni dhe diksioni i tij. Ai iu shpall Muhamedit (a.s) para 1400 viteve dhe është pa dyshim një kryevepër e cila kërkon të interpretohet. Në lidhje me këtë në Kuran thuhet:

بِالْبَيِّنَاتِ وَالزُّبُرِ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ

“(I patëm dërguar) Me argumente e me libra të shenjtë. Ty ta zbritëm Kuranin që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kuranin).”<sup>20</sup> Duke qenë se gjuha e bashkëbiseduesve të parë të Kuranit ishte një arabishte me stil të lartë, përmbajtja dhe qëllimet e shumanshme të saj duhet të interpretoheshin në mënyrë që mesazhi hyjnor të mund të aplikohet. Përveç kësaj, struktura të ajeteve të ngjashme mes vete dhe në shikim të parë jo shumë të qarta që shfaqen në Kuran herë pas here, bënë të nevojshme një marrëdhënie “mësues nxënës” midis pejgamberit a.s dhe shokëve të tij: “Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi tyre që t’ju lexojë ajetet e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë librin dhe sheriatin.”<sup>21</sup> Në këtë kontekst, sahabët e pyetnin të dërguarin për vargjet që ata nuk mund të i kuptonin; kësaj ai ua shpjegonte domethënien e tyre.

Mungesa përmbajtjeve kontradiktore në Kuran është tregues i fuqishëm se ai është libër i zbritur nga Zoti xh.sh. Në lidhje me këtë në Kuran thuhet:

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ أَلَمْ يَكُنْ مِنْ عِنْدِ غَيْرِ اللَّهِ لَوْ كَانَتْ مِنْ دُونِ مَا نُنزِّلُ فِيهِ أَحْتِلَافًا كَثِيرًا

“A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kuranin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.”<sup>22</sup> Mirëpo, për shkak të injorancës së tyre, disa njerëz shfaqën

<sup>20</sup> En-Nahl, 44.

<sup>21</sup> El-Xhumua, 2.

<sup>22</sup> En-Nisa, 82.

iluzionin se ka disa kundërthënie ndërmjet disa ajeteve kuranore. Fjala vjen nga këndvështrimi i jashtëm i disa ajeteve mund të mendohet se ka një kundërthënie midis vargjeve në lidhje me krijimin e njeriut nga *dheu*<sup>23</sup>, *balta*<sup>24</sup>, *baltë që ngjitet*<sup>25</sup> dhe *balta e terur*.<sup>26</sup> Mirëpo, kur konsiderojmë kontekstet e vargjeve në aspektin e gradualitetit të krijimit të njeriut, shihet se shprehjet e lartpërmendura tregojnë për faza të ndryshme të krijimit dhe se nuk ka ndonjë kundërthënie në mes tyre.<sup>27</sup> Shkenca e Kuranit, e cila u shfaq për të eliminuar këtë iluzion, quhet “mushkilu’l-Kuran”. Përderisa në aspektin linguistik shprehja “mushkil” ka kuptimin “diçka konfuze dhe kontradiktore”, në atë terminologjik paraqet shkencën e cila shqyrton dallimin, kontradiktën dhe kundërthënien që në shikim të parë/nga ana e jashtme e tekstit duket sikur ekziston midis disa vargjeve të Kuranit dhe që mundëson zgjidhjen dhe harmoninë e tyre.<sup>28</sup> Kur shikojmë zanafillën e kësaj shkence shohim se edhe vetë Pejgambëri, a.s në interpretimet e tij shpjegoi disa ajete në lidhje me të. Fjala vjen, kur zbriti ajeti

وَإِذْ قَالَ لُقْمَانُ لِابْنِهِ وَهُوَ يَعِظُهُ يَا بُنَيَّ لَا تُشْرِكْ بِاللَّهِ إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ

“(Përkujtoju popullit tënd) *Kur Llukmani duke e këshilluar, birit të vetë i tha: “O djali im, mos i përshkruaj Allahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe!”*<sup>29</sup> sahabët erdhën tek i Dërguari i Allahut dhe e pyetën se “Cili nga ne nuk i bënë zullum (padrejtësi) vetes së vetë?” Ai u përgjigj “Shirku është një mizori e madhe.” duke sjellë argument ajetin:

<sup>23</sup> Ali Imran, 59.

<sup>24</sup> El-Hixhër, 29.

<sup>25</sup> Es-Saffat, 11.

<sup>26</sup> Err-Rrahman, 14.

<sup>27</sup> Es Sujuti, *El Itkan*, III, 88; Po ashtu shiko: Krasniqi, Batatina Valmire, *Zemahsheri'nin Keshshaf'inda Mushkilu'l-Kuran*, Bursa: Emin, 2022.

<sup>28</sup> Es Sujuti, *El Itkan*, II, f. 724; Batatina, vepër e cituar, f. 37.

<sup>29</sup> Llukman, 13.

الَّذِينَ ءَامَنُوا وَمَ يَلْسِنُوا إِيْمَانَهُمْ بِظُلْمٍ أُولَٰئِكَ هُمُ الْآمِنُونَ وَهُمْ مُّهُتَدُونَ

*“Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me besim të kotë, atyre u takon të jenë të sigurt dhe ata janë në rrugë të drejtë.”*<sup>30</sup> në të cilin shprehjen “dhulm” e interpretoi si shirk/politeizëm.<sup>31</sup>

Në Kuran shohim se disa ajete të quajtura “muxhmel” kanë strukturë përmbledhëse kuptimi i vërtetë i të cilave del në pah pas një gjurmimi dhe hulumtimi të thellë.<sup>32</sup> Në këtë grup ajetesh përveç tjerash mund të numërohen edhe shumë ajete që flasin mbi adhurimet si namazi, agjërimi, haxhi etj. Përderisa në Kuran nuk shpjegohet detajisht forma e kryerjes së këtyre ibadeteve Pejgamberi, a.s i sqaroi me deklaratat e tij verbale. Kështu u formua thelbi i një prej shkencave më të rëndësishme të Kuranit, pra, shkencës së “muxhmelit dhe mubejjenit”. Në Kuran një ajet “muxhmel” mund të bëhet “mubejjen” edhe me një ajet tjetër kuranor sqarues. Fjala vjen, وَالسَّمَاءِ وَالطَّارِقِ – *“Pasha qiellin dhe yllin ndriçues (të natës)”*<sup>33</sup> Në ajetin kuranor ku si muxhmel ka ardhur shprehja الطَّارِقُ është sqaruar me ajetin e të njëjtës kaptinë në të cilin thuhet: النَّجْمُ الثَّاقِبُ – *“Ai është ylli që shpon (errësirën me dritë).”*<sup>34</sup>

Tematika e Nes’hit po ashtu është një nga shkencat për të cilat bëhet fjalë në periudhën e pejgamberit a.s. Fjala vjen:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نَاجَيْتُمُ الرَّسُولَ فَقَدِمُوا بَيْنَ يَدَيْهِ نَجْوَاكُمْ صَدَقَةٌ

*“O ju që keni besuar, kur dëshironi të bisedoni me të dërguarin, epni një sadaka para bisedës suaj.”*<sup>35</sup> ajeti që flet rreth “nexhvas” (konsultës me Pejgamberin a.s.) është derroguar me ajetin:

<sup>30</sup> El-En’am, 82.

<sup>31</sup> Es Sujuti, Xhelaluddin, *ed-Durru’l-Mensur fi’t-Tefsiri bi’l-Me’thur*, Bejrut: Daru’l-Fikr, pa v. b., III, 308.

<sup>32</sup> Xherrahoglu, *Tefsir Usulu*, Ankara: 1985, f. 182.

<sup>33</sup> Et-Tarik, 1.

<sup>34</sup> Et-Tarik, 3.

<sup>35</sup> El-Muxhadele, 12.

أَشْفَقْتُمْ أَنْ تُقَدِّمُوا بَيْنَ يَدَيْ جُؤَاكُمُ صَدَقَاتٍ فَإِذْ لَمْ تَفْعَلُوا وَتَابَ اللَّهُ عَلَيْكُمْ  
فَأَقِمْو الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَاللَّهُ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ

*“A u frikësuat (varfërisë) të jepni lëmoshë në prag të bisedës suaj? E kur ju nuk e bëtë dhe All-llahu ju fali, atëherë pra, falni namazin, jepni zeqatin, respektojeni Allahun dhe të dërguarin e Tij, All-llahu është i njohur me punën tuaj.”*<sup>36</sup> Pra, përmendja e këtij koncepti nga i dërguari i Zotit tregon se kjo temë ka qenë aktuale që në periudhën e parë të Islamit.<sup>37</sup> Nes’hi, në leksik përmban kuptimet “asgjësim, ndërrim, kthim nga një gjendje në një gjendje tjetër (tahvil), kopjim, shumëfishim (istinsah) dhe bartje”, në kuptimin shkencor ai paraqet “abrogimin (shfuqizimin) e një dispozite me një dispozitë tjetër apo konkluzionin e një ajeti të mëparshëm me anë të një ajeti të mëvonshëm.”<sup>38</sup> Përmendja e abrogimit në Kuran<sup>39</sup> dhe fakti se ai lidhet me hallallin dhe haramin në fushën e adhurimit dhe jurisprudencës,<sup>40</sup> u bënë shkak që kjo shkencë të përpilohet në një periudhë që mund të konsiderohet e hershme. Këtë e dëshmon edhe fakti që vepra e parë e shkruar në këtë fushë e quajtur *Kitabu'n-Nâsîh ve'l-Mensuh* nga Katade bin Diame daton që nga shek. i dytë Hixhëri.<sup>41</sup>

Po ashtu kur flitet për shkencat e hershme kuranore nuk mund të anashkalohet edhe shkenca “muhkem dhe muteshabih”. Në veçanti në lidhje me këtë shkencë në ajetin e shtatë të kaptinës Ali Imran thuhet se ajetet që janë të qarta (muhkem) janë baza e Kuranit, kurse ato (muteshabih) të paqarta janë të njohura vetëm nga Zoti i Madhërishëm, prandaj ato janë objekt i besimit.<sup>42</sup> Në periudhat e mëvonshme, me nocioin muh-

<sup>36</sup> El-Muxhadele, 13.

<sup>37</sup> Birishik, vepër e cituar, f. 34

<sup>38</sup> Ibën Barizi, Hibetullah bin Abdurrahman, *Nasihu'l-Kurani'l-Adhim ve Mensuhuh*, Muessetu'r-Risale, 1418/1998, f. 19.

<sup>39</sup> El-Bekare, 106; En-Nahl, 101-103.

<sup>40</sup> Subhi Salih, *Mebahith fi Ulumi'l-Kuran*, Bejrut: Daru'l-Ilmi li'l-Melajjin, 1394/1974, f. 263.

<sup>41</sup> Xherrahoglu, vepër e cituar, f. 127.

<sup>42</sup> Vahidi, Ebu'l-Hasen Ali bin Ahmed, *Esbabu Nuzuli'l-Kuran*, Damman: Daru'l-Islah, 1412/1992, f. 97; Nisaburi, Nexhmuddin, *Ixhazu'l-Bejan an Meani'l-Kuran*, Bejrut: Daru'l-Garbi'l-Islami, 1415/1994, II, 100.

kem janë shprehur urdhëra dhe ndalesa me kuptim të drejtpërdrejtë, me një kuptim të vetëm, që kuptohen pa pasur nevojë për sqarime, ndërsa muteshabih përfshin fjalë apo shenja shkronjore me kuptim të mbyllur ose me disa kuptime, për zgjedhjen e njërit prej të cilëve ka nevojë për argument shtesë.<sup>43</sup>

Siç shihet, zanafilla e shkencave kuranore në aspektin përmbajtësor por jo nga forma e një koncepti ka burimin tek vetë Kurani dhe Pejgamberi, a.s, i cili është interpretuesi i parë i tij. Në veçanti, ajetet e Kuranit në të cilat mbështeten shkencat si “muhkem-muteshabih” dhe “nasih-mensuh”, ishin shkak që këto shkenca të dalin në pah qysh në periudhën e hershme në këndvështrimin përmbajtësor të tyre. Në këtë aspekt, mund të themi se interpretimi i pjesshëm i Kuranit nga ana e Pejgamberit a.s krijoi bazën për strukturimin e shkencave kuranore në periudhat pas tij. Interpretimi i tij i Kuranit; jo vetëm që dha njohuri të nevojshme për të kuptuar shpalljen; ai në të njëjtën kohë, përfaqëson thelbin e një metodologjie në fushën e *fehmu'l-Kuranit (të kuptuarit e Kuranit)* me rëndësi jetike për të gjitha kohërat. Madje mund të themi se pjesa më e madhe e këtyre njohurive, fjalëve dhe koncepteve kuranore, përfshirë edhe konceptin “Ulumul Kuran”; i përket Profetit a.s. që i shpjegoi ato në vende, kohë, kallëpe dhe forma të ndryshme.

### III. Koncepti i Ulumul Kuranit në Periudhën e Sahabëve

Kur shikojmë transmetimet nga Pejgamberi, a.s në lidhje me shpjegimin e Kuranit, vihet në pah fakti se ai nuk e ka shpjeguar atë në tërësi, ngase interpretimet e tij ishin më shumë të një natyre të drejtuar nga nevojat e masës se sa shqetësime intelektuale dhe epistemologjike. Këtë rrugë të interpretimit kuranor e ndoqën edhe sahabët duke krijuar kështu rrethe mësimore pas tij. Përveç kësaj besimi i tyre i palëkundur, dituria dhe ur-

<sup>43</sup> Zerkeshi, *El Burhan fi Ulumi'l-Kuran*, Egjipt: Daru`t-Turath, II, 68-70. Shiko: Ibën Tejmijje, Takijjuddin, *El Iklil fi'l-Muteshabih ve't-Te'vil, Tahrixhu'l-Ehadith ve't-Ta'lik*, Muhammed Esh Shimi, Egjipt: Daru'l-Iman li't-Tab'i' ve'n-Neshri ve't-Tevzi', f. 12.

tësia e tyre e paprekur nga lëvizjet joislame, njohuritë e shkaqeve të shpalljes së ajeteve dhe ndërtimi i karakterit në përputhje me to, i bëri ata superior në krahasim me gjeneratat e mëvonshme në kuptimin dhe interpretimin e Kuranit. Mirëpo, si domosdoshmëri e dallimeve në natyrën njerëzore, ata ishin gjithashtu në shkallë të ndryshme sa i përket aspektit të të menduarit, shkencës dhe të kuptuarit. Në mesin e sahabëve që u njohën në këtë periudhë dhe përgatitën bazën për “Ulumul Kuran” janë Hulefa-i Rashidin, Ibën Abbas, Ibën Omer, Ibën Mes’ud, Abdullah bin Amir, Zejd bin Thabit, Ubej bin Ka’b, Xhabir bin Abdillahi, Ebu Musa El Eshariu.<sup>44</sup> Veprimtaria e “Ulumul Kuranit” në këtë periudhë kohore vazhdoi kryesisht gojarisht.<sup>45</sup> Nga kjo periudhë nuk ka arritur në kohën tonë asnjë tefsir apo ndonjë vepër tjetër në lidhje me shkencat e Kuranit. Edhe pse përmenden disa vepra, nuk ka evidencë për ndonjë vepër e cila përfshin në mënyrë të detajzuar shkencat kuranore nga kjo periudhë.<sup>46</sup>

Sahabët i zgjidhnin problemet që hasnin në kuptimin e shpalljes gjatë jetës së peygamberit a.s. duke ia paraqitur ato personalisht atij; prandaj, ata nuk e ndjenin nevojën për t’u thelluar në shumë mendime dhe ixhtihad. Mirëpo, pas vdekjes së tij, ishte e pamundur të zgjidhej një problem i të kuptuarit kuranor duke e pyetur atë<sup>47</sup> dhe si rrjedhojë u hodhën hapat e parë të metodës “dirajet” në fushën e tefsireve. Përveç kësaj, ballafaqimi i besimtarëve me fe, gjuhë, raca, kultura dhe zakone tjera të ndryshme menjëherë pas vdekjes së profetit shkaktoi një sërë problemesh të reja në kuptimin dhe interpretimin e Kuranit. Ky është një tjetër shkak që interpretimi dirajet të marrë përmasa më të gjera.<sup>48</sup>

Gjatë paraqitjes së shkencës së tefsirit, që është tërësia e veprimtari-ve të të kuptuarit dhe të shpjegimit të Kuranit, sahabët fillimisht ndjenë

---

<sup>44</sup> Subhi Salih, vepër e cituar, f. 120.

<sup>45</sup> Po aty.

<sup>46</sup> Bash, E., “Kuran Ilimlerinin Dogushu ve Tarihi Gelishimi”, Stamboll: Neshrijat, 2002, f. 28, 30.

<sup>47</sup> Gorener, “Tefsir Usulu ve Kuran Ilimlerinin Tefsir Jontemi Açısından Degerlendirilmesi”, Kajseri: Universiteti Erxhujes Fakulteti i Ilahijatit, f. 230

<sup>48</sup> Xherrahoglu, vepër e cituar, I, 88-89.



nevojën për të përfitur nga gjuha arabe.<sup>49</sup> Në veçanti në Kuran; përdorimi i një fjale në disa kuptime të ndryshme si dhe përdorimi i disa fjalëve të ndryshme me kuptim të njëjtë, që njihet si “vuxhuh ve nedhair”, e bëri të pashmangshme për sahabët kuptimin dhe shpjegimin e Kuranit bazuar në analizat leksikore.<sup>50</sup> Përveç kësaj, në Kuran shohim që disa fjalë në disa raste përdoren në kuptimin literal (të drejtpërdrejtë) të tyre dhe në raste tjera përbajnë kuptim metaforik. Shembull, ndërsa fjala “tregti” përdoret në kuptimin literal në ajetin 282 të sures Bekare; në ajetin e 29-të të sures Fatir përdoret në kuptimin metaforik.<sup>51</sup> Kjo gjendje konsiderohet si bazë e një prej shkencave kuranore e ashtuquajtur shkencë “haki-kat ve mexhaz”.<sup>52</sup>

Pejgamberi, a.s po ashtu i njoftoi myslimanët për shpalljen e Kuranit në “shtatë harfe” në mënyrë që ata ta kenë më të lehtë recitimin e tij.<sup>53</sup> Megjithatë, pas vdekjes së tij gjatë kalifatit të Ebu Bekrit (v. 13/634), gjatë luftës me “renegatët” që filloi në Gadishullin Arabik -veçanërisht në Betejën e Jemames (12/633) kundër Musejlemetu'l-Kedhdhab- me rënien shehid të shumë hafizëve të Kuranit, u ndje e nevojshme përmbledhja dhe koleksionimi i Kuranit, i cili ishte i shkruar në vende dhe gjësende të ndryshme. Dhe, kështu Kurani u përmbledh brenda dy kopertinave.<sup>54</sup> Në kohën e Othmanit (v. 35/656), konfliktet e thella të shkaktuara nga dallimet në recitim që buronin nga çështja e “shtatë harfeve” e bënë të nevojshme që muslimanët të bashkoheshin në një kopje të përbashkët.<sup>55</sup> Për të realizuar këtë unitet, Hz. Othmani e “kodifikoi” Kur`anin në dialektin

<sup>49</sup> Ibën Muthenna, Ma'mer, *Mexhazu'l-Kuran*, Thk. Muhammed Fuad Sezgin, Egjipt: Mektebetu Hanxhi, 1381, I, 16.

<sup>50</sup> Zerkeshi, vepër e cituar, I, 103. 103; Shiko: Nisa, 4/9; Tevbe, 9/24; Nur, 24/37; Xhum'a, 62/11.

<sup>51</sup> Xherrahoglu, vepër e cituar, f. 178.

<sup>52</sup> Birishik, vepër e cituar, f. 33.

<sup>53</sup> Atik, Kemal M., “Endulus ve Kuran Ilimlerindeki Jeri”, Kajseri: Universiteti i Erxhijesit Revista e Fakulteti të Ilahijetit, Nr: 2, 1985, f. 277.

<sup>54</sup> Sujuti, *El Itkan*, I, 206.

<sup>55</sup> Zerkeshi, vepër e cituar, I, 236, 239.

kurejshit, i dërgoi mus'hafët e shkruar në këtë dialekt në qendra të rëndësishme të gjeografisë islame dhe urdhëroi që të digjen të gjithë ekzemplarët e tjerë (personal) që gjendeshin në mesin e sahabëve. Kështu, u shfaq një stil zyrtar i të shkruarit specifik të Kuranit.<sup>56</sup> Këto dy ngjarje që kanë të bëjnë me tubimin dhe kodifikimin e Kuranit kanë zënë vendin e tyre si bazë në veprat që do të përpilohen më vonë mbi shkencat e Kuranit. Veçanërisht ngjarja e kodifikimit e njohur si "resmu'l-mushaf" pranohej si thelbi i shkencave kuranore.<sup>57</sup>

Në përgjithësi, mund të thuhet se në këtë periudhë studimet mbi Kuranin u bënë njëkohësisht me zhvillimin politik, shoqëror dhe kulturor të Islamit, nën ndikimin e faktorëve njerëzor në rrjedhën e zakonshme jetësore.

#### IV. Koncepti i Ulumul Kuranit në periudhën e Tabiinëve

Pa dyshim që edhe periudha e tabiinëve ishte një kohë e artë në evolucionin e shkencave kuranore. Gjatë kësaj periudhe dijetarët e ithtarëve të librit si Ka'bul Ahbar (v. 32/652), Vehb bin Munebbih (v. 110/728) dhe Abdulmelik bin Xhurejku (v. 150/767) pranuan Islamit dhe "Israilijjatet" filluan të përdoren si argument shtesë në interpretimin e Kuranit.<sup>58</sup> Në këtë periudhë, me ndikimin e njohurive nga kultura të ndryshme, filluan të interpretohen vargje që trajtonin çështje të së fshehtës (gajbit) dhe po ashtu interpretimi sektar mori një hov të madh. Veç kësaj, nisma e diskutimit të temave të tilla si kadaja-kaderi dhe kalifati luajtën rol të kësaj në formimin e sekteve. Në këtë periudhë kur fenomeni i sektarizimit mo-

---

<sup>56</sup> Xherrahoglu, vepër e cituar, f. 72-75.

<sup>57</sup> Zerkeshi, vepër e cituar, I, 376.

<sup>58</sup> "Israilijjat" është emri i përgjithshëm i transmetimeve që hynë në kulturën islame nga Hebrenjt në veçanti, Krishterimi dhe kulturat e tjera në përgjithësi, dhe përdoren në kuptimin dhe interpretimin e Kuranit. Ebu Shuhbe, Muhammed bin Muhammed bin Suvejlmi, *El Israilijjat ve'l-Mevduat fi Kutubi't-Tefsir*, Mektebetu's-Sunne, f. 12-14.

ri vrull, interpretimi i Kuranit për të vërtetuar këndvështrimet sektare u përdor në zhvillimin e shkencave kuranore.<sup>59</sup>

Pra, nga një periudhë e cila karakterizohej me pyetje-përgjigje ndaj çështjeve që parashtroheshin dhe me interpretim të pjesshëm, filloi interpretimi i përgjithshëm pothuajse i gjithë Kuranit Famëlartë. Shqetësimi për humbjen e dijes për shkak të vdekjes së sahabëve dhe dijetarëve nga tabiinët, dhe përhapja e trillimeve (isralijateve) ishin si shkak kyç në fillimin e koleksionimit të shkencave që lidheshin me Kuranin. Në këto koleksione, prioritet i është dhënë tubimit të haditheve, fjalëve të sahabëve dhe pikëpamjeve të tabiinëve.<sup>60</sup> Në veçanti në literaturën e tefsirit përmenden dijetarët si Hasan El Basri (v. 110/728) dhe Katade bin Diame (v. 117/735) të cilët sollën atë që u transmetua nga Pejgamberi, a.s së bashku me fjalët (interpretimet) e sahabëve dhe tabiinëve rreth tefsirit. Në shekullin e dytë, pra, në periudhën aktive të tabiinëve dolën në pah vepra mbi shkencat kuranore si “nasih-mensuh, fedailu'l-Kuran dhe kiraat”, disa prej të cilave kanë arritur tek ne.<sup>61</sup>

Në këtë periudhë të fillimit të koleksionimit dhe shkrimit të shkencave, metoda e zinxhirit të transmetuesve (isnadit) vazhdoi të përdorej në përcaktimin e transmetimeve që vinin nga Pejgamberi, a.s. Vlen të përmendet se dijetarët Mukatil bin Sulejman (v. 150/767), Sufjan Eth Thevri (v. 161/777) dhe Jahja bin Selam (v. 200/815) e aplikuan këtë metodë në tefsiret e tyre. Në shekullin e katërt Hixhëri, Taberiu (v. 310/923) duke përdorur metodën e dijetarëve të mëhershëm të transmetimeve, por për dallim nga ata njëkohësisht duke i filtruar transmetimet me kritika dhe herë pas here duke bërë zgjedhje ndërmjet tyre luajti një rol jetik në transferimin e tefsirit nga një periudhë e transmetimeve në atë të kritikës dhe klasifikimit.<sup>62</sup>

<sup>59</sup> Shekulli i dytë Hixhëri është një periudhë në të cilën në aspektin e besimit u shfaqë drejtimi shii, havarixhët dhe mutezilët. Ndërsa në aspektin e fikhut u shfaqë medhhebi Maliki, Hanbeli, Hanefi dhe Shafii. Bash, punim i cituar, f. 30.- 34.

<sup>60</sup> Ulu, Arif, “Tâbiin”, Turkije Dijanet Vakfi İslam Ansiklopedisi, XXXIX, 329.

<sup>61</sup> Bash, vepër e cituar, f. 31-32.

<sup>62</sup> Bash, vepër e cituar, f. 37-39.

Qendrat më të njohura të interpretimit të Kuranit gjatë periudhës tabiine ishin ajo e Mekës, Medinës dhe Irakut. Themeluesi i shkollës mekase ishte Abdullah bin Abbasi. Ndër nxënësit më të njohur të tij ishin Said bin Xhubejr (v. 95 h.), Muxhahid (v. 103 h.), Ikrime (v. 105 h.), Ata bin Ebi Rabah (vd. 114 h.) dhe Tavus bin Kejsan (v. 106 h.). Në qendrën e Medinës e cila udhëhiqej nga Ubej bin Ka'b ishin të njohur, Ebu'l-Alije (v. 90 h.) dhe Zejd bin Eslem (v. 136 h.). Ndërsa qendra e Irakut themeluesi së cilës ishte Abdullah bin Mes'ud, kishte ndër nxënësit më të njohur Alkame bin Kajs (v. 62 h.), Mesruk bin El Exhda (v. 63 h.), Hasan El Basri (v. 110 h.), Katade bin Diame (v. 117 h.).<sup>63</sup>

Sahabët nuk e interpretuan Kuranin të tërin, ata u fokusuan vetëm në interpretimin e ajeteve të paqarta që kishin nevojë për sqarime më të thella; po ashtu ata u njaftuan me njohuri dhe metoda më të përmbledhura si lidhshmëria e një ajeti me ajetin tjetër apo të një kaptine me tjetrën apo ndërlidhja e ajetit me shkakun e zbritjes etj. Ndërsa nga ana tjetër, në periudhën e tabiinëve, filloi të bëhet interpretimi i çdo ajeti dhe çdo fjale në kuadër të këndvështrimeve të ndryshme. Edhe pse shkencë e tefsirit në periudhën e sahabëve shihej si një nëndegë e shkencës së hadithit, ajo u bë një degë e pavarur e kësaj shkence në kohën e tabiinëve. Prandaj, kjo periudhë është periudha kur filloi shkrimi dhe koleksionimi i veprave në fushën e tefsirit.<sup>64</sup>

Shkrimi i tekstit kuanor në fillimet e tij si dhe në mus'hafin e kodifikuar në kohën e Othmanit r.a ishte pa pika, viza, shenja etj., pra ishin vetëm konsonantet (bashkëtingëlloret) të cilat nuk ishin të shënuara me pika. Mirëpo kjo gjendje nuk shkaktonte asnjë pengesë në leximin e drejtë të tij nga ana e sahabëve ngase ata ishin prezentë gjatë zbritjes së tij dhe e memorizuan atë. Mirëpo zgjerimi i gjeografisë islame, çlirimet e reja dhe vështirësia e leximit që filloi me hyrjen e elementeve persiane në Islam, bëri që të shtrembërohej kuptimi i disa fjalëve kuranore. Për

<sup>63</sup> Zerkani, *Menahilu'l-Irfan fi Ulumi'l-Kuran*, II, 19-22; Mennau'l-Kattan, Halil, *Mebahith fi Ulumi'l-Kuran*, Bejrut: Mektebetu'l-Mearif li'n-Neshri ve't-Tevzi', 1421/2000, f. 7.

<sup>64</sup> Xherahoglu, vepër e cituar, I, 141-143, 146, 168.

këtë qëllim, me kërkesën e mëkëmbësit të Basrës Zijad bin Sumejje (v. 53/673) Ebu'l-Esved ed-Dueliu (vd. 69/688) është i pari që shpiku shenjat të cilat në mus'hafe janë shkruar me ngjyrë tjetër dhe i kanë përfaqësuar vokalet e sotme. Këto shenja ishin pika në këto forma: një pikë mbi harf paraqiste vokalin “fetha”, një pikë nga ana e majtë e shkronjës paraqiste “dammeh” një pikë nën shkronjë paraqiste vokalin “kesreh”, tenvinin e paraqisnin dy pika njëra pranë tjetrës.<sup>65</sup> Kjo formoi bazën e shkencës së “i’rabu’l-Kuranit”.<sup>66</sup> Nxënësi i Ed Dueliut-Nasër bin Asim El Lejthi- praktikisht është i pari i cili bëri reformë në shkrimin e konsonanteve kuranore e me këtë edhe të konsonanteve të gjuhës arabe në përgjithësi. Përmirësimet ortografike të Halil bin Ahmedit (v. 175/791) gjithashtu janë të rëndësishme si kaptinë në historinë e Kuranit dhe kontribut i konsiderueshëm në përmirësimin e formës së shkrimit kuranor.<sup>67</sup> Libri “El Kitab” i Sibevejhrit mund të konsiderohet si burimi i parë i literaturës mbi shkencën “i’rabu’l-Kuran.”<sup>68</sup>

Po ashtu distanca kohore në mes të shpalljes dhe periudhës së tabiinëve krijoi nevojën e kërkimit të njohurive mbi shpalljen. Ky fakt përshpejtoi shfaqjen e shkencave kuranore nën tituj të veçantë. Në kuadër të kësaj, një nga shkencat që doli në pah dhe që kishte një rol të rëndësishëm në kuptimin e drejtë të Kuranit ishte edhe shkencë e “esbabu’n-nuzulit”.<sup>69</sup> Kjo disiplinë e cila në tefsir njihet si shkencë që merret me shkaqet apo ngjarjet që çuan në shpalljen e ajeteve, pati një rol parësor në kuptimin e Kuranit nga ana e sahabëve.<sup>70</sup> Duke qenë prezentë në ngjarjen e shpalljes, ata nuk e ndjenë nevojën për të hartuar një vepër të pavarur në këtë fushë gjatë periudhës së tyre. Mirëpo pasuesit e tyre “tabiinët”, të cilët nuk ishin prezentë dhe nuk kishin njohuri mbi shkaqet e shpalljes së ajeteve, kishin nevojë për nxjerrjen në pah të një vepre në

<sup>65</sup> Zerkani, vepër e cituar, I, 408.

<sup>66</sup> Mennau’l-Kattan, “Kuran Ilimlerinin Tarifi, Ortaya Çikishi ve Gelishmesi”, f. 188.

<sup>67</sup> Xherahoglu, vepër e cituar, f. 88-91.

<sup>68</sup> Ibën Nedim, *El Fihrist*, f. 92.

<sup>69</sup> Sujutiu, *El Itkan*, I, 108

<sup>70</sup> Mennau’l-Kattan, *Mebahith fi Ulumi’l-Kuran*, f. 75.

këtë fushë. Edhe pse thuhet që vepra e parë në këtë temë është shkruar nga nxënësi i Ibën Abbasit (r.a.), Ikrime (v. 104/722), në një transmetim nga mufesiri i njohur Es Sulemi (v. 412/1021) vepra e quajtur *Tenzilu'l-Kuran* e shkruar prej Ibën Shihab El Zuhriut (v. 124/742) konsiderohet literatura e parë e shkruar në këtë fushë.<sup>71</sup>

Një nga problemet që u shfaq veçanërisht me hyrjen e elementeve të huaja në Islam ishte interpretimi i fjalëve të huaja në Kuran. Kjo hapi rrugë për shfaqjen e shkencës së njohur “garibu’l-Kuran”. Sqarimet mbi këtë shkencë përgjithësisht bazohen tek Ibën Abbasi, madje thuhet se ai ka shkruar veprën e parë në këtë fushë.<sup>72</sup> Mirëpo, kur marrim parasysh se qasjet leksikore në ekzgjegjzen kuranore fituan rëndësi në gjysmën e parë të shekullit të dytë, domosdoshmëria për të iu qasur këtyre prete-ndimeve me kujdes bëhet e evidente. Sipas mendimit të përgjithshëm, vepra e parë mbi këtë fushë ishte *Garibu’l-Kuran* e shkruar nga Ata bin Ebi Rabah (114/732). Po ashtu Eban bin Taglib bin Rebah (v. 141/758) shkroi një vepër mbi këtë temë.<sup>73</sup>

## V. Koncepti i Ulumul Kuranit në periudhën e mëvonshme

Shkenca e tefsirit u bë një degë e pavarur nga shkenca e hadithit, me shkrimin e veprave të pavarura që nga koha e “tabiinëve” dhe veçanërisht “etbau’t-tabiinëve”.<sup>74</sup> Në periudhën e tabiinëve, me urdhërin e Umer bin Abdulazizit, hadithet e Pejgamberit, a.s, mendimet e sahabëve dhe pikëpamjet e tabiinëve u përpiluan duke mos e ndjekur ndonjë rregull të veçantë. Meqenëse ky përpilim pas një kohe shkaktoi disa vështirësi, fi-

<sup>71</sup> Birishik, vepër e cituar, XLII, 134.

<sup>72</sup> Demirci, *Kuran'in Muteshabihleri Uzerine*, Stamboll: Birleshik, 1996, f. 28. Ndërsa sipas disa dijetarëve, i pari që punoi në këtë fushë ishte Ma'mer bin El Muthenna (vd.210/825). Xherrahoglu, vepër e cituar, f. 152-153.

<sup>73</sup> Katip Çelebi, *Keshfu'z-Zunun*, Stamboll: Tarih Vakfi Jurtu, I, 1207; Demirci, vepër e cituar, f. 29.

<sup>74</sup> Xherrahoglu, Tefsir Tarihi, I, 174-175.

lloi “klasifikimi” i tyre në kohën e etbau’-t-tabiinëve. Kjo periudhë konsiderohet si periudha e vendosjes së sistemit të transmetimit (isnadit).<sup>75</sup>

Në këtë periudhë, e cila në aspektin e koleksionimit të shkencave mund të konsiderohet si epoka e artë e “Ulumul Kuranit”, u shkruan vepër mbi shkencat kuranore si “meani’l-Kuran, esbabu’n-nuzul, nasih-mensuh, mushkilul-Kuran, vuxhuh-nedhair” etj. Gjithashtu ia vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe Ebu Bekr bin Muxhahidi (v. 324/935) bëri klasifikimin e shtatë imamëve pra leximeve mutevatir dhe stileve të tyre të leximit. Prandaj, kjo mund të konsiderohet si një periudhë kohore në të cilën shkrimet janë të përqendruara në “shkencën e kiraetit”.<sup>76</sup>

Në gjysmën e dytë të shekullit të tretë, çlirimet nga ana e myslimanëve i sollën ata ballë për ballë me kultura të ndryshme si indiane dhe iraniane në lindje dhe filozofinë greke në perëndim. Në këtë mjedis, u shfaqën edhe disa qasje heretike të cilat mohuan autenticitetin hyjnor dhe aspektin e mrekullisë së Kuranit. Fjala vjen, është transmetuar që Abdullah bin Mukaffa (v. 142/759) shkroi një vepër duke mohuar origjinalitetin hyjnor të Kuranit, ndërsa si përgjigje ndaj kësaj dijetari Kasim bin Ibrahim Er Razi (v. 246/860) shkroi librin, *Er Red ala Zindiki’l-Lain Ibën Mukaffa*.<sup>77</sup> Kjo tregon faktin se në përpilimin e disa shkencave në kuadër të “Ulumul Kuranit” ndikuan edhe disa lëvizje kundër Kuranit të cilët nganjëherë përdorën edhe ajetet e Kuranit për të mbështetur idetë e tyre. Në këtë frymë u themelua edhe shkenca “Ixhazu’l-Kuran” e cila kishte për qëllim studimin e gjuhës së Kuranit, elekuencën, përmbajtjen, të fshehtësë dhe mbrojtjen e tij deri në ditën e gjykimit.<sup>78</sup> Vepra e parë e shkruar në këtë fushë ishte *Nazmu’l-Kuran* e dijetarit Xhahiz (v. 255/869).<sup>79</sup>

Mrekullia e Kuranit bazohet në epërsinë në elokuencë dhe në unikalitetin e tij. Përshatshmëria e çdo fjale me ajetin ose me ajetet paraprake

<sup>75</sup> Ulu, “Tebeu’t-Tâbiîn” XL, 217.

<sup>76</sup> Bash, vepër e cituar, f. 38.

<sup>77</sup> Bash, vepër e cituar, f. 36.

<sup>78</sup> Menau’l-Kattana, *Mebahith*, f. 270.

<sup>79</sup> Abdurrahman, Ajshe, *El I’xhazu’l-Bejani li’l-Kuran ve Mesailu Ibni’l-Ezrak*, Daru’l-Mearif, f. 22.

dhe pasuese si dhe aftësia për të shprehur kuptime shumë të gjera me një numër të vogël fjalësh, tregon faktin se Kurani i takon vetëm Allahut, i cili përfshin çdo gjë me njohuritë e Tij dhe di çdo fjalë në mënyrë të përsosur. Renditja e fjalëve në të është vepër e një fuqie dhe dijeje që e tejkalon atë njerëzore. Kjo gjendje përbën një nga aspektet e ixhazit (mrekullisë) kuranore dhe është emërtuar si shkenca e “munasebetu’s-suver ve’l-ajat/ Lidhmëria në mes sureve dhe ajeteve.”<sup>80</sup> Sipas Sujutiut vepra e parë e shkruar në këtë fushë është ajo e Ebu Bekr en-Nisaburi (v. 324/936).<sup>81</sup>

Edhe pse në shekujt e parë dhe të dytë Hixhëri nuk kemi ndonjë vepër specifike në lidhje me “Ulumul Kuran”, mund të rastisim në shkrime dhe pjesë të tefsireve që përmbajnë njohuri të ndryshme mbi konceptin e shkencave kuranore në këtë periudhë. Megjithatë, kuptohet se koncepti nuk u shfaq në këtë periudhë në atë mënyrë që të shprehë një disiplinë sistematike shkencore.

## Përfundim

Gjatë historisë janë bërë studime dhe hulumtime të shumta për të kuptuar Kurandin, burimin kryesor të Islamit. Këto studime për të kuptuar fjalën e Zotit xh.sh fillimisht bëheshin të shpërndara në tema të ndryshme të cilat më vonë u përpiluan nën tituj të veçantë të “Ulumul Kuranit”. Meqenëse objektivi studimor i Ulumul Kuranit është vetë Kurani, procesi i formimit të tij filloi me vetë shpalljen. Edhe pse jo në formë të sistemuar ajo ishte e para e kësaj shkence dhe mund të thuhet se themelet e para të saj i ka hedhur Muhamedi a.s. Këndimi dhe mësimi përmendësh i ajeteve nga ana e Pejgamberit a.s, procesi i shkrimit, shpjegimi, këshilla e tij për sahabët që të mësojnë fjalët nga poezitë e injorancës që nuk i dinin etj., mund të konsiderohen si shembujt e parë të shkencave kura-

---

<sup>80</sup> Gernati, Ahmed bin Ibrahim, *El Burhan fi Tenasubi Suveri’l-Kuran*, Thk. Muhammed Shabani, Egjipt: Vizaratu’l-Evkaf ve’sh-Shuni’l-Islamijje, 1410/1990, f. 180-181.

<sup>81</sup> Sujuti, *El Itkan*, III, 369.



nore. Pra objekt studimi i këtyre shkencave janë dimensionet fetare, historike, sociologjike dhe psikologjike që gjenden në Kuran.

Sahabët ishin brezi i parë që morën edukimin kuranor nga Pejgamberi, a.s, ata këto njohuri të vlefshme si një emanet i veçantë ua përcollën gjeneratave të ardhshme me shumë zell. Faktorët kryesorë që ua mundësuan atyre të jenë kompetentë në shkencat kuranore ishin: Kuptimi i drejtë i ajeteve të Kuranit, prezenca e tyre në mjedisin e shpalljes, kalitja i tyre nga edukimi i Pejgamberit a.s, si dhe zbatimi i dispozitave kuranore në jetën e tyre në dimension praktik.

Kontributi kryesor i sahabëve në shkencat kuranore del në pah pas vdekjes së Pejgamberit a.s. për shkak të përfundimit të vahjit i cili ishte një proces kontrolli hyjnor. Hapat vendimtarë që ata ndërmorën drejt tubimit dhe kodifikimit të Kuranit ishin përpjekje që ruajtën integritetin dhe kuptimin e tekstit kuranor kundër çdo ndryshimi. Ata në këtë formë hodhën themelet e shkencave kuranore duke transferuar këto njohuri tek brezat e mëvonshëm (tabi'inët) në saje të të cilëve shumica e transmetimeve të tefsirit arritën deri në kohërat tona.

Për shkak të rrezikut të përzierjes së tekstit të shenjtë të Kuranit me njohuri tjera, deri në shekullin e dytë Hixhëri, çdo njohuri tjetër përveç Kuranit përcillej vetëm gojarisht. Ndërsa me fillimin e ndarjes dhe koleksionimit të shkencave filloi edhe shkrimi i veprave të para mbi shkencat e Ulumul Kuranit. Veprat e para të shkruara në këtë shkencë ishin të një cilësie që përmbanin vetëm një shkencë të veçantë të Ulumul Kuranit. Fjala vjen, shkruheshin vepra në lidhje me garibu'l-Kuranin, ose vepra tjera mbi shkencën i'rabu'l-Kuran, dhe disa tjera mbi nes'hin etj.

Veprat e para të sistemuara veçanërisht mbi tematikën "Ulumul Kur'an" filluan të shkruheshin në fund të shekullit III h. Këto vepra u shkruan duke mbledhur studimet e mëhershme të natyrës së Ulumul Kuranit. Edhe pse studiuesit e periudhës së vonë, të cilët shkruan vepra në fushën e shkencave të Kuranit, pretendojnë se ato janë të pakufizuara, nuk duhet të neglizhohet fakti se ato përfshijnë vetëm shkencë që kontribuojnë në nxjerrjen e kuptimeve të Kuranit. Subjektet në këto punime janë informacione procedurale në këtë fushë.

# Koncepti pejgamberik ndaj “tjetrit”<sup>1</sup>

Prof. Ass. Dr. Zija Abdullahu

## Abstrakt

Pejgamberi, a.s., kishte një mirësjellje të lartë me të gjithë njerëzit. Kjo sjellje reflektohej jo vetëm me myslimanët por edhe me të tjerët që nuk ishin myslimanë, siç ishin mushrikët (politeistët), e gjithsesi edhe me Ithtarët e Librit. Sjellja e tij buronte nga morali i lartë i artikuluar nga Kurani famëlartë, madje kjo ishte përgjigja e Aishes, r.a., kur u pyet për moralin e tij, a.s.,ajo tha: “Moralin e tij ishte Kurani”<sup>2</sup>. Ky moral në thelb buronte nga mëshira që kishte për mbarë njerëzimin, sa që shtrihej jo vetëm ndaj myslimanëve, por edhe ndaj çdo njeriu tjetër pa marrë parasysh besimin e tij, qoftë edhe ndaj idhujtarëve, bile edhe armiqve. Madje mëshira e tij e tejkalonte gjininë njerëzore duke përfshirë çdo gjallesë tjetër.<sup>3</sup> Qëndrimet e mëshirës së tij shfaqeshin në shumë

<sup>1</sup> Me “tjetrit” nënkuptohet çdo njeri tjetër që nuk është i besimit islam, pa marrë parasysh besimin tjetër të cilit i takon, është fetar, ateist apo idhujtar.

<sup>2</sup> Ahmedi në Musned, Musnedu’s-Siddika Aishete bintu’s-Sid-dik, nr. had. 25302.

<sup>3</sup> Në përmbledhjet e librave të hadithit kemi shumë hadithe që porositin për kujdes ndaj kafshëve, këtu i shënojmë vetëm disa nga se hapësira nuk na lejon më shumë: “Abdullah bin Mesudi në një transmetim thotë: Ishim me të Dërguarin e Allahut, a.s., në një udhëtim, ai u larguar për një nevojë. Ne e pamë një skuqavec (zog i vogël), dhe me të dy zogj të vegjël, e ne ia morëm zogjtë e saj. Erdhi skuqavec i rrahur krahët, kur erdhi Pejgamberi, a.s. tha: “Kush e ka tronditur këtë me fëmijët e saj? Kthejani të vegjlit e

aspekte si në momentet më kritike kur edhe sulmohej jo vetëm në aspektin psikik por edhe kur kishte lëndime fizike. Ai në vend se të lutej kundër tyre, lutej dhe kujdesej jo vetëm për ata por edhe për pasurin e tyre. Këto qëndrime i hasim në shumë raste; si në rastin e braktisjes së Mekës kur e la Aliun, r.a., që t'ua shpërndaj pasurinë që e kishin lënë amanet pronarëve të tyre, edhe pse ata kishin ardhur për ta mbytë atë. Po ashtu peripecitë që pati në Taif, dhe me mundësinë e shfarosjes së atij populli, ai në të kundërtën u lut për ata. Gjithashtu edhe në betejën e Uhudit edhe pse u lëndua fizikisht ai lutej për ata që ia thyen dhëmbin dhe ia gjakosën fytyrën. Ndërsa me ithtarët e librit kishte një sjellje edhe më të veçantë, ngase besimi në esencë ishte i përbashkët në shumë çështje me myslimanët. Ai ishte i kujdesshëm për mbrojtjen e të gjithëve, kishte sjellje të butë, i vizitonte të sëmurët, i respektonte të vdekurit e tyre duke u zgjuar në këmbë, ishte i drejtë edhe atëherë kur drejtësia ishte në dëm të myslimanëve, gjithashtu kishte marrëdhënie financiare me ata. Pejgamberi, a.s., këto marrëdhënie nuk i pati vetëm në mënyrë individuale dhe teorike, por, i artikuloi edhe në praktikë në Medine, duke i bërë çifutët të barabartë me myslimanët në shtet-formim, me formulimin e Kartës së Medinës apo siç njihet edhe si Kushtetuta e Medinës.

**Fjalët kyçe:** Pejgamberi, mëshirë, politeizëm, dhurata, ithtarët e librit.

---

*saj*". [Suneni i Ebu Davudit, kitabu: El Xhihad, babu: fi keraheti harki-l aduvvi, nr. had. 2300]. "Ibën Umeri, r.a., transmeton prej Pejgamberit, a.s. se tha: "Një grua ka hyrë në zjarr për një mace, të cilën e lidhi, e që nuk e ushqeu as e la të ushqehet nga bimët e tokës". [Buhariu në Sahih, kitabu: Bed'ul halk, babu: humsun mined-davabbi fevasikun, nr. had. 3155]. "Prej Xhabirit, r.a., transmetohet se Pejgamberi, a.s., kaloi pranë një gomari të cilit ia kishin djegur fytyrën me hekur. Pejgamberi tha: "Allahu e mallkoftë atë të cilin e ka djegur kështu". [Muslimi në Sahih, kitabu: El Libas vEz ziine, babu: En-Nehju an darbi'l hajvani, nr. had. 4047].

## Abstract

The Prophet, peace be upon him, had a high courtesy towards all people. This behavior was reflected not only with Muslims but also with others who were not Muslims, such as the mushriks (polytheists), and anyway with the People of the Book. His behavior stemmed from the high morals articulated by the holy Quran, even this was the answer of Aisha, r.a., when she was asked about his morals, a.s., she said: "His morals were the Quran". This morality basically stemmed from the mercy he had for all mankind, which extended not only to Muslims, but also to every other person regardless of his faith, even to idolaters and even to enemies. His mercy even exceeded the human race by including every other living thing. His attitudes of mercy appeared in many aspects, such as in the most critical moments when he was attacked not only in the psychic aspect but also when he had physical injuries. Instead of praying against them, he prayed and cared not only for them but also for their property. We encounter these attitudes in many cases; as in the case of the abandonment of Makkah when he left Ali, may God bless him and grant him peace, to distribute the wealth that they had entrusted to their owners, even though they had come to suffocate him. Also the vicissitudes that he had in Taif, and with the possibility of the extermination of that people, he instead prayed for them. Also in the battle of Uhud, even though he was physically injured, he prayed for those who broke his tooth and bled his face. While with the followers of the book there was an even more special behavior, because the belief in essence was common in many matters with the Muslims. He was careful for the protection of all, had a gentle manner, visited the sick, respected their dead by waking up on their feet, was just even when justice was against the Muslims, also had financial dealings with them. The Prophet, peace be upon him, did not only have

these relationships individually and theoretically, but also articulated them in practice in Medina, making Jews equal to Muslims in state formation, with the formulation of the Charter of Medina or as also known as the Constitution of Medina.

**Keywords:** Prophet, mercy, polytheism, gift, Followers of the Book,

## Hyrje

Allahu, xh.sh., në Kuranin famëlartë e thekson mëshirën e Pejgamberit, a.s., duke thënë:

﴿وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ﴾

*“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët”.<sup>4</sup>*

Ajeti na e bënë të qartë se mëshira e tij ka qenë gjithëpërfshirëse për të gjitha *botët*, e që “është e tërë ekzistenca pos Zotit: bota e melaqeve, bota e xhindeve, bota njerëzore, bota e tërë gjallesave, bota bimore, e sendeve etj.”<sup>5</sup> Prandaj, përfshihen të gjitha krijesat, sepse çdonjëra prej tyre e ka botën e vet, dhe është botë në vete në aspektin e species së saj. “Me këtë veti të “mëshirës për botët”, nuk gjejmë në tërë Kuranin fisnik që është cilësuar ndonjë pejgamber tjetër pos Pejgamberit, a.s.”<sup>6</sup> Mënyra se si e manifestoi Pejgamberi, a.s., mëshirën e tij edhe në rastet kur nga njeriu si zakonisht pritet një kundër reagim së paku i papëlqyer, e nëse do të ishte edhe armiqësor do të dukej si normal? Çfarë qëndrimi pati ndaj politeistëve, të cilët e përndjekin, torturuan madje edhe e dëbuan

<sup>4</sup> El-Enbija, 107.

<sup>5</sup> Muhammed MutevEl li Esh Sh’aravi, “*Tefsiru Esh Sh’aravi – Havatir*, bot. Ahabru’l Jevm, Kajro, 1997, v. 16, f. 9675.

<sup>6</sup> Muhamed Tahir bin Ashur, “*Tefsir Et Tehrir ve’t Tenvir*, Daru’t Tunisije li’n Neshr, Tunis, 1984, v. 17, f. 167.

nga vendlindja? Si sillej në momentet më të vështira, në luftëra me armiqtë e tij? Si i trajtonte ata të cilët orvateshin në çdo mënyrë ta likuidonin atë? Çfarë qëndrimi pati me Ithtarët e Librit? Si i konsideroi të sëmurët e tyre? Si ishte drejtësia e tij me të *tjerët* edhe atëherë kur ishte në dëm të myslimanëve? Në çfarë baza i bëri marrëveshjet me të *tjerët*, e sidomos në Kartën e Medinës? Këto përgjigje dhe shqyrtime tjera ndaj *tjetrit* nga Pejgamberi, a.s., do t'i shohim në trajtesat e haditheve, udhëzimeve dhe normave që ia caktoi myslimanit në sjelljet e tij me tjetrin, duke mos ia lënë atë dëshirës dhe tekeve të tij momentale, apo nënshtrimit ndaj situatës nën të cilën gjendet.

## 1. Sjellja e Pejgamberit, a.s., ndaj mushrikëve (politeistëve)

Nga qëndrimet madhështore të sjelljes së lartë dhe mëshirës së tij ishte qëndrimi që pati kur u kthye nga Taifi.<sup>7</sup> Pejgamberi, a.s., shkoi ta ftojë popullin e atij qyteti në fe, por në vend që ta pranonin fenë e Zotit, apo së paku të rrinin indiferent, ata jo vetëm e kundërshtuan por edhe u tallën me të, madje, për më tepër, edhe e përdoqën atë. Nuk u mjaftuan vetëm të rriturit, e sidomos të fisit Thekiif, por me të dalë Pejgamberi, a.s., nga Taifi, ata i nxitën fëmijët që ta gjuanin me gurë, saqë ia gjakosën edhe këmbët e tij.<sup>8</sup> Megjithëkëtë torturë të talljes, nënçmimit dhe armiqësisë që treguan ndaj tij, ai, a.s., përsëri ishte zemërgjerë, dhe sillej ndaj tyre si prindi ndaj fëmijëve, duke e pasur parasysh injorancën e cila i pati kapluar. Prandaj nga mëshira dhe dhembshuria që pati ndaj tyre, me gjithë atë tmerr që përjetoi nga ata, ai edhe pse pati mundësi të hakmerrëj në mënyrën më brutale dhe efikase, madje edhe t'i fshijë tërësisht nga faqja e dheut përmes melekëve që ishin dërguar enkas për dënimin e tyre, ai jo vetëm që ua fali, por edhe u lut për ata duke shpresuar që

---

<sup>7</sup> Taifi; është qytet në juglindje të Mekës dhe është larg saj 86 km.

<sup>8</sup> Abdul Melik bin Hisham, "Es Siretu'n-Nebevije", Kajro, 1990, v. I, f. 418-420.

Allahu, xh.sh., të nxjerr nga ata robër që do ta adhuronin Zotin.<sup>9</sup> Këtë ngjarje e mësojmë nga Aisheja, r.a., kur në një rast ajo e pyeti Pejgamberin, a.s., për ditët më të vështira që ka përjetuar me popullin e tij, përveç ditës së Uhudit, duke i thënë:

أَنَّ عَائِشَةَ . رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا . زَوْجَ النَّبِيِّ ﷺ حَدَّثَتْهُ أَنَّهَا قَالَتْ لِلنَّبِيِّ ﷺ هَلْ أَتَى عَلَيْكَ يَوْمٌ كَانَ أَشَدَّ مِنْ يَوْمِ أُحُدٍ قَالَ " لَقَدْ لَقِيتُ مِنْ قَوْمِكَ مَا لَقِيتُ، وَكَانَ أَشَدَّ مَا لَقِيتُ مِنْهُمْ يَوْمَ الْعَقَبَةِ، إِذْ عَرَضْتُ نَفْسِي عَلَى ابْنِ عَبْدِ يَالِيلَ بْنِ عَبْدِ كِلَابٍ، فَلَمْ يُجِئْنِي إِلَى مَا أَرَدْتُ، فَأَنْطَلَقْتُ وَأَنَا مَهْمُومٌ عَلَى وَجْهِي، فَلَمْ أَسْتَفِيقْ إِلَّا وَأَنَا بِقَرْنِ الثَّعَالِبِ، فَرَفَعْتُ رَأْسِي، فَإِذَا أَنَا بِسَحَابَةٍ قَدْ أَظَلَّتْنِي، فَتَنَطَّرْتُ فَإِذَا فِيهَا جِبْرِيْلُ فَنَادَانِي فَقَالَ إِنَّ اللَّهَ قَدْ سَمِعَ قَوْلَ قَوْمِكَ لَكَ وَمَا رَدُّوا عَلَيْكَ، وَقَدْ بَعَثَ إِلَيْكَ مَلَكَ الْجِبَالِ لِتَأْمُرَهُ بِمَا شِئْتَ فِيهِمْ، فَنَادَانِي مَلَكُ الْجِبَالِ، فَسَلَّمَ عَلَيَّ ثُمَّ قَالَ يَا مُحَمَّدُ، فَقَالَ ذَلِكَ فِيمَا شِئْتَ، إِنَّ شِئْتَ أَنْ أُطِيقَ عَلَيْهِمُ الْأَخْشَبِينَ، فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ بَلْ أَرْجُو أَنْ يُخْرِجَ اللَّهُ مِنْ أَصْلَابِهِمْ مَنْ يَعْبُدُ اللَّهَ وَحْدَهُ لَا يُشْرِكُ بِهِ شَيْئًا.

*“O i dërguar i Allahut, a ke hasur ndonjë ditë më të vështirë se sa dita e Uhudit? Pejgamberi, a.s., u përgjigj: “Në të vërtetë populli yt më ka shqetësuar shumë, dhe vuajtjen më të madhe e kisha në ditën e Akabes, kur iu paraqita Ibën Abdu Jalile bin Abdu Kulalit, (me synimin për ta ftuar në Islam), por ata nuk iu përgjigjen ftesës sime. Kështu u largova nga aty duke qenë i dëshpëruar, dhe nuk jam kthjellur derisa kam arritur në vendin e quajtur Karnuth Thealib, ku ngrita kokën aty pash një re që më mbulonte papritur. Ngrita sytë dhe pash Xhibrilin . Ai më thirri duke thënë: “Allahu i Lartmadhëruar e ka dëgjuar bisedën e popullit për ty, dhe atë që ata të janë përgjigjur ty! Allahu ta dërgoi melekun e kodrave që ta urdhërosh*

<sup>9</sup> Shih gjerësisht për ftesën e Pejgamberit a.s. në Taif: Safijjurr Rahman El Mubarekfuri, *Netkari i vulosur i xhenetit*, përkth. nga boshnj. Muhamed Iljaz Dolaku, Prishtinë, 2001, f. 147-151.

të bëj çfarë të duash ndaj tyre". Meleku i kodrave më thirri e më përshëndeti e pastaj më tha: "O Muhamed! Urdhëro çfarë të duash. Nëse dëshiron i bashkoj dy kodrat të bien mbi ata. Pejgamberi, a.s., tha: "Jo, por shpresoj se Allahu do t'i lërë ata të lindin fëmijë të cilët nuk do të adhurojnë askënd tjetër përveç Tij dhe nuk do t'i bëjnë shok Atij".<sup>10</sup>

Pejgamberi, a.s., në momentet edhe më të vështira, dhe në ato më kritike, kur ishte i lënduar jo vetëm në aspektin psikik por edhe në atë fizik, madje kur merrte plagë të rënda, dhe kur kishte mundësi të hakmerrej kundër mushrikëve, (politeistëve) ai, a.s., e bënte të kundërtën, në vend se t'i mallkonte ai lutej për ata. Këtë e shohim qartë dhe në mënyrë praktike në betejën e Uhudit kur Pejgamberit, a.s., iu thye dhëmbi në nofullën e djathtë, dhe balli iu lëndua, siç na e tregon ngjarjen Abdullah bin Ubejdi dhe thotë:

عَبْدُ اللَّهِ بْنِ عُبَيْدٍ ، قَالَ: لَمَّا كُسِرَتْ رُبَاعِيَّةُ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، وَشَجَّ فِي جَبْهَتِهِ، فَجَعَلَتِ الدِّمَاءُ تَسِيلُ عَلَى وَجْهِهِ، قِيلَ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، اذْعُ اللَّهُ عَلَيْهِمْ، فَقَالَ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: "إِنَّ اللَّهَ تَعَالَى، لَمْ يَبْعَنِي طَعَانًا وَلَا لَعَانًا، وَلَكِنْ بَعَنِي دَاعِيَةَ وَرَحْمَةً، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِقَوْمِي فَإِنَّهُمْ لَا يَعْلَمُونَ.

"Kur të Dërguarit të Allahut iu thye dhëmbi para dhëmballëve, dhe u lëndua në ballë, saqë gjaku i rridhte nëpër fytyrë, dikush i tha: O i Dërguar i Allahut, lutu kundër tyre! Ai, a.s., iu përgjigj: "Allahu i Lartësuar nuk më dërgoi shpifës e as mallkues, por më dërgoi ftues dhe mëshirues. O Zot falua popullit tim sepse ata nuk e dinë".<sup>11</sup>

Në një rast tjetër të cilin e transmeton Ebu Hurejra, r.a., e tha:

<sup>10</sup> Buhari në Sahih, kitabu: Bed'u'l halk, babu: Idha kale ehadukum Amin, nr. i hadithit: 3231.

<sup>11</sup> Bejhëkiu në *Shuabi-l Iman*, faslun: Fi hudabin-Nebij, a.s., ala ummetihi..., had. nr. 1425.



قِيلَ يَا رَسُولَ اللَّهِ اذْعُ عَلَيَّ الْمُشْرِكِينَ قَالَ إِنِّي لَمْ أُبْعَثْ لَعَانًا وَإِنَّمَا بُعِثْتُ رَحْمَةً

*“Dikush i tha Pejgamberit: O i Dërguar i Allahut, lutu kundër idhujtarëve, ai tha: “Nuk jam dërguar mallkues, por jam dërguar mëshirë”.*<sup>12</sup>

Pejgamberi, a.s., në vështirësitë më të mëdha, madje edhe kur donin që ta mbytnin, edhe në ato çaste ai mendonte dhe ishte i mëshirshëm ndaj armiqve të tij. Këtë më së miri e ilustron ngjarja e braktisjes së Mekës, kur idhujtarët e thurën kurthin që ta vrisnin Pejgamberin, a.s., duke e përgatitur nga një djalë të ri nga secili fis që gjendej në Mekë. Këtë, për ta shpërndarë gjakun e tij nëpër tërë fiset e Mekës, që t’i pamundësohet fisit të Pejgamberit hakmarrja ndaj tyre! Këto ishin planet e tyre që i kurdisën ndaj Pejgamberit, a.s., por Xhibrili, a.s., sipas transmetimit të Ibën Hishamit, “kishte ardhur te i dërguari i Allahut dhe i kishte thënë: *Sonte mos buj në shtratin tënd në të cilën flije më parë*. Tha: kur erdhi errësira e natës u tubuan pranë derës së tij për ta pritur kur të flejë ta sulmojnë. Pejgamberi, a.s. kur i pa pozitat e tyre i tha Aliut: *“Fli në shtratin tim dhe mbulohe me xhyben time të gjelbër hadramite (ishte e sjellë nga Hadrameti - Jemeni v.i.) me pjesën e parë të saj. Fli në të, ata vërtetë nuk do të mund të shkaktojnë asgjë që do ta urresh”*. Pejgamberi, a.s., mbulohej me atë xhybe kur flinte”.<sup>13</sup>

Shkaku i zëvendësimit të Aliut, r.a., në shtratin e tij ishte, siç e cekin studiuesit e biografisë së tij, shpërndarja e pasurisë së mushrikëve që e kishin lënë amanet t’ua ruante Pejgamberi. Ata në njërin anë e luftonin, ndërsa në anën tjetër ia linin pasurinë t’ua ruaj ngase te askush tjetër s’kishin besim pos te Pejgamberi, a.s.

Sa e çuditshme sjellja e tyre kontradiktore, ndërkohë sa mahnitëse dhe mbresëlënëse sjellja e Pejgamberit, a.s. Ata orvateshin ta mbytnin, ndërsa ky ende kujdesej për pasurinë e tyre! Vallë a ka pasur historia

<sup>12</sup> Muslimi në *Sahih*, kitabu: El Birr ve Es Sileh, babu: En-Nehju an la’ni ed-devabbi..., nr. 4704.

<sup>13</sup> Abdul Melik bin Hisham, “*Es Siretu En Nebeviye*”, v. II, f. 428-429.

ndonjëherë njeri të tillë kaq të kujdesshëm me mëshirën e tij ndaj armikut, madje, edhe ndaj pasurisë së armikut?

Nga qëndrimet më madhështore të Pejgamberit, a.s., ishte ai i faljes kolektive të banorëve të Mekës. Ata më parë jo vetëm që e kishin torturuar, persekutuar e përndjekur, por edhe nga vendlindja e kishin dëbuar. Për më tepër, edhe në Medinë shpesh e kishin sulmuar. Shumica e tyre ishin ende gjallë, madje, ata akoma e luftonin me të gjitha mjetet dhe mënyrat, deri në momentet e çlirimit të Mekës. Mirëpo, edhe pse situata ende ishte gjendje lufte, pra, çfarëdo veprimi nëse do të bënte do të ishte më se normal ai veprim. Madje ai, a.s., në ato çaste ishte njeriu me pushtet më të fuqishëm, dhe do të mjaftonte vetëm ndonjë shenjë nga ai që të gjithë t'i shfaros, apo cilin do të dëshironte. Por Pejgamberi, a.s., pasi e bëri *tavafin* (ritin e sjelljes shtatë herë rreth Qabes) në Qabe, u ndal në derën e saj, ndërkohë mekasit ishin tubuar aty, të cilët ende ishin idhujtarë. E mbajti një fjalim të shkurtër, në të cilin pasi e falënderoi Allahun, i shpalli disa dekrete, që kishin të bënin me vrasjen, dhe kriteret e shpërgimit të saj dhe me kamatën, iu drejtua fisit Kurejsh duke iu thënë: *"O fisi Kurejsh! Allahu ua ka larguar lavdërimin e "xhahilijetit" (periudhës së injorancës), dhe madhërimin me stërgjyshërit. Të gjithë njerëzit janë nga Ademi, kurse Ademi është nga dheu. Më pastaj e lexoi ajetin: "O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise për ta njohur njëri tjetrin. Më i nderuari për jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtetë, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë"*<sup>14</sup>

Më pas tha: "O fisi Kurejsh! Çka mendoni, si do të veprojnë unë me ju? I thanë: Do të veprosh me të mirë, vëlla bujarë dhe djalë i vëllait bujar: ai iu tha: "Shkoni ju jeni të lirë"<sup>15</sup>.

Pra, megjithëse Pejgamberi, a.s., kishte mundësi të hakmerrej e t'i ndëshkonte në çfarë mënyre të dëshironte, jo vetëm për veti por edhe

<sup>14</sup> El-Huxhurat, 13.

<sup>15</sup> Abdul Melik bin Hisham, "Es Siretun En Nebevije", v. IV, f. 295.

për sahabët e tjerë, ai, a.s., e zgjodhi faljen ndonëse akoma ata ishin idhujtarë.

I Dërguarit i Zotit nuk lejoi që myslimanët, nën udhëheqjen e tij, të hakmerren ndaj mizorive që ua kishin shkaktuar atyre në të gjitha fushat e jetës, si në ato shoqërore, politike, ekonomike etj., sepse nëse do të ndodhte një gjë e tillë, atëherë do të shndërrohej çështja nga ajo fetare e pastër, në atë të karakterit hakmarrës personal e privat. Pejgamberi, a.s., la të kuptohej se të gjitha ato zhvillime që kishin ndodhur nuk kishin qëllime të caktuara me interes të ngushtë personal apo privat të një grupi, fisi apo shoqërie të caktuar, por tërë ato peripeci, tortura e vuajtje ishin vetëm për të dominuar adhurimin ndaj Zotit Një, dhe që të vendoset ligji i Tij në shoqëri i cili është i pa të meta dhe nuk i jep përparësi askujt ndaj ndokujt tjetër. Këtë, sepse posa u arrit ky qëllim, u harruan padrejtësitë dhe hakmarrjet personale apo fisnore, dhe u falën të gjitha të kaluarat.

Ndërkaq, për dallim nga Krishterimi Palian i cili posa u përforcua dhe arriti të bëhet fe e pushtetit që dominonte në atë kohë, jo vetëm që u ndal përndjekja dhe torturimi ndaj të krishterëve, por edhe u shndërruan të krishterët nga të persekutuar në persekutues të tmerrshëm, siç njihet në histori, aq sa arriti gjendja deri te shpikja e gjykatave të inkuizicionit! Pra, shihet qartë se Krishterimi devijimin e parë e bëri duke e shndërruar fenë e Zotit, në çështje personale dhe private, duke e harruar tërësisht porosinë ungjillore të paqes dhe të dashurisë, bile u barazua me çdo lloj tmerri tjetër që shkaktonin tiranët apo grupet e tjera për interesa vetjake të tyre.<sup>16</sup>

---

<sup>16</sup> Shih më gjerësisht për përndjekjet e të Krishterëve dhe anasjelltas libri i autorit të këtij punimi, *Studim krahasimtarë i feve*, Shtëpia Botuese Dituria Islame, Prishtinë, 2010, f. 360-366.

## 2. Sjellja e Pejgamberit, a.s., me Ithtarët e Librit

Pejgamberi, a.s., pati një sjellje më të veçantë me Ithtarët e Librit. Po ashtu një trajtim më të lartë në krahasim me idhujtarët, ngase këta të fundit ndonëse kishin fe tjetër por në disa çështje kishin botëkuptime të përbashkëta, si në besim në metafizikë, (besimin në Zot, melek, exhin, etj.), në pejgamberë, në botën tjetër, ndonëse me devijime të caktuara, por në përgjithësi ekzistonte një besim i përbashkët në këto çështje.

### 2.1. Barazia në pejgamberi:

Pejgamberi, a.s., kur rrëfente për pejgamberët para tij, ai i konsideronte ata si vëllezër dhe të barabartë në misionin pejgamberik, e që ishte element i cili i afronte Ithtarët e Librit, prandaj e gjejmë se kishte një trajtim më të veçantë ndaj tyre. Prej Ebu Hurejres, r.a., transmetohet se:

أَنَا أَوْلَى النَّاسِ بِعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ، وَالْأَنْبِيَاءِ إِخْوَةٌ لِعَلَّاتٍ،  
أُمَّهَاتُهُمْ شَتَّى، وَدِينُهُمْ وَاحِدٌ.

"I dërguari i Allahut, a.s., ka thënë: *"Edhe në këtë botë edhe në botën tjetër, unë jam më i afërt nga të gjithë njerëzit me Isain të birin e Merjemes. Pejgamberët janë vëllezër nga babai, nënat e tyre janë të ndryshme, por feja e tyre është një"*.<sup>17</sup>

Edhe për Musain, a.s., pati një qëndrim përmes të cilit e tregoi afërsinë me të, madje edhe për të si për Isain, a.s., tha se e konsideron të afërt më shumë se sa vetë jahuditë. Kështu u shpreh pasi arriti në Medine siç e transmeton Ibën Abbasi e thotë:

عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَدِمَ الْمَدِينَةَ فَوَجَدَ الْيَهُودَ صِيَامًا يَوْمَ عَاشُورَاءَ فَقَالَ لَهُمْ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: "مَا هَذَا الْيَوْمِ الَّذِي تَصُومُونَهُ؟" فَقَالُوا: هَذَا يَوْمٌ عَظِيمٌ: أَنْجَى اللَّهُ فِيهِ مُوسَى وَقَوْمَهُ وَعَرَّقَ فِرْعَوْنَ وَقَوْمَهُ فَصَامَهُ مُوسَى شُكْرًا فَنَحْنُ نَصُومُهُ فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ

<sup>17</sup> Buhariu në Sahih, kitab: El Enbija; babu: Vedhkur fi-l Kitabi Merjem, nr. 3649.

وَسَلَّمَ: "فَنَحْنُ أَحَقُّ وَأَوْلَىٰ بِمُوسَىٰ مِنْكُمْ" فَصَامَهُ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَأَمَرَ بِصِيَامِهِ

*“Kur i dërguari i Allahut, a.s., erdhi në Medine i gjeti çifutët duke agjëruar ditën e Ashuresë (ditën e dhjetë - dhjetëshen të muajit muharrem). I dërguari i Allahut, a.s., iu tha: “Çfarë është rëndësia e kësaj ditë që ju e agjëroni?” Ata thanë: Kjo është një ditë e madhe, në të cilën Allahu e shpëtoi Musain dhe popullin e tij, dhe e fundosi Faraonin dhe popullin e tij. Kështu që Musai e agjëroi në shenjë falënderimi, edhe ne e agjërojmë për të njëjtën arsye. I Dërguari i Allahut, a.s., tha: “Ne kemi më shumë të drejtë, dhe ne kemi një lidhje më të ngushtë me Musain se sa ju”, kështu që i dërguari i Allahut, a.s., e agjëroi dhe dha urdhër që të agjërohet ajo ditë”<sup>18</sup>*

Pra Pejgamberi, a.s., me këto qëndrime e tregonte afërsinë dhe unitetin që kishte me pejgamberët e tjerë para tij, e që ndërkohë si të krisherët po ashtu edhe çifutët i konsiderojnë për pejgamber të tyre. Ndërkaq Pejgamberi thoshte se ne kemi më shumë të drejtë dhe përparësi për ata se sa pretenduesit e ndjekësve të tyre. Sepse këta më pas e devijuan rrugën e tyre duke shpikur gjëra, e duke shpifur ndaj tyre, për të cilët pejgamberët, në fakt, ishin dërguar që t’i largojnë nga ato. Pra, me këto sjellje Pejgamberi, a.s., na e tregon afërsinë që e kanë pejgamberët e tjerë me të, dhe anasjelltas ky me ata. Me këtë mënyrë na e bënë të qartë se edhe myslimanët duhet t’i trajtojnë dhe t’i respektojnë ata, dhe për rrjedhojë afërsinë që duhet ta kenë me ata pejgamberë, ndonëse Ithtarët e Librit pretendojnë se janë vetëm si pejgamberë të tyre!

## 2.2. E shndërroi teorinë në praktikë

Në një kohë kur, ndoshta, në asnjë skaj të botës nuk ekzistonte koncepti i “të drejtave të pakicave”, ai me të arritur në Medine, e shkroi një marrëveshje me çifutët e që më pas u bë e njohur si Karta apo Kushtetuta e Medinës. Përmbajtja e së cilës ishte e mbushur më se gjysma e saj

<sup>18</sup> Muslimi në Sahih, kitab: Es Sijam, babu: Savmu jevme ashurai, nr. 1911.

me nene që kishin të bënin me të drejtat e pakicave, posaçërisht me Ithtarët e Librit, apo me statusin e çifutëve që gjendeshin në Medine.<sup>19</sup> Ai e shndërroi teorinë e marrëdhënieve me Ithtarët e Librit në praktikë, duke i konsideruar ata si pjesëmarrës të shtet-formimit me të gjitha të drejtat e barabarta. Ja disa nene të saj:

**Neni 16.** *Ata nga hebrenjtë që varen prej nesh, do të fitojnë të drejtën e ndihmës dhe mbështetjes nga ana jonë pa u shkaktuar padrejtësi dhe pa bërë bashkëpunim me armiqtë e tyre.*

**Neni 24.** *Ashtu si myslimanët, ashtu edhe hebrenjtë, janë të detyruar që shpenzimet e luftërave që i zhvillojnë vetë, t'i përballojnë vetë.*

**Neni 25/a.** *Hebrenjtë Benu Avf përbëjnë një bashkësi me myslimanët duke mbajtur secila palë fenë e vet. Në këtë kusht përfshihen si ata vetë, si dhe ata që iu përkasin atyre.*

Pastaj i përmendi të gjitha fiset hebreje që banonin në Medine secilin në mënyrë të veçantë që edhe ata ndërmjet tyre të ndihen të barabartë, duke mos anashkaluar një fis apo i privilegjuar tjetrin. Çifutët ishin fise të shumta që jetonin në Medine si: Benu Nexhar, Benu Harith, Benu Saide, Benu Xhushem, Benu Evs, Benu Thea'lebe, Benu Shatbije etj.

**Neni 36/b.** *Nuk do të ndalohej ose pengohet marrja e shpagimit për një plagosje. Është e padiskutueshme se, po qe se dikush vret dikë, i vë nën përgjegjësi veten dhe personat e familjes, në të kundërtën, bëhet padrejtësi, domethënë, kush e kundërshton këtë rregull, bën padrejtësi. Zoti është me ata që e respektojnë këtë shkresë.*

**Neni 37/a.** *Në rast luftime, shpenzimet e hebrenjve bien mbi hebrenjtë dhe shpenzimet e myslimanëve bien mbi myslimanët. Pa dyshim se personat që përmenden në këtë shkresë do të bashkëpunojnë në ndihmën e njëri-tjetrit kundër atyre që u shpallin luftë. Mes tyre do*

---

<sup>19</sup> Karta apo Kushtetuta e Medinës, nuk i kishte të radhitur nenet e saj me numra, por studiuesit më pas ia shtuan numrat për lehtësim, e që numri i neneve arrin në 51 sosh, apo te dikush më pak e dikush më shumë varësisht nga futja e disa neneve në nën nene, prandaj në disa burime gjejmë nene më numër më të reduktuar .

*të ketë sjellje të mirë e me dobi të dyanshme. Do të respektohen rregullat, nuk do të bëhen veprime në kundërshtim me to.*

**Neni 35.** *Personat që strehohen te hebrenjtë (Bitane) do të trajtohen njëllë si vetë hebrenjtë.*

**Neni 39.** *Nëse një komunitet i tretë zhvillon luftë kundër myslimanëve dhe çifutëve, pjesëmarrës në traktat, ata do të duhet të luftojnë bashkërisht. Ata duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin reciprokisht dhe ndërmjet tyre duhet të ekzistojë dashamirësia dhe besueshmëria e ndërsjellë.*

**Neni 44.** *Në raste sulmesh kundër Jethribit (emri i Medinës para se të emigroj Pejgamberi, a.s.), myslimanët dhe hebrenjtë do ta ndihmojnë njëri-tjetrin.*

**Neni 45/a.** *Po qe se ata (hebrenjtë) do të ftohen nga myslimanët për të nënshkruar një paqe ose për të marrë pjesë në një marrëveshje paqeje, do ta nënshkruajnë drejtpërdrejt paqen, ose do të marrin pjesë drejtpërdrejt në atë marrëveshje paqeje. Po qe se ata (hebrenjtë) do t'ua propozojnë myslimanëve të njëjtat gjëra, do të kenë të njëjtat të drejta në krahasim me myslimanët, duke përjashtuar rastin e luftërave të filluara për çështje fetare.*

**Neni 46.** *Kushtet e paraqitura për personat e shënuar në këtë dokument (shkresë), do të zbatohen rreptësisht dhe në mënyrë plotësisht korrekte nga ana e personave të sqaruar në këtë dokument (shkresë), në të njëjtën mënyrë edhe për hebrenjtë Evs, domethënë, për zotërinjtë e tyre si dhe për vetë personat e tyre. Rregullat do të respektohen në mënyrë absolute, nuk do të bëhen veprime në kundërshtim me to, dhe ata që sigurojnë përfitime në mënyrë të padrejtë, nuk do t'i bëjnë dëm kujt tjetër pos vetës së tyre. Zoti është në anën e atyre që i respektojnë në mënyrën më të drejtë e më të përkryer nenet e shënuara në këtë dokument (marrëveshje)!<sup>20</sup>*

Pra, me këtë Kushtetutë Pejgamberi, a.s., vendosi ligje të marrëdhënieve ndër-shoqërore në mënyrë praktike jo vetëm ndërmjet myslima-

<sup>20</sup> Abdul Melik bin Hisham, "Es Siretun En Nebevije", v. II, f. 445-448.

nëve, por edhe ndërmjet Ithtarëve të Librit, të cilët, siç pamë në këto pak nene që i parashtruam, konsideroheshin qytetarë me status plotësisht të barabartë me të gjithë myslimanët, me tërë të drejtat dhe obligimet që i takojnë një qytetari të rëndomtë në kohën tonë. Por ajo që është për tu theksuar këtu, se Pejgamberi, a.s., në çështjet fetare aspak nuk ndërhyri që të bëjë ndonjë lloj trysnie, qoftë edhe ndonjë kërkesë të vogël tjetër nga ata. Madje, në rast se lufta bëhet për çështje fetare në këtë rast nuk ndihmohen mes veti. Pra, nuk kanë obligim asnjëra palë ndaj tjetrës për ndihmë. Ndërsa e tërë kërkesat dhe obligimet kishin të bënin me çështjet e pjesëmarrjes në shtet-formim, dhe siguri shtetërore.

Nga kushtetuta e Medinës gjithashtu nënkuptojmë se kur në një shoqëri bashkëjetojnë komunitete të ndryshme i jepet përparësi aspektit të interesit të bashkëjetesës, sigurisë shoqërore dhe përforsimit të shtetit, ndaj aspektit fetar. Sepse, siç pamë nga nenet e lartcekura, se secila palë duhet ta ruaj fenë e saj, duke mos ndërhyrë aspak në çështje fetare të fesë së "tjetrit". E tërë traktati ishte i fokusuar në aspekte të interesit të përbashkët të kësaj bote, apo të interesit të bashkëjetesës ndërmjet myslimanëve dhe Ithtarëve të Librit, apo në këtë rast të çifutëve.

Qëndrimi tjetër që tregon sjelljen e veçantë të Pejgamberit, a.s., me Ithtarët e Librit ishte ai i një delegacion të krishterë nga Nexhrani<sup>21</sup> i cili erdhi te Pejgamberi, a.s., të diskutoj për çështjen e h. Isait, a.s., dhe ta kundërshtojë deklaratën e Pejgamberit në lidhje me Isain, a.s., se ai ka qenë vetëm pejgamber e jo siç pohojnë të krishterët si bir i Zotit dhe zot. Madje, ardhja e tyre ishte me një lloj shfaqjeje të mendjemadhësisë ndaj Pejgamberit, a.s., dhe banorëve të Medinës. Kjo dukej qartë, ngase erdhën në formë të organizuar dhe me një imazh shumë të stilizuar deri në ekzagjerim, pasi ata mbanin rroba mëndafshi dhe mbanin unaza dhe byzylyk ari. Këtë, vetëm për ta treguar superioritetin ndaj myslimanëve. Pejgam-

<sup>21</sup> Nexhrani, është qytet në jug të Mekës, afër 875 km. prej saj. Gati në kufi me Jemenin. Tani konsiderohet po ashtu kryeqytet i provincës së Nexhranit. Nexhrani në të kaluarën ishte një qendër tepër e rëndësishme e Krishterimit në Arabi, atëherë në rajon në veri të Jemenit. Në të ka ekzistuar një Katedrale madhështore, të cilën të krishterët e konsideronin si Qabe të tyre.



beri, a.s., i ftoi në Islam, por ata as që kishin ndërmend të pranonin një propozim të tillë, megjithatë kur ata kërkuan që Pejgamberi t'ua lejojë të bëjnë lutjet në xhami, sepse pikërisht në ato ditë ishin festat e Pashkëve, Pejgamberi, a.s., ua hapi dyert e xhamisë për tu futur dhe lutur brenda saj.<sup>22</sup>

Pejgamberi, a.s., me Ithtarët e Librit gjithashtu bëri shumë marrëveshje të tjera me grupe të ndryshme e sidomos me ato krishtere.<sup>23</sup>

### 3. Mbrojtja dhe kujdesi ndaj "tjetrit".

Kemi disa hadithe në të cilat Pejgamberi, a.s., porositë për kujdes dhe mbrojtje të Ithtarëve të Librit, apo siç e thotë ai "të mbrojturit". Në një hadith të cilin e shënon Ebu Davudi, Pejgamberi, a.s., ka thënë:

عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ أَلَا مَنْ ظَلَمَ مُعَاهِدًا أَوْ انْتَقَصَهُ أَوْ كَلَّفَهُ فَوْقَ طَاقَتِهِ أَوْ أَحَدًا مِنْهُ شَيْئًا بَغَيْرِ طَيْبِ نَفْسٍ فَأَنَا حَاجِبُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ  
 "Kujdes, çdo kush i cili i bën zullum një "të besatuari", (të mbrojturi) ose e përçmon atë, apo e detyron të punoj përtej mundësive të tij, ose i merr diçka pa pëlqimin e tij, unë do të jem armiku i tij në Ditën e Kiametit".<sup>24</sup>

Gjithashtu Abdulla bin Amri, r.a., transmetoi prej Pejgamberit, a.s., të ketë thënë:

<sup>22</sup> Abdul Melik bin Hisham, "Es Siretun-Nebevije", v. II, f. 509, dhe Safijjurr Rahman El Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i xhenetit*, f. 524-525; Sultan Ahmed Kureshi, *Letrat e Muhamedit a.s.*, Përth. nga angl. Mimoza Sinani, Logos-A, Prishtinë, 2015, f. 62-64.

<sup>23</sup> Ejup Haziri: "Traktatet në të drejtën Islame" bot: Dituria, Prishtinë, 2010, f. 77- 100; Muhammed Hamidullah, "Mexhmuatu'l vethaikis-sijasijeti lil 'ahdin-nebevij ve'l hi-lafetir-rashideh", Darun-Nefais, Bejrut, bot. 5, 1405h/1985, f. 92, 99, 107, 125, 135, 139, 165-206; Muhammed bin Sead bin Meniu Ez Zuhri, *Et Tabekatu'l kubra*, ver. Ali Muhammed Umer. bot. Mektebetu'l Hanxhi, Kajro, 2001, v. 1, f. 307-308.

<sup>24</sup> Ebu Davudi në Sunen, libri: El Harraxh, ve-l Imare ve-l Fej'ë, babu: fi ta'shiri ehli-dh-dhimeh, nr. 2654.

عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا عَنْ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ مَنْ قَتَلَ مُعَاهِدًا لَمْ يَرِحْ رَائِحَةَ الْجَنَّةِ وَإِنَّ رِيحَهَا تُوجَدُ مِنْ مَسِيرَةِ أَرْبَعِينَ عَامًا  
*"Kushdo që vret një të "besatuar", nuk e nuhat aromën e Xhenetit, edhe pse, në të vërtetë, aroma e tij mund të dallohet në një distancë prej dyzet vjetësh".<sup>25</sup>*

### 3.1. Sjellja e butë dhe etike ndaj tyre

Pejgamberi, a.s., të gjitha sjelljet i kishte me dashamirësi dhe butësi të paparë. Kjo butësi që e shoqëronte ishte me të gjithë njerëzit. Prandaj këtu nuk bënin përjashtim as Ithtarë e Librit. Kjo sjellje buronte nga etika e lartë që posedonte Pejgamberi, a.s., të cilën Kurani e shënon me një lëvdatë të veçantë, dhe thotë:

﴿وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ﴾

*"Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!"*

Këtë lartësi morale Pejgamberi, a.s., e pohoi kur tha, siç e transmetoi Ebu Hurejra:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِنَّمَا بُعِثْتُ لِأُتَمِّمَ صَالِحَ الْأَخْلَاقِ

*"Në të vërtetë unë u dërgova për ta përsosur karakterin e mirë"<sup>26</sup>*

Prandaj ai, a.s.,porosiste që njerëzit të sillen me njëri tjetrin sa më mirë, sepse ajo sjellje e lartëson atë te Allahu xh.sh., e sidomos me njerëzit më të afërt në jetën e përditshme. Prej Amër bin El Asit, transmetohet se Pejgamberi, a.s., ka thënë:

عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو بْنِ الْعَاصِ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ خَيْرُ الْأَصْحَابِ عِنْدَ اللَّهِ خَيْرُهُمْ لِصَاحِبِهِ وَخَيْرُ الْجِيرَانِ عِنْدَ اللَّهِ خَيْرُهُمْ لِجَارِهِ

<sup>25</sup> Buhariu në Sahih, kitabu; El Xhizje, babu; Ithmu men katele muahiden, nr. 2930.

<sup>26</sup> Musnedi i Ahmedit, kitabu: Baki musnedi'l mukthirine, babu: Baki musnedi's sabik, nr. 8595.

*“Shoku më i mirë te Allahu është ai që është më i mirë për shokun e tij. Fqinji më i mirë te Allahu është ai që është më i miri për fqinjin e tij”*.<sup>27</sup>

Në këtë hadith Pejgamberi, a.s., nuk e caktoi që shoku dhe fqinji të jetë mysliman, e që nënkuptohet se mund të jetë edhe jo mysliman, pra, sjellja e tillë duhet të jetë me shokun dhe fqinjin para se të shikohet besimi i tij.

Etika e sjelljes së lart të Pejgamberit, a.s., theksohet në tregimin e Aishes, r.a., e cila tha:

دَخَلَ رَهْطٌ مِنَ الْيَهُودِ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَقَالُوا السَّامُ عَلَيْكُمْ  
قَالَتْ عَائِشَةُ فَفَهَّمْتُهَا فَقُلْتُ وَعَلَيْكُمْ السَّامُ وَاللَّعْنَةُ قَالَتْ فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى  
اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ مَهْلًا يَا عَائِشَةُ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الرِّفْقَ فِي الْأَمْرِ كُلِّهِ فَقُلْتُ يَا رَسُولَ  
اللَّهِ أَوْ لَمْ تَسْمَعْ مَا قَالُوا قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَدْ قُلْتُ وَعَلَيْكُمْ

*“Hyri një grup çifutësh te i Dërguari i Allahut, a.s., dhe thanë: “Es Samu ‘Alejke”*<sup>28</sup> (Vdekja qoftë mbi ju!) Aisheja tha: E kuptova (qëllimin e tyre), dhe u thash: “Alejkum Es samu ve’l-leanetu”, (vdekja dhe mallkimi qoftë mbi ju). I Dërguari i Allahut, a.s., tha: Qetësohu o Aishe; Allahu vërtetë e do butësinë në të gjitha çështjet. Thash: O i Dërguar i Allahut: A nuk i dëgjove çfarë thanë? I Dërguari i Allahut, a.s., tha: Po (tashmë), iu thash: “Ve alejkum” (Edhe mbi ju!)”<sup>29</sup>

Pejgamberi, a.s., jo vetëm që ishte lider në Medine, por edhe me pozitë më të fuqishme në qytet. Ky grup hebrejsh i bënë lutje para syve për vdekjen e tij. Këtë, duke përdorur hile të fjalës “Es sam - vdekje” me fjalën “Es selam - paqe”, kështu nëse do të ballafaqohen me Pejgamberin do të pohonin rrejshëm: Ne kemi thënë: “Es selam”. Ndonëse Pejgamberi, a.s., ishte i sigurt në atë që thanë, madje edhe në prezencën e Aishes, r.a.,

<sup>27</sup> Suneni i Darimiut, kitabu: Es Sijer, babu: fi husni’s sahabe, nr. 2330.

<sup>28</sup> Fjala ‘Es saammu’ dhe ‘Es selamu’ janë të afërta si shprehje në gjuhën arabe, prandaj nëse do të ballafaqoheshin me Pejgamberin do t’i thoshin, se e thanë të dytën!

<sup>29</sup> Buhariu në Sahih, kitabu: El Edeb, babu; Er Rrifku fi’l emri kul-lihi, nr. 5565.

e cila po ashtu i dëgjoi mirë se çfarë thanë, prandaj reagimi i saj ishte i vrullshëm. Por ai nuk reagoi ndaj tyre, përderisa ata do ta mohonin një thënie të tillë. As nuk tha: ja dëshmia ime, dhe dëshmia e Aishes, r.a., mjafton pranë dëshmisë suaj, por u mjaftua duke ua kthyer atyre me edukatë: "edhe mbi ju". Për më tepër, e ndaloi Aishen, r.a., nga agresiviteti dhe fyerja, duke e urdhëruar ta ndjek butësinë në trajtimin e atyre që luten për vdekjen ndër sytë e tu.

Një ngjarje tjetër akoma më e çuditshme se kjo, është ndodhia e Zejd bin Sea'nete, i cili ishte rabin i çifutëve. Sipas transmetimit të Ibën Hibbanit nga Abdullah bin Selam, ky nga babai i tij, ndërsa babai nga gjyshi i tij i cili ka thënë:

Allahu i Lartmadhëruar deshi ta udhëzojë Zejd bin Sea'nete. Zejdi e tregon ngjarjen vetë dhe thotë: Kur e shikova fytyrën e Muhamedit, a.s., i njoha të gjitha shenjat e peygamberisë, pos dy prej tyre që nuk isha i informuar për ato:

- Butësia e tij ngadhënjente ndaj çdo injorance.
- Sa më shumë që shtoheshin veprimet injorante ndaj tij, aq më tepër shtohet butësia e tij.

Prandaj e përcillja që t'i afrohesha e ta di butësinë në krahasim me analfabetizmin e tij.

Tha: (Zejdi), doli Peygamberi, a.s., nga dhomat e shtëpisë së tij, dhe me atë ishte edhe Ali bin Ebu Talibi. Erdhi një njeri hipur mbi deve, duke sikur të ishte beduin, dhe i tha: O i Dërguar i Allahut, vendbanimi i bijve të filanit kanë hyrë në Islam. Unë i pata lajmëruar se nëse bëhen myslimanë do ta kenë një jetesë të begatshme. Mirëpo ata i ka kapluar thatësisë e madhe, prandaj frikësohem o i Dërguar i Allahut se do të dalin nga Islami për shkak të lakmisë siç hynë për shkak të saj! Nëse është e mundur t'u dërgosh atyre ndokënd që do t'iu ndihmojë. Tha (Zejdi), Peygamberi, a.s., e drejtoi shikimin ndaj njërit afër tij - më duket se ishte Aliu, i cili iu përgjigj: Nuk ka mbetur asgjë o i Dërguar i Allahut. Zejdi tha: Iu afrova dhe i thash: O Muhamed a më shet hurmat e vendit të caktuar që janë të rrethuara nga bijtë e filanit deri në këtë e në këtë kohë?

Tha: *“Jo o çifut, të shes hurmat e vendit të caktuar deri në këtë e në këtë kohë, por nuk e caktoj bahçen e bijve të filanit”*. I thash: po (pranoj). M’i shiti, a.s., unë shkova dhe i solla të hollat dhe ia dhashë tetëdhjetë sikla (*mithkale*) ari, për hurmat e vendit që ishte i njohur deri në kohën e caktuar. Tha: (Zejdi): I tha atij njeriut: *“Përshpejto dhe ndihmoju atyre më këto”*.

Zejdi vazhdoi: Kur pat mbetur dy apo tri ditë para kohës së caktuar, Pejgamberi, a.s., doli në përcjellje të një xhenazeje të njerit nga ensarët dhe me të ishin Ebu Bekri, Omeri, Uthmani, dhe një grup nga shokët e tij. Kur e fali xhenazen u afrua pranë një muri dhe u ulë aty. Unë shkova dhe e rroka për tërë këmishën e tij, e shikova me një fytyrë të vrazhdë pastaj i thash: A nuk po ma kthen hakun tim o Muhamed? Për Zotin ju bijtë e Abdul Muttalibit jeni njerëz që nuk i vononi borxhet, këtë e kam parë gjatë bashkëpunimit me juve! Zejdi shtoi: E shikova Omer bin El Hattabin që sytë i rrotulloheshin në fytyrë sikur të ishin orbitë e rrumbullakët! Pastaj më gjuajti me një shikimin dhe tha: O armik i Allahut, a të Dërguarit të Allahut a.s. i thua atë që dëgjova, dhe po vepron me të atë që po shoh? Pasha Atë që e ka dërguar këtë me të vërtetën, po të mos ishte droja e tij, pata për të goditur kokën me shpatën time. Pejgamberi, a.s., e shikonte Omerin në heshtje, pastaj pa nxituar tha: *“O Omer ne ishim të nevojshëm për gjë tjetër prej teje! Mua të më urdhëroje me përmbushje (shlyerje) të mirë, dhe ta urdhëroje atë me kërkesë të mirë. Shko me këtë o Omer dhe ktheja hakun e tij, dhe shtoi njëzet sa’a<sup>30</sup> në vend të frikës së tij”*. Zejdi vazhdoi duke thënë: Më mori mua Omeri, ma dha hakun tim, dhe m’i shtoi edhe njëzet sa’a hurma. I thash: Çka është kjo shtesë? Më tha: Më urdhëroi i Dërguari i Allahut, a.s., që t’i shtoj në vend të frikës (që ta shkaktova).

I thash: A më njeh, o Omer? Më tha: Jo, e kush je ti? I thash: Unë jam Zejd bin Sea’nete. Tha: Rabini? I thash: Po rabini. Më tha: Çka të shtyri që t’i thuash të Dërguarit të Allahut atë që ia the, dhe të veprosh me të

<sup>30</sup> صاع Sa’un, ishte njësi matëse e peshës në kohën e Pejgamberit a.s., e që tani është e barasvlershme me 2.035 kg., apo sipas mendimi tjetër 2.6 kg.

siç veprove? I thash: O Omer, të gjitha shenjat e pejgamberisë i njoha në fytyrën e të Dërguarit të Allahut kur e shikoja fytyrën e tij, pos dy nuk i kisha testuar te ai: Butësia e tij ngadhënjente ndaj çdo injorance, dhe sa më shumë që shtoheshin veprimet injorante ndaj tij, aq më tepër shtohesh butësia e tij. Edhe këto dyja i provova, prandaj të kam dëshmitarë, o Omer, se unë e pëlqej Allahun për Zot, Islamin për fe, Muhamedin, a.s., pejgamber. Po ashtu të kam dëshmitarë se gjysma e pasurisë sime, e të cilën e kam të shumtë, është sadakë (lëmoshë) për umetin e Muhamedit, a.s. Omeri tha: Për një pjesë të tyre, sepse ti nuk mund t'i përfshish të gjithë ata. I thash: Për një pjesë prej tyre. Omeri e Zejdi u kthyen te i Dërguari i Allahut, a.s., dhe Zejdi tha: Dëshmoj se nuk ka zot tjetër pos Allahut, dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij, a.s. E besoj atë, dhe e vërtetoj. Zejdi pastaj mori pjesë me të Dërguarin e Allahut, a.s., në shumë ngjarje. Më pas vdiq në betejën e Tebukit, me plagë në gjoks e jo në shpinë, Allahu e mëshiroftë Zejdin.<sup>31</sup>

Pra, shohim se si jahudiu planifikoi dhe intrigoj ta provokoi zemërimin e Pejgamberit, a.s., që ta testoi vërtetësinë e pejgamberisë së tij. Pejgamberi nuk e dinte të fshehtën përpos nëpërmjet shpalljes, prandaj në tregim nuk kishte ndonjë shenjë se Pejgamberi, a.s., e dinte qëllimin e tij. Madje, jahudiu u orvat sa pati mundësi për ta sjell atë në kulmin e zemërimit. Andaj edhe bëri shumë gjëra, e që do të mjaftonte që njëra nga ato për ta provokuar zemërimin e çdo qenie njerëzore.

Ai, së pari, shkoi t'ia kërkoi borxhin në rast të papërshtatshëm e që ishte rast vdekje, dhe si zakonisht, në ato raste nuk duhet të përmenden çështje të tjera pos rastit në fjalë, sepse në ato raste njerëzit janë të pikëlluar dhe nuk dëshirojnë t'ia dinë për çështje tjera, pra, ishte vend dhe kohë e papërshtatshme dhe tërësisht jo edukative një sjellje e tillë.

---

<sup>31</sup> Ibën Habbani në Sahih, kitabu: El Birr ve'l ihsan, dhikru istihbabi lil mer'i en je'mure bi'l ma'ruf, nr. 287. Po ashtu e transmetohet me të njëjtat fjalë edhe: El Mustedrek ala Es sahihajni, li'l Hakim, kitabu: Ma'rifetus-sahabe r.a. dhikru islam Zejd bin Sa'nete, nr. 6587.

E dyta, shkoi dhe ia kërkoi borxhin para kohës së caktuar, e që nuk kishte të drejtë në këtë kohë.

E treta, këtë kërkesë e bëri në mënyrë shumë të vrazhdë, duke e rrok Pejgamberin, a.s., me tërë këmishën e tij. Ta parafytyrojmë këtë qëndrim, kur jahudiu e tërheq Pejgamberin për këmishe, ndërsa Pejgamberi, a.s., në mesin e shokëve të tij, dhe në sy të të gjithë njerëzve të pranishëm!

Pastaj, e katërta, edhe me fytyrë të vrenjtur dhe shikim të ashpër.

E pesta, e thirri me emrin e tij personal, të zhveshur nga çdo titull pejgamberie duke i thënë: a s'po ma kthen hakun tim, o Muhamed?!

E gjashta; ai pastaj edhe e ofendoi duke e ulë vetëm këtë nga e tërë familja kur i tha: Për Zotin ju bijtë e Abdul Muttalibit jeni njerëz që nuk i vononi borxhet! Pra, vetëm ti ke dalë ndryshe nga ata. E që haptas ishte ofendim i drejtpërdrejtë vetëm ndaj tij.

Këto gjashtë arsye përmbajnë fyerje dhe ofendime që do të ishin jo vetëm të mjaftuara por edhe të tepërta për ndëshkimin e tij. Nëse kësaj ia shtojmë se jahudiu iu drejtua në këtë mënyrë kreut të Medines dhe autoritetit më të lartë të saj. Duke e pas parasysh se i Dërguari, a.s., në atë kohë posedonte fuqinë dhe krenarinë më të lartë në mesin e muhaxhirëve (mekasve) dhe ensarëve (medinasve). Kur t'i kemi parasysh të gjitha këto ofendime ndaj një autoriteti kaq të lartë si në aspektin fetar, e po ashtu edhe në atë politik, dënimi i zakonshëm për ofendime të tilla pritej vrasja! Dënim që ishte i pritur aq sa Omeri, r.a., ia propozoi Pejgamberit, a.s., mbytjen e tij, por i dërguari i Allahut si veprooi?

Ai këto sulme e ofendime i pranoi jo vetëm me mirëkuptim, dhe kërkimin të justifikimit të tij, por me buzëqeshje dhe zemërgjerësi!

Pejgamberi, a.s., e shikoi Omerin, siç tregon Zejd bin Sean'ete në heshtje dhe pa nxituar, pastaj tha: *Unë dhe ai kemi qenë më të nevojshëm për një gjë tjetër nga ti, o Omer! Mua të më urdhërosh për kthim të mirë (të borxhit), ndërsa atë për kërkim të mirë. Shko me këtë, o Omer dhe jepja hakun, dhe shtoja atij njëzet sa'a, hurma, në vend të asaj që e frikësove.*"

Këtë sjellje të lartë vallë e kuptojnë sot liderët politikë, qofshin ata? Kryetarë, mbretër apo liderët të partive? Në të vërtetë modestia e të

Dërguarit bëri që t'i thotë Omerit se ai kishte nevojë për këshillën e tij! Ndonëse Pejgamberi, a.s., nuk pati nevojë për këtë këshillë, sepse ai vetë ia kujtoi Omerit atë, dhe se koha e larjes së borxhit ende nuk kishte ardhur, por ajo ishte përpjekje për ta zbutur situatën si dhe zemrën e jahudiut dhe ai të ndihet sa më lirshëm.

Më pastaj ai, a.s., e konsideron si të drejtë kompensimin për shkak të frikës që iu shkaktua jahudiut, si rezultat i shikimit kërcënues së Omerit, r.a., duke ia shtuar njëzet sa'a. Të gjitha këto i bëri pa ndonjë reagim apo fanatizëm, madje, pa ndonjë hapësirë kohore të vogël që të mendohet se si të vepro, dhe pa llogaritur pasojat dhe rezultatet. Ky ishte reagim normal i tij, për të cilin nuk kishte ndonjë angazhim të veçantë. Kjo ishte sjellje e natyrshme me të gjithë njerëzit, qofshin ata myslimanët apo jomyslimanë, qofshin që kanë prezantuar në mënyrë të mirë, apo edhe në mënyrë të keqe.

A nuk kanë nevojë ekspertët e etikës dhe sociologjisë në botë të thellohen në studimin e biografisë së Pejgamberit, a.s., që t'i ndryshojnë standardet dhe vlerat e etikës që ata i dinë, mbi bazë të asaj që shohin në moralin dhe etikën e tij të lartë?

### 3.2. Vizita e të afërmve dhe të sëmureve

Pejgamberi, a.s., kur u pyet për vizitat e të afërmve jomysliman, i lejoi vizitat e tilla, por edhe vetë ai, a.s., e vizitoi një fqinjë që ishte jahudi. Esmā, bija e Ebu Bekrit, r.a., transmetohet se ka thënë:

عَنْ أَسْمَاءَ، قَالَتْ قَدِمْتُ عَلَى أُمِّي رَاغِبَةً فِي عَهْدِ قُرَيْشٍ وَهِيَ رَاغِمَةٌ مُشْرِكَةٌ  
فَقُلْتُ يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنَّ أُمِّي قَدِمَتْ عَلَيَّ وَهِيَ رَاغِمَةٌ مُشْرِكَةٌ أَفَأَصِلُهَا قَالَ  
نَعَمْ فَصَلِّي أُمَّكَ.

*“Nëna ime erdhi duke kërkuar ndonjë veprim mirësie nga unë gjatë marrëveshjes së Kurejshëve (në Hudejbije). Ndërsa ajo e urrente Islamit dhe ishte politeiste. I thashë: O i Dërguari i Allahut, nëna ime ka ardhur tek unë, ndërsa ajo e urren Islamit dhe ajo është politeis-*



te. A mund të bëj një akt dashamirësie ndaj saj? Ai u përgjigj: Po, trajtoje atë me mirësi”.<sup>32</sup>

Ngjarja tjetër që tregon përkushtimin e Pejgamberit, a.s., ndaj të afërmeve të tij, ndonëse nuk ishin myslimanë, atë të xhaxhait të tij Ebu Talibit, të cilin e transmeton Ebu Hurejra, r.a.:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ لِعَمِّهِ "قُلْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ أَشْهَدُ لَكَ بِهَا يَوْمَ الْقِيَامَةِ". قَالَ لَوْلَا أَنْ تُعَيِّرَنِي فُرَيْشٌ يَقُولُونَ إِنَّمَا حَمَلُهُ عَلَى ذَلِكَ الْجُرْعُ لَأَقْرَرْتُ بِهَا عَيْنَكَ فَأَنْزَلَ اللَّهُ إِنَّكَ لَا تَهْدِي مَنْ أَحْبَبْتَ وَلَكِنَّ اللَّهَ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ

“I dërguari i Allahut, a.s., i tha xhaxhait të tij (Ebu Talibit në momentet e vdekjes) “Thuaj: Nuk ka zot tjetër përpos Allahut, që të dëshmoj (se ishe mysliman) në Ditën e Kiametit”, ai iu përgjigj: Sikur të mos më përqeshnin kurejshitet duke thënë se ishte frika nga (afrimi i vdekjes) ajo që më shtyu ta bëja këtë, sigurisht që do t'i gëzoja sytë tuaj. Atëherë Allahu shpalli (ajetin): “Vërtet, ti (Muhammed) nuk mund të udhëzosh në rrugë të drejtë atë që do. Allahu është Ai që e udhëzon atë që do.”<sup>33, 34</sup>

Ndërsa Enesi r.a. na tregon vizitën e Pejgamberit, a.s., që i bëri shërbëtorit të tij i cili ishte jahudi:

عَنْ أَنَسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ كَانَ غُلَامًا يَهُودِيًّا يَخْدُمُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَمَرَضَ فَأَتَاهُ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَعُودُهُ فَقَعَدَ عِنْدَ رَأْسِهِ فَقَالَ لَهُ أَسْلِمَ فَنَظَرَ إِلَى أَبِيهِ وَهُوَ عِنْدَهُ فَقَالَ لَهُ أَطِيعْ أَبَا الْقَاسِمِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَأَسْلَمَ فَخَرَجَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَهُوَ يَقُولُ الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَنْقَذَهُ مِنَ النَّارِ  
“Një djalosh çifut i cili i shërbente Pejgamberit, a.s. u sëmur. Pejgamberi, a.s., shkoi për ta vizituar atë. U ulë pranë kokës së tij, i tha “Pranoje Islamin”. Ai e shikoi babanë e tij që ishte ulur aty pranë; i cili i tha: “Bindju Ebu’l Kasimit”, (nofka e Pejgamberit, a.s.) kështu

<sup>32</sup> Sunen Ebi Davudi, kitabu: Ez Zekah, babu: Es sadekatu ala elhi’ dh dhimeh, nr. 1668.

<sup>33</sup> 28-Kasas: 56.

<sup>34</sup> Ibën Hibbani në Sahih, dhikru’l haberi’l mud-hid, nr. 6361.

*ai e pranoi Islamin. Pejgamberi, a.s., doli duke thënë: "Falënderimi i takon Allahut që e shpëtoi nga zjarri i xhehenemit".<sup>35</sup>*

### 3.3. Respekti i të vdekurve të jomyslimanëve

Pejgamberi, a.s., nuk u mjaftua vetëm me respektin e të gjallëve edhe pse nuk ishin myslimanë, por respekti dhe nderi i tij ishte edhe ndaj të vdekurve të tyre. Këtë më së miri e ilustron tregimi i dy sahabëve e që quheshin:

عَبْدَ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي لَيْلَى، قَالَ كَانَ سَهْلُ بْنُ حُنَيْفٍ وَقَيْسُ بْنُ سَعْدٍ قَاعِدَيْنِ بِالْمَدِينَةِ، فَمَرُّوا عَلَيْهِمَا بِجَنَازَةٍ فَقَامَا. فَقِيلَ لَهُمَا إِنَّهَا مِنْ أَهْلِ الْأَرْضِ، أَى مِنْ أَهْلِ الدِّمَةِ فَقَالَا إِنَّ النَّبِيَّ ﷺ مَرَّتْ بِهِ جَنَازَةٌ فَقَامَ فَقِيلَ لَهُ إِنَّهَا جَنَازَةٌ يَهُودِيٍّ. فَقَالَ "أَلَيْسَتْ نَفْسًا"

*"Sehl bin Hunaiif dhe Kais bin Sa'd ishin duke ndenjor ulur (një ditë) në qytetin e El Kadisije. Një xhenaze kaloi para tyre dhe këta u ngritën në këmbë. Dikush ju tha atyre: xhenazja ishte e një njeriut të vendit, d.m.th. nga dhimmitët, (të një të "të mbrojturit". Ata u përgjigjën: "Kur kaloi një xhenaze pranë Pejgamberit, a.s., ai u ngrit në këmbë. Kur iu tha që ajo ishte xhenaze e një çifuti, ai tha: "A nuk ishte një qenie njerëzore?".<sup>36</sup> Pra, respekti i tij ndaj asaj xhenaze ishte nga respekti i dinjitetit së qenies njerëzore, pa marrë parasysh besimin dhe kombësinë e tij.*

### 3.4. Pranimi i ushqimeve si dhurata dhe ftesat

Pejgamberi, a.s., kishte një marrëdhënie normale me të gjithë njerëzit, ai i përgjigjej ftesave të të gjithëve, po ashtu i pranonte dhuratat, pa marrë parasysh prej kujt ishin, dhe çfarë besimi kishin. Prandaj ai, a.s., në një rast e pranoi dhuratën e një çifute. Ajo me këtë dhuratë deshi ta

<sup>35</sup> Buhariu në Sahih, kitabu: El Xhenaiz, babu: Idha eslemEs sabijju, nr. had. 1268.

<sup>36</sup> Buhariu në Sahih, kitabu: El Xhenaiz, babu: Men kame li xhenazeti jahudij, nr. had. 1312.

mbys Pejgamberin, a.s., duke ia helmuar ushqimin që do ta hante ai a.s. dhe shoqëruesit e tij. Prej Ebu Selemes, r.a., transmetohet se ka thënë:

عَنْ أَبِي سَلَمَةَ قَالَ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَأْكُلُ الْهَدْيَةَ وَلَا يَقْبَلُ  
الصَّدَقَةَ فَأَهْدَتْ لَهُ امْرَأَةٌ مِنْ يَهُودِ حَيْبَرَ شَاةً مَصْلِيَّةً فَتَنَاوَلَ مِنْهَا وَتَنَاوَلَ مِنْهَا  
بِشْرِ بْنِ الْبَرَاءِ ثُمَّ رَفَعَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَدَهُ ثُمَّ قَالَ إِنَّ هَذِهِ تُخْبِرُنِي أَنَّهَا  
مَسْمُومَةٌ فَمَاتَ بِشْرِ بْنُ الْبَرَاءِ فَأَرْسَلَ إِلَيْهَا النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ مَا حَمَلَكَ  
عَلَى مَا صَنَعْتَ فَقَالَتْ إِنْ كُنْتُ نَبِيًّا لَمْ يَضُرَّكَ شَيْءٌ وَإِنْ كُنْتُ مَلِكًا أَرَحْتُ  
النَّاسَ مِنْكَ فَقَالَ فِي مَرَضِهِ مَا زِلْتُ مِنَ الْأَكْلَةِ الَّتِي أَكَلْتُ بِحَيْبَرَ فَهَذَا أَوَانُ  
انْقِطَاعِ أَبْهَرِي

*“I Dërguari i Allahut, a.s., e pranonte dhuratën, por jo lëmoshën (saddakanë). Një grua nga çifutët e Hajberit ia dhuroi një dele të pjekur. Pejgamberi hëngri nga ajo, po ashtu hëngri nga ajo edhe Bishër bin El Bera’ë. Pastaj Pejgamberi, a.s., e ngriti dorën dhe tha: Kjo po më lajmëron se është e helmuar. Bishër bin El Bera’ë vdiq. Pejgamberi, a.s., e dërgoi dikë (te ajo gruaja) që ta pyes: Çfarë të shtyri në atë që e ke bërë? Ajo tha: Po të ishe pejgamber nuk do të të bënte dëm; por po të ishe mbret do ta rehatoja popullin prej teje. Më pas ai tha për dhimbjen prej së cilës vdiq: Vazhdova të ndjeja dhimbje nga kafshata që kisha ngrënë në Hajber. Kjo është koha e ndërprerjes së aortës (venës kryesore të gjakut)”*<sup>37</sup>

Po ashtu, Enesi, r.a., transmeton se:

عَنْ أَنَسٍ أَنَّ يَهُودِيًّا دَعَا رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِلَى حُبْزِ شَعِيرٍ وَإِهَالَةٍ  
سَنِحَةٍ فَأَجَابَهُ

*“Një çifut e ftoi Pejgamberin, a.s., për të ngrënë bukë elbi, dhe vaj të thartë, ai (pa hezitim) e pranoi ftesën”*.<sup>38</sup>

<sup>37</sup> Darimiu në Sunen, kitabu: El Mukaddime, babu: Ma ekreme bihi en-nebijje, nr. 67.

<sup>38</sup> Ahmedi në Musned, kitabu: baki musnedi-l mukthirine, babu: baki-l musnedi-s sabik, nr. 13357.

#### 4. Drejtësia ndaj *tjetrit*, edhe kur ishte në dëm të myslimanëve

Ndodhi një vjedhje, hajni ishte një nga myslimanët nga një fis i ensarëve nga Beni Ubejrekët. Ai quhej Tu'me bin Ubejrek,<sup>39</sup> e kishte vjedhur një mburojë nga një fqinj i tij mysliman që quhej Katade bin En Nu'man. Mburoja kishte qenë në një thes që kishte pas miell. Mielli kishte rrjedhur nga një vrimë që kishte qenë në thes, deri sa përfundoi te shtëpia e tij. Por ai pastaj atë e fshehu te një çifut që quhej Zejd bin Es Semin. Mburojën e kërkuan te Tu'me, ky u betua në Zot se nuk e ka marrë. Pro-narët e mburojës thanë: Ne e kemi parë gjurmën e miellit brenda shtëpisë së tij! Por meqë ky u betua e lanë atë, dhe i ndoqën gjurmët e miellit deri te shtëpia e çifutit, ku edhe e gjetën mburojën në shtëpinë e tij. Çifuti tha: Atë ma ka dhënë Tu'me bin Ubejrek! Erdhën Benu Dhufri, që ishin nga fisi i Tu'me-s te Pejgamberi, a.s., dhe kërkuan që ta mbrojnë njeriun e tyre. Pejgamberi, a.s., gati sa deshi ta ndëshkojë çifutin (sepse të gjitha argumentet e dukshme tregonin që ai e kishte vjedh mburojën), pastaj Allahu, xh.sh., i shpalli këto ajete në suren Nisa:<sup>40</sup>

إِنَّا أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِتَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ بِمَا أَرَاكَ اللَّهُ وَلَا تَكُنْ  
لِلْخَائِنِينَ خَصِيمًا (١٠٥) وَأَسْتَغْفِرِ اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ غَفُورًا رَحِيمًا (١٠٦)  
وَلَا تُجَادِلْ عَنِ الَّذِينَ يَخْتَانُونَ أَنْفُسَهُمْ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ مَنْ كَانَ خَوَانًا  
أَئِيمًا. ﴿ إلى قوله تعالى: ﴿وَمَنْ يَكْسِبْ إِثْمًا فَإِنَّمَا يَكْسِبُهُ عَلَى نَفْسِهِ وَكَانَ  
اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا (١١١) وَمَنْ يَكْسِبْ خَطِيئَةً أَوْ إِثْمًا ثُمَّ يَرْمِ بِهِ بَرِيئًا فَقَدِ  
احْتَمَلَ بُهْتَانًا وَإِثْمًا مُبِينًا (١١٢)

*“Vërtet, Ne (o Muhamed) ta kemi zbritur Kuranin me të drejtën, në mënyrë që ti të gjykosh ndërmjet njerëzve sipas asaj që të ka shpallur Allahu. Dhe mos u bëj mbrojtës i tradhtarëve! Kërko*

<sup>39</sup> Ibën Ubejreku e mohoi besimin dhe u arratis në Mekë, ku vazhdoi jetën e tij si keqbërës, derisa e gurrëzuan.

<sup>40</sup> Termidhiu në Sunen, kitab: Tefsiril Kuran an resulil-lah, babu: Min sureti-n Nisa, nr. 3962.

*ndjesë prej Allahut! Se Allahu është Falës e Mëshirëplotë. Dhe mos i mbro ata që mashtrojnë vetveten! Se Allahu nuk i do tradhtarët dhe gjynahqarët. Deri tek ajeti: “Kush bën ndonjë gjynah ose të keqe, pastaj ia vesh atë një të pafajshmi, atëherë ai e ka ngarkuar veten me fajin e shpifjes dhe me një gjynah të qartë”.<sup>41</sup>*

Pastaj Pejgamberi, a.s., gjykoi në favor të jahudiut, dhe e nxori në shesh hajnin e vërtetë edhe pse ishte mysliman dhe ndonëse familja e tij kërkuan mbrojtjen e Pejgamberit, a.s.

## 5. Marrëdhëniet tregtare me tjetrin

Pejgamberi, a.s., po ashtu kishte marrëdhënie tregtie me jo myslimanët. Ai blinte prej tyre, madje merrte edhe borxhe nga ata në rast nevoje. Këtë e tregojnë dy hadithet në vijim.

عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ قَالَ تَوَيَّ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَدِرْعُهُ مَرْهُونَةٌ عِنْدَ يَهُودِيٍّ بِنِثْلَيْنِ صَاعًا مِنْ شَعِيرٍ أَخَذَهُ طَعَامًا لِأَهْلِهِ

Ibën Abbasi, r.a., transmeton, duke na treguar se: “Vdiq i Dërguari i Allahut a.s., ndërsa mburoja e tij ishte peng te një çifut me tridhjetë sa’u elbi, e kishte marrë ushqim për familjen e tij”.<sup>42</sup>

Ndërsa ngjarjen e huazimit të Pejgamberit, a.s., me jahuditë, e pamë më lart huazimin dhe blerjen e tij nga Zejd bin Sean’ete i cili ishte jahudi, në hadithin e lartpërmendur. Madje edhe kompensimin e Zejdit, për frikën që iu shkaktua nga kërcënimi i Omerit, r.a.

## Përfundim

Sjellja e Pejgamberit, a.s., me njerëzit, para se gjithash, ishte mbi baza të dinjitetit njerëzor, e jo mbi baza të fesë, kombit apo racës. Madje, ai, e ndërjegjësoi myslimanin edhe më shumë në sjelljet e tij me njerëzit,

<sup>41</sup> Nisa: 105-109; 111-112.

<sup>42</sup> Musnedi i Ahmedit, kitabu: Min musned Beni Hashim, babu: Musnedis-sabik, nr. 3334.

qofshin ata myslimanë apo jo, sepse urdhëroi që myslimani të ketë sjellje shembullore. Ai ishte i mëshirshëm edhe ndaj armikut, madje edhe atëherë kur tentonin ta vrisnin akoma interesohej për t'ua ruajtur pasurinë e tyre! Madje, në Medine i trajtoi Ihtarët e Librit si myslimanët, e posaçërisht e shohim këtë nderim të tyre në Kartën e Medinës, në të cilën i bëri shtet-formues me të gjitha të drejtat që i takojnë një qytetari me ligjet moderne. Për më tepër, ai as që përmendi ndonjë nen se ata duhet ta rishqyrtojnë besimin e tyre, por tërësisht të kundërtën e pohoi, ku deklaroi se secila palë e ka fenë e saj, pra, duhet respektuar ashtu siç janë njëra tjetrën pa ndërhyrje në çështjet fetare. Drejtësia e tij, butësia dhe sjellja sa më e mirë dhe më e lartë, afrimin që shfaqte ndaj të gjithëve, qoftë duke i vizituar kur ishin të sëmurë, qoftë me këmbimin e dhuratave, madje edhe respektin ndaj të vdekurve duke u zgjuar në këmbë për xhenazet e të *tjerëve*, për më tepër, duke i urdhëruar myslimanët që çdo herë në raste të tilla të çohen në këmbë duke treguar respekt për qenien njerëzor, janë më se mbresëlënëse, për të cilën kemi nevojë në kohët tona, që të mësohen nga ai jo vetëm myslimanët, por mbarë njerëzia, e posaçërisht liderët dhe udhëheqësit e ndryshëm të kohës sonë. Veçmas për bashkëpunimin dhe bashkëjetesën me *tjetrin*, kur njerëzit e konsiderojnë *tjetrin* aq të largët, madje shpesh edhe sikur mos të ishte qenie njerëzore. Andaj mësimi nga sjellja e Pejgamberit, a.s., është imperativ jo vetëm i kohës sonë, por i çdo kohe sa herë që njeriu largohet nga sjellja jo njerëzore.



# Veshja e mëndafshit mes të ndaluarës dhe të lejuarës

Dr. Ilmije Kuçi

## Abstrakt

Zoti i Madhëruar u ka dhënë begati të shumta dhe të mëdha bijve të Ademit, duke përfshirë edhe atë të veshjes. Kjo, për t'i mbrojtur ata nga të nxehtit dhe të ftohtit, si dhe për të qenë stoli e petk i mbulimit të trupave të tyre, në përputhje me thënien e të Madhëruarit:

يَا بَنِي آدَمَ قَدْ أَنْزَلْنَا عَلَيْكُمْ لِبَاسًا يُؤَارِي سَوَاتِكُمْ وَرِيثًا

*“O bijtë e Ademit, Ne krijuam për ju petk që ju mbulon vendturpësinë dhe petk zbukurues”*<sup>1</sup>. Prandaj, njeriu duhet ta ruajë begatinë që i ka dhënë Zoti i Madhëruar, duke i respektuar rregullat që burojnë nga ligjet.

Legjislacioni Islam lejon që burrat dhe gratë të zbukurohen, veçanërisht me veshje, por njëkohësisht ka bërë edhe disa kufizime duke përfshirë ndalimin e disa llojeve të veshjeve si për burrat ashtu edhe për gratë, e në mënyrë specifike disa sosh vetëm për burrat, gjithnjë si shenjë përkushtimi ndaj Zotit të Madhëruar. Ai i lejoi disa gjëra dhe i ndaloi disa të tjera, jo për t'i kufizuar nje-

<sup>1</sup> El-Araf, 26.



rëzit, por që ata t’iu përmbahen kufijve dhe rregullit në univers. Kjo, sepse Zoti i Lartmadhëruar është i Urtë në urdhrat dhe ndalesat e Tij. Ai nuk urdhëron përveç asaj që është në interes të njeriut dhe nuk ndalon përveç asaj që është e dëmshme për të. Urtësia e këtyre urdhëresave dhe ndalesave mund t’iu shfaqet krijesave të Tij dhe mund të mos iu shfaqet. Prandaj, çështja e veshjes në Islam, duke i nënkuptuar këtu atë të grave dhe të burrave, është e rëndësishme në Legjislacionin Islam. Juristët i kanë kushtuar vëmendje të veçantë duke përcaktuar kapituj të tërë për rregullat e saj. Ndërsa ne në vijim, do fokusohemi në sqarimin e dispozitës së veshjes së mëndafshit për burrat.

**Fjalë kyçe:** mëndafshi, e lejuara, ndalimi, stoli, legjislacioni islam.

## Abstract

The Almighty God has given many and great blessings to the sons of Adam, by including that of clothing. This, to protect them from heat and cold, as well as to be an ornament and a garment to cover their bodies, according to Allah’s saying in the Quran:

يَا بَنِي آدَمَ قَدْ أَنْزَلْنَا عَلَيْكُمْ لِبَاسًا يُؤَارِي سَوْآتِكُمْ وَرِيشًا

“O sons of Adam, We created for you garment that covers your modesty and a garment ornamental”. Therefore, man should preserve the prosperity that God Almighty has given him, by respecting the rules that come from Allah’s law.

Islamic legislation allows men and women to adorn themselves, especially with clothing, but at the same time it has also made some restrictions, including the prohibition of some types of clothing for both men and women, and specifically some more just for men, always as a sign of devotion to the Almighty God. He allowed some things and forbade some others, not to limit the people, but to keep them within limits and order in the universe.

This, because God Almighty is Wise in His commands and prohibitions. He does not command except what is in the interest of man, and He does not forbid except that which is harmful to them. The wisdom of these ordinances and prohibitions can be shown to His creatures or it may not appear to them. Therefore, the issue of clothing in Islam, meaning here that of women and men, is important in the legislation of Islam. Jurists have paid special attention to it by defining whole chapters for it its rules. In the following, we will focus on clarifying the provision of mean wearing silk.

**Keywords:** silk, permitted, prohibition, adornment, Islamic legislation.

## Dispozita e veshjes se mëndafshit

Duhet ditur se rroba e mëndafsh të, mund të jetë nga mëndafsh i papërzier dhe mund të jetë mëndafsh i përzier me diçka tjetër. Gjithashtu, ajo mund të vishet dhe mund të përdoret duke mos u veshur. Prandaj, ne në vijim, do të flasim për secilën veç e veç.

### Një: Rroba e endur me mëndafsh të pastër.

Veshja e rrobës që komplet është prej mëndafshi dhe nuk është e përzier me diçka tjetër, është e ndaluar për burra të vishet jashtë luftës, unanimisht, si dhe gjatë luftës sipas Imamit<sup>2</sup>. Këtë e argumentojmë me

---

<sup>2</sup> Sipas dy nxënësve të tij lejohet, për shkak se veshja e mëndafshit në rast lufte është një domosdoshmëri, sepse personi ka nevojë të shmangë dëmtimin e armës nga vetvetja, ndërsa mëndafshi e shmangë me së miri, si dhe për shkak se kjo ju shkakton frikë armikut për shkak të shkëlqimit të tij, prandaj dhe është lejuar për shkak të domosdoshmërisë. El Bedai, 5/131; El Hidajeh, 4/366; El Muhit, 5/342; El Ihtijar, 4/158; Et Tebjin, 6/15; El Bahr, 8/216, etj.

Ky mospajtim është nëse rroba është e trashë dhe me të arrihet të mbrohet nga armiku në luftë. Mirëpo, nëse rroba është e hollë dhe nuk shkakton frikë armikut, nuk lejohet

hadithin, të cilin e transmeton Ebu Musa El Esharij, r.a., se Pejgamberi, a.s., ka thënë:

أَجَلُ الذَّهَبِ وَالْحَرِيرِ لِإِنَاثِ أُمَّتِي، وَحَرَمٌ عَلَى ذُكُورِهَا

*“Ari dhe mëndafshi janë lejuar për femrat e umetit tim, ndërsa janë ndaluar për meshkujt e tij”<sup>3</sup>.*

Ky hadith sqaron ndalimin e arit dhe mëndafshit, qoftë përmes stolisjes apo veshjes, për burrat; por jo për gratë, sepse veshja e mëndafshit për gratë lejohet në çfarëdo forme qoftë, për shkak haditheve të shumta të përmendura në lidhje me të.

Ndalueshmërinë e mëndafshit e dëshmon edhe hadithi, të cilin e transmeton Ibën Zubejri dhe Ebu Umame, r.a., se Pejgamberi, a.s., ka thënë:

مَنْ لَبَسَ الْحَرِيرَ فِي الدُّنْيَا لَمْ يَلْبَسْهُ فِي الْآخِرَةِ

*“Kush vesh mëndafsh në këtë botë, nuk do ta veshë atë në ahiret”<sup>4</sup>.*

Ky hadith është një paralajmërim për burrat që të mos veshin mëndafsh në këtë botë, pasi hadithi e bënë të qartë se kushdo që vesh mëndafsh në këtë botë nuk do të mund ta veshë atë në ahiret, gjë që tregon se në çfarë mase burrat janë të ndaluar të veshin mëndafsh.

Kjo transmetohet edhe prej Umerit, Aliut, Muavijes bin Ebi Sufjanit, Ukbetu bin Amirit, Enesit, Hudhejjes, Umu Hanit, Abdullah bin Amrit, Imran bin Husajn, Xhabirit, Ebu Rejhane, Ibën Umerit dhe Berae bin Azibit, r.a., Enes bin Malikut, Museleme bin Mahledit, Ukbe bin Amir El Xhuheniut dhe Ebu Hurejres, r.a.<sup>5</sup>

Këto hadithe, në lidhje me ndalimin e veshjes së mëndafshit, kanë ardhur të pakufizuara, duke mos bërë dallim midis gjendjes së luftës dhe asaj në gjendjeje paqeje, prandaj dhe mbesin të përgjithshme.

unanimisht, për shkak të mungesës së dobisë. El Ihtijar, 4/158; El Xhevhere, 2/281; Mexhma El Enhur nga “El Minh”, 2/535; Ed Durr El Muhtar ve hashijetuhu, 6/357, etj.

<sup>3</sup> Ahmedi, nr: 19503, 32/259, Shejh Shuajbi thotë: “Hadithi është sahih me rrugët tjera të tij”; Et Tirmidhi, nr: 1720, 3/269, dhe thotë: “Hadithi është i mirë sahih”; Sunen El Kubra i Nesaiut, nr: 9387, 8/358; Sunen El Kubra i Bejhekiut, nr: 4220, 2/596.

<sup>4</sup> El Buhari, nr: 5833, 7/150; Muslimi, nr: 2074, 3/1646.

<sup>5</sup> Et Tirmidhi, 3/269; Nexhahu El Karij, 1/2049.

Ndërsa sa i përket domosdoshmërisë së veshjes së rrobës së mëndafshitë gjatë luftës, kjo mund të mënjanohet me veshjen e rrobës së përzier, domethënë duke veshur atë rrobë që në formë horizontale është e endur me mëndafsh, ndërsa në formë vertikale është e endur me diçka tjetër, për shkak se mbrojtja nga dëmtimit i armëve dhe nevoja e frikësimit të armikut arrihet me të, andaj nuk ka nevojë të veshjes së rrobës prej mëndafshit të pastër, sepse ndalueshmëria nuk bie përveçse në rast nevojshmërie, e këtu nuk ka nevojë sepse ajo mënjanohet me përzierje<sup>6</sup>.

Në ndalueshmërinë e veshjes së rrobës së papërzier të mëndafshit, nuk ka dallim në mes të atij që është në moshë të rritur dhe të voglit, pasi që ai është mashkull, sepse Pejgamberi, a.s., ndalueshmërinë e ka lidhur me gjininë mashkullore, e kjo përfshinë edhe të vegjlit e gjinisë mashkullore<sup>7</sup>. Vetëm se nëse personi që ka veshur është i vogël, atëherë mëkati bie mbi atë që ia ka veshur atij, jo mbi të voglin, sepse fëmija nuk është prej atyre që është i ngarkuar me obligime<sup>8</sup>.

### Rastet në të cilat është e lejuar për burrat të veshin mëndafsh

Feja Islame ka ardhur të sigurojë një jetë të denjë njeriut, në të cilën mund të jetojë në paqe, kështu që ka disa përjashtime në çdo rregull të fesë që lehtësojnë rregullin, kështu që është e mundur që burrat të veshin mëndafsh, por kjo bëhet sipas nevojës. Prandaj, edhe në këtë çështje, nga ndalueshmëria e veshjes së rrobës së mëndafshitë të papërzier me diçka tjetër, bënë përjashtim paraqitja e nevojës së veshjes së saj<sup>9</sup>, si për shembull, kur njeriu ka zgjebën apo vuan nga kruajtja e lëkurës dhe nuk

---

<sup>6</sup> Tuhfetu El Fukaha, 3/341; El Bedai, 5/131; El Hidajeh, 4/366; Et Tebjin, 6/15; El Binajeh, 12/102-103; El Bahr, 8/216, etj.!

<sup>7</sup> El Bedai, 5/131; Mirkatu El Mefatih, 7/2779.

<sup>8</sup> Tuhfetu El Fukaha, 3/341-342; El Bedai, 5/131; El Ihtijar, 4/159; Et Tebjin, 6/16; Mirkatu El Mefatih, 7/2779, etj.!

<sup>9</sup> El Muhit, 5/341.

gjënë rrobë tjetër për t'u veshur veç mëndafshit, në këtë rast nuk është e ndaluar<sup>10</sup>. Prej Enesit, r.a., transmetohet se ka thënë:

أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ رَخَّصَ لِعَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عَوْفٍ وَالرُّبَيْرِ، فِي فَمِيصٍ مِنْ حَرِيرٍ مِنْ حِكَّةٍ  
كَانَتْ بَيْنَهُمَا

*“Pejgamberi, a.s., ia lehtësoi Abddurrahman bin Avfit dhe Zubejrit (veshjen e) këmishën e mëndafshit, për shkak të kruarjes që e kishte”<sup>11</sup>.*

Gjithashtu, nga ndalueshmëria e veshjes së rrobës së mëndafshit të papërzier me diçka tjetër, për burra, bënë përjashtim ajo që është në madhësi të katër gishtërinjve të gjerësisë së rrobës<sup>12</sup>. Nëse janë në vende të ndryshme të rrobës, ato nuk mblidhen, më përjashtim në qoftë se një rresht i tij është mëndafsh dhe një rresht është diçka tjetër, sa që i tëri shihet si mëndafsh. Mirëpo, nëse ato vende të qëndisura apo të endura me mëndafsh<sup>13</sup>, nuk e arrin secila në vete sasinë e katër gishtërinjve, lejohet veshja e asaj robe, edhe nëse e tejkalon këtë sasi në rast se bashkohet, përderisa nuk shihet i gjithi si mëndafsh<sup>14</sup>.

Se kjo madhësi, është e falur apo e toleruar, e argumenton hadithi, të cilin e transmeton Umeri, r.a., i cili thotë:

نَهَى رَسُولُ اللَّهِ ﷺ عَنْ لُبْسِ الْحَرِيرِ إِلَّا مَوْضِعَ أُصْبُعَيْنِ أَوْ ثَلَاثَةٍ أَوْ أَرْبَعَةٍ

*“I Dërguari i Allahut, a.s., e ndaloi veshjen e mëndafshit, përveç në sasi të dy apo tre apo katër gishtave”<sup>15</sup>.*

Ky hadith sqaron kufirin e lejuar që burrat të veshin mëndafsh, pasi madhësia e mëndafshit në veshjet e burrave nuk duhet të kalojë katër gishta.

<sup>10</sup> El Bahr nga “*Et Tatarhanijeh*”, 8/216.

<sup>11</sup> El Buhari, nr: 2919, 4/42.

<sup>12</sup> Et Tebjin, 6/14; El Bahr, 8/215; Mexhma El Enhur, 2/533; El Hedijetu El Alajeh, f. 275; Ed Durr El Muhtar, 6/351, etj.

<sup>13</sup> Në gjuhën arabe quhet kazun, që është mëndafshi ashtu siç është nxjerr nga fshikëza dhe më pas nga ai bëhet mëndafshi natyral. Mu'xhem El Lugati El Arabijeh, 3/1809.

<sup>14</sup> El Hedijetu El Alajeh, f. 275; Ed Durr El Muhtar ve hashijetuhu, 6/352 dhe 6/357, etj.

<sup>15</sup> Muslimi, nr: 2069, 3/1643.

Këtë e dëshmon gjithashtu edhe hadithi, të cilin e transmeton Esma bint Ebi Bekër, r.a., e cila thotë:

هَذِهِ جُبَّةُ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ، فَأَخْرَجْتُ إِلَيَّ جُبَّةً طَيَّالِسَةً كِسْرَوَائِيَّةَ لَهَا لَبْنَةٌ دِيْبَاجٍ وَفَرْجِيهَا مَكْفُوفَيْنِ بِالْدِّيْبَاجِ، فَقَالَتْ: هَذِهِ كَانَتْ عِنْدَ عَائِشَةَ ؓ حَتَّى قُضِضَتْ، فَلَمَّا قُضِضَتْ قَبِضْتُهَا، وَكَانَ النَّبِيُّ ﷺ يَلْبَسُهَا فَحَنُّ نَعْسِلُهَا لِلْمَرَضَى نَسْتَشْفِي بِهَا

*“Kjo është rroba e të Dërguarit të Zotit, a.s. Ajo ma nxori një xhybe të leshtë të zezë nga Persia, e cila kishte një copë të mëndafshit dhe dy të qarat e saj (një përpara dhe një prapa) ishin të qepura me mëndafsh. Ajo (transmetuesja) tha: Kjo ishte tek Aisheja, r.a., derisa vdiq. Kur ajo vdiq unë e kapa atë. Pejgamberi, a.s., e vishte atë. Ne e lanim atë që të sëmurët të shërohen me të”<sup>16</sup>.*

Prandaj, mund të themi se është e lejuar, ajo që qepet skajeve të mëngëve nga mëndafshi dhe ajo që vendoset në jakën e xhybes, e cila quhet kupolë, gjithashtu pulla dhe vrima e saj, skajet e çallmës, rripi i hollë i pantallonave<sup>17</sup>, ajo që është në shpatullat e abajes dhe shpinën e saj, ajo që është në skajet e pëlhurës se hollë prej pambuku që përdoret për mbështjelljen e çallmës ose si mbulesë për kokën ose fytyrën, pavarësisht se a është punë me gjilpërë ose thurje, dhe ajo që vendoset në skajet e çallmës, e gjithë kjo është e lejuar nëse është katër gishta e gjerë<sup>18</sup>.

<sup>16</sup> Muslimi, nr: 2069, 3/1641.

<sup>17</sup> El Haskefi, në Ed Durr El Muhtar, 6/353, e saktëson ndalueshmërinë e rripit të mëndafshit të pantallonave. Gjithashtu, Zejnudin Err Rrazi, në Tuhfetu El Muluk, f. 228, ecë sipas mendimit të ndalueshmërisë.

Mirëpo, Ibën Abidini, në Redu El Muhtar ala Ed Durr, 6/354, shton: “Në “*El Fetava Et Tatarhanijeh*” thuhet se kjo nuk është e ndaluar, sepse ai nuk vishet vetëm. Gjithashtu, në korrektimin e “*El Xhami Es Sagir*” të disa korrektoreve kanë thënë se nuk ka asgjë të keqe në rripin e pantallonave për burra sipas mendimit të Ebu Hanifes, ndërsa Sadru Esh Shehid e ka përmendur se kjo është e ndaluar te dy nxënësit e tij”. Gjithashtu, Shejh Zadeh, në Mexham El Enhur, 2/534, thotë: “Në “*El Fetava Es Sugra*”, “*Edh Dhehira*” dhe “*Sherh El Kuduri*” thuhet se nuk është i ndaluar rripi prej mëndafshi, sipas Imamit, ndërsa sipas Ebu Jusufit është i ndaluar”. Po ashtu, Ibën Nuxhejmi, në El Bahr, 8/216, ecë sipas mendimit të lejueshmërisë.

<sup>18</sup> Redu El Muhtar ala Ed Durr, 6/352.

Gjithashtu, rroba e endur me ar është e lejuar nëse është në këtë sasi, domethënë në madhësi të katër gishtave, përndryshe nëse është më shumë se kaq është e ndaluar për burra<sup>19</sup>.

### Rroba e endur me mëndafsh në formë vertikale, ndërsa me diçka tjetër në formë horizontale.

Veshja e asaj rrobe që në formë vertikale është e endur me mëndafsh, ndërsa në formë horizontale është e endur me diçka tjetër, si pambuku, liri dhe leshi, është e lejuar të vishet në të gjitha rastet<sup>20</sup> unanimisht<sup>21</sup>, qoftë ajo e mbizotëruar, apo mbizotëruese apo e barabartë me mëndafshin<sup>22</sup>. Kjo, për shkak se rroba bëhet rrobë me anë të endjes në formë horizontale, sepse rroba bëhet rrobë përmes endjes, ndërsa endja përbëhet prej endjes në formë horizontale dhe asaj vertikale, ndërsa endja e fundit vjen në formën horizontale, kështu që nëse endja në formë horizontale është mëndafsh, atëherë i tëri konsiderohet mëndafsh<sup>23</sup>.

Me fjalë tjera rroba nuk bëhet rrobë pa endjen në formë horizontale dhe atë vertikale, kështu që shkak është në dy anë, prandaj në konsideratë merret ajo që duket, jo ajo që është e fshehur<sup>24</sup>. Si dhe për shkak të transmetimeve. Prej tyre: Prej Ibën Abasit, r.a., transmetohet se ka thënë:

إِنَّمَا نَهَى رَسُولُ اللَّهِ ﷺ عَنْ تَوْبِ الْمُصْمَتِ مِنَ الْحَرِيرِ، فَأَمَّا الْعَلَمُ وَسَدَى  
التَّوْبِ فَلَا بَأْسَ بِهِ، وَفِي رَوَايَةٍ: إِنَّمَا نَهَى النَّبِيُّ ﷺ عَنِ التَّوْبِ الْحَرِيرِ الْمُصْمَتِ،  
فَأَمَّا التَّوْبُ الَّذِي سَدَاهُ حَرِيرٌ لَيْسَ بِحَرِيرٍ مُصْمَتٍ، فَلَا نَرَى بِهِ بَأْسًا

<sup>19</sup> Et Tebjin, 6/14; Mexhma El Enhur nga "Et Tenvir", 2/534; El Hedijetu El Alajeh, f. 275; Ed Durr El Muhtar, 6/352, etj.

<sup>20</sup> El Hidajeh, 4/366; El Inajeh, 10/20; Fet'hu El Kadir, 10/20; El Bahr, 8/216; Ed Durr El Muhtar ve hashijetuhu, 6/356; El Lubab fi sherhi El Kitab, 4/158, etj.

<sup>21</sup> Tuhfetu El Fukaha, 3/341; El Muhit, 5/341; El Ihtijar, 4/158, etj.

<sup>22</sup> Mexhma El Enhur, 2/535; Redu El Muhtar ala Ed Durr, 6/356; El Hedijetu El Alajeh, f. 277.

<sup>23</sup> El Bedai, 5/131; El Muhit, 5/341.

<sup>24</sup> Et Tebjin, 6/15; El Bahr, 8/216.

*“I Dërguari i Zotit e ndaloi rrobën e pastër<sup>25</sup> prej mëndafshi. Ama sa i përket të qëndisurës<sup>26</sup> dhe asaj në formë vertikale të rrobës, nuk ka asgjë të keqe në të<sup>27</sup>. Në një transmetim tjetër: “Pejgamberi, a.s., e ndaloi rrobën e pastër të mëndafshit. Ndërsa sa i përket rrobës që është e qepur në formë vertikale me mëndafsh, ajo nuk është mëndafsh i pastër, kështu që nuk shohim asgjë të keqe në të<sup>28</sup>”.*

### Rroba e endur me mëndafsh në formë horizontale, ndërsa me diçka tjetër në formë vertikale.

Kjo formë është kundërta e së dytës, e që është: veshja e asaj rrobe që në formë horizontale është e endur me mëndafsh, ndërsa në formë vertikale është e endur me diçka tjetër, si pambuku, liri dhe leshi. Kjo formë është e lejuar të vishet vetëm në luftë unanimisht, për shkak të domosdoshmërisë, e që është futja e frikës në sytë e armikut me shkëlqimin e tij dhe mbrojtjen nga dëmi që mund ta shkaktojnë armët gjatë përdorimit të tyre, ndërsa jashtë luftës nuk ka nevojë për të, prandaj është e ndaluar<sup>29</sup>.

### Dispozita e përdorimi të mëndafshit

Dijetarët nuk u kufizuan në shpjegimin e dispozitës së veshjes së mëndafshit për burrat, por ata përfshinë edhe dispozitën e përdorimit të tij, e detajuan dhe e sqaruan atë.

<sup>25</sup> Që i tëri është mëndafsh dhe nuk është i përzier me pambuk apo diçka tjetër.

<sup>26</sup> E qëndisura është në sasi të katër gishtërinjve.

<sup>27</sup> Ebu Davudi, nr: 4055, 4/50; Sunen El Kubra i Bejhekiut, nr: 4211, 2/594. Ibën Mulekkini, në Tuhfetu El Muhtaxh, 1/537, thotë: “E transmeton Ahmedi dhe Ebu Davudi me sened të saktë”.

<sup>28</sup> Ahmedi, nr: 2951, 5/109, Shejh Shuajbi thotë: “Hadithi është sahih”; Sunen El Kubra i Bejhekiut, nr: 6087, 3/384.

<sup>29</sup> Tuhfetu El Fukaha, 3/341; El Muhit, 5/341; El Ihtijar, 4/158; El Inajeh, 10/20; Fet’hu El Kadir, 10/20; El Bahr, 8/216; El Lubab fi sherhi El Kitab, 4/158, etj.



Sa i përket përdorimit të mëndafshit për jastëk, shtroje dhe fjetje në to, qilima ose të ngjashme, kjo është e lejuar për burra<sup>30</sup>, ashtu siç është e lejuar edhe për gra.

Nuk është i ndaluar çarçafi i dyshekëve<sup>31</sup>, perdja e derës dhe dritares<sup>32</sup>, peri i tespiheve prej mëndafshi, kapësja e çelësave për rrobe të trupit, mbështjellësja e rrobave<sup>33</sup>, ajo që mbulon enët dhe të ngjashme, në të cilat ka përfitim pa veshje të tyre apo që i ngjan veshjes<sup>34</sup>.

Falja në sexhadenë e mëndafshit nuk është e ndaluar, sepse e ndaluar për burra është veshja, qoftë ajo edhe në formë formale, siç është jorgani, ndërsa përfitimi në forma tjera nuk është i ndaluar.

Qesja e mëndafshit e Kuranit, është e ndaluar nëse mbahet në qafë, jo nëse lihet e varur në shtëpi. Qesja e mëndafshit e dërrhemëve, është e ndaluar nëse mbahet e varur në qafë, jo në xhep<sup>35</sup>.

Kjo është kështu sipas mendimit të Imamit<sup>36</sup>. Ndërsa, sipas mendimit të Imam Ebu Jusufit dhe Imam Muhamedit përdorimi i mëndafshit në këto forma, është i ndaluar, për shkak të haditheve të përgjithshme të ndalueshmërisë së mëndafshit, sepse ato përfshijnë veshjen, mbështetjen dhe shtrojën. Si dhe hadithi, të cilin e transmeton Hudhejfe, r.a., i cili thotë:

<sup>30</sup> El hidajeh, 4/366; El Ihtijar, 4/158; Et Tebjin, 6/14; Mexhma El Enhur, 2/534; El Hedijetu El Alajeh, f. 276; Ed Durr El Muhtar ve hashijetuhu, 6/355; Mirkatu El Mefatih, 7/2768, etj.

<sup>31</sup> Ed Durrer El Mubaha, f. 125.

<sup>32</sup> El Ihtijar, 4/158; Hashijetu Esh Shilbi ala Et Tebjin, 6/14; El Inajeh, 12/99; Mexhma El Enhur, 2/534, etj.

<sup>33</sup> El Hedijetu El Alajeh, f. 276; Redu El Muhtar ala Ed Durr, 6/354; Ed Durrer El Mubaha, f. 124, etj.

<sup>34</sup> Redu El Muhtar ala Ed Durr, 6/354.

<sup>35</sup> El Hedijetu El Alajeh, f. 276; Redu El Muhtar ala Ed Durr, 6/354; Ed Durrer El Mubaha, f. 124, etj.

<sup>36</sup> Këtë e lejojnë edhe Ibën El Maxhishun El Maliki, disa Shafii, Abdulaziz bin Seleme dhe biri i tij Abdulmeliku. Umdetu El Karij, 22/14; Nexhahu El Karij, 1/20443.

نَهَانَا النَّبِيُّ ﷺ أَنْ نَشْرَبَ فِي آيَةِ الْفِضَّةِ وَالذَّهَبِ وَأَنْ نَأْكُلَ فِيهَا، وَعَنْ بُسِّ  
الْحَرِيرِ وَالذِّيْبَاجِ، وَأَنْ نَجْلِسَ عَلَيْهِ

*“Pejgamberi, a.s., na e ka ndaluar që të pimë në enë argjendi dhe të hamë në to, si dhe nga veshja e mëndafshit dhe ulja në to”<sup>37</sup>.*

Gjithashtu, për shkak se kjo është uniformë e kryelartëve dhe perandorëve, ndërsa ngjashmëria me ta është e ndaluar<sup>38</sup>.

Po ashtu, për shkak se kuptimi i zbukurimit dhe kënaqësisë, ashtu siç arrihet me veshje, arrihet edhe me jastëk, ulje dhe fjetje<sup>39</sup>. Si dhe për shkak se veshja e tij nuk lejohet, po kështu edhe ulja në të nuk lejohet<sup>40</sup>.

Sipas Imamit përdorimi i mëndafshit është i lejuar, për shkak se mbështetja në jastëk, fjetja mbi të, si dhe shtroja, nuk është përdorim i plotë, por përdorim në formë përbuzjeje. Kështu që, kuptimi i përdorimit dhe zbukurimit është kufizuar në të, andaj dispozita e ndalueshmërisë nuk e tejkalon veshjen që është përdorimi i plotë i saj<sup>41</sup>.

<sup>37</sup> El Buhari, nr: 5837, 7/151.

Përgjigje ndaj këtij hadithi: ndalueshmëria e veshjes së mëndafshit është transmetuar prej një numër sahabësh, si Enes bin Maliku, Umer bin El Hatabi, Ibën Umeri, Ebu Hurejra, r.a., dhe të tjerë, dhe në asnjërin prej tyre nuk ka asgjë që ndalon uljen mbi mëndafsh. Ndërsa hadithin e Hudhejjes, prej tij e transmeton Abdurrahman bin Ebi Lejla dhe Abdullah bin Ukejmi dhe në hadithin e tyre nuk ka diçka që ndalon uljen, por është vetëm ajo që e ndalon veshjen.

Ndërsa hadithin e Abdurrahmanit e transmeton Hakem bin Utejbe, Jezid bin Ebi Zijadi dhe Muxhahidi. Në hadithin e Hakemit dhe të Jezidit nuk ka ndalueshmëri të uljes, ndërsa hadithin e Muxhahidit e transmeton Sejf bin Ebi Sulejmani, Ibën Avfi, Mensuri dhe Ibën Ebi Nuxhejhi, dhe në transmetimin e Sufjanit, Ibën Avnit dhe Mensurit nuk ka ndalueshmëri të uljes, ndërsa hadithin e Ibën Ebi Nuxhejhit e transmeton Sufjani dhe Xheriri, dhe në transmetimin e Sufjanit nuk ka ndalueshmëri të uljes, por kjo është vetëm në transmetimin e Xheririt. Kështu që, Xheriri edhe nëse është i besueshëm prej të cilit transmetojnë, ai siç thuhet në “Et Takrib”: ‘Ai ka iluzione kur flet nga mbamendja’. Prandaj, kjo shtesë është iluzion i tij dhe nuk ka argument në të, siç thotë Et Tehanevi, në l’lau Es Sunen, 17/345-346.

<sup>38</sup> El Hidajeh, 4/366; El Ihtijar, 4/158; El Binajeh, 12/99; Mexhma El Enhur, 2/534; El Lubab fi sherhi El Kitab, 4/157; Fet’h babi El Inajeh, 5/166, etj.

<sup>39</sup> El Bedai, 5/131; Et Tebjin, 6/14, etj.

<sup>40</sup> El Xhevhere, 2/281;

<sup>41</sup> El Muhit, 5/345; Mexhma El Enhur, 2/534; Redu El Muhtar ala Ed Durr, 6/355.

Po ashtu, për shkak se ulja mbi mëndafsh është nënçmim i tij dhe jo nderim, kështu ai u bë si pikturat në qilim, mbi të cilin lejohet ulja por nuk lejohet veshja e pikturave<sup>42</sup>.

Gjithashtu, për shkak se të gjithë janë unanim se sasia e paktë e mëndafshit në rrobën e veshur është e lejuar, e që është në sasi të katër gishtërinjve, kështu si veshja është edhe përdorimi<sup>43</sup>. Ajo që bën bashkimin midis sasisë së paktë të mëndafshit në rrobën e veshur dhe përdorimit të paktë, është të qenit secila prej këtyre dyjave model, shembull i kësaj është zbulimi i avretit në namaz, zbulimi i paktë nuk e prishë atë, po kështu zbulimi i shumtë në një periudhë të shkurtër nuk e prishë. Kjo është ndryshe nga ulja në karrige të argjendte ose të arit, në të cilën nuk lejohet ulja, sepse ky është përdorim i plotë për sa i përket këtyre dyjave, për shkak se këto dyja nuk vishen, prandaj nuk janë model, sepse vetë gjëja nuk është e vlefshme të jetë model, por është model nëse është një gjë e vogël prej saj<sup>44</sup>.

Mendimin e Imamit, e mbështet edhe etheri, të cilin e transmeton Misar ibën Rashidi r.a., i cili thotë:

رَأَيْتَ عَلَى فِرَاشِ ابْنِ عَبَّاسٍ مَرْفَقَةَ حَرِيرٍ

*“Pashë në shtratin e Ibn Abasit një rrethim jastëk të mëndafshit”<sup>45</sup>.*

Në këtë ether të Ibën Abasit, r.a., ka argument për lejueshmërinë e mbështetjes në jastëk të mëndafshit, si dhe ulje në shtrat të mëndafshit për burra<sup>46</sup>.

<sup>42</sup> El Bedai, 6/355; El Ihtijar, 4/158; Redu El Muhtar ala Ed Durr, 6/355, etj.

<sup>43</sup> El Hidajeh, 4/366; El Muhit, 5/345; El Ihtijar, 4/158; Mexhma El Enhur, 2/534, etj.

<sup>44</sup> Et Tebjin, 6/14-15; El Binajeh, 122/101.

<sup>45</sup> Et Tabekat El Kubra i Ibën Sadit, 1/193-194, në të thuhet: “Transmetuesit e tij janë të besueshëm, më përjashtim të Rashidit të cilit nuk i kemi gjetur përkthim”. Et Tehanevi, në l’lau Es Sunen, 17/346, thotë: “Nuk e kam gjetur përkthimin e Rashidit mevla Beni Amir apo Beni Temim, vetëm se ai është prej gjeneratave me të mira, mbi njerëzit e të cilëve mbizotëron drejtësia, prandaj dhe transmetimi i tij pranohet”; Nasbu Err Rrajeh, 4/227; Ed Dirajeh, 2/221; Umdetu El Karij, 22/14.

<sup>46</sup> l’lau Es Sunen, 17/345.

Gjithashtu, këtë e mbështet edhe etheri, të cilin e transmeton Amër bin Ebi El Mikdami, prej myezinit Beni Vadih, se ka thënë:

دَخَلْتُ عَلَى عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَبَّاسٍ، وَهُوَ مُتَّكِيٌّ عَلَى مِرْفَقَةِ حَرِيرٍ، وَسَعِيدُ بْنُ جُبَيْرٍ  
عِنْدَ رَجُلَيْهِ، وَهُوَ يَقُولُ لَهُ: أَنْظِرْ كَيْفَ تُحَدِّثُ عَنِّي، فَإِنَّكَ حَفِظْتَ عَنِّي كَثِيرًا

*“Hyra te Abdullah bin Abasi, i cili ishte i mbështetur në një jastëk mëndafshi, ndërsa Seid bin Xhubejri ishte te këmbët e tij dhe i thoshte: Shiko se si flet kah unë, vërtet ti ke memorizuar shumë kah unë”<sup>47</sup>.*

Në jastëk të mëndafsh të është mbështetur edhe Enesi, r.a., siç pohon El Kasani, i cili thotë: *“Prej Enesit, r.a., transmetohet se mori pjesë në një gosti dhe u ul në një jastëk mëndafshi, në të cilin ishin vizatuar ca zogj”*. Kështu që, veprimi i tij, r.a., tregon se lejohet ulja në mëndafsh dhe në jastëk të vogël, në të cilin ka fotografi. Me këtë u bë e qartë se ajo që nënkuptohet me ndalimin në hadith është ndalimi i veshjes, kështu që veprimi i sahabiut është sqarues i thënies së Pejgamberit, a.s., dhe jo në kundërshtim me të. Ndërsa analogjia me veshjen nuk është e saktë, sepse stolisja në këto drejtime nuk është si stolisja me veshje, sepse kjo përdoret për të fyer gjënë e përdorur, ndryshe nga veshja, kështu që argumentimi me të është i pavlefshëm<sup>48</sup>. Prandaj, sa i përket teksteve të transmetuara, në lidhje me mëndafshin, themi se ato janë transmetuar në lidhje me ndalueshmërinë e veshjes se rrobës së mëndafsh të, ndërsa fjetja mbi të është me poshtë se sa veshja në përdorim, prandaj nuk e pason atë në dispozitë<sup>49</sup>. Ndërsa sa i përket hadithit, të cilin e transmeton Hudhejfe, r.a., atij i jemi kundërpërgjigjur në fusnotë të hadithit të tij.

Sa i përket mendimit të përzgjedhur brenda medhhebit, në lidhje me të, kemi mendime të ndryshme. Et Tehanevi, thotë: *“Sa i përket asaj në të cilën mbështetemi, ai është mendimi i dy nxënësve, dhe ne e marrim atë siç e kanë marrë shumica e dijetarëve. Në ‘El Mavahib’ është shpre-*

<sup>47</sup> Nasbu Err Rrajeh, 4/227; Ed Dirajeh, 2/221.

<sup>48</sup> El Bedai, 5/131-132.

<sup>49</sup> El Ihtijar, 4/158;

hur qartë saktësimi (i këtij mendimi)<sup>50</sup>. Mirëpo, ky saktësim është në kundërshtim me mutunet që merren në konsideratë dhe që janë të njohura dhe me shpjegimet që u janë bërë atyre, siç thotë Esh Shurunbulali<sup>51</sup>. Këtë e mbështet edhe El Haskefi duke thënë se kjo është në kundërshtim me atë që është e njohur<sup>52</sup>. Saktësimin e mendimit të Imamit e kanë zgjedh El Burhani, En Nesefi, Sadru Esh Sheria dhe të tjerë, siç thotë Abdul Gani El Mejdani<sup>53</sup>.

## Rezime

Mund të themi se shumë prej dijetarëve tanë, për fetva e kanë marr mendimin e dy nxënësve të Imamit, duke u mbështetur në fjalën e Bedrudin El Ajnit, i cili thotë: “Në ‘*El Hakaik*’ thuhet: Shumica e dijetarëve tanë e morën mendimin e dy nxënësve<sup>54</sup>. Këtë e thekson edhe Ibën Abidini, prej El Kahsetanij, se ai ka thënë: “Shumë prej dijetarëve tanë e kanë marr këtë (mendim)<sup>55</sup>. Kjo, sepse devotshmëri është kur personi braktisë atë që nuk ka asgjë të keqe nga frika se mos ajo është e keqe<sup>56</sup>.

---

<sup>50</sup> I'lau Es Sunen, 17/347.

<sup>51</sup> Hashijetu Esh Shurnbulali ala Ed Durrer, 1/312.

<sup>52</sup> Ed Durr El Muhtar, 6/355.

<sup>53</sup> El Lubab fi sherhi El Kitab, 4/157.

<sup>54</sup> El Binajeh, 12/101.

<sup>55</sup> Redu El Muhtarr ala Ed Durr, 6/355.

<sup>56</sup> Mirkatu El Mefatih, 7/2768.

# Mësimet (derset) si formë e diskursit në dave

---

Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma

## Abstrakt

Duke u kthyer në retrospektivë të thirrjes islame (Da've) na shfaqen bindshëm edhe mësimet (derset) që nuk janë të reja në fushën e Da'ves, edhe pse e reja në to mbetet fakti se është radhitja dhe programimi, si dhe mundësia e komunikimit. Mësimet (derset) ngërthejnë në vete substancën e dijes që jepet apo ligjërohet prej një imami të caktuar, në mënyrë sistematike, në një kohë dhe në një vend të caktuar. Mësimet konsiderohen si mjetet më të suksesshme në komunikimin të da'ves duke u bazuar në faktin se ato përmbajnë apo kanë lidhje të fuqishme dhe të drejtpërdrejta mes folësit dhe dëgjuesit, sikurse po ashtu përmbajnë edhe lëndën e dijes. Sikurse, po ashtu, ato konsiderohen edhe lidhje besnike mes daiut dhe të thirrurit, si dhe shpirti i qëndrueshëm mes tyre, e që i heq të gjitha dilemat dhe pengesat ndaj mësimi të çdo gjëje të re dhe me interes për masën. Në shumicën e rasteve, në dhënien e leksioneve duhet të jetë shpjegimi i ndonjë ajeti, hadithi të të Dërguarit, a.s., apo ndonjë shpjegimi të çështjeve të Fikhut (jurisprudencës islame). Zakonisht në këto tubime marrin pjesë një numër i vogël i pjesëmarrësve, të cilët me përkushtim e

dëgjojnë ligjëratën (dersin), dhe se në këtë mënyrë thirrësit i jepet mundësia e mirë që t'u ofrojë atyre njohuri rreth librave bazë të Sheriatit, dhe t'i forcojë lidhjet me ta. Po ashtu kushtëzohet që thirrësi në leksion të jetë i përgatitur mirë për prezantimin e leksionit, dhe mos të largohet shumë nga brendësia e temës, ngase shmangia e tepërt nga tema e bën dëgjuesin që mos të interesohet për thelbin e temës, e që më pas të mërzhitet nga dersi. Po ashtu, gjatë mësimdhënies, kur ndodh komentimi i Kuranit, preferohet që komentimi i tij të bëhet me Kuran, ngase libri i Allahut, xh.sh., më së miri komentohet me anë të ajeteve kuranore dhe, kur nuk mund të gjendet shpjegim me ajete, atëherë i shfrytëzohet më thëniet pejgamberike, dhe po që se nuk ka, atëherë merren për bazë edhe mendimet e komentuesve të Kuranit, të radhës së sahabëve dhe të tabiinëve.

**Fjalët kyçe:** mësim, edukim, trashëgimia institucionale, rrëfime kuranore, da've.

## Abstract

Reflecting on the Islamic call (Da'wah), it is evident that the teachings (lessons) are not new in the field of Da'wah, although the novelty lies in the organization and programming, as well as the potential for communication. The teachings encompass the substance of knowledge imparted or lectured by a specific imam systematically, at a specific time and place. Lessons are considered the most successful means of communication in Da'wah, as they contain or have strong and direct connections between the speaker and the listener, as well as the substance of knowledge. They are also considered faithful links between the preacher and the one that is called, establishing a stable connection that eliminates all dilemmas and obstacles to learning anything new and interesting to the masses.

In most cases, the explanation of a verse, a saying of the Prophet (peace be upon him), or an explanation of issues in Islamic jurisprudence (Fiqh) should be provided during the lectures. Typically, a small number of participants attend these sessions, who attentively listen to the lecture, providing an excellent opportunity for the callers to offer them knowledge about the fundamental books of Sharia and strengthen their ties. It is also essential for the lecturer to be well-prepared for the presentation and not deviate too much from the core of the topic, as excessive deviation makes the listener lose interest in the essence of the subject and subsequently become bored with the lesson.

Additionally, during teaching sessions involving the commentary on the Quran, it is preferable that the commentary is done with the Quran itself, as the Book of Allah is best explained through its verses. When an explanation cannot be found within the verses, then the sayings of the Prophet are utilized, and if not available, the opinions of Quranic commentators, the Prophet's companions (the sahabah), and the followers of the sahabah (the tabi'un) are taken into consideration.

**Keywords:** teaching, education, institutional heritage, Quranic narratives, Da'wah.

## Hyrje

Tejet me rëndësi mbetet fakti se kur thirrësi në fenë e Allahut, xh.sh., e shpjegon një çështje të caktuar nga fusha e Fikhut, preferohet ta shpjegojë një çështje nga jurisprudenca islame, pra, preferohet që ta shpjegojë vendimin mbizotërues juridik (el kavlu erraxhih), nëse ai është i aftë ta bëjë dallimin dhe njohjen e mendimeve më të argumentuara dhe mendimeve që nuk janë edhe aq të fuqizuara me argumente. E, po që se nuk shfaq aftësi dhe nuk ka njohuri të bollshme aq sa ta bëjë përcaktimin e



mendimit më të saktë dhe më të argumentuar, atëherë ky duhet t'i shpjegojë çështjet e Fikhut sipas njërës nga drejtimit juridike islame (medhebeve), pa i përmendur divergjencat juridike për çdo çështje, ngase përmendja e divergjencave mund të shkaktojë hutim në mendjen e atyre që e dëgjojnë leksionin.<sup>1</sup>

Kujdes të duhur thirrësi duhet t'i kushtojë në veçanti paraqitjes së dinjitetshme në mes të njerëzve.

## Ndryshimi shoqëror dhe diskursi (komunikimi) pedagogjik

Me pranimin e faktit se umeti ndodhet në një periudhë shumë delikate dhe të rëndë, si pasojë e përçarjes, dobësisë dhe nënçmimit, po në të njëjtën kohë vendet e umetit janë vendet më të pasura me burime materiale dhe me vlera e parime të larta etike e shpirtërore. Nëse përfunduar se prapambetja e umetit në esencë është për shkak të dobësisë që ndodhi si rezultat i konfliktit mes elitës politike dhe intelektuale në kohët e mëhershme, gjë e cila solli deformime të llojllojshme në pikëpamjet e umetit, kjo u reflektua në plan-programet, shkencat dhe njohuritë njerëzore që shprehin njëanshmëri, sipërfaqësi, ngurtësi dhe parcializëm. Nëse kuptuar se si gjatë shekujve kanë dështuar të gjitha përpjekjet për reformë dhe rilindje në realizimin e qëllimeve, për ta ripërtërirë energjinë e umetit dhe përmirësimin e ecurisë së tij, dhe nëse problematika në fund të fundit është humbja e dinjitetit të njeriut guximit, shpenzimit, ndihmës dhe fuqisë së tij, si dhe dobësimi në fushën e shkencës dhe njohurisë, atëherë përgjigjja është ajo që kërkohet, e që është domosdoshmëria e ndryshimit në natyrën e formimit psikologjik dhe emocional të këtij njeriu. Pra, është i domosdoshëm angazhimi për formimin e mentalitetit shkencor, kreativ, pozitiv dhe efektiv të myslimanit, me të gjitha parimet, vlerat, konceptet dhe pikëpamjet e larta të këtij mentaliteti.

---

<sup>1</sup> Zejdani, Abdulkerim, *Usulu-d-da've*, Muesesetu errisale, botimi i IX-të, Bejrut, 1999, f. 576.

Dhe, është i pamundur ndryshimi real, si dhe dështojnë përpjekjet reformiste në realizimin e qëllimeve, sepse diskursi i drejtuar vetëm të rriturve nuk e ndryshon formimin e tyre, si dhe se vetë përkufizimi ynë me diskurs vetëm ndaj të rriturve nuk mund ta sjellë ndryshimin e domosdoshëm pedagogjik të fëmijët dhe tek adoleshentët.

Diskursi islam në periudhën e shpalljes ka qenë i llojllojshëm, varësisht nga nevoja; atyre që u është drejtuar me ligjërim, gjendjes, dimensioneve dhe qëllimeve. Për këtë edhe diskursi ishte efektiv dhe ndikues. Nga shkaqet më të rëndësishme të dobësimit të diskursit në kohën e mëvonshme ishte mungesa e eksperiencës për ligjërim, mungesa e perceptimit të dimensioneve, të gjendjes dhe të nevojave të atyre që u drejtohet me ligjërim. Kjo gjendje bëri që të gabohet të kuptuarit e diskursit të tyre, të kuptuarit e diskursit në përgjithësi, si dhe të kuptuarit e realitetit dhe qëllimeve. E gjithë kjo solli deformime, e dobësoi ndikimin e tij dhe e shndërroi atë në diskurs teorik, e që shpesh i ka bërë rezultatet e tij të jenë të kundërta me atë që ka qenë për qëllim!<sup>2</sup>

Në mesin e teoricienëve të komunikimit me masën është konkluduar se një nga shkaqet e largimit të njerëzve është edhe paraqitja e keqe, në pamjen e jashtme, në veshje dhe në figurë, gjë që jep përshtypje të masave e njerëzve, veçanërisht atyre bashkëkohorë, se ky person është i prapambetur dhe jeton jashtë rrethit të kohës, bile ndoshta e akuzojnë fenë se është ajo shkak për këtë, kur personi është prej besimtarëve. Pejgamberi, a.s., tregonte kujdes që i çonte lart shijet dhe estetikën e shokëve të tij në figurën dhe paraqitjen e tyre, njësoj siç përpiquej edhe për ngritjen lart të anës së tyre të brendshme. Prej sahabiut Abdullah bin Mesudit, r.a., transmetohet se një ditë ai u tha shokëve të tij: “Nuk do të hyjë në Xhenet ai që në zemrën e vet e ka qoftë edhe një grimcë mendjemadhësi!”. Një burrë i tha: “O Pejgamber i Zotit, mua më pëlqen shumë e bukura në çdo gjë, aq sa nuk dua që të ma kalojë askush, qoftë edhe te këpucët! A bën pjesë kjo te mendjemadhësia?! Ai i tha: “Allahu është i bukur, dhe i

---

<sup>2</sup> Ebu Sulejman, Abdulhamid, Civilizimi islam rënia dhe ripërtëritja e tij, Logos-A, 2021, Shkup, f. 139-140.

pëlqen e bukura. Mendjemadhësia është mohimi i të vërtetës dhe nënçmimi i njerëzve.”<sup>3</sup> Përveç kësaj, edhe më e bukur dhe më e lartë është edhe figura me të cilën u paraqitet Islami njerëzve, sepse ka një figurë tërheqëse dhe një larguese, një figurë përgëzuese dhe një tjetër frikësuese, dhe ne mund t’i fitojmë të tjerët me figurën e tij përgëzuese.<sup>4</sup>

Përvojën që e kemi fituar përgjatë studimeve e kontaktit me njerëz duke zbuluar me përvojat dhe metodologjitë e tyre në misionin e thirrjes dhe të predikimit të Islamit, gjë kjo na ndihmon shumë në realizimin e objektivave tona përgjatë derseve. Puna institucionale e ka një rol efektiv në trashëgimin e përvojave, e të cilat e pasurojnë edukimin e gjeneratave dhe ofrimin e eksperiencave të nevojshme për ta. Ne duhet, siç thotë Ahmed Tutunxhi, të sakrifikojmë dhe të punojmë me të gjitha energjitë tona, përpara besimtarëve të vendit ku punojmë, nën sytë dhe veshët e të gjithë atyre, dhe të ecim me ta hap pas hapi, derisa të vijë koha e plotësimit të punës, të forcohet trunghi i saj dhe t’ua dorëzojmë përgjegjësinë udhëheqësve të rinj; kurse ne të vazhdojmë drejt horizonteve të reja dhe drejt zbulimeve të reja, në fusha të reja. Kjo është ajo që quhet “trashëgimia institucionale”, e cila, nëse për ndonjë arsye mungon ose ndalon, sjell dëme të mëdha për umetin. Mospërcjellja e eksperiencës dhe e përvojës në mënyrë institucionale përbën një rrezik të madh. Se sa reformatorë të një niveli të lartë ndaluan së lëni gjurmë në një moment të caktuar të historisë, kjo nuk do diskutim. Pastaj, ky ndikim u shpërbë dhe u venit në praktikë, sikur mos të kishte qenë kurrë. Sa keq ndihet zemra kur e rishikojmë historinë, dhe atje gjejmë se shumë përpjekje humbën kot vetëm e vetëm për shkak të ndërprerjes në procesin e trashëgueshmërisë institucionale! Prandaj, duke e pasur parasysh rëndësinë e përfitimit të përvojës prej atyre që zotërojnë eksperiencë, dhe për ta transferuar atë te brezat e rinj, ne duhet të ofrojmë ide se cila mund të jetë mënyra më e mirë për të përfituar nga ato përvoja, në një mënyrë

---

<sup>3</sup> Transmeton Muslimi në kapitullin “El iman”, nr. 91.

<sup>4</sup> Kardavi, Jusuf, Rizgijimi islam nga adoleshenca drejt pjekurisë, Furkan, Shkup, 2007, f. 178.

apo në një tjetër, pa paraqitur pengesë për të rinjtë. Në këtë kontekst, puna kolektive institucionale luan një rol aktiv në trashëgueshmërinë e përvojave që kanë për qëllim edukimin e brezave të ardhshëm, për t'u ofruar atyre eksperiencë të nevojshme. Për ta arritur këtë, ne duhet të kërkojmë për programe edukative dhe medie informuese, detyra e të cilave është mbështetja e këtij brezi. Kjo përmes punës institucionale, e cila shkon përtej përpjekjeve individuale, për në punën kolektive metodologjike, dhe që përfiton nga përvojat e kaluara, duke shikuar përpara në horizontet e së ardhmes. Në kontekstin e kërkimit të mjeteve për të trashëguarit e punës kolektive konsiderojmë se është e rëndësishme për çdo punëdhënës dhe për çdo pjesëmarrës në këtë punë, që t'i shqyrtojë të dhënat e secilës përvojë që ai e ka ndërmarrë, ose që e ka ndërmarrë dikush tjetër, ta analizojë dhe t'i identifikojë pikat e forta dhe të dobëta të saj, si dhe arsyet e suksesit ose të dështimit të saj.<sup>5</sup>

Kështu, ajo që është më e rëndësishmja e të rëndësishmëve për prijësit myslimanë, për shoqatat dhe organizatat fetare, si edhe për shtetet myslimane, është: rrënjësja e besimit në zemrat e myslimanëve, ndezja e ndjenjës fetare, përhapja e thirrjes për tek Allahu dhe i dërguari i Tij, besimi në jetën tjetër, sipas modelit të thirrjes islame të kohëve të para, duke mos anashkaluar asnjë mundësi, duke përdorur të gjitha rrugët dhe metodat, të vjetra e të reja të përhapjes dhe mësimi. Thirrësi vazhdimisht duhet vërë në fokus faktin se Kurani dhe jeta e Muhamedit, a.s., janë dy forca të mëdha, e të cilat mund të ndezin zjarr zelli dhe besimi në botën islame, si dhe të nxisin në çdo kohë revolucion mbi botën injorante dhe të prapambetur, atë që nga një popull i dorëzuar dhe i nënshtruar, i përgjumur dhe i harruar e nxjerr në një popull të gjallë e të zellshëm, një popull pasionant dhe të paepur, i cili e lufton injorancën dhe sistemet mizore.<sup>6</sup>

---

<sup>5</sup> Tutunxhi, Ahmet. Mësime nga jeta ime, Logos-A, Shkup, 2020, f. 77-78.

<sup>6</sup> En Nedevi, Ebu Hasen Ali El Husnij, Ma dha hasire el alemi el islami bi inhitati-l- muslimin, mektebul iman, Mensure, 2014, f. 337.

Po ashtu, fokusi i predikuesit, në kuadër të këtyre derseve që janë tepër domethënëse, duhet të jetë sidomos për gjeneratën e re, pasi ndaj saj po zhvillohet një luftë e pamëshirshme materiale e shpirtërore, duke e zbehur dhe mënjanuar çdo gjë që është vlerë njerëzore dhe duke e degraduar rolin që e ka njeriu në mbajtjen gjallë të frymës së vlerave etike e njerëzore në këtë glob.

Po ashtu, në kuadër të trajtimit të temave dhe derseve të ndryshme në këtë fushë nuk duhet harruar trajtimi i faktit se Islami është fe e unitetit dhe fe e bashkimit, fe që e adhuron vetëm Allahun, Një të Vetëm. Umeti islam krenohet me këtë tevhid (adhurim të Allahut, Një të Vetëm). Ky umet, krahas tevhidit të Allahut në adhurim, i bashkon radhët edhe në tokën e Tij, bëhet një. Që këtej aktiviteti thirrës duhet të përqendrohet në thirrjen drejt bashkimit të umetit, në një ide, ndjenjë dhe praktikë, ta qortojë përçarjen e umetit, në ide dhe praktikë. Uniteti është fuqi, mëshirë, bekim dhe efikasitet, siç është shkak i mbështetjes që vjen prej Allahut të Madhërishëm dhe ndihmës që vjen prej Tij, ndërkaq që përçarja e nënkupton të kundërtën. Puna në aktivitet da'vetor nuk arriti që umetit t'i ofrojë arritje që i përshtatet mundit dhe sakrificës që e bëri për hir të tij, edhe pse kishte potencial të madh për këtë, veçmas nëse kemi parasysh se da'veti është vendkalim i vërtetë që shëron brengat e umetit dhe vendkalim të shpresat e tij. S'do mend se një gjë e tillë i referohet disa shkaqeve nga të cilat vuan puna e da'vetit, e në rend të parë përçarja që disa herë kalon edhe në urrejtje dhe armiqësi. Nijeti i sinqertë, për hir të Allahut të Madhërishëm, do të ishte ndihmesa e parë në realizmin e unitetit-bashkimit, pastaj përhapja e dashurisë, shpërfillja e polemikave rreth çështjeve dytësore dhe marginale në fushën e Akides, degët e Fik-hut, shpërfillja e mospajtimeve të dijetarëve dhe zënkave të mëvonshme, sepse, siç dihet, ai që ia ka qëlluar, do të shpërblehet, kurse ai që e pati gabim, do të arsyetohet.<sup>7</sup>

---

<sup>7</sup> Talib, Hisham, Besëlidhja e thirrjes islame, Logos-A, Shkup, 2017, f. 64-64.

## Veçoritë e mësimëve të predikuesit

Mësimi që jep predikuesi dallon dukshëm nga mësimet që i ofrojnë të tjerët, dhe atë për disa arsye:

1. Mësimi që zhvillon predikuesi e ka një formë specifike dhe shije të dallueshme, e cila nuk është e njëjtë me mësimet e kurseve shkencore. Zakonisht në këto ambiente mësimi predikuesit nuk i intereson gjerësisht të thellohet në qartësimin e temave që kanë të bëjnë me lëndën e Gjeografisë, Kimisë, Inxhinierisë, Mjekësisë etj., nga se këto janë fusha të tjera dhe për studiues e tjerë të këtyre fushave.
2. Një nga veçoritë e mësimëve është se ia japin një nxënësi të rregullt një bagazh të bollshëm dijesh, një sasi lënde Fikhu të konsiderueshme dhe një vijë të qartë për një ecuri sa më të saktë në terrenin e kërkimit të dijes. Mësimet të edukojnë, ta formojnë personalitetin dhe të dhurojnë ekuilibër në të menduar.
3. Mësimet që i zhvillon thirrësi islam në shumicën e rasteve ndërlihdin mes temës së dëshiruar dhe realitetit jetësor të individëve dhe problematikave të tyre, të cilave u kushtojnë rëndësi ditore. Mësimi që flet kundër kamatës, nga e cila masës i kërkohet të largohet nga mësimet që nxisin drejt këtij mëkati, mund të jetë që të investojë mbi parime të shëndosha islame që ka dobi vetë shoqëria. Apo edhe mund të trajtojë tema që e kundërshtojnë dhe e luftojnë dhunën dhe padrejtësinë që zhvillohet e rëndon mbi ta, apo zhvillon mësimë që e nxisin dashurinë dhe investimin sa më të mirë në gjeneratat e reja.
4. Mësimi-dersi i ligjëruesve nuk mundet që mos të përbëhet dhe mos të ketë dhe përçojë emocione, jo sa hytbeja, por synohet që ky element mos të duket i thatë dhe mësim pa sens.

Duhet theksuar se rrëfimet e Kuranit lidhur me popujt e mëhershëm paraqesin mjet për edukim, si dhe janë burim i udhëzimit të mirëfilltë dhe këshillë që e ndihmon individin e shoqërinë. Ato janë fragmente nga e kaluara, të cilat fragmente Shpallja e Lartë i rikthen për qëllime të lar-

ta, për mësim dhe këshillë. Rrëfimet kuranor përmbajnë gjallëri të jash-tëzakonshme; të duket sikur janë ngjallur shekujt e vdekur qëmoti, sikur janë gjarpërinj që lëvizin, sikur e dëgjojmë zhurmën e luftës që zhvillohet mes të mirëve dhe të këqijve, sikur shiriti i ngjarjeve lëviz për t'i rikthyer kështu periudhat e historisë së botës.

Me prezantimin e mësimëve historike, predikuesi prezanton shembuj që kanë të bëjnë me këtë çështje, e që ne e shohim se çfarë pësuan ata para nesh që u treguan të padëgjueshëm dhe ata që u treguan të dëgjueshëm, ata që u treguan të udhëzuar dhe ata që ishin të devijuar, të drejtët e mburravecët, të shpëtuarit dhe të humburit etj. Këto janë transmetime që e rrëfejnë realitetin e ndodhur, e assesi imagjinatën.

كَذَلِكَ نَقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ مَا قَدْ سَبَقَ ۗ وَقَدْ آتَيْنَاكَ مِنْ لَدُنَّا ذِكْرًا . مَنْ

أَعْرَضَ عَنْهُ فَإِنَّهُ يَحْمِلُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وِزْرًا . خَالِدِينَ فِيهِ وَسَاءَ لَهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ حِمْلًا

*Po kështu Ne të rrëfejme ty për disa nga ndodhitë që kanë kaluar më herët dhe nga ana jonë ta dhamë ty shpalljen plot përkujtime. Kush ia kthen shpinën kësaj (shpalljes - Kuranit), ai në Ditën e Kiametit do ta bartë barrën më të rëndë. Nën atë do të qëndrojnë përgjithmonë. Sa barrë e keqe është për ta në Ditën e Kiametit.<sup>8</sup>*

Prandaj, bota islame nuk mund ta përmbushë mesazhin sipas formave dhe aparenceve të qytetërimit që solli Evropa në botë, apo në përvetësimin e gjuhëve të saj në mënyrë të jetesës, e të cilat nuk kanë të bëjnë aspak me rizgjimim e ringjalljen e popujve. Mesazhi përçohet vetëm me shpirtin dhe fuqinë morale në të cilën Evropa përditë e më shumë po dështon. Ai bëhet fitimtar vetëm me besim dhe mosdhënie pas kësaj jete dhe epsheve apo pasioneve të saj, me dëshirën e zjarrtë për të vdekur në mbrojtje të çështjes së Allahut, me dëshirën e pashoqe për Xhenetin, me largimin nga përjetimet e kësaj jete, me durimin e së keqes për hir të Allahut, me durim dhe duke shpresuar në shpërblimin tek Allahu, siç thuhet në Kuran:

<sup>8</sup> Taha, 99-100.

وَلَا تَهِنُوا فِي ابْتِغَاءِ الْقَوْمِ ۗ إِن تَكُونُوا تَأْلَمُونَ فَإِنَّهُمْ يَأْلَمُونَ كَمَا تَأْلَمُونَ ۗ وَتَرْجُونَ  
مِنَ اللَّهِ مَا لَا يَرْجُونَ ۗ وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا

***“Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e armikut, se nëse ndieni dhembje, edhe ata ndiejnë dhembje sikurse ju, e ju shpresoni tek Allahu çka ata nuk shpresojnë. Allahu është i Dijshëm, Ligdhënës i Matur.”***

1. Predikuesi që jep mësim duhet të demonstrojë përgatitje shumë profesionale në shtjellimin e mësimet, si dhe të tregojë edhe afinitet për përgjigje që mund të parashtrohet brenda suazave të mësimet. Krahas kësaj, ai duhet të tregojë edhe durim (sabër), te jetë i dashur, si dhe nuk bën të nevikoset dhe mos të lëshohet (hyjë) në gjëra që nuk duhet dhe që nuk ka dobi në to, duke e humbur kohën, e cila është shumë e çmuar.
2. Preferohet që da’iu mos të hyjë në polemika kur në disa mesele ka divergjencia të thella mes dijetarëve islamë, duke u munduar ta japë mendimin mbizotërues në të, përveç nëse i njeh mirë drejtimitet (medhebet), dhe t’i tregojë masës se ky mendim i takon një medhebi të caktuar, në mënyrë që mos të ngjallet huti e as dyshime në mes të xhematit.

## Disa veçori negative që shfaqen gjatë mësimdhënies

Duke u nisur nga parimi se si veçori e mësimetve është edhe se ne ia japin një nxënësi të rregullt një bagazh të bollshëm dijeje, një sasi të konsiderueshme lënde nga Fikhu dhe një vijë të qartë për një ecuri sa më të saktë në terrenin e kërkimit të dijës, mësimet të edukojnë, të ndihmojnë në formimin e personalitetit dhe të dhurojnë ekuilibër në të menduar.

- Disa mësimet bëhen monotone dhe të ftohta.

<sup>9</sup> En Nisaë, 104.



- Moslënia e hapësirave për bashkëbisedim, çka jep mundësi që nxënësit mos ta kuptojnë atë që kërkohet, apo nuk jem mundësi të qartësohet çështja rreth dilemave që mund të jenë.
- Dobësia në hedhjen e themeleve të dijes. Nxënësit i jepen gjëra dytësore, larg dijes së vërtetë nga Kurani dhe Suneti, sa nuk është në gjendje të nxjerrë gjykime, madje as të vlerësojë mes mendimeve të ndryshme.
- Ambientimi i nxënësve me imitim, çka e bllokoi mendimin dhe e ndryshk mekanizmin e ixhtihadit. Kjo gjë bën që të diplomohen nxënës që nuk e njohin komentin e ajeteve që flasin për ligjet, si dhe as hadithet e po të njëjtës fushë.
- Dobësia e procesit të edukimit. I gjithë shqetësimi përqendrohet në grumbullimin informacionit, dhe lihet mënjanë edukimi.
- Mosdhënia rëndësi anës predikuese, formimi rrënjësor në këtë drejtim dhe mosushtrimi i nxënësve në praktikë.<sup>10</sup>

Po ashtu, një rëndësi të veçantë në këtë mes e ka çështja që predikuesi (da'iu) të përdorë terminologji të sakta dhe të veçantë, sidomos të atyre që i kemi ne, që këto terminologji të jenë të sakta, të qarta dhe të pavarura, të përzgjidhen me kujdes dhe urtësi, t'i shmangen ecurisë pas valëve ideologjike, e që herë pas here dalin në sipërfaqe. Gjithashtu nuk duhet ta cilësojnë Islamin me socializëm, nëse përhapet ekonomia-socialiste, e as me kapitalizëm, nëse përhapet ekonomia kapitaliste, po as me demokraci, edhe në qoftë se shtrihet në shkallë të gjerë, apo nëse përhapet ekonomia demokratike etj. Islami është Islam me kriteret dhe parimet e tij të pandryshueshme, me platformën dhe mjetet e tij. Pikëtakimi me disa nga parimet e tij me të tjerat i referohet universalitetit dhe gjithëpërfshirjes së tij në çdo gjë, mirëpo ky pikëtakim nuk na lejon që atë ta cilësojmë me këtë apo atë frymë ideologjike. Parimet islame janë konstante, kurse parimet e tjera janë jokonstante. Islami është e vërteta ab-

<sup>10</sup> Zejdani, Abdulkërim, *Usulu-d-da've*, Muesesetu errisale, botimim i IX-të, Bejrut, 1999, f. 251.

solute, përkundër të tjerave, parimet e të cilave ndryshojnë herë pas here.<sup>11</sup>

Gjatë shpjegimeve të mësimave që kanë të bëjnë me fikhumekasid (fikhu i objektivave të Sheriatit), kur thirrësi detyrohet të mësojë dhe të kuptojë mirë fikh të objektivave, të studiojnë mirë dhe të thellohet në dije, nuk lejohet që thirrësi të kapet për kuptimin sipërfaqësor të teksteve, të ndalet në shpjegimin e fjalëpërfjalshëm, ta shpërfill atë që ndodhet pas, objektivat, fshehtësitë dhe urtësitë etj. Kjo nuk nënkupton shpërfiljen e vlerës së teksteve, por depërtimin në shpirtin e tyre, në dritën e të përgjithshmeve, në dritën e objektivave të përgjithshme të Sheriatit dhe në dritën e rregullit që thotë: “Qëllimi është me objektivat dhe kuptimet, e jo me shprehjet dhe frazat.”. “Çështjet vlerësohen sipas objektivave”, thotë rregulli tjetër. S’ka dyshim se kjo kërkon dëgjueshmëri dhe respekt të të specializuarve në këto fusha.<sup>12</sup>

## Rezyme

Në përfundim të këtij punimi shkencor me titull “Mësimet (derset) si formë e ligjërimit në Da’ve”, konkludojmë se fusha e Da’ves mbetet e gjerë si në tematikë ashtu edhe në trajtesa, prandaj predikuesi me mprehtësi duhet t’i zgjedhë temat (derset) që janë të nevojshme për xhematin, duke iu përshtatur nivelit të tyre arsimor dhe edukativ. Pastaj edhe duhet të hapë tema që nuk nxisin përçarje e thyerje të unitetit të xhematit. Po ashtu predikuesi duhet të jetë faktor uniteti mes xhematit, si dhe t’i ruajë vlerat dhe shpirtëroren e Islamit. Po ashtu nuk duhet harruar që thirrësi në leksioni të jetë i përgatitur mirë për prezantimin e leksionit (dersit) dhe mos të largohet shumë nga brendësia e temës, ngase shmangia e tepërt nga tema e bën dëgjuesin që mos të interesohet për thelbin e temës, dhe pastaj edhe të mërzitet nga dersi.

---

<sup>11</sup> Talib, Hisham, Besëlidhja e thirrjes islame, Logos-A, Shkup, 2017, f. 42.

<sup>12</sup> Ibid, f. 45.



# Metoda e tretë e thirrjes

Prof. Ass. Dr. Musa Vila

## Abstrakt

Kjo temë ka të bëjë me një metodë specifike të thirrjes që në fjalorin islam njihet si hytbe, dhe që në gjuhën shqipe do të thotë kur një person (imami) në ditën e xhuma i drejtohet masës me një fjalim për të dhënë një mesazh rreth ngjarjeve që zhvillohen në atë vend dhe më gjerë. Imami në petkun e hatibit do të mundohet që për një kohë të shkurtër të japë gjëra të mëdha pavarësisht se a kanë të bëjnë me inkurajim apo frikësim. Ky veprim i imamit mbështetet në veprimin që Pejgamberi, a.s., u ishte drejtuar njerëzve përmes hytbes duke u dhënë atyre këshilla, përgëzime, qortime, urdhra dhe ndalesa. Gjatë hytbes hatibi i suksesshëm ngjall ndjenjat dhe emocionet humane, fetare dhe atdhetare duke përdorur argumente nga Kurani dhe hadithet pejgamberike si dhe trashëgimia e dijetarëve).

**Fjalë kyqe:** hytbe, iman, ligjërim, hatib, këshillë

## Abstract

This topic is about a specific method of calling that in the Islamic dictionary is known as *hytba*, and that in the Albanian language means when a person (imam) on Friday addresses the mass with a speech to give a message about the events that take place in that country and beyond. The imam in the cloak of the *hatib* will try to give great things for a short time regardless of whether they are about encouragement or intimidation. This action of the imam is based on the action that the Prophet, may God bless him and grant him peace, had addressed to people through the sermon, giving them advice, praise, reprimands, commands and prohibitions. During the sermon, the successful preacher evokes human, religious and patriotic feelings and emotions using arguments from the Qur'an and prophetic hadiths as well as the legacy of scholars).

**Keywords:** al *hutba*, iman, lecture, *hatib*, advice

## Hytbeja - الحُطْبَةُ

All-llahu, xh.sh., thotë:

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا كَلِمَةً طَيِّبَةً كَشَجَرَةٍ طَيِّبَةٍ أَصْلُهَا ثَابِتٌ وَفَرْعُهَا فِي السَّمَاءِ

*“Shembulli i fjalës së mirë është si një pemë e mirë, rrënja e së cilës është e ngulitur fort dhe degët e saj ngrihen lartë në qiell”<sup>1</sup>*

Përmes fjalës së mirë ngrihen bazamente të forta, freskohen shpirtat, gjeneratat futen në lëvizje dhe lartësohen popujt.

---

<sup>1</sup> Ibrahim, 24.

Me fjalën e mirë përmirësohet gabimi, ngrihet drejtësia, mposhtet e keqja, ndriçohet errësira.

Fjala e mirë është rrugë e punës, përfitohet nga e kaluara, ngjallet e sotmja dhe shpresohet e ardhmja.

Fjala e mirë është më e fuqishme kur buron nga minberi, kokat i ngrit lart, shpirtrat i qetëson, sytë i stërmadhon dhe udhëhiqet nga qetësia që nuk dëgjohet bile asnjë zë. Në ato momente ngrihet hatibi lart, me një oratori përplot argumente, i përcjellë me pamje të bukur.

Veprimin e parë që e kishte bërë Pejgamberin, a.s., drejtuar njerëzve të shkretëtirës ishte dhënia këshillave nga hytbeja, përgëzimeve, qortimeve, urdhrave dhe ndalesave. Përmes hytbes këta njerëz i transferoi nga robërit paganë, në umet të pastër që u bënë yje udhëzimi; nga cuba dhe plaçkitës të haxhilerëve, në luftëtarë të vijës së parë të frontit; nga poetë alkoolistë, në shkrimtarë të urtësisë dhe mbrojtës të së vërtetës; nga fshatarë të varfër e të zhveshur, në pronarë të deteve, oqeanëve dhe të tokave në lindje e perëndim.

Gjuha e sinqertë predikuese u flet shpirtrave drejtë për së drejti, shpirtrat i shpëton dhe sytë i ngopë. Në hytben me ndikim, njerëzit e vërtetë dhe poseduesit e moralit i gjejnë kërkesat e tyre. Gjatë dëgjimit të hytbes trimërohet frikacaku, koprraci bëhet dorëllirë, mendjelehti merr mençuri dhe dembeli bëhet luftëtar. Gjatë dëgjimit të hytbes ushqehet i varfëri, vishet i zbathuri, ndihmohet i shtypuri dhe fshihen lotët e atij që e kanë kapluar sprovat. Hatibët oratorë rrëfejnë për një kohë të shkurtër një histori të gjatë, dhe për një kohë të shkurtër organizojnë shpresa të mëdha. Kur flasin për trimërinë, ushtarëve vdekjen ua bëjnë të lehtë, sikur ata të ishin në një panair duke parë kopshte të lulëzuara. Inkurajojnë ushtarët për trimëri, sikur dëshirojnë t'u thonë se nuk ka jetë pa vdekje, dhe mbetja në jetë pa mbrojtje është shkrirje dhe nënçmim, dhe jeta pa heronj është turp. Hatibët armikun dhe fuqinë e tyre e paraqesin sikur shpatat e tyre të jenë shkopinj të paqëndrueshëm, ndërsa shigjetat e tyre filiza që luajnë fëmijët.

Hatibët oratorë kur u flasin të pasurve i inkurajojnë për t'u bërë bujarë dhe dorëdhënës, dhënien ua bëjnë jetë, kurse koprracinë vdekje, ndërsa shpenzimin lumturi. Në fjalët e hatibit shkrihet ari dhe argjendi, paraja derdhet, depot hapen nga drynat e shumtë dhe vërshon bujaria e lulëzon shoqëria.

Pejgamberin, a.s., në hytben e Bedrit atyre të cilët ishin të etshëm për lumturi ua ofroi Xhenetin, e jetën e kësaj bote ua bëri të urryer, e atyre që kërkonin vdekjen ua lehtësoi rrugën e saj. Pasi që vdekja ishte dëshira e tyre, besimtarët kur fjalët e tij i dëgjuan iu vërsulën armikut, dhe aty gjetën tetë dyert e Xhenetit, ujin e Keutherit, ibrikët e arit e të argjendit të Xhenetit Adn.

Hatibi orator posedon frerët që drejtojnë dhe largojnë ndjenjën e kotjes dhe monotoninë brenda xhamisë. Ai nuk i lë shpirtrat që të koten, por me fjalët e tij i bënë ata të përqendrohen në fushën e fjalëve të tij. Fjalë e tij i drithërojnë zemrat, shpirtrat i forcon, këmbët i ngulit dhe gjymtyrët i stabilizon. Hatibi orator është sikur lumi vërshues, çdo barrikadë që del para e tejkalon, çdo gropë që ka e mbushur me ujë, çdo gurë apo rrasë e shmangë në të djathtë apo në të majtë. Hatibi i suksesshëm qetëson dhe vetëm qetëson, veshët i bën të dëgjojnë, sytë të shikojnë e zemrat të dirigjojnë, dhe atmosferën e bëjnë të nxehtë.

Hatibi orator armën e fortë e ka argumentin që vjen nga veraset kuranore dhe hadithet pejgamberike si dhe fjalët e dijetarëve.

## Definicioni i hytbes

Hytbeja është art i mënyrës gojore drejtuar masës me synim për ta bindur atë, për t'ia mbushur mendjen dhe për t'ia ngjallur emocionet.<sup>2</sup>

Me fjalën **art** nënkuptohet dhunti e lindur, diapazon i dijes, metodologji e ekspozimit përmes tri elementeve: idesë, emcioneve dhe shprehjes. Po ashtu nënkupton përsosmëri në përgatitjen e hytbes, në zgjedhjen

<sup>2</sup> Muhamed Ebu Zehre, El Hattabetu, Darul Fikr El arabij, Beirut, botimi I, 1416 h., f. 9.

e temës, radhitjen e mendimeve dhe sistematizimin e strukturës së fjalëve.

Me fjalën **mënyrë gojore** nënkuptohet që hytbeja të mos jetë prozë, poezi, artikull, tregim, shkresë etj. Mënyra gojore është diçka më precize se sa fjalimi, i cili mund të realizohet tek njerëzit edhe përmes leximit apo bisedës mediatike të kohës së sotme. Hatibi, të cilit i mungon elementi gojor dhe që temën e lexon nga letra, ka humbur pjesën më të rëndësishme dhe esenciale të hytbes, ngase ai përmes leximit e humb përqendrimin e audiencës - dëgjuesve, kështu ata çorientohen nga ai tek letra e tij, dhe fjalët e tij, pavarësisht se sa ndikuese mund të jenë, nuk prek shpirtat e tyre, e më së paku ndjenjat dhe emocionet.

Fjala **masë apo audiencë** është ajo që e bënë hytben të dallohet nga ligjërata, debati dhe këshilla, ngase këto arte edhe pse kanë pika të përbashkëta me hytben në mënyrën gojore, prapëseprapë dallojnë për nga numri i dëgjuesve (audiencës). Duhet patjetër që hatibi ta bëjë unifikimin e gjuhës, kohës, vendit dhe qëllimit, në mes tij dhe masës në mënyrë që t'u flasë atyre dhe tua mbushë mendjen. Kjo pjesë e fundit e bënë hatibin e suksesshëm të veçohet nga hatibët e tjerë. Hatibi, i cili i kënaq dëgjuesit dhe i bind ata, është hatib i vërtetë. Ai këtë mund ta arrijë përmes disa mënyrave: përmes idesë së shëndoshë, sistematizimit të saj, ekspozimit të bukur, me fakte dhe argumente të vërteta.

Mbushja e mendjes dhe ngjallja e emocioneve janë dy shtylla të hytbes. Ngjallja e emocioneve është shtylla e dytë e hytbes, ngase masa apo xhemati, pavarësisht se cilës strukturë i takon: intelektuale, qytetare apo popullore, - ata vetëm përmes emocioneve do ta gjykojnë lidhjen e tyre me hutben. Lidhja emocionale e tyre me hytben është më e fortë se sa mbushja e mendjes.<sup>3</sup>

Mendja dhe emocionet janë dy pjesë të pandashme të masës që e ndihmojnë dhe e përforcojnë njëra-tjetrën, dhe që nuk e tradhtojnë njëra-tjetrën. Hatibi, i cili fokusohet vetëm në njërin prej tyre, rezultati i

---

<sup>3</sup> Muhamed Atif Abdul Maksud, El Hutab El xhediye vEl mevaiddh El mufide, Muesesetul muhtar, botimi I, Kajro, 1998, f. 40.



hytbes është i zbehtë dhe negativ, dhe kjo i përngjet personit i cili ec vetëm me një rënë këmbë.

Ekzistojnë edhe disa çështje që e ndihmojnë suksesin e këtyre dy shtyllave (mbushjes së mendjes dhe ndikimit emocional):

- Disa çështje ndërlidhen me tematikën e hytbes;
- disa çështje ndërlidhen me hatibin;
- e disa të tjera ndërlidhen me audiencën (xhematin).

Kur tematika e hytbes është e një rëndësie të veçantë për audiencën (xhematin), temë që u bën dobi ose është e shijes dhe e ndjenjave të tyre, atëherë kjo ia lehtëson hatibit që atyre t'ua mbushë mendjen dhe t'ua ngjallë emocionet. Pra, për të qenë hytbeja e suksesshme disa çështje ndërlidhen drejtpërsëdrejti me personalitetin e hatibit, e disa janë të lidhura me gjendjen e dëgjuesve, e disa me tematikën. Secila prej tyre e ka rolin dhe ndikim e saj në suksesin e hytbes.

### **Hytbeja patjetër duhet t'i ketë tri kritere:**

1. Hyrja
2. Tematika dhe
3. Përfundimi

## **Hyrja e hytbes**

### **Hyrja është e domosdoshme në këto raste:**

1. Nëse hatibi është anonim dhe i pa njohur për dëgjuesit, atëherë identifikimi i tij mund të bëhet në hyrje, që do t'i shërbejë si nyje lidhëse mes tij dhe dëgjuesve, xhematit.
2. Nëse hatibi është i padëshirueshëm për xhematin për shkak të qëndrimeve të tij të mëhershme ose të përhapjes së ndonjë të pavërtete, e cila e ka bërë hatibin të jetë i pakëndshëm për ta, atëherë përmes hyrjes hatibi mund ta shlyejë atë barrikadë të urrejtjes ose atë atmosferë të zbehtë dhe të ftohtë në shpirtat e xhematit.
3. Hyrja është e domosdoshme kur tematika e hytbes është larg vëmendjes dhe përqendrimit të xhematit, kështu që përmes hyrjes u

bëhet e qartë atyre se kjo tematikë është e rëndësisë së veçantë për ta, dhe që prek interesat e tyre, dhe se përmes kësaj tematike largohen apo pengohen dëmet që mund t'i prekin ata.

4. Hyrja është e domosdoshme nëse tematika e hytbes bie në kundërshtim me traditat joshëse të tyre apo me mendimet dhe qëndrimet që i kanë përqafuar më herët, kështu hyrja e hytbes shlyen çdo pengesë apo barrikadë që mund të ndodhë në mes hatibit dhe xhematit.
5. Hyrja është e domosdoshme nëse tematika është fare e panjohur për xhematit, atëherë hyrja sqaron rëndësinë dhe peshën e asaj hytbeje.

Hyrja nuk është e domosdoshme nëse hatibi është person i njohur për xhematit, nuk është i urryer dhe që tematika e tij prek interesat e tyre. Në të shumtën e rasteve nuk do të kishte nevojë për hyrje kur bëhet fjalë për gjendje lufte apo përplasje politike, në këto raste hatibi kyçet drejtpërsëdrejti në tematikë.

## Kushtet që duhet përmbushur për një hyrje cilësore

1. Hyrja duhet të ketë lidhje të ngushtë me tematikën e hytbes për të zgjuar vëmendjen e xhematit.
2. Hyrja duhet të ekspozohet me metodën më joshëse që të realizojë synimin, i cili është të kthyerit e dëgjueshmërisë së masës, e kjo nuk mund të arrihet përveçse duke njohur anën e brendshme shpirtërore të xhematit, se cila është nevojja e tyre.
3. Hyrja duhet të jetë me fjalë të qarta, të kuptueshme, e cila i përshtatet nivelit të tyre, ngase xhematit në fillim të hytbes anon kah mosdisponimi, inati dhe kritika. E nëse hatibi në hyrje me shkathtësi i mposhtë këto, atëherë ata do të jenë nën direktivat e tij dhe fjalët e tij do të depërtojnë në mendjet e tyre dhe nuk ka vend për monotoni.
4. Hyrja duhet të jetë në përputhshmëri të plotë me hytben për nga shkurtimi dhe gjatësia, në mënyrë që energjia e hatibit të mos shpenzohet krejtësisht në hyrje. Apo vëmendja e xhematit të jetë në hyrje

në disfavor dhe llogari të vetë tematikës. Në këtë rast ia vlen që hatibi të e potencojë se këtë që e thash është hyrja, e jo tema.

## Llojet e hyrjes

1. Hyrja mund të fillojë përmes pyetjeve që i parashtrohen xhematit, në mënyrë që ata të jenë më afër tematikes që do të zhvillohet në vijim. Ose në hyrje mund të ceket ndonjë shembull apo urtësi, në mënyrë që xhemati të zgjojë interesim për tematikën. Një formë të tillë e kishte praktikuar vetë i Dërguari, a.s., në fillim të komunikimit të shpalljes. *“Një ditë papritmas Pejgamberi a.s. u ngjit në kodrën Saffa dhe i thirri njerëzit. E pasi që ata u grumbulluan, fjalimin e tij e filloi përmes pyetjeve, ndërsa u tha: “Më tregoni mua, nëse unë ju them se prapa kësaj kodre gjendet kalorësia e armikut që dëshiron t’ju sulmojë juve, a do të më besonit mua?” E përgjigjja e tyre ishte: “Po.”<sup>4</sup>*
2. Hyrja e hytbeve fetare duhet bërë me falënderim të Allahut dhe madhërim të Tij, duke kërkuar falje dhe pendim, pastaj duke qar salavat për Pejgamberin, a.s. Shembuj të tillë kemi mjaft, e ndër to është edhe hytbja e Pejgamberit, a.s., në Haxhin e Lamtumirës.
3. Hyrja e hytbeve, që ndërlidhen me luftën, patjetër duhet të fillohet me potencim të xhihadit, vlerës së tij, shpërblimin e luftëtarëve dhe rëndësinë e luftës. Shembuj të tillë kemi mjaft nga jeta e sahabëve, e këtu kemi edhe thënien e Omerit, r.a., kur thotë: *“Vërtetë xhihadi është një derë prej dyerve të Xhennetit, kush e braktisë atë Allahu atë do ta nënçmojë, do ta veshë me petkun e poshtërimit, e atë do ta kaplojë belaja dhe do të jetë vazhdimisht i nënshtuar dhe i poshtëruar.”*
4. Hyrjet e hytbeve këshilluese (te vaizit), kërkojnë të fillohet me potencimin e vdekjes, shpenzimin e kësaj bote, inkurajimin në vepra të mira, tërheqje vërejtjesh nga fenomenet që janë shkatërruese. E she-

<sup>4</sup> Sahihul Buhari, nr. 4770; Sahihu Muslim, nr. 207.

mbuj të tillë kemi mjaft, ndër to është edhe fillimi i hytbes së Omer bin Abdulazizit:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّكُمْ لَمْ تُخْلَقُوا عَبَثًا وَ لَمْ تُتْرَكُوا سُدىً... وَ اعْلَمُوا أَنَّ الْأَمَانَ عَدَا  
لِمَنْ خَافَ اللَّهَ الْيَوْمَ وَ بَاعَ قَلِيلًا بِكَثِيرٍ وَ فَانِيًا بِنَاقٍ .

*Ai tha: "O njerëz, vërtetë ju nuk jeni krijuar kot, e as nuk jeni të raste-sishëm, e dijeni që amaneti-vdekja është para jush; për atë që ka frikë Allahun sot e shet të paktën për të shumtën, të përkohshmen për të përhershmen (e shet Dunjanë për Ahiretin)."*<sup>5</sup>

## Tematika e hytbes

### Shfaqja e tematikës së hytbes përfshin tri faza, e ato janë:

#### a. Faza e përcaktimit të idesë dhe përgatitjes së materialit.

Që në fillim hatibi e përcakton tematikën e hytbes në formën më të qartë në mendjen e tij, pavarësisht a ka karakter këshillues, orientues, politik apo luftarak. Ai përcakton pozitën e tij para dëgjuesve se a duhet të jetë përkrahës apo kundërshtar i tyre. Ai duhet të arrijë që të përfitojë shpirtin e masës si dhe të paraqet metodën më të përshtatshme që duhet t'i flet atyre. Po ashtu ai duhet ta njohë strukturën e masës në aspektin e ngritjes intelektuale dhe shoqërore. Hatibi, i cili u flet masës ku ka dije-tarë, udhëheqës, administratorë, duhet të jetë ndryshe nga hatibi, i cili u flet masës që janë punëtorë, tregtarë apo bujq.

لِكُلِّ مَقَامٍ مَقَالٌ وَ لِكُلِّ حَادِثَةٍ حَدِيثٌ

*Pra, çdo vend e ka kuvendin e vetë (sipas vendit edhe kuvendin) dhe çdo ngjarje e ka bisedën e vetë (sipas motit edhe gëzofi).*<sup>6</sup>

<sup>5</sup> Shebeke Aluke, aluka.net, El Muslimune fil alem, 26.06.2008.

<sup>6</sup> Halid Salah, Reis Tahriri El Bejan, Youm7.com.

## b. Faza e bashkërenditjes

Kjo fazë nënkupton grumbullimin e materies shkencore në përpikëri të lartë dhe që ajo të jetë gjithëpërfshirëse. Kjo përfshin disa pika:

- Ndarja e tematikës në tituj dhe mendime thelbësore, duke i radhitur bukur, të ndihmuara me fakte dhe argumente nga Kurani, Hadithi, jurisprudenca islame, historia, biografia e Pejgamberit a.s.-sireja e tij, dhe urtësitë.
- Hatibi duhet t'i shmangët futjes së fjalëve dhe mendimeve që nuk kanë lidhshmëri me tematikën, ngase një gjë e tillë do ta shqetësojë masën dhe do t'ia humbë përqendrimin nga tema.
- Hatibi bën radhitjen e titujve duke filluar nga më i rëndësishmi dhe më i argumentuari, pastaj gradualisht zbret tek titujt më pak të rëndësishëm.
- Hatibi duhet të zgjedhë fakte dhe argumente të përshtatshme për tematikën, duke iu shmangur tematikave kundërtënëse, kundërshtuese, polemizuese, shembujve të kotë, përrallave, legjendave, paragjykimeve si dhe gjërave që bien ndesh me të vërtetat shkencore dhe dëshmime aktuale.<sup>7</sup>

## c. Faza e zhvillimit dhe komunikimit

Kjo fazë është vendimtare ngase tek dëgjuesit përcillet ideja, mendimi, argumenti dhe ndjenjat e hatibit. Në këtë fazë hatibi është fytyrë për fytyrë dhe sy me sy përballë masës, kështu që patjetër duhet t'u përmbahet këtyre pikave:

1. Duhet të ketë përshtatshmëri mes fjalëve dhe kuptimit të tyre, apo fjalët duhet të korrespondojnë me kuptimin e tyre. Kështu që fjalën që e thotë duhet ta thotë për aq sa ka kuptim dhe synim, pa e shtuar apo pakësuar atë.

---

<sup>7</sup> Aid El Karnij. El Misku vel Inberu fi hutabil mimber, f. 248, botimi III, Mektebetul Ubejkan, Riad.

2. Duhet të zgjedhë fjalë dhe struktura të fjalive që janë të qarta, larg çdo ngarkese dhe ekzagjerimi. Nuk duhet të flasë diçka që nuk ka kuptim apo nuk e ka menduar, ngase fjala është mjet që të shpie të synimi dhe nuk duhet të shprehë diçka që e largon nga synimi.
3. Nuk duhet të e bëjë zakon që gjatë zhvillimit të fjalimit t'i përsëris fjalët dhe fjalitë, ngase një gjë e tillë e largon nga fjalori i ri dhe adekuat, i cili ka ndikim në joshjen e dëgjuesve. Bërja zakon e përsëritjes e humb efektin e synimit dhe kalon në efekt të mjetit apo pretekstit. Shpeshherë ndodh që bërja zakon e përsëritjes së fjalëve ta shpie hatibin në harresë të synimit të tematikës.

## Përfundimi

S'ka dyshim se përfundimi është prej tri elementeve thelbësore të hytbes. Se sa i rëndësishëm është përfundimi në hytbe tregon vet fakti se rumbullakimi i tematikës bëhet në fund të saj. E ajo ndodhë përmes një përfundimi që ngjall memorizim dhe kureshtje për hytben e ardhshme. Duhet ditur se përfundimi është pjesa e fundit e tematikës, e që më së shumti memorizohet te dëgjuesit. Në përfundim shpaloset një pjesë e konsiderueshme e personalitetit të hatibit. Edhe këtu duhet të kemi parasysh këto pika:

1. Hatibi duhet t'i përmbyllë mendimet të cilat i përmban tematika e hytbes, e këtë e bënë me fjalor të ri dhe mendime të thella. Çdo përsëritje e fjalëve të mëparshme e shpije dëgjuesin në monotoni dhe lodhje.
2. Patjetër duhet të ndikojë tek dëgjuesit që ndjenjave të tyre t'u japë kureshtje për punë dhe veprim të menjëhershëm, e kjo do të ndodhte nëse ndjenjat e tyre i futë në ngjallje dhe lëvizje.
3. Përfundimi duhet të jetë i shkurtër, në mënyrë që t'i përfitojë zemrat e dëgjuesve. Hatibi duhet t'i nxisë ata që të jenë në vazhdimësi të zbatimit të këshillave të tij.

4. Gjithashtu përfundimi duhet të bëhet me fjalë të fuqishme që përmbajnë një mesazh largpamës dhe praktik, e njëhësh edhe ta shpallë përfundimin e hytbes.

## Përmbajtja e hytbes

**E para:** Metodatat e llojllojshme ndërmjet hytbes përmbledhëse dhe zgjatjes së saj, varësisht nga gjendja e dëgjuesve dhe tematikës së hytbes.

Të zgjaturit e hytbes i përshtatet hytbeve gjyqësore dhe politike, ngase hytbet e tilla kanë nevojë që t'i shtrijnë argumentet, faktet, mendimet produktive dhe mendimet kontraproduktive të palës tjetër. Ndërsa, hytbeja përmbledhëse i përshtatet hytbes luftarake, ngase natyrshmëria e saj është domosdoshmëria dhe fuqia ndikuese si dhe bindja e thellë ndaj palës që i drejtohesh. Në këtë rast hatibi nuk duhet ta humbë synimin duke u zgjeruar në argumente të shumta dhe mendime të ndryshme. Por, përkundrazi, ai përdor një përmbledhje, e cila lë gjurmë në shpirtrat e dëgjuesve, gjithmonë duke pasur parasysh gjendjen dhe situatën e dëgjuesve. Nganjëherë vet pozicioni i dëgjuesit të detyron që hytbeja të jetë sa më përmbledhëse, si p.sh. kur hatibi e ndjen se në prani të masës ka udhëheqës të ndryshëm administrativë, apo njerëz që duhet të kthehen sa më shpejt në vende të punës, apo udhëtarë që udhëtojnë me aeroplan, anije apo tren. Kështu që hatibi duhet ta arrijë objektivin e tij me hytbe përmbledhëse në rrugën sa më të shkurtër që është e mundshme.

**E dyta:** Qartësia e hytbes

Me këtë nënkuptojmë që të kemi ide, fjalë dhe ndjenja të qarta. Kjo cilësi të jep siguri në lidhshmëri me hytben, ngase përmban elementin kryesor për dëgjuesin. Ndodhë që hatibi përdor elemente artistike hipotetike që ndërliken me analogji, krahasim, metaforë, alegori, por kjo duhet të jetë me masë dhe kujdes të madh, ngase një pjesë e konsiderueshme e dëgjuesve nuk kanë nevojë për këto elemente.

**E treta:** Tërheqja e vëmendjes dëgjuesve (xhematit)

Gjatë zhvillimit të hytbes, hatibi duhet të ndikojë që t'ia tërheqë vëmendjen të pranishmëve. Kjo njëherësh quhet edhe element tërheqës, i cili mund të arrihet në disa mënyra.

1. Me ripërtëritje dhe diçka të re, që ekspozimi i hytbes të bëhet me ilustrime dhe shembuj të ri, kështu vëmendja e dëgjuesve do të jetë më e përqendruar dhe e fortë, dhe njëherësh do të zgjojë gjallëri dhe kureshtje. Nëse fjalët përsëriten, ajo qon deri tek monotonia, zbehja në formën më të ulët dhe humbja e përqendrimit të dëgjuesve.
2. Llojlojshmëria e strukturave të fjalisë duke përdorur metoda nga më të ndryshmet, ndonjëherë duke përdorur mënyrën thirrrore, ndonjëherë duke përdorur fjali që në fund kërkojnë vendosjen e pikëpyetjes apo pikëçuditjes. Po ashtu duhet përdorur llojlojshmëri të përemrave: nganjëherë duhet të përdoret përemri i vetës së parë, herën tjetër i vetës së dytë, e nganjëherë i vetës së tretë; nganjëherë duke përdorur njëjësin e ndonjëherë shumësin.
3. Argumentimi i fjalëve me ajete kuranore dhe me argumente nga Suneti, ngase këta janë kandila ndriçues të mendimit tënd. Argumentimi mund të bëhet edhe me fjalë të dijetarëve, urtësi të larta, shembuj mahnitës dhe tregime interesante e tërheqëse.
4. Shkurtimi i shprehjeve në fjali të shkurta mundëson dhe lehtëson të kuptuarit dhe memorizimin e hytbes. Po ashtu në tërheqjen e vëmendjes dëgjuesve gjatë hytbes bënë pjesë edhe zgjedhja e fjalëve më ndikuese dhe më të përshtatshme për shpirtin. Ndikim të veçantë ka edhe zëri i pastër, i lartë dhe përdorimi i gjuhës letrare.<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> Muhamed Et Tavale, *Silvetul Hatir fi hutabil menabir*, f. 11. Dar El Kitab ve Sunneh, botimi III, 1433 h., Riad.



**E katërta:** Të referuarit

Kjo nënkupton kur hatibi në fjalorin e tij përmban fjalë të personaliteteve tjera, siç janë fjalët e poetëve, të të urtëve dhe të shkrimtarëve. Këtu hatibi ka mundësi të tërheqë një pjesë nga shtypi ditor, nga radioja, televizioni apo interneti. Po ashtu ai mund të përmbajë thënie apo ngjarje që ndërlidhen me aktualitetin, por pa ekzagjeruar gjërat e tilla, duke mos i trajtuar nga pozita e të menduarit, por nga pozita e argumentimit. Të gjitha këto duhet të jenë në përputhshmëri me realitetin në të cilin ndodhemi.

**Motivi i hytbes**

Nuk ka dyshim se motivi i hytbes është zgjerimi i thirrjes islame, ngase hytbeja është një mjet prej mjeteve të davetit, është gjuhë që flet për bukurinë e davetit. Ajo ua sqaron njerëzve atë që u mungon atyre nga e vërteta, i drejton në udhëzim, në të vërtetën dhe në mirëqenien. Hytbeja njerëzve ua bën të dashur të mirën dhe bën dialog me kundërshtarin me argumente.

**Llojet e hytbes****Kemi katër lloje të hytbes, ato janë:**

1. Hytbe fetare
2. Hytbe politike
3. Hytbe luftarake
4. Hytbe shoqërore.

**Hytbet fetare**

Ky lloj i hytbeve ka të bëjë me tematikën fetare, ku përfshihen udhëzimi i myslimanëve në rrugën e vërtetë; këshillimi dhe drejtimi në atë që është e dobishme për ta dhe jetën e tyre; vetëdijesimi i besimtarëve për çështjet e ndryshme fetare; urdhërimi në çështjet e mira dhe pengimi nga çë-

shtjet e këqija. Këto hytbe ishin shumica e hytbeve që vet Pejgamberin, a.s., i kishte mbajtur, gjithashtu edhe halifët e drejtë, gjatë këshillimit dhe udhëzimit të popullit, ishin fokusuar në këso hytbe. Të tilla hytbe mund të ilustrohen edhe me shembuj. Hytbe fetare mund të jenë: Hytbeja mbi vlerën e namazit të xhumasë, hytbeja e Bajramit të Fitrit dhe e Bajramit të Kurbanit, hytbeja mbi vlerën e namazit, agjërimit, haxhit, hytbeja e Arafatit që është e dedikuar në veçanti për haxhilerët, hytbeja për hixhretin e Pejgamberit, a.s., hytbeja për Isranë dhe Miraxhin, hytbeja për vlerën e muajit shaban dhe përkujtimi i ndërrimit të Kibles, hytbeja për çlirimin e Mekes, hytbeja për pritjen e muajit të ramazanit, për Natën e Kadrit, Hytbeja Lamtumirëse etj., etj.

## Një shembull i përgatitjes së hytbes fetare:

### Ngjarja e hixhretit

Tema e hytbes është: **“Thirrësi i dëbuar”**

Të nderuar besimtarë, ju brezi i lavdishëm i islamit, ju që mbi supet bartni amanetin e islamit, - sot jemi ndalur për t’i ngjallur zemrat tona, gjymtyrët tona në përkujtimin e thirrësit të parë ne islam, i cili njëherazi është edhe emigranti i parë i dëbuar nga dheu i tij. Ne sot jetojmë me fëmijët tanë, ndërsa përkujtojmë ditët kur ai, Resulullahi, a.s., u privua nga fëmijët e tij. Ne sot jetojmë në komoditetin më të lartë, në pallatet dhe shtëpitë tona, ndërsa sot përkujtojmë ditët kur më i madhi i njerëzimit u privua nga shtëpia dhe oborri i tij. Ne sot jetojmë të lumtur dhe optimist, ndërsa përkujtojmë ditët më të vështira të vuajtjes dhe pikëllimit të Muhamedit, a.s. Të gjithë këto vuajtje dhe sakrifica ndodhën vetëm për shkak të fjalës më të lartë, për të cilën është krijuar bota dhe njerëzimi, e ajo është fjala: *la ilahe illallah Muhamedun resulallah*.

Ky është hixhreti. Në këtë ditë, më i madhi i njerëzimit, *Thirrësi* i rrugës së vërtetë u dëbua. Atë e përzunë farefisi i tij, të afërmit, miqësia. Vallë cili ishte shkak i përzënies së tij? A thua pse ai bartte një rilindje të njerëzimit? Apo për shkak se kishte ardhur për të plaçkitur pasuri, për të derdhur gjak, për të uzurpuar toka? Jo! I pastër ishte ai nga këto vese!

Ai u dëbua për shkak se donte ta zgjonte njerëzimin nga injoranca, për t'i shpëtuar ata, për t'i nxjerr nga errësira në dritë.

Për t'u çuditur është vërtet! Ai, Muhamedi, a.s., kishte lindur në mesin e tyre, fëmijërinë e kaloi me ta, u rrit dhe u zhvillua krah për krah me ta, kishte pirë ujin e vendlindjes sikur ata, e kishte thithur të njëjtin ajër me ta, ishte ushqyer nga e njëjta tokë si ata, dhe në fund Mekeja iu drejtua: Dil prej këtu! Ku të shkojë? Por, më e keqja ishte se ata nuk e lejonin të dilte nga ai vend shëndosh e mirë, ata dëshironin ose ta burgosnin, ta prangosnin me pranga të hekurta, ose ta nxirrnin të vdekur dhe ta zhduknin nga dheu i tokës.

وَإِذْ يَمْكُرُ بِكَ الَّذِينَ الَّذِينَ كَفَرُوا لِيُثْبِتُوكَ أَوْ يَقْتُلُوكَ أَوْ يُخْرِجُوكَ وَيَمْكُرُونَ وَيَمْكُرُ  
اللَّهُ وَاللَّهُ خَيْرُ الْمَاكِرِينَ

*“(Kujto) edhe kur mosbesimtarët thurën komplot kundër teje (o Muhamed) për të të mbajtur ty në pranga, për të të vrarë, ose për të të përzënë nga shtëpia jote (Meka), ata po kurdisnin plan, por edhe Allahu po thurte plan, dhe (padyshim që) Allahu është më i miri i planifikuesve.”<sup>9</sup>*

Kur shtëpia e thirrësit të njerëzimit u rrethuar prej jobesimtarëve dhe shkatërruesve, ai në shtratin e tij e la Aliun. Këtë komplot e përgatitën, ngase ai (Pejgamberi a.s.) paraqiste një kërcënim serioz për interesat e tyre të ndërtuara në mizori dhe pabesi; ngase ai (Pejgamberi a.s.) po përballlej me pasionet e ulëta të tyre; ngase ai nuk po i nënshtrohej kërkesave dhe injorancës së tyre. Gjithmonë, si në të kaluarën e lashtë ashtu edhe sot, të këqijtë i shohin për armiq njerëzit që nuk përkrahin të keqen e tyre. Ai refuzoi që dielli t'i zbriste në të djathtë e tij dhe hëna në të majtë e tij, me qëllim që të largohej nga misioni me të cilin ishte ngarkuar. Ai kurrsesi në asnjë çast nuk u largua as për një hap të vetëm nga të proklamuarit e bazës së njerëzimit, që është e lidhur fortë me tokën, e ajo është: La ilahe ilallah.

<sup>9</sup> El Enfal, 30.

Ishte i rrethuar, e Xhibrili erdhi e i tregoi se armiqtë ishin mbledhur jashtë shtëpisë së tij, e dëshironin ta mbysnin. E ai Pejgamberi, a.s., tha: “Allahu është me ne, në dorën e Tij jemi, ai është që na jep dhe na e merr shpirtin, në dorën e Tij është trimëria dhe lavdia, e pastaj doli nga shtëpia pa pasur as shpatë në dorë, ndërsa armiqtë ishin me shpata. Doli pa pasur në dorë as hark e shigjeta, kurse armiqtë ishin të pajisur përplot shigjeta. I mjaftoi atij, alejhi selamit, një grusht dhe që ua gjuajti fytyrave të tyre, e Allahu i vuri në gjumë dhe fjetën. Nga duart e tyre rrëshqitën shpatat, ndërsa ai doli duke ecur para tyre, ndërsa dheu kishte mbetur mbi kokat dhe fytyrat e shkatërrimtarëve. Pejgamberi në ato momente thoshte:

وَجَعَلْنَا مِنْ بَيْنِ أَيْدِيهِمْ سَدًّا وَمِنْ خَلْفِهِمْ سَدًّا فَأَغْشَيْنَاهُمْ فَهُمْ لَا يُبْصِرُونَ  
*“Ne u kemi vënë edhe para tyre pendë edhe mbrapa tyre pendë-pengesë dhe ua kemi mbuluar sytë, kështu që ata nuk mund të shohin.”<sup>10</sup>*

Sot ne, nga kjo ngjarje që ka ndodhur para 14 shekujve, mund të marrim mësim:

- **Duhet të marrim** mësim se si duhet t’i mbështetemi vetëm Allahut التَّوَكُّلُ – et tevekulu, se si duhet që çështjet tona t’i lihen Atij, ngase nuk ka kush që na mjafton përveç Tij. Në këtë kontekst Allahu xh.sh. në Kuran tregon fjalët e një thirrësi besimtar, të cilin, familja e firaunit (ithtarët e tij) e kishte kërcënuar:

...وَأَفْوُضُ أَمْرِي إِلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ بَصِيرٌ بِالْعِبَادِ. فَوَقَاهُ اللَّهُ سَيِّئَاتٍ مَا مَكَرُوا...  
*“...dhe çështjen time unë ia lë Allahut. Vërtetë që Allahu është gjithëvëzhgues i robërve të Tij. Kështu Allahu e shpëtoi atë nga poshtërsitë që ata ia kurdisën (kundër tij).”<sup>11</sup>*

Muhamedi, a.s., me këtë dëshironte të themelonte dhe ndërtonte një brez të ri, të fuqishëm, të pajisur me trimëri, ku secili prej tyre të ishte në gjendje që për fjalën la ilahe illallah të sakrifikohej. Nuk ka dyshim

<sup>10</sup> Jasin, 9.

<sup>11</sup> Gafir: 44-45

se tregimi i hixhretit është përplot mbështetje të fuqishme tek Allahu xh.sh., dhe secila mbështetje shfaqet në mënyrën dhe formën më të bukur. Ai u fut në shpellë, e biseda rreth shpellës shpesh po përsëritet. Po, sepse historia pikërisht fillon nga shpella. Nga aty dolën rrezet e dritës. Këtu u strehua Muhamedi a.s., i cili ishte i paarmatosur, pa ushtarë, pa përkrahës, e në ato momente Ebu bekri po i thoshte: “O i Dërguar i Allahut, për Allahun sikur ndonjëri prej tyre të përulej e të shikonte, do të na shihte neve.” E Pejgamberi a.s. buzëqeshi, e të buzëqeshurit në momente kritike (në rrezik jete) nuk mund ta bëjnë përveç se të mëdhenjtë. Ai qeshte dhe thoshte:

ما ظنك يا أبا بكر باثنين الله ثالثهما

“Çfarë mendon ti o Ebu Bekër, në mesin e dy vetave, i treti është Allahu?”<sup>12</sup>

Mos vallë mposhten ata tre, apo radhën e kanë të mposhten armiqtë e Allahut? Kur Allahu është i treti, kush do të mposhtet? Kush është humbësi në fund të kësaj beteje? Pejgamberi a.s. i thoshte Ebu Bekrit, duke e përkrahur atë :

لا تُحْزِنُ إِنَّ اللَّهَ مَعَنَا - “Mos u pikëllo, se vërtetë Allahu është me ne.”<sup>13</sup>

Pra, Ai – Allahu është me ne në ruajtje, në mbrojtje, në përkrahje, nga se Ai nuk i mposhtë miqtë e Tij. Ai është me ne sikurse ishte me Ibrahimin a.s., kur atë e hodhën në zjarr erdhi Xhibrili e i tha: “A ke ndonjë nevojë nga unë?” Ai tha: “Prej teje jo, ndërsa prej Allahut po”, dhe fjalët e fundit i tha: **حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ** - “Allahu na mjafton neve dhe për ne ai është mbështetësi më i mirë.”<sup>14</sup> Nga këto fjalë të mëdha zjarri u bë i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin a.s.

<sup>12</sup> Sahihul Buhari, v.III, f. 1337, nr. 3453.

<sup>13</sup> Et Tevbe, 40.

<sup>14</sup> Ali Imran, 173.

- **Hixhreti na mëson** për sakrificë dhe luftë të vazhdueshme për mbrojtjen e fjalës la ilahe ilallah, e cila është më e shtrenjtë se jeta, pasuria dhe familja. Pejgamberin, a.s., në një rast tha:

وَالَّذِي نَفْسُ مُحَمَّدٍ بِيَدِهِ لَوَدِدْتُ أَبِي أَعَزُّو فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَأُقْتَلُ ثُمَّ أَعَزُّو فَأُقْتَلُ ثُمَّ أَعَزُّو فَأُقْتَلُ

“Pasha atë në dorën e të cilit është shpirti i Muhamedit, do të dëshiroja të luftoj në rrugën e Allahut e të mbytem, prapë të luftoj e të mbytem, pastaj prapë të luftoj e të mbytem.”<sup>15</sup>

Pejgamberi a.s. doli nga Meka i përzënë, para syve të tij Meka (banorët e saj) i mbylli dyert, e ai në qiellin e errët të mesnatës po i flet Mekës, me një monolog përplot fjalë të buta:

وَاللَّهِ إِنَّكَ خَيْرُ أَرْضِ اللَّهِ وَأَحَبُّ أَرْضِ اللَّهِ إِلَى اللَّهِ وَلَوْلَا أَنِّي أُحْرِجْتُ مِنْكَ مَا حَرَجْتُ

“Pasha Allahun, ti (oj Meke) vërtet je toka më e mira dhe je prej tokave të Allahut më të dashura te Allahut, dhe sikur (banorët e tu) të mos më përzinin nga ti, nuk do të largohesha”<sup>16</sup>, e lotët vazhdonin t’i rridhnin nëpër fytyrë.

Të nderuar besimtarë të pranishëm, çfarë kemi dhënë ne për këtë fe? Sa e kemi ngrit atë? A thua po përfitojmë ne nga feja, apo feja po përfiton nga ne?

Pra, ky ishte *emigranti i parë*. Ky ishte thirrësi i dëbuar për hir të së vetmes fjalë, të vetmit kriter, të vetmit shpëtim të njerëzimit, të fjalës “La ilahe ilallah”.

أَقُولُ مَا تَسْمَعُونَ وَاسْتَعْفِرُ اللَّهَ لِي وَ لَكُمْ وَ لِكُلِّ الْمُؤْمِنِينَ  
فَاسْتَغْفِرُوهُ وَ تُوبُوا إِلَيْهِ إِنَّهُ هُوَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ.

“E them këtë që po e dëgjoni duke kërkuar falje tek Allahu xh.sh. për ju, për mua dhe për të gjithë besimtarët. Andaj kërkonte falje dhe

<sup>15</sup> Sahihul Buhari, vëll. I, f. 14, nr. 2787; Sahihu Muslim, vëll. III, f. 1496, nr. 1876.

<sup>16</sup> “Sunen Et Tirmidhij”, vëll. 12, f. 434, nr. 3860.

*pendohuni te Ai, se vërtet Ai është Pranues i pendimit dhe Mëshirues i madh.”*

## Përfundimi

Çdo hatib duhet të jetë i pajisur me njohuri të mjaftueshme fetare dhe sociale dhe njëherazi duhet të jetë në gjendje të bëjë një hyrje të mrekullueshme të hytbes, sqarim dhe përmbledhje të saj. E në veçanti luan rol qartësimi i hytbes e cila përmban elementin kryesor për audiencën. Me qartësi të hytbes nënkuptojmë që të kemi ide, fjalor dhe metodologji për ngjalljen e ndjenjave. Gjithashtu hatibi duhet të ketë referenca stabile, fjalë të urta dhe argumente, qofshin nga Kurani apo Suneti i Pejgamberit, a.s. Ajo çka është shumë e rëndësishme hatibi duhet të flasë për gjëra që përputhen me realitetin e kohës.

# Modeli i qeverisjes së mirë sipas sures El Bekare

Prof. Ass. Dr. Lulzim Esati

## Abstrakt

Në pjesën e dytë të sures “El Bekare” mësojmë për modelin e suksesshëm i cili kaloi edhe testin e qeverisjes së mirë e me përpikëri. Ky model është modeli i Ibrahimit, a.s., që i përmbushi obligimet e veta në formën më të mirë, për këtë edhe meritoi që të bëhet prijës/udhëheqës për njerëzimin. Umeti islam, kryesisht gjenerata e parë, ishte model për qeverisje shembullore, për arsye se ata iu përgjigjen thirrjes së Allahut xh.sh., me këtë: “*Dëgjuam dhe respektojmë*”. Islami ofroi rregullimin total të shoqërisë përmes legjislacionit penal, dispozitave të adhurimit, dispozitave të trashëgimisë dhe sistemit ekonomik e financiar që synim ka zhvillimin e jo rritjen e kamatës e të interesit. Sureja “El Bekare” na mëson që për të arritur sukses në qeverisje, duhet t’iu përmbahemi një sërë obligimeve e ndalimeve. Këto urdhra e ndalime lidhen ngushtë me këto tri gjëra: 1) bindja ndaj Allahut; 2) dallimi nga të tjerët, 3) devotshmëria.

**Fjalët kyçe:** qeverisja, ndryshimi, bindja, rregullim, paqe.



## Abstract

In the second part of Surah "El Bekare" we learn about the successful model which also passed the test of good governance with precision. This model is the model of Ibrahim, peace be upon him, who fulfilled his obligations in the best way, for this he deserved to become a leader/leader for humanity. The Islamic Ummah, mainly the first generation, was a model for exemplary governance, for the reason that they responded to the call of Allah, the Exalted, with this: "We listened and respected". Islam offered the total regulation of society through criminal legislation, provisions of worship, provisions of inheritance and the economic and financial system aimed at the development and not the increase of interest. Surah "Al Bekare" teaches us that in order to achieve success in governance, we must adhere to a series of obligations and prohibitions. These orders and prohibitions are closely related to these three things: 1) obedience to Allah; 2) difference from others, 3) piety.

**Key words:** governance, change, obedience, regulation, peace

### Modeli i Ibrahimit, a.s.

Modeli i Ibrahimit, a.s., është modeli i vetëm që korri sukses në këtë testin e qeverisjes së mirë, nga tri modelet, e ofruara në suren El Bekare.

Allahu i madhërishëm, na mëson në këtë sure, që gjatë sprovave që iu nënshtruan të tri modelet (modeli i Ademit, a.s., modeli i Beni Israhilëve dhe modeli i Ibrahimit, a.s.), vetëm njëri prej tyre e kaloi testin, ai ishte modeli i Ibrahimit, a.s.

وَإِذِ ابْتَلَىٰ إِبْرَاهِيمَ رَبُّهُ بِكَلِمَاتٍ فَأَتَمَّهُنَّ قَالَ إِنِّي جَاعِلُكَ لِلنَّاسِ إِمَامًا

*“Përkujto (O i dërguar) kur Zoti i vet, Ibrahimin e provoi me disa obligime, e ai i përmbushi ato, e Ai tha: “Unë po të bëj ty prijës (imam) të njerëzimit!”<sup>1</sup>*

<sup>1</sup> El Bekare, 124.

Ajo çka vërehet në këtë ajet, është që Ibrahim, a.s., jo vetëm që e ka kaluar provimin, por ai i përmbushi obligimet e përcaktuara, në formën më të mirë. Ibrahim, a.s.. kur i përmbushi obligimet që iu kërkuan (hedhja në zjarr, migrimet dhe lënia e fëmijës në mes të shkretëtirës, si dhe bindja për ta therur djalin), Allahu i madhërishëm e njoftoj se do ta bën prijës të njerëzimit (për t'i qeverisur). Kjo erdhi si rezultat i përmbushjes së obligimeve në mënyrën më të mirë. Ibrahim kur e dëgjojë njoftimin, tha: **Ai tha:** *“(bën o Zot) Edhe nga pasardhësit e mi!”* (Zoti) **Tha:** *“Mirësinë Time nuk mund ta gëzojnë mizorët!”*<sup>2</sup>

Fjala e Lartë madhërishmit: “mirësinë time nuk mund ta gëzojnë mizorët!”, është një mësim i rëndësishëm për ne, që të kuptojmë se Allahu xh.sh., nuk e favorizon askënd qoftë ai edhe nga umeti i Muhamedit, a.s. Qeverisja është e kushtëzuar me bindje ndaj Tij, jo me lidhjen e gjakut! Në këtë çështje komentuesi Ebu Lejth Es Semerkandi sqaron se mirësitë e Allahut xh.sh., nuk i gëzojnë jobesimtarët.

Po ashtu, vlen të theksojmë që kush dëshiron të qeverisë në emër të Allahut xh.sh., synon të bëhet përgjegjës në tokë kërkohet nga ai që të nxjerr leksione nga gabimet e të tjerëve, të ketë kujdes prej materializmit dhe polemikave që nuk justifikohen, sikur që nuk lejohet të bëjë lojëra me ligjin e Allahut, por duhet t'i bindët Allahut të plotfuqishëm ashtu siç kërkon. Sureja El Bekare, ku përcakton urdhrat dhe ndalimet që duhet t'i përmbahet umeti, nëse do të qeverisë, ato urdhra e ndalime lidhen ngushtë me këto tri gjëra:

1. Me iu bindë Allahut xh.sh.
2. Të dallohet shoqëria.
3. Devotshmëria.<sup>3</sup>

Kush mendon të qeverisë në tokë, patjetër që duhet të ketë një program që do ta ndjek gjatë udhëheqjes.

**Ndryshimi i kibles:** ndryshimi i kibles ishte test i bindjes si dhe urdhër për tu dalluar nga të tjerët.

<sup>2</sup> El Bekare: 124.

<sup>3</sup> [www.quran-radio.com](http://www.quran-radio.com).

Nëse e përcjellim më vëmendje këtë ngjarje, kur Allahu xh.sh. i urdhëroj myslimanët që ta ndryshojnë kiblen prej mesxhidi Aksasë dhe të kthehen nga Qabeja, duke ia shtuar po ashtu edhe dyshimin që shfaqën hebrenjtë në Medine për këtë çështje, siç njofton Kurani:

... سَيَقُولُ السُّفَهَاءُ مِنَ النَّاسِ مَا وَلَاهُمْ عَن قِبَلَتِهِمُ الَّتِي كَانُوا عَلَيْهَا

*“Disa mendjelehtë nga njerëzit do të thonë: “Çka i ktheu ata (myslimanët) prej kibles (drejtimit) në të cilin ishin ata (Kudsi)?”<sup>4</sup>*

Shtrohet pyetja: çka ndërlihet kjo ngjarje me tri tregimet e mëparshme ( të Ademit, a.s., tregimi i Beni Israilëve dhe ai i Ibrahimit, a.s.)?

Arsyeja qëndron këtu: ajo që i bashkon këto tri tregime është testimi për bindje. Ademi, a.s., u testua me ngrënien e pemës, Bëni Israilët u testua me therjen e lopës, kurse Ibrahimit, a.s., u testua me disa teste për bindje ndaj Allahut xh.sh., e ai i plotësoi ato: **“Përkujto (o i Dërguar) kur Zoti i vet, Ibrahimin e provoi me disa obligime, e ai i përmbushni ato”** (El Bekare: 124)

Pasi na njoftoj me gjendjen e popujve të mëhershëm, dhe deshi që të na e strukturojë një kurrikulë për këtë umet, e që bazamenti i parë i saj ishte – urdhri për bindje. Pas rrëfimit të ngjarjeve të tyre qëndron urtësia, e ajo urtësi është; krijimi i konceptit “bindje-taaton”, tek umeti që do të jetë përgjegjës për tokën. Kështu që ngjarja e ndryshimit të kibles ishte test praktik<sup>5</sup> për ta kuptuar këtë që cekëm:

وَمَا جَعَلْنَا الْقِبْلَةَ الَّتِي كُنْتَ عَلَيْهَا إِلَّا لِنَعْلَمَ مَن يَتَّبِعُ الرَّسُولَ مِمَّنْ يَنْقَلِبُ  
عَلَىٰ عَقْبَيْهِ

*“E kiblen nga e cila ti u drejtove nuk e bëmë për tjetër, vetëm se për të provuar atë që shkon pas të dërguarit, nga ai që kthehet prapa”<sup>6</sup>*

Disa mund të mendojnë që kjo çështje ishte e lehtë, por në realitet nuk është kështu. Arabët e shenjtëronin Qabenë, qysh nga koha e Ibrahi-

<sup>4</sup> El Bekare: 142.

<sup>5</sup> En-Nesefi, Medariku Tenzil ve Hakaiku Tavit, vëll: 1, f: 545.

<sup>6</sup> El Bekare: 143.

mit, a.s., kështu që marrja e Aksasë për kible, më pas urdhri për t'u kthyer nga Qabeja për herë të dytë, ishte për të demonstruar bindjen<sup>7</sup> ndaj Allahut xh.sh. pra, në fund e pamë se si lidhet kjo pjesë<sup>8</sup> e sures Bekare me pjesët tjera të saj ku flitet për tri rrëfimet e sipër përmendura.

### **Ndryshimi i terminologjisë:**

Umeti-shoqëria duhet të dallohet edhe për nga terminologjia të cilën e përdor. Objektivi tjetër i sures Bekare, pos testimit të bindjes ndaj Allahut xh.sh., është dallimi i umetit në terminologjinë që e përdor nga popujt e tjerë.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَقُولُوا رَاعِنَا وَقُولُوا انظُرْنَا

*“O ju që keni besuar, mos thoni: Raina - po thuajini: Undhurna.”*

Ky ajet, na mëson që umeti mysliman duhet të dallohet nga popujt e tjerë, në mënyrë që të jetë i pavarur nga ata, siç ndodhi me ndryshimin e kibles, për ta shkëputur ndjekjen dhe pasimin e hebrenjve. Mesazhi i këtyre ndryshimeve përmbledhet në këtë: si ka mundësi të jetë përgjegjës për tokën një umet që nuk dallohet nga të tjerët, sidomos nga ata që kanë dështuar në bartjen e kësaj përgjegjësie?<sup>10</sup>

Megjithatë, dallimi nga të tjerët, duhet ta ndjekë një mesatare. Nuk do të thotë që çdo gjë që bëjnë popujt jomysliman është gabim, as nuk do të thotë që çdo gjë që bëjnë jomyslimanët duhet refuzuar.

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا

*“Gjithashtu (sikur u udhëzuam në fenë Islame) Ne u bëmë juve një popull të drejtë, (një mes të zgjedhur).”<sup>11</sup>*

<sup>7</sup> Esad Humid, Ejseru Tefasir, botimi i VI, 2009, vëll: 1, f: 345.

<sup>8</sup> Ngjarja e ndryshimit të kibles.

<sup>9</sup> El Bekare: 104.

<sup>10</sup> <https://mawdoo3.com>

<sup>11</sup> El Bekare: 143.

## Islami dhe rregullimi total

Kaptina Bekare po ashtu përfshinë një seri të urdhrave të përgjithshme të cilat ftojnë në riparimin dhe rregullimin e çdo segmenti të shoqërisë. I Lartmadhërisë thotë:

لَيْسَ الْبِرُّ أَنْ تُولُّوا وُجُوهَكُمْ قِبَلَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ وَلَكِنَّ الْبِرَّ مَنْ آمَنَ  
بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَالْمَلَائِكَةِ وَالْكِتَابِ وَالنَّبِيِّينَ وَآتَى الْمَالَ عَلَىٰ حُبِّهِ ذَوِي  
الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسَاكِينَ وَابْنَ السَّبِيلِ وَالسَّائِلِينَ وَفِي الرِّقَابِ وَأَقَامَ  
الصَّلَاةَ وَآتَى الزَّكَاةَ وَالْمُوفُونَ بِعَهْدِهِمْ إِذَا عَاهَدُوا وَالصَّابِرِينَ فِي الْبَأْسَاءِ  
وَالصَّرَاءِ وَحِينَ الْبَأْسِ

*“Nuk është tërë e mira (e kufizuar) të ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, lajmëtarëve dhe pasurisë që e do, ua jep të afërmeve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirim të robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës.”<sup>12</sup>*

Komentuesi i mirënjohur et Teberi në sqarimin e këtij ajeti kuranor potencon se e mira e shprehur në ajetin kuranor nuk nënkupton vetëm namazin, por e mira “*El birr*” janë tiparet që do tua bëjë të qarta këtu.<sup>13</sup> Në këtë ajet shihet qartë gjashtë parimet të cilat e bëjnë të qartë të vërtetën e së mirës së kërkuar.<sup>14</sup>

Allahu i plotfuqishëm, pasi e nguliti në karakterin e sahabëve bindjen ndaj Tij, dhe dallimin nga të tjerët, ua bëri të qarta që këtu nuk është në fokus çështja e drejtimit nga kibla por, më e rëndësishme se kjo është rregullimi masiv.

Kur erdh urdhri për t’u drejtuar kah Qabeja, kishte për synim testimin dhe përfundimin e bindjes ndaj Allahut, xh.sh., dhe dallimin nga të

<sup>12</sup> El Bekare: 177.

<sup>13</sup> Et-Taberi, Muhamed Ibën Xherir, Xhamiul Bejan, ....vëll. 2, f. 123. El-Ksimij, Mehasinu Tevil,... vëll: 1, f. 231.

<sup>14</sup> El-Gazali, Muhammed, Komentimi tematik i Kuranit famëlartë, f. 26.

tjerët mirëpo, objektivi kryesorë është vepra e mirë me të gjitha format që kanë ardhur në ajetin 177.

## Legjislacioni penal

I Lartë madhërishti thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الْقِصَاصُ فِي الْقَتْلَى

*“O ju që besuat, u është bërë obligim gjurmimi për dënim për mbytje.”<sup>15</sup>* Pas kësaj thotë:

وَلَكُمْ فِي الْقِصَاصِ حَيَاةٌ يَا أُولِي الْأَلْبَابِ

*“O ju të zotët e mendjes, kjo masë e dënimit është jetë për ju.”<sup>16</sup>*

## E drejta e trashëgimisë

I Lartë madhërishti thotë:

كُتِبَ عَلَيْكُمْ إِذَا حَضَرَ أَحَدَكُمُ الْمَوْتُ إِنْ تَرَكَ خَيْرًا الْوَصِيَّةَ لِلْوَالِدَيْنِ  
وَالْأَقْرَبِينَ

*“Kur ndonjërit prej jush i është afruar vdekja, nëse lë pasuri pas vete, testamenti (vasijeti) për prindërit dhe për të afërmit u është bërë juve obligim.”<sup>17</sup>*

## Dispozitat e adhurimit

I Lartëmadhërishti thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ  
لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

*“O ju që besuat, agjërimi (saum) u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”<sup>18</sup>*

<sup>15</sup> El Bekare: 178.

<sup>16</sup> El Bekare: 179.

<sup>17</sup> El Bekare: 180.

Ajo që vërehet këtu është: se të gjitha dispozitat e ardhura në këto ajete, i kushtojnë theks të veçantë devotshmërisë. ajeti i dispozitës së gjakmarrjes përfundon me *“që të bëheni të devotshëm.”*

Dhe ajeti i trashëgimisë mbyllet me këtë porosi *“Për ata që janë të devotshëm”;*

Po ashtu dhe ajeti i dispozitës së agjërimit përmbillet me *“që të bëheni të devotshëm”;*

Dhe pas paraqitjes së këtyre dispozitave në përmbyllje thotë:

كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ آيَاتِهِ لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ

*“Ja kështu, në këtë mënyrë Allahu ua sqaron njerëzve argumentet e veta që ata të ruhen.”<sup>19</sup>*

Mundë të themi që platforma e qeverisjes së suksesshme e ofruar në këtë sure, kërkon njerëz që i binden Allahut xh.sh., që dallohen nga të tjerët, dhe që synojnë me këtë kënaqësinë e Lartëmadhërishmit.

## Mburoja e fortifikuar e Islamit

Pjesa dytë e kaptinës Bekare njashtu flet mbi legjislacionin e dhe dispozitat e xhihadit. I Lartëmadhërishmi thotë:

وَقَاتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ الَّذِينَ يُقَاتِلُونَكُمْ وَلَا تَعْتَدُوا ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ\* وَأَقْتُلُوهُمْ حَيْثُ تَقْتُلُوهُمْ وَأَخْرِجُوهُمْ مِّنْ حَيْثُ أَخْرَجَكُمُ

*“Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni se Allahu nuk i do ata që e teprojnë (e fillojnë luftën). Dhe luftoni ata kudo që t'i zini, dëboni prej vendit ata sikurse ju përzhunë ata juve”.<sup>20</sup>*

Kjo na mëson që patjetër se do të ketë luftime për mbrojtjen e këtij program, dhe se patjetër që duhet të shpenzojmë pasuri për luftë.

<sup>18</sup> El Bekare: 183.

<sup>19</sup> El Bekare: 187.

<sup>20</sup> El Bekare: 190-191.

***“Dhe jepni për një rrugë të Allahut e mos hidhni veten në rrezik.”<sup>21</sup>***

Ky program qeverisës detyron luftimin për t’u mbrojtur nga armiqtë që na sulmojnë, e jo për të terrorizuar e as për të derdhur gjakun. Në Kuran vërehet një normë të përgjithshme: sa herë që përmendet lufta në Kuran, përmendet me rregullat dhe normat e saj. Për shembull: këtu përcakton luftimin e agresorëve e atyre që na luftojnë:

وَقَاتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ الَّذِينَ يُقَاتِلُونَكُمْ

***“Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju sulmojnë”.***

*(El Bekare, 190).*

Siç na bën të qartë dhe etikën e luftës në betejë, se nuk lejohet të teprojmë ***“e mos e teproni”***.

## Thirrja për hyrje në paqe

Pas paraqitjes së ajeteve të dispozitave, arrijmë tek ajeti që konsiderohet boshti i kësaj sure. Në këtë ajet Allahu xh.sh., fton që të gjithë të hymë në paqe e shpëtim:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا ادْخُلُوا فِي السِّلْمِ كَافَّةً

***“O ju që besuat, hyni në islamizmin e tërësishëm (përqafojeni fenë islame në tërësi),”<sup>22</sup>***

Kuptimi i fjalës “silm” këtu është; Islami.<sup>23</sup> Ky është mendimi i interpretuesve të Kuranit. Domethënë, o ju që besuat, hyni në islamizim/pranonte Islamit si tërësi e cili e prezanton këtë program me të gjitha sferat e jetës (ligjin penal, dispozitat e adhurimit, të trashëgimisë, të luftës, investimit). Prandaj ky ajet bën thirrje që ta pranojmë Islamit me kom-

<sup>21</sup> El Bekare: 195.

<sup>22</sup> El Bekare: 208.

<sup>23</sup> El-Begavij, Mealimu Tenzil, vëll: 1, f. 333. Tabatabai, elmijzan fi Tefsiril Kuran, ....vëll. 2, f. 214. Alusi, Ruhul Meani, ...vëll. 2, f. 431. El-Kurtubij, el-Xhamiu Liahkamil Kuran, ...vëll. 2, f. 555.



plet dispozitat që i ka, duke na e tërheqë vërejtjen që mos ta marrim një pjesë të tij, e ta lëmë një pjesë tjetër:

أَفْتُوْمُنُونَ بِبَعْضِ الْكِتَابِ وَتَكْفُرُونَ بِبَعْضٍ

*“A e besoni një pjesë të librit, e tjetrën e mohoni?”<sup>24</sup>*

## Sistemi ekonomik e financiar

Së fundmi, kjo sure e bekuar “Suretul Bekare”, na e nxjerr në pah sistemin ekonomik-financiar që Allahu i plotfuqishëm e ka aprovuar në Islam. Ky sistem titullohet: Islami është program i zhvillimit ekonomik dhe nuk është program i kamatës/interesit.

يَمْحَقُ اللَّهُ الرِّبَا وَيُرِي الصَّدَقَاتِ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ كُلَّ كَفَّارٍ أَثِيمٍ

*“Allahu zhduk kumatën dhe shton lëmoshën, Allahu nuk e do asnjë besëprerë dhe mëkatar”.<sup>25</sup>*

Pas kësaj, pasojnë ajtet që paralajmërojnë ata që nuk heqin dorë nga kamata dhe sistemet e saja financiare!

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَذَرُوا مَا بَقِيَ مِنَ الرِّبَا إِن كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ  
فَإِن لَّمْ تَفْعَلُوا فَأْذَنُوا بِحَرْبٍ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ وَإِن تُبْتُمْ فَلَكُمْ رُءُوسُ أَمْوَالِكُمْ  
لَا تَظْلِمُونَ وَلَا تُظْلَمُونَ

*“O ju që besuat, keni frikë Allahun dhe nëse jeni besimtarë të sinqertë hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata. E në qoftë se nuk e bëni këtë (nuk heqni dorë nga kamata), atëherë binduni se jeni në konflikt me Allahun dhe të dërguarin e Tij. E nëse jeni penduar, atëherë juve ju takon kryet e mallit tuaj - askënd nuk dëmtoni, e as vetë nuk dëmtoheni”.<sup>26</sup>*

Pastaj vjen ajeti i borxhit, që është ajeti më i gjatë në Kuran. Në këtë ajet, tregon mënyrën e huazimit dhe evidentimit që duhet ti bëhet bor-

<sup>24</sup> El Bekare: 85.

<sup>25</sup> El Bekare: 276.

<sup>26</sup> El Bekare: 278-279.

xhit me anë të shkrimit ose me anë të dëshmitarëve. Kjo vjen si dëshmi shtesë për konfirmimin e transaksioneve gjatë biznesit, etj.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا تَدَايْتُمْ بَدِينِ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى فَاكْتُبُوهُ

*“O besimtarë, kur merrni hua prej njëri-tjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë.”<sup>27</sup>*

Dëgjuam dhe iu bindëm.

Sureja El bekare, mbyllet me këtë çështje “Dëgjuam dhe iu bindëm”, më të cilën i lavdëron Allahu xh.sh. besimtarët mysliman:

وَقَالُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا ۖ غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ

*“dhe thanë: “Dëgjuam dhe respektoam. Kërkojmë faljen tënde o Zoti ynë, te Ti është ardhmëria (jonë).”<sup>28</sup>*

Beni Israilët thanë: “ne dëgjuam por kundërshtojmë”<sup>29</sup> kurse umeti islam thotë: “Dëgjuam dhe iu bindëm”. Të mbetemi pra përgjegjës për tokën. Pastaj vjen duaja:

لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا ۚ لَهَا مَا كَسَبَتْ وَعَلَيْهَا مَا اكْتَسَبَتْ ۗ رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِنْ نَسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا ۗ رَبَّنَا وَلَا تَحْمِلْ عَلَيْنَا إِكْرَامًا كَمَا حَمَلْتَهُ عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِنَا ۗ رَبَّنَا وَلَا تُحَمِّلْنَا مَا لَا طَاقَةَ لَنَا بِهِ ۗ وَاعْفُ عَنَّا وَاعْفِرْ لَنَا وَارْحَمْنَا ۗ أَنْتَ مَوْلَانَا فَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ

*“Allahu nuk ngarkon askënd përtej mundësive të veta, atij (njeriut) i takon ajo që e fitoi dhe atij i bie ajo (e keqe) që e meritoi. “Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë! Zoti ynë, mos na ngarko neve barrë të rëndë siç i ngarkove ata para nesh! Dhe Zoti ynë, mos na ngarko me atë për të cilën nuk kemi fuqi! Dhe na i mbulo të këqijat, na fal dhe na mëshiro. Ti je Mbrojtësi ynë, pra na ndihmo kundër popullit jobesimtar!”<sup>30</sup>*

<sup>27</sup> El Bekare: 282.

<sup>28</sup> El Bekare: 285.

<sup>29</sup> El Bekare: 93.

<sup>30</sup> El Bekare: 286.

Njeriu gjatë zbatimit të këtij programi në jetën e tij, mund të ndodhë që të bëj gabime, por edhe mund të dobësohet, për këtë myslimani ka nevojë për ndihmën e Allahut fuqiptotë, që të lutet për falje dhe mëshirë. Gjatë ballafaqimit me armiq në fushëbetejë, por edhe sfida të tjera që mund të tejkalojnë fuqinë e tij. Për këtë e lutë Allahun që t'i ndihmojë. E padyshim që Allahu i gjithëmëshirshëm u është përgjigjur (po e pranoj lutjen tënde).<sup>31</sup>

## Përfundim

Në përmbyllje të këtij punimi theksojmë: kjo sure e bekuar “El Bekare”, gjatë frekuentimit të mësimave të saja na bënë të ditur që nga tri modellet e qeverisjes të cilat i ofroi Allahu xh.sh., në këtë sure, modeli i Ibrahimit, a.s. ishte modeli që duhet marrë për shembull. Ibrahim, a.s. i përmbushi detyrime që iu kërkuan nga i Lartëmadhërishti në formë të përkryer. E si shpërblim për këtë sukses, Allahu xh.sh., Ibrahimin a.s. e bërë prijës (imam) për mbarë njerëzimin. Së këndejmi, themi që umeti islam është umeti më i mirë që ka parë bota, për atë se stema/logoja e tyre ishte “*Dëgjuam dhe respektojmë*”. Umet i përgëzuar me librin më të mirë që përmban legjislacion e dispozita që garantojnë barazi e drejtësi, si dhe mirëqenie e siguri. Por garancinë e qeverisjes për këtë umeti është përmbushja e premtimeve dhe kryerja e obligimeve. Nuk mjafton vetëm përkatësia Islame për të merituar udhëheqjen e njerëzve ashtu siç nuk ishte e mjaftuar për brezat e parë të tij.

---

<sup>31</sup> Siç ka ardhur në hadithin e Ebu Hurejres, sahih Muslim, kitabul Iman, babë: I Lartëmadhërishti nuk ngarkon më atë që s’kemi fuqi: “Allahu tha: po”. Nr: 125.

# Vlera e të mësuarit përgjatë tërë jetës sipas koncepteve islame

(Perspektiva e Fakultetit të Studimeve Islame ndaj këtij koncepti)

Mr. Vedat Shabani

## Abstrakt

Të mësuarit përgjatë gjithë jetës është prej parimeve të fesë Islame. Nëse e vështrojmë Kuranin Famëlartë këtë parim do ta hasim në shumë ajete të tij, siç janë: **“O Zoti im shtoma diturinë”** (Taha, 114); pastaj ajeti **“A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm njerëzit e mençur i pranojnë këshillat”** (Ez Zumer, 9). Përveç kësaj, edhe shumë thënie peygamberike theksojnë rëndësinë dhe vlerën e të mësuarit. Prej tyre mund ta veçojmë hadithin e Pejgamberit, a.s., në të cilin thotë: **“Ai i cili del nga shtëpia me qëllim të kërkimit të diturisë, në realitet llogaritet si një person i cili ka dalë për hir të Allahut dhe i tillë do të cilësohet derisa të kthehet.”** Shembujt më të mirë ne i kemi gjeneratat e hershme të dijetarëve dhe ato pas tyre. Në vazhdimësi, hasim të ati-llë që kanë bërë shumë sakrifica vetëm e vetëm që të arrijnë për të përvetësuar ndonjë njohuri, për të mësuar dije. Nëse e shfletojmë historinë Islame vërejmë se përkushtimi i myslimanëve ndaj dijes nuk ka qenë vetëm në fushën fetare, por edhe në dijet dhe shkencat tjera. Fakulteti i Studimeve Islame është insti-

tucion i pavarur edukativo-arsimor dhe hulumtues-shkencor, i cili organizon studime universitare dhe pasuniversitare për studentët e interesuar për të përfituar nga fusha e teologjisë Islame. Strategjia e Fakultetit të Studimeve Islame, përmes organizimit të studimeve universitare po edhe pasuniversitare, është që diturinë dhe njohuritë bashkëkohore t'i distribuojë përmes aktivitetit të mësimdhënies, të studimeve dhe hulumtimeve, si dhe të arsimojë kuadro të niveleve të ndryshme. Me këtë punim kemi për synim të sqarojmë vlerën dhe rëndësinë e të mësuarit përgjatë tërë jetës si dhe praktikat të cilat i ofron FSI në fushën e studimeve teologjike në Kosovë dhe më gjerë.

**Fjalët kyçe:** Vlera e diturisë, mësimi përgjatë tërë jetës, dituri, FSI, mësimdhënie

## Abstract

Lifelong learning is one of the principles of Islam. If we look at the Noble Qur'an, we will find this principle in many of its verses, such as: "O my Lord, I have increased knowledge" (Taha: 114); then the verse "Are those who know and those who do not know equal?! Only wise people accept advice" (Ez Zumer: 9). In addition, many prophetic sayings emphasize the importance and value of learning. Among them, we can single out the hadith of the Prophet, peace be upon him, in which he says: "He who leaves the house for the purpose of seeking knowledge, in reality is counted as a person who has gone out for the sake of Allah and will be considered as such until he returns." The best examples we have are the early generations of scholars and those after them. In continuation, we come across those who have made many sacrifices just to be able to acquire some knowledge, to learn knowledge. If we look at Islamic history, we notice that the commitment of Muslims to knowledge was not only in the

religious field, but also in other sciences and knowledge. The Faculty of Islamic Studies is an independent educational and research-scientific institution, which organizes university studies and postgraduate for students interested in benefiting from the field of Islamic theology. The strategy of the Faculty of Islamic Studies, through the organization of university and post-graduate studies, is to distribute knowledge and contemporary knowledge through teaching, studies and research activities, as well as to educate cadres of different levels. With this paper, we aim to clarify the value and importance of lifelong learning as well as the practices that FSI offers in the field of theological studies in Kosovo and beyond.

**Keywords:** Value of knowledge, lifelong learning, knowledge, FSI, teaching.

## Rëndësia dhe vlera e dijes në aspektin fetar

Fetja Islame i ka dhënë rëndësi të madhe dijes dhe shkencës. Këtë e vërteton edhe Kurani Famëlartë në të cilin dija-shkenca përmendet me qindra herë. Si e tillë ajo përfshin të gjitha format e njohjes, me anë të së cilave arrihet deri te dija dhe më pas, të kuptuarit e gjërave. Përmes dijes largohet injoranca dhe padituria zhduket, ngrihet individi dhe forcohet e avancohet shoqëria.<sup>1</sup> Për pozitën e dijes mjafton që ajeti i parë i zbritur për njerëzimin i cili ndërlidhet direkt me dijen, e i cili nxit njeriun për lexim, njohje dhe studim, në mënyrë që t'i kuptojë gjërat e të mos mbetet peng i injorancës. Allahu, xh.sh., thotë në Kuran:

"اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ، خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ، اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ"

*“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi! E krijoi njeriun prej gjakut të ngjizur. Lexo për Zotin tënd Bujar!”<sup>2</sup>*

<sup>1</sup> Jusuf El Kardavij, El Aklü Vel Ilmu fil-Kuran, bot. I, Mektebetu-l-Vehbeh, Kajro, 1416, f. 149.

<sup>2</sup> El Alek: 1,2,3.

Nëse hedhim një vështrim mbi ajetet e para të zbritura në Kuran vërejmë se ato nuk ishin prej atyre të cilat iu drejtuan njeriut që ai t'i kushtojë rëndësi ushqimit apo pijes, e as ndërtimit të banimit, apo ndonjë aktiviteti tjetër nga jeta e përditshme, por pikërisht dijes si një vlerë e jashtëzakonshme, përmes së cilës njeriu kalon nga një stad në një tjetër më të lartë. Kjo padyshim që është një shenjë e qartë se kjo fe e lartëson tej mase vlerën e dijes dhe thërret ithtarët e saj t'ia japin rëndësinë e duhur asaj nëpërmes leximit, shkrimit dhe studimit.<sup>3</sup> Nuk është e rastësishme përse shpallja hyjnore rrugëtimin e saj e filloni me fjalët e dijes dhe njohjes, ngase njohja është para hyrje në qytetërim dhe civilizim, bazament i ngritjes dhe qëllim i lartë edukativ.<sup>4</sup>

Për vlerën dhe rëndësinë e diturisë në fenë Islame flasin shumë ajete kuranore, prej tyre mund të përmendim ajetet në vazhdim:

شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُو الْعِلْمِ قَائِمًا بِالْقِسْطِ

**“Allahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtësisë”.**<sup>5</sup> Në këtë ajet kuranor vërejmë se Allahu, xh.sh., fillimisht ka nisur me përshkrimin e qenies së Tij të Lartmadhërishme, më pas ka vazhduar me dëshminë e engjëjve dhe në radhë të tretë ka përmendur dijetarët, njerëzit e dijes. Kjo mjafton për të treguar se çfarë respekti dhe vlere kanë njerëzit e dijes te Allahu, xh.sh.

Në një ajet tjetër Allahu, xh.sh., thotë:

يَرْفَعُ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ وَالَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ دَرَجَاتٍ

**“Allahu lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri”**,<sup>6</sup> në ajetin tjetër thotë:

<sup>3</sup> Abdulkarim Bekkar, El Muslimune bejne-t-tehaddi vEl muvaxhehe havle-t-erbiye vEl talim. Bot., Darul Kalem, Damask 2011, f. 131.

<sup>4</sup> Mina Ali Es Salus, El Hukuk Et-talimije lil-mereti fil islam min vaki-i-l Kurani ve-sunneh. Darun-n-eshr, Kajro-2020, f. 131.

<sup>5</sup> Ali Imran: 18.

<sup>6</sup> El Muxhadeleh: 11.

...قُلْ هَلْ يَسْتَوِي الَّذِينَ يَعْلَمُونَ وَالَّذِينَ لَا يَعْلَمُونَ...

“...*Thuaj a janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë...*”,<sup>7</sup>

pastaj thotë:

...وَلَوْ رَدُّوهُ إِلَى الرَّسُولِ وَإِلَى أُولِي الْأَمْرِ مِنْهُمْ لَعَلِمَهُ الَّذِينَ يَسْتَنْبِطُونَهُ مِنْهُمْ...

“...*e sikur t’ia linin atë (përhapjen e lajmit) Pejgamberit dhe përgjegjëse të tyre, ata do të dinin të nxjerrin përfundime (se si do të duhej shpallur)...*”<sup>8</sup>. Përmes këtij ajeti Allahu, xh.sh., dispozitat e ngjarjeve i ka mbështetur në arritjet e dijetarëve dhe gradën e tyre e ka barazuar me gradën e Pejgamberëve në çështjen e nxjerrjes së dispozitave.

Në vende të caktuara të shpalljes hyjnore, kur flitet për vlerën e dijes, e lartëson atë tej mase, duke i trajtuar dijetarët si të vetmit që në realitet ia kanë frikën Zotit, xh.sh., gjegjësisht si njohësit më të mirë të Tij. Zoti, xh.sh., në Kuran thotë:

إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ الْعُلَمَاءُ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ غَفُورٌ

“... *po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët, Allahu është mbi gjithçka është mëkat falës*”.<sup>9</sup>

Feja Islame nuk ia ka kushtuar asnjë çështjeje tjetër më tepër rëndësi se sa ilmit (dijes) dhe alimit (dijetarit). Dija në Islam konsiderohet rruga e vetme e ngritjes, përparimit dhe vetëdijesimit të umetit. Ilmi (dija) është cilësi e veçantë e cila nuk ka fjalë kontradiktore. Ajo është cilësia më e vlefshme sepse rreth saj sillet çdo gjë. Ajo është vet vlera, ndaj nuk ka vlerë përmbi vlerë. Ilmi (dija) është prej cilësive të Allahut, xh.sh. Për vlerën e ilmit dhe ulemasë tregon edhe ky ajet i Kuranit ku Allahu, xh.sh., thotë:

<sup>7</sup> Ez Zumer: 9.

<sup>8</sup> En-Nisa: 83.

<sup>9</sup> Fatir: 28.



وَتِلْكَ الْأَمْثَالُ نَضْرِبُهَا لِلنَّاسِ وَمَا يَعْقِلُهَا إِلَّا الْعَالِمُونَ

*“Dhe këto shembuj Ne i paraqesim për njerëzimin, por askush nuk do t’i kuptojë përveç ulemasë, të diturve”.*<sup>10</sup>

Ky ajet, ulemanë (dijetarët), i veçon nga kategoritë e tjera të njerëzimit për nga aftësitë dhe kapacitetet e të kuptuarit, madje në këtë drejtim ata janë të veçuar tek Allahu, xh.sh., dhe te njerëzit në këtë botë.<sup>11</sup>

Edhe Pejgamberi, a.s., përmes fjalëve të tij i ka dhënë rëndësi të madhe dhe dije dhe shkencës. Ai në disa thënie të tij shprehet:

مَنْ يُرِدِ اللَّهُ بِهِ خَيْرًا يُفَقِّهْهُ فِي الدِّينِ

*“Atij që Allahu, xh.sh., ia do të mirën e bënë njohës të çështjeve fetare”,*<sup>12</sup> pastaj hadithi tjetër:

وَإِنَّ الْعُلَمَاءَ وَرِثَةُ الْأَنْبِيَاءِ

*“Dijetarët janë trashëgimtarë të Pejgamberëve”,*<sup>13</sup> së këndejmi, është e ditur se nuk ka gradë më të lartë dhe më me vlerë se sa grada e pejgamberisë, prandaj edhe të qenit trashëgimtar i asaj grade s’do mend se është një nder, respekt dhe privilegj i madh.

Në një hadith tjetër Pejgamberi, a.s., ka thënë:

إِذَا أَتَى عَلَيَّ يَوْمٌ لَا أَرْدَادُ فِيهِ عِلْمًا يُقَرِّبُنِي إِلَى اللَّهِ عَزَّوَجَلَّ فَلَا بُورْكَ لِي فِي طُلُوعِ شَمْسِ ذَلِكَ الْيَوْمِ

*“Nëse një ditë më kalon dhe unë nuk mësoj diçka të re, e cila më bën që të jem më afër Zotit, atëherë mos qoftë me bereqet ajo ditë për mua”.*<sup>14</sup> Ky hadith apo kjo thënie e Pejgamberit, a.s., është argument i fuqishëm se njeriu sa të jetë gjallë e të ketë mundësi ai duhet të angazhohet, të mësojë e të studioj në mënyrë që të pajiset me njohuri të reja. Këtë çështje Pejgamberi ynë, a.s., e ka theksu-

<sup>10</sup> El Ankebut: 43.

<sup>11</sup> Musa Vila, “Nën hijen e haditheve të Resulullahut”, FSI, Prishtinë, 2017, f. 17.

<sup>12</sup> Transmeton Imam Buhariu, nr. hadithit: 71.

<sup>13</sup> Transmeton Imam Ebu Davudi, nr. hadithit: 3641.

<sup>14</sup> Transmeton Imam Taberaniu në El Evsat dhe Ebu Nuajmi në El Hilje.

ar edhe në shumë raste të tjera duke i nxitur shokët e tij që në vazhdimësi të arsimohen dhe të angazhohen për të mësuar diçka të re.

Pejgamberi, a.s., i ka dhënë rëndësi më të madhe dijetarit dhe angazhimit të tij se sa çdo angazhimi tjetër, ai në një hadith ka thënë:

فَضْلُ الْعَالِمِ عَلَى الْعَابِدِ كَفَضْلِي عَلَى أَدْنَى رَجُلٍ مِنْ أَصْحَابِي

“Vlera (diferenca) e dijetarit ndaj adhuresit (të rëndomtë), është sikurse diferenca ime me sahabiun më të ri nga mesi juaj”,<sup>15</sup> përmes këtij hadithi Pejgamberi, a.s., e ka krahasuar pozitën e dijes me atë të pejgamberisë.

Ndërsa në një hadith tjetër ka thënë:

فَضْلُ الْعَالِمِ عَلَى الْعَابِدِ كَفَضْلِ الْقَمَرِ لَيْلَةَ الْبَدْرِ عَلَى سَائِرِ الْكَوَاكِبِ

“Vlera (diferenca) e dijetarit ndaj adhuresit (të rëndomtë), është sikurse diferenca e Hënës së plotë ndaj planetëve tjerë”.<sup>16</sup>

Prej porosive të Llukman hakimit ndaj birit të tij ishte edhe kjo:

يَا بُنَيَّ جَالِسِ الْعُلَمَاءَ وَزَارِهِمْ وَرَاحِمُهُمْ بِرُكْبَتِكَ فَإِنَّ اللَّهَ سُبْحَانَهُ يُجِيبِي الْقُلُوبَ بِنُورِ الْحِكْمَةِ كَمَا يُجِيبِي الْأَرْضَ بِوَابِلِ السَّمَاءِ

“O biri im! Ulu me dijetarët dhe rri afër tyre sepse Allahu, xh.sh., i ngjall zemrat përmes dijes ashtu siç e ngjallë tokën përmes shiut nga qielli”.<sup>17</sup>

## Vlera e të mësuarit (mësim nxënies)

Feja Islame, siç u vu në dukje edhe më sipër, i ka dhënë rëndësi shumë të madhe dijes, mësimdhënies dhe mësim nxënies. Shumë ajete kuranore dhe hadithe të Pejgamberit, a.s., flasin për rëndësinë e të mësuarit dhe vlerën e mësuesit dhe nxënësit/studentit. Allahu, xh.sh., në njërin prej ajeteve kuranore thotë:

<sup>15</sup> Transmeton Imam Tirmidhiu, nr. hadithit: 2686

<sup>16</sup> Transmeton Ebu Davudi, nr. hadithit: 3641-3642

<sup>17</sup> Muhamed bin Abdulbaki Ez Zerkavij, “Sherh Ez Zerkavij ala Muvata Imam Malik”, Kapitulli mbi kërkimin e diturisë, f. 683.

وَمَا كَانَ الْمُؤْمِنُونَ لِيَنْفِرُوا كَافَّةً فَلَوْلَا نَفَرَ مِنْ كُلِّ فِرْقَةٍ مِّنْهُمْ طَائِفَةٌ لِّيَتَفَقَّهُوا  
فِي الدِّينِ وَلِيُنذِرُوا قَوْمَهُمْ إِذَا رَجَعُوا إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ

*“E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t’u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vetë kur të kthehen te ata, në mënyrë që ata të kuptojnë”<sup>18</sup>.*

Gjithashtu:

فَاسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

*“Ju pyetni pra dijetarët nëse ju nuk dini”<sup>19</sup>, e ajete të tjera të shumta kuranore.*

Nëse flasim për kohën ditore të të Dërguarit, a.s., atëherë shumicën e saj e gjejmë se i Dërguari a.s, qëndronte me shokët e tij, i mësonte ata, i këshillonte dhe i edukonte në forma të ndryshme. Vetë thëniet e tij janë indikacione të qarta se si ai kishte synim avancimin në dije dhe luftimin e injorancës. Pejgamberi, a.s., një popull të tërë të paditur e ktheu në një popull që përhapte dije të mirëfilltë. Thuajse në çdo çast këshillonte të tjerët që t’i rreken dijes dhe të mos mbesin të paditur.

Prej haditheve të Pejgamberit, a.s., të cilat inkurajojnë dhe flasin për vlerën e mësim-nxënies janë edhe këto:

مَنْ سَلَكَ طَرِيقًا يَلْتَمِسُ فِيهِ عِلْمًا سَهَّلَ اللَّهُ لَهُ طَرِيقًا إِلَى الْجَنَّةِ

*“Ai person i cili ndjek rrugën e dijes Allahu, xh.sh., do t’ia lehtësojë rrugën për në Xhenet”<sup>20</sup>*

لَأَنْ تَعْدُوا فَتَتَعَلَّمَ بَابًا مِنَ الْعِلْمِ خَيْرٌ مِنْ أَنْ تُصَلِّيَ مِئَةَ رُكْعَةٍ

*“Të udhëtosh me qëllim të mësimin të një fushe të dijes është më e vlefshme se sa falja e njëqind reqateve namaz”<sup>21</sup>*

<sup>18</sup> Et Tevbe: 122

<sup>19</sup> En Nahl: 43

<sup>20</sup> Transmeton Tirmidhiu, Libri, Dyert e diturisë nga i Dërguari i Allahut nr; hadithit: 2646

<sup>21</sup> Transmeton Ibën Maxhe, Kapitulli mbi vlerën e të mësuarit të Kuranit, nr; hadithit: 219

طَلَبُ الْعِلْمِ فَرِيضَةٌ عَلَى كُلِّ مُسْلِمٍ

“Kërkimi i diturisë është obligim primar për çdo mysliman”<sup>22</sup>.

إِنَّ طَالِبَ الْعِلْمِ يَسْتَعْفِرُ لَهُ مَنْ فِي السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ، حَتَّى الْحَيَاتَانِ فِي الْمَاءِ

“Vërtetë për kërkuesin e diturisë (alimin) luten çka ka në qiej (prej krijesave) dhe çka ka në tokë, edhe peshqit (balenat) në thellësi të oqeanit”<sup>23</sup>.

I mahnitur me fjalët e Pejgamberit, a.s., dhe duke parë rëndësinë e dijes dhe vlerën e saj sipas koncepteve islame, njëri nga shokët e Pejgamberit, a.s., i quajtur Ebu Derda<sup>24</sup>, ka thënë: (Mësimi i një çështjeje të dijes, është më e rëndësishme për mua se sa të fali namaz tërë natën).

Abdullah bin Mesudi<sup>25</sup> ka thënë: (Përkushtojuni diturisë dhe kini kujdes përderisa nuk është ngritur, ngase ngritja e diturisë bëhet me vdekjen e dijetarëve, asnjëri nuk ka lindur i ditur, por dituria përfitohet përmes mësimi).<sup>26</sup>

Edhe gjeneratat në vazhdimësi pas Pejgamberit, a.s., i kanë dhënë rëndësi të madhe çështjes së dijes dhe të mësuarit. Prej tyre, por jo vetëm, kemi edhe thënien e Imam Shafiu ku thotë: (Kërkimi i diturisë është më i rëndësishëm se sa namazet vullnetare). Ndërsa një dijetar, Fet’h El Mevsiliu, ka thënë: (Nëse të sëmurit i ndalet ushqimi, pija dhe barërat a do të vdes ai? Të pranishmit i thanë: gjithsesi, ai tha: ashtu është edhe zemra, nëse i ndalohet urtësia dhe dituria për tre ditë ajo vdes)<sup>27</sup>.

<sup>22</sup> Transmeton Ibën Maxhe, Kapitulli mbi vlerën e dijetarëve dhe mësimnxënien, nr; hadithit: 224

<sup>23</sup> Transmeton Ebu Davudi në Sunenin e tij, nr; 3641

<sup>24</sup> Uvejmir bin Malik El Ensarij, në kohën e Omer bin Hatabit ka qenë Qykatës në Damask. Ka vdekur në vitin 32 sipas hixhretit.

<sup>25</sup> Abdullah ibën Mesud El Hudhelij, Ebu Abdurrahman, ka qenë shërbëtor i Pejgamberit a.s., dhe shoqëruesi më i afërt e tij, si gjatë qëndrimit në Medine ashtu edhe gjatë udhëtimeve dhe ekspeditave të tij. Omer ibën Hatabi, r.a., ka thënë për te: (Ai është një kovë e mbushur me dituri). ka lindur në Meke ndërsa ka vdekur në Medine në vitin 32 sipas hixhretit.

<sup>26</sup> Abdurrahman Rafet El Basha, “Fragmente nga jeta e Sahabëve”, përktheu: Qemajl Morina dhe të tjerë, Prishtinë, 2004, f. 97

<sup>27</sup> Muhamed Xhemaluddin El Kasimij, “Mevidhatu-l-Muminin min Ihja-i-Ulumiddin”, Darun-Nefais Bejrut, 1994, f. 44

## Vlera e mësimdhënies

Mësuesi më i madh që njohu njerëzimi është i Dërguari i fundit, Muhamedi, a.s., i cili nuk e kishte lutur Zotin që t'i shtonte diç tjetër ashtu siç e kishte lutur që t'ia shtojë dijen, këtë fakt e përmendi edhe Allahu, xh.sh., në Kuran:

وَقُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا

**“dhe thuaj: “Zoti im më shto dituri!”**<sup>28</sup> Nuk ka si të mos kërkonte një gjë të tillë i Dërguari i Allahut, kur atij i janë zbritur ajete të tëra rreth penës e dijes, madje vet Allahu, xh.sh., ishte betuar në lapsin që nënkupton vlerën e dijes:

ن وَالْقَلَمِ وَمَا يَسْطُرُونَ

**“Nun, betohem në pendën dhe në atë çka shkruajnë”**<sup>29</sup>

Edhe çështjes së mësimdhënies mësimet Islame i kanë dhënë një rëndësi dhe vlerë të veçantë. Ajetet kuranore që flasin për vlerën e mësimdhënies janë të shumta, prej tyre janë edhe këto:

...وَلْيُنذِرُوا قَوْمَهُمْ إِذَا رَجَعُوا إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ

**“...dhe kur të kthehen tek ata të këshillojë popullin e vetë që t'i druajnë Perëndisë”**<sup>30</sup>, domethënia e këtij ajeti është që t'i mësojnë e t'i udhëzojnë në rrugën e drejtë. Ajeti tjetër kuranor thotë:

وَإِذْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ لَتُبَيِّنُنَّهُ لِلنَّاسِ وَلَا تَكْتُمُونَهُ فَنَبَذُوهُ  
وَرَاءَ ظُهُورِهِمْ وَاشْتَرَوْا بِهِ ثَمَنًا قَلِيلًا فَبَيَّسَ مَا يَشْتَرُونَ

**“Kujtoje (o Muhammed) kohën kur Allahu mori premtimin nga ata, që u është dhënë libri se do t'ua shpjegojnë atë njerëzve dhe me siguri nuk do të fshehin asgjë nga ai, por ata e lanë pas dore atë për pak send të kësaj jete; pra, bënë punë të keqe”**<sup>31</sup>, ky ajet e

<sup>28</sup> Taha: 114

<sup>29</sup> El Kalem: 1

<sup>30</sup> Et Tevbe: 122

<sup>31</sup> Ali Imran: 187

bënë të obligueshëm mësimin e të tjerëve. Ajeti tjetër kuranor thotë:

وَأِنَّ فَرِيْقًا مِّنْهُمْ لَيَكْتُمُونَ الْحَقَّ وَهُمْ يَعْلَمُونَ...

“...por disa prej tyre e fshehin të vërtetën, duke e ditur mirë”<sup>32</sup>, përmes këtij ajeti Allahu, xh.sh., e bëjnë të ndaluar-haram fshehjen e diturisë. Ajeti tjetër kuranor thotë:

ادْعُ إِلَى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحُكْمَةِ وَالْمَوْعِظَةِ الْحَسَنَةِ وَجَادِهِمْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ...

“Thirri në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur. Dhe diskuto me ta si është më bukur!...”<sup>33</sup>.

Ndërsa hadithet e Pejgamberit, a.s., të cilat flasin për vlerën e mësimdhënies janë të shumta gjithashtu, prej tyre: kur Pejgamberi, a.s., e dërgoi Muadhin në Jemen ai e porositi duke i thënë:

لَأَنْ يَهْدِيَ اللَّهُ بِكَ رَجُلًا وَاحِدًا خَيْرٌ لَّكَ مِنَ الدُّنْيَا وَمَا فِيهَا

“Të bëhesh ti shkaktar në udhëzimin e një personi është më mirë për ty se sa e gjithë kjo botë”.<sup>34</sup>

Në një thënie tjetër Pejgamberi, a.s. ka thënë:

مَنْ عَلِمَ عِلْمًا فَكَتَمَهُ أَجْمَهُ اللَّهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ بِلِجَامٍ مِنَ النَّارِ

“Ai person i cili e mëson një shkencë dhe e fsheh atë, Zoti ditën e Kiametit do ta prangosë me pranga prej zjarrit”.<sup>35</sup>

Fjalimi tjetër i Pejgamberi, a.s., thotë:

إِنَّ اللَّهَ سُبْحَانَهُ وَمَلَائِكَتُهُ وَأَهْلَ سَمَوَاتِهِ وَأَرْضِهِ حَتَّى التَّمَلُّةُ فِي جُحْرِهَا وَحَتَّى

الْحَوْثُ فِي الْبَحْرِ لِيُصَلُّوا عَلَى مُعَلِّمِ النَّاسِ الْخَيْرِ

“Me të vërtetë Allahu, xh.sh., engjëjt e Tij, banorët e qiejve dhe tokës, madje edhe milingonat në vrimat e tyre si dhe peshku, luten mirë për mësuesin e njerëzve”.<sup>36</sup>

<sup>32</sup> El Bekare: 146

<sup>33</sup> En Nahël 125

<sup>34</sup> Transmeton Imam Buhariu nr. hadithit: 3009.

<sup>35</sup> Transmeton Imam Tirmidhiu nr. hadithit: 2651.

<sup>36</sup> Transmeton Imam Tirmidhiu nr. hadithit: 2686.

Në një hadith tjetër Pejgamberi, a.s., ka thënë:

إِذَا مَاتَ ابْنُ آدَمَ انْقَطَعَ عَمَلُهُ إِلَّا مِنْ ثَلَاثٍ - صَدَقَةٍ جَارِيَةٍ أَوْ عِلْمٍ يُنْتَفَعُ بِهِ  
أَوْ وَكَلٍ صَالِحٍ يَدْعُو لَهُ

*“Kur të vdes i biri i Ademit pushojnë vlerësimi i veprave të tij, përveç tri veprave: lëmoshës rrjedhëse, dijes nga e cila njerëzit kanë dobi prej saj, dhe fëmijës së mirë që lutet për të”.*<sup>37</sup>

Është pyetur Abdullah bin Mubareku<sup>38</sup> se cilët janë njerëzit më të mirë? Ai ishte përgjigjur duke thënë: Ulemaja. E prej udhëheqësve kush janë? Asketët (ata që nuk jepen shumë pas dynjasë) u përgjigj. E prej njerëzve të rëndomtë? Ata që dynjanë e japin për fe – u përgjigj ai.

Imam Gazaliu<sup>39</sup> duke komentuar thënien e Abdullah ibën Mubarekut ka thënë: (Prej njerëzve zgjodhi dijetarët ngase njerëzit mbeten njerëz dhe janë të veçuar prej krijesave të tjera vetëm me dituri e jo për nga forma, sepse deveja është më e fortë se njeriu, e as për nga madhësia, sepse elefanti është më i madh se njeriu, e as për nga trimëria, sepse ka

<sup>37</sup> Transmeton Imam Tirmidhiu nr. hadithit: 1376.

<sup>38</sup> Abdullah ibn Mubareku, u lind në vitin 118 h, ishte një musliman i hershëm, i devotshëm i njohur për kujtesën e tij dhe zellin për dije, mbledhjen e hadithit dhe njihet për asketizmin e tij. Ai fitoi titullin Emir El Mu'minin fi al-Hadith. Babai i tij, i quajtur Mubarek, ishte turkmen nga Horasani, dhe nëna e tij thuhej të ishte nga Harezmi. Abdullah ibn Mubarek u largua nga qyteti i tij i lindjes Merv, dhe ndërsa jetonte në Hamadan, vazhdoi të vizitonte dhe të fliste shpesh në Bagdad. Mësimdhënësit e tij ishin Sufjan El Theuri dhe Ebu Hanife.[4] Ai shkroi Kitab El Xhihadin, një koleksion të haditheve dhe thënieve të muslimanëve të hershëm në luftë, dhe Kitab El Zuhd ve El Rakaik, një libër mbi asketizmin. Ai ishte gjithashtu i njohur për mbrojtjen e kufijve islamikë në kufijtë e Tarsusit dhe El Masisah, dhe më vonë vdiq në Hit, pranë Eufratit, në vitin 181 sipas hixhretit

<sup>39</sup> Muhamed bin Muahmed bin Muhamed bin Ahmed Ebu Hamid et Tusij, Esh Shafi'ij, Huxh-xhetu El Islam, El Gazali, u lind në vitin 450 h. I thuhet Et-Tusij, sepse ka lindur në një qytezë të vogël të quajtur Tus në krahinën e Huarasanit të Iranit të sotëm, e që sot ajo qytezë njihet me emrin Meshhed. Ndërsa i thuhet El Gazalij, marr nga fjala gazel, e që është përpunim i leshit të deleve, kjo për faktin se babai i tij e ka pasur këtë art, e atij që e bënë këtë art i thuhet gazalij, domethënë përpunues i leshit. Thuhet se Gazale, është emër fshati në afërsi të qytetzës Tus ku ka lindur El Gazaliu. Imam Gazali vdiq në vitin 505 h.

egërsira që janë më trime se njeriu, e as për nga ngrënia, sepse ka kafshë që e mbushin barkun e tyre shumë më tepër se njeriu. Pra, njeriu vetëm për Ilm – dije është veçuar dhe krijuar në këtë formë më të bukur).<sup>40</sup>

### Të mësuarit në vazhdimësi lartëson njeriun dhe ndikon në zhvillim

Sa njerëz të padijshëm e injorantë, fal rrugës së dijes dhe diturisë që morën, u shndërruan në yje që shndritën mbarë globin. Ata ishin krejtësisht të panjohur gjersa nuk kishin dije, e kur u pajisen me dije, ata i njohu e tërë bota.

Kush do ta njihje Abdullah bin Mesudi, r.a., kur ruante bagëtinë e që në takimin e parë me të Dërguarin e Allahut, xh.sh., përderisa ai po ruante bagëtinë, i Dërguari i Allahut i tha: “*Ti je një fëmijë i mençur*”. Ai e shoqëroi të Dërguarin e Allahut, xh.sh., siç e shoqëron hija bartësin e saj, ku nuk u nda prej tij as në vend e as jashtë vendit. Ai në çdo moment mësonte prej tij dhe gjithnjë shfrytëzonte ndejat me të. E zgjonte të Dërguarin, a.s., kur ai flinte, kur nisej ia mbathte të mbathurat e kur vinte ia hiqte ato. Ai u edukua në shtëpinë e Pejgamberit, a.s., u udhëzua sipas udhëzimeve të tij, ndoqi dhe pasoi të gjitha veprimet dhe virtytet e të Dërguarit, a.s., ai u edukua në shkollën e Pejgamberit, a.s., prandaj ishte njëri nga njohësit më të mirë të Kuranit, më i dituri për kuptimin e tij dhe më i njohuri për ligjin e Zotit, xh.sh. Ishte recitues i njohur i Kuranit, saqë i Dërguari, a.s., dëgjoi Kuran prej tij. I Dërguari i Allahut për të ishte shprehur:

مَنْ سَرَّهُ أَنْ يَقْرَأَ الْقُرْآنَ رَطْبًا كَمَا أَنْزَلَ، فَلْيَقْرَأْهُ عَلَى قِرَاءَةِ ابْنِ أُمِّ عَبْدِ

“*Ai që dëshiron të lexojë Kuran ashtu siç është zbritur le të lexojë sikur që është leximi i Abdullah ibën Mesudit*”<sup>41</sup>. Për diturinë e tij rreth Kuranit ai ka thënë:

<sup>40</sup> Musa Vila, “Nën hijen e haditheve të Resulullahut”, f. 19.

<sup>41</sup> Transmeton Imam Ahmedi në Musned, nr. hadithit: 1۷۰.



وَالَّذِي لَا إِلَهَ غَيْرُهُ، مَا نَزَلَتْ آيَةٌ مِنْ كِتَابِ اللَّهِ إِلَّا وَأَنَا أَعْلَمُ فِيمَا نَزَلَتْ، وَأَيْنَ نَزَلَتْ، وَلَوْ أَعْلَمُ مَكَانَ أَحَدٍ هُوَ أَعْلَمُ بِكِتَابِ اللَّهِ مِنِّي، تَنَالَهُ الْمَطَايَا لِأَتَيْتُهُ  
*“Pasha Allahun përveç të cilit nuk ka Zot tjetër, nuk ka zbritur ndonjë ajet nga libri i Allahut e që unë mos ta di se ku ka zbritur dhe për çfarë ka zbritur, e sikur ta dija se ndokush është më i ditur se unë rreth librit të Zotit, po të jetë e mundur të arrija te ai, do të shkoja”*.<sup>42</sup>

Po dijetarët tjerë të kalibrit të lartë, siç janë Imam Ebu Hanife (vdiq: 150 h), Imam Maliku (vdiq: 179 h), Imam Shafiu (vdiq: 204 h) dhe Imam Ahmedi (vdiq: 241), e shumë e shumë të tjerë, kush do t'i njihte ata sikur të mos merreshin me dije dhe të shkëlqenin në fushën e dijes? Fal kontributit të tyre në shumë fusha të shkencës ata sot e gjithë ditën përmenden ne mesin e myslimanëve, sa që mund të themi se nuk ka ditë që nuk u përmendet emri i tyre. Prandaj, a ka vlerë më të madhe se sa përmendja për të mirë? E tërë kjo fal dijes dhe kontributit të tyre në shumë fusha të shkencave Islame.

Edhe në aspektin kolektiv, pas vdekjes së Pejgamberit, a.s, myslimanët përhapën me të madhe mësimet e Kuranit dhe traditën e tij që përbëhej kryesisht nga fjalët dhe veprat e tij. Në sundimin e dinastisë së hershme, Abasidëve, myslimanët i dhanë rëndësi të madhe dijes. Ata krijuan një qytetërim që solli ndryshime të mëdha në historinë njerëzore. Ata u nisën nga motoja: “Ngjyra e dijetarit është e barabartë me gjakun e dëshmorit” dhe krijuan një ambient të dijes e kulturës, të panjohur gjër atëherë. Hapën biblioteka të shumta, përkthyen dituritë e popujve të tjerë dhe përhapën mësimet islame në të gjitha anët e botës. Gjatë kësaj periudhe, bota myslimane u bë qendra intelektuale e pakrahasueshme për shkencën në përgjithësi, ndërsa për filozofinë, mjekësinë dhe teologjinë në veçanti. Aty u krijuan akademi të cilat u nda në dy seksione, njëra ishte e lidhur me punën e përkthimit dhe tjetra në lidhje me mbledhjen e

<sup>42</sup> Abdurrahman Rafet El Basha, “Fragmente nga jeta e sahabëve”, përktheu: Qemajl Morina dhe të tjerë, Prishtinë, 2004, f. 90-106.

librave dhe strehimin e një biblioteke të madhe. Kjo frymë Islame që lartëson dhe kultivon dijen u bart gjeneratë pas gjenerate, e derisa myslimanët i jepnin rëndësi dijes dhe njohurive, ata ishin prijatarë dhe udhëhiqnin një pjesë të madhe të botës. E, në momentin kur ata lanë dijen dhe u përçanë, atëherë të tjerët i sunduan ata dhe aty filloi e keqja që as sot e kësaj dite nuk është ndalur. Popujt që i kushtuan rëndësi arsimimit dhe dijes, kurrë nuk pësuan, përkundrazi u ngritën dhe u lartësuan. Shembull kemi sot shtetet evropiane dhe ShBA-në, të cilat shtete i japin një rëndësi të veçantë arsimit dhe dijes, këto shtete ndodhen në majat më të larta dhe universitetet e tyre janë bërë ëndërr thaujse për secilin.<sup>43</sup>

## Të mësuarit gjatë tërë jetës

Domethënia e të mësuarit gjatë tërë jetës është mjaft e gjerë dhe në vetë përfshinë mësimin formal, jo formal dhe jo të sistemuar gjatë jetës së njeriut me qëllim të realizimit të zhvillimit më të përsosur të mund-shëm në jetën shoqërore, profesionale dhe intelektuale. Ky botëkuptim përfshinë të mësuarit me të gjitha llojet e tij; përfshinë mësimin në shkollë, në vendin e punës, përmes të gjitha mjeteve teknologjike me qëllim të përforcimit të njohurive dhe aftësive.

Qëllimi i të mësuarit gjatë tërë jetës është dhënia mundësi çdo personi për të mësuar në kohë të ndryshme për qëllime, nivele dhe angazhime të ndryshme. Gjithashtu qëllimi i të mësuarit gjatë tërë jetës është ofrimi i mundësisë ndaj individit që të mësojë gjatë tërë jetës. Me këtë rast, institucionet të cilat merren me çështje të rinisë të cilët marrin mësim jo formal duhet t'i ftojnë ata për mësim gjatë tërë jetës.<sup>44</sup>

Të mësuarit gjatë tërë jetës në realitet nuk është çështje e re, sepse te të gjitha shoqëritë, anë e kënd globit, hasim dhe vërejmë se i kanë dhënë rëndësi çështjes së të mësuarit tërë jetësor, që nga lindja e njeriut deri në vdekjen e tij. Sot, në fillim të shekullit të njëzetë e një prapë jemi duke

<sup>43</sup> Më gjerësisht rreth kësaj çështje shih: Jack Goody, "Islam in Europe", botim i vitit 2004.

<sup>44</sup> Revistë në gjuhën arabe: "Dirasatun terbevije", nr. 8, f. 208-211, viti: 2009.

dëgjuar zëra të cilët thërrasin për mësim tërë jetësorë duke potencuar dobritë e këtij procesi. Ajo çfarë sot është shumë e qartë është se çështja e të mësuarit gjatë tërë jetës nuk është më një çështje fakultative – opsionale thjeshtë për zhvillim dhe avancim individual, jo, kjo çështje tani më është orientim i pashmangshëm dhe nevojë imediate ekonomike për t'u ballafaquar me sfidat aktuale të llojlojshme.

Prej sfidave më të dukshme, me të cilat bota sot ballafaqohet, është efekti i herë pas hershëm i krizës financiare dhe efekteve të saja ekonomike, karshi çështjes së ofertës dhe kërkesës në tregun e kualifikuar, ku bartësit e diplomave universitare në nivel global janë shtuar ndërsa përfitimet materiale si rezultat i këtyre diplomave është zvogëluar. Ndoshta prej çështjeve më të theksuara të cilat kanë ndikuar në lëvizjen e tregut të punës dhe e kanë sfiduar atë është zhvillimi mjaft i shpejtë i teknikave të inteligjencës artificiale e cila realisht ka filluar që të ndikojë në punën dhe jetën tonë të përditshme.

Të mësuarit gjatë tërë jetës, ose mësimi i vazhdueshëm, është prej parimeve më madhështore të fesë Islame. Allahu, xh.sh., e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij që në vazhdimësi të mësoj dhe të kërkoj dituri, duke e porositur atë që të thotë:

وَقُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا

*“Dhe thuaj: Zoti im më shto diturinë”<sup>45</sup>.*

Gjithashtu edhe Pejgamberi, a.s., ka kërkuar në vazhdimësi nga shokët e tij që të jenë të përkushtuar ndaj kërkimit të dijes. Ai në njërin prej haditheve të tij ka thënë:

مَنْ حَرَجَ فِي طَلَبِ الْعِلْمِ فَهُوَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ حَتَّى يَرْجِعَ

*“Çdo njëri i cili del për të kërkuar dituri, ai është në rrugë të Zotit derisa të kthehet”<sup>46</sup>.* Ai i ka inkurajuar shokët e tij që të merren me dije pa marr parasysh moshën e tyre.

<sup>45</sup> Taha: 114.

<sup>46</sup> Transmeton Imam Tirmidhiu (2/108).

### Qëllimet e të mësuarit gjatë tërë jetës:

Nuk ka dyshim se prej qëllimeve më esenciale të të mësuarit gjatë tërë jetës është arritja deri te përvojat e reja, përfitimi i njohurive të ndryshme duke mos i kufizuar ato me moshë, kohë, cikël të caktuar mësimor, ose vend të caktuar. Gjithashtu të mësuarit e vazhdueshëm mund të arrihet edhe përmes ndjekjes dhe pjesëmarrjes në kurse të ndryshme mësimore, ose përmes leximit të një numër librash nga fusha të ndryshme.<sup>47</sup>

### Veçoritë e të mësuarit në vazhdimësi

Të mësuarit e vazhdueshëm veçohet me disa veçori, ato janë:

- Kontributi në arsimimin e individit dhe pajisjen e tij me njohuri nga shumë fusha shkencore, ekonomike, kulturore dhe të tjera.
- Përforcimi i fuqisë së mendjes për analiza logjike, përmes mbështetjes së aftësive personale të individëve të cilat janë të ndërlidhura me memorizim dhe kuptim.
- Të mësuarit e vazhdueshëm përfshinë të gjitha llojet e mësimit formal dhe jo formal, për këtë arsye është lehtë e mundshme përfitimi i lëndëve mësimore.
- Shton dhe rritë vetëbesimin personal të individit dhe i ndihmon ata në përkujdesje të vazhdueshme ndaj përparimit shkencor.
- Inkurajon në forcimin e rolit të pjesëmarrjes shoqërore te nxënësi duke e bërë atë që të krijoj kontakte me një numër mësuesish të fushave të ndryshme shkencore.<sup>48</sup>

---

<sup>47</sup> “Et Terbije medal-Hajat”, të autorit: Ahmed Ozi, në: [www.mawdoo3.com](http://www.mawdoo3.com) (01.09.2020).

<sup>48</sup> Ibid.

### Strategjitë e të mësuarit të vazhdueshëm:

Të mësuarit e vazhdueshëm mbështetet mbi disa strategji të cilat duhet t'i sigurojnë si institucionet publike ashtu edhe ato private për individët të cilët kanë shprehur dëshirë për këtë lloj të të mësuarit, këto përbëhen prej pesë strategjive, e të cilat janë:

1. Përkushtimi ndaj të gjitha llojeve të të mësuarit, e jo vetëm në të mësuarit ekzistues sipas plan-programeve mësimore.
2. Përkushtimi për të fut në praktikë mjete mësimore bashkëkohore, minimizimi i praktikimit të metodave klasike në të gjitha institucionet mësimore.
3. Heqja e çfarëdo pengese apo ndalese ndaj individit i cili dëshiron që të mësoj në vazhdimësi, si dhe orvatja për sigurimin e të gjitha mjeteve të cilat ua mundësojnë atyre mësimin.
4. Furnizimi me të gjitha burimet edukative të cilat kontribuojnë në realizimin e qëllimeve të kërkuara nga të mësuarit e vazhdueshëm.
5. Sigurimi i ekzistimit të bashkëpunimit konkret mes ministrive të arsimit të çdo vendi dhe institucioneve private të cilat përkujdesen për të realizuar të gjitha kërkesat esenciale për mësimin në vazhdimësi.<sup>49</sup>

### Etapat e mësimit të vazhdueshëm:

Bazuar në studimet dhe hulumtimet edukative të cilat janë marr me çështjen e mësimit të vazhdueshëm, këtë lloj të të mësuarit e kanë ndarë në katër nivele, ato janë:

1. Periudha e të mësuarit të vazhdueshëm prej fëmijërisë deri në moshën 5 vjeçare: është prej periudhave të vazhdueshme e të obligueshme edukative, të cilat ndiqen nga të gjithë fëmijët me qëllim të mësimit të aftësive të para shkollore.

---

<sup>49</sup> "Mefhum Et Talim El Mustemirr" nga: Muhamed bin Abdurrahman El Medenij, në: [www.mawdoo3.com](http://www.mawdoo3.com) (01.09.2020).

2. Periudha e të mësuarit të vazhdueshëm prej moshës 6 vjeçare deri në moshën 24 vjeç: është periudhë akademike e edukimit të vazhdueshëm përmes së cilës nxënësit mësojnë në shkollat e tyre publike dhe private.
3. Periudha e të mësuarit të vazhdueshëm prej moshës 25 vjeçare deri në moshën 60 vjeç: është periudhë e të mësuarit të vazhdueshëm jo e obligueshme dhe e cila nuk llogaritet si e ndërlidhur me periudhën paraprake.
4. Periudha e të mësuarit të vazhdueshëm prej moshës 60 vjeçare: është periudhë e të mësuarit të vazhdueshëm e cila mbështete mbi periudhën paraprake, në këtë periudhë njeriu kërkon të arrijë deri te shumë njohuri.<sup>50</sup>

### Relacioni mes të mësuarit të vazhdueshëm dhe shfrytëzimit të tij gjatë tërë jetës

Në të kaluarën relacioni mes të mësuarit dhe përfitimit në të shumtën e rasteve ka anuar kah ndjekja e një rregulli të thjeshtë: arritja sa më e madhe e edukimit në moshë të re dhe më pastaj vjelja e përfitimeve në pjesën e mbetur të jetës profesionale. Mirëpo, si duket ekuacioni ka ndryshuar sot shumë! Siç e ka potencuar edhe autori Tom Friedman në revistën prestigjioze “New York Times” duke thënë: (Ka përfunduar ideja që për katër vite të shkojmë në fakultet, e më pastaj ato njohuri të cilat i kemi përfituar të operojmë për periudhën tridhjetë vjeçare të ardhshme ... nëse një person dëshiron sot që të jetë një nëpunës i mirë dhe i denjë atëherë ai duhet të mësojë gjatë tërë jetës).

Diploma universitare me rastin e fillimit të punës nuk e anulon nevojën për të përfituar përvoja dhe njohuri të reja në vazhdimësi. Në veçanti kur një person është i angazhuar për një kohë të gjatë në një profesion. Nuk ka dyshim se trajnimet e ndryshme gjatë periudhës së

---

<sup>50</sup> Po aty.

angazhimit të personit në një vend të caktuar të punës janë mjaftë të mirëseardhura me qëllim të përfitimit të njohurive dhe përvojave të reja<sup>51</sup>.

### Kontributi i Fakultetit të Studimeve Islame në mësimdhënie

Fakulteti i Studimeve Islame është institucion i pavarur edukativo-arsimor dhe hulumtues-shkencor, i cili organizon studime universitare, me ambicie reale edhe për studime pasuniversitare deri në doktoraturë. Ai ka për mision arsimimin, edukimin dhe përgatitjen e kuadrove profesionale e shkencore për nevojat e Bashkësisë Islame dhe të shoqërisë kosovare në tërësi, po edhe më gjerë, në frymën e parimeve shkencore dhe të vlerave bashkëkohore nga fusha e islamistikës. Punën pedagogjike, shkencore dhe hulumtuese Fakulteti i Studimeve Islame e kryen dhe e zhvillon sipas standardeve evropiane të përcaktuara me Deklaratën e Bolonjës.

Strategjia e Fakultetit të Studimeve Islame, përmes organizimit të studimeve universitare, por edhe pasuniversitare, është që diturinë dhe njohuritë bashkëkohore t'i distribuojë përmes aktivitetit të mësimdhënies dhe të studimeve, si dhe të arsimojë kuadro të niveleve të ndryshme në përputhje me Kushtetutën e BIK-ut, Statutin e FSI-së dhe Ligjin mbi Arsimimin e Lartë të Kosovës. E veçanta e Fakultetit të Studimeve Islame është orientimi kah fushat e dijes në islamistikë, shkenca humane, teologji, filologji etj.<sup>52</sup>

Studimet në Fakultetin e Studimeve Islame janë të rregullta dhe me korrespondencë. Ato zgjatin katër vjet, respektivisht, tetë semestra, si për studentët e rregullt, ashtu edhe për ata me korrespondencë në nivelin e studimeve bachelor, programi "Teologji Islame"; ndërsa një vit, përkatësisht dy semestra, në nivelin e studimeve master. Studentët i nënshtrohen studimit sipas sistemit të ECTS kredive, për lëndët obliguese e zgjedhore, seminare dhe punimin e diplomës. Me këtë program, përveç

---

<sup>51</sup> Po aty

<sup>52</sup> Fakulteti i Studimeve Islame (Monografi me rastin e 25 vjetorit të themelimit), Prishtinë, 2017, f. 11.

që synohet aftësimi profesional i studentëve për punë në fushat e ndryshme, që mbulohen nga studimet e këtij programi, bëhet edhe përgatitja e studentëve për vazhdimin e studimeve të doktoratës, si në fushën e islamistikës, ashtu edhe në fusha të tjera të studimit.

Fakulteti i Studimeve Islame ka për qëllim sendërtimin e studimeve universitare bashkëkohore në përputhje me Deklaratën e Bolonjës, me specifikat që e dallojnë, duke e kurorëzuar atë me një diversitet në mësimdhënie, traditë dhe arritje të ndryshme bashkëkohore. Fakulteti ndihmon në përvetësimin e metodave bazë të kërkimit, përfshirë edhe aftësinë për të përcaktuar, vlerësuar dhe sintetizuar informacione e të dhëna. Zhvillon aftësitë e mendimit analitik, sintetik dhe kritik te studentët. Fakulteti i Studimeve Islame rëndësi të veçantë u kushton vlerave universale ndërnyerëzore, sidomos atyre me premisa hyjnore, si dhe kultivon marrëdhënie të shëndosha ndërmjet mësimdhënësit e studentit.

Fakulteti i Studimeve Islame ka për qëllim që:

- Të sigurojë kushte për arsimimin e kuadrove shkencore-mësimore;
- Të ofrojë kushtet për hartimin e literaturës shkencore mësimore për nevojat e studimit;
- Të krijojë kushte për mësimdhënie dhe studime cilësore;
- T'iu ofrojë shërbime profesionale e shkencore organeve dhe institucioneve të Bashkësisë Islame si dhe institucioneve të tjera;
- Të zhvillojë bashkëpunim me fakultetet homologe teologjike dhe me institucione e me asociacione të tjera shkencore-arsimore në vend dhe jashtë<sup>53</sup>.

Kandidatët e interesuar për të studiuar pranë Fakultetit të Studimeve Islame fillimisht, pas shpalljes së konkursit nga ana e dekanatit të FSI-së dhe përcaktimit të kriterëve për pranim, ata i nënshtrohen testit pranues i cili përbëhet nga 5 lëndë esenciale. Testit për pranim i nënshtrohen edhe kandidatët e interesuar për studime të rregullta po edhe ata me korrespondencë. Zakonisht dekanati i FSI-së shpall dy afate për pranim, njërin në fillim të muajit korrik e tjetri në gjysmën e muajit shtator.

<sup>53</sup> Po aty, f. 12.



Duke pasur parasysh rëndësinë e të mësuarit dhe mësim nxënies, në Fakultetin e Studimeve Islame mund të regjistrohen të gjitha kandidatët të cilët kanë të përfunduar ciklin e shkollimit të mesëm. Gjithashtu vlen të potencohet se nuk ka moshë të kufizuar për t'u regjistruan në FSI, e tëra kjo realizohet vetëm e vetëm që t'i jepet mundësi çdo njërit i cili ka shprehur dëshirën për t'u avancuar në studimet islame dhe ka dëshirë që të vazhdojë avancimin dhe ngritjen e tij intelektuale.

Hapësirat e brendshme të Fakultetit të Studimeve Islame janë të rregulluara sipas standarteve më bashkëkohore për realizimin e mësimdhënies. Ato janë të ndriçuara, të ngrohta, të pastra dhe të pajisura me pajisje dhe aparaturo të cilat ofrojnë komoditet për studentët në procesin e mësim nxënies por edhe kushte të përshtatshme të punës për personelin mësimor.

Sallat dhe kabinetet e mësimi disponojnë hapësirë të mjaftueshme, janë të pajisura me projektorë dhe kompjuterë, si dhe secili student ka tavolinën dhe karrigen e punës. I tërë objekti i Fakultetit të Studimeve Islame ka qasje në internet.

Vlen të ceket se Fakulteti i Studimeve Islame ka amfiteatër, salla mësimi, atë të kompjuterëve si dhe bibliotekën të realizuar në mënyrë moderne. Biblioteka e Fakultetit të Studimeve Islame është e pajisur me literaturë shkencore akademike në gjuhën shqipe dhe atë të huaj. Objekti i Fakultetit është i ri tërësisht dhe ofron kushte të mira për punë dhe studim. Biblioteka e Fakultetit të Studimeve Islame është në dispozicion të studentëve gjatë gjithë ditës, nga mëngjesi ora 8:00 deri në orët e vona të mbrëmjes, në ora 21:00. Studentet janë të lirë ta shfrytëzojnë hapësirën e bibliotekës për studimet e tyre gjatë tërë vitit akademik. Fakulteti i Studimeve Islame, ka një sistem të avancuar të sigurimit të materialeve që jap në shfrytëzim (librat) që posedon në bibliotekë.

Fakulteti i Studimeve Islame përveç mësimi të rregullt teorik dhe praktik që organizon për studentët, ofron edhe kurse të veçanta të mësimdhënies për studentët në lëmi të ndryshme islame si Kur'an, Hadith, Gjuhë arabe, Sire, Tefsir etj. Qëllimi i organizimit të këtyre kurseve është

përgatitja profesionale e studentëve për karrierën e tyre të ardhshme në tregun e punës. Veçmas në organizimin e kurseve për studentët rëndësi i kushtohet mësimit të gjuhës angleze si gjuhë e rëndësishme për komunikim ndërkombëtar.

## Përfundim

Vlera e diturisë në fenë Islame është e veçantë. Këtë e vërteton fakti se shpallja nuk filloi me urdhrin e adhurimit, apo njohjen e Allahut, xh.sh., apo nënshtrimin ndaj Tij, por filloi me fjalën *“Ikre – Lexo”*. Çdo njeri i cili analizon ajetet e Kuranit kupton qartë se Islami obligon marrjen me hulumtimin dhe arritjen e diturisë dhe zhvillimin e shkencës.

Feja Islame ia imponon popullatës, e cila e ka përqaftuar atë, që të jetë popull i arsimuar, që ta ulë nivelin – përqindjen e analfabetizmit, si dhe të ngritë përqindjen e intelektualëve. Kjo fe na mëson se nëse një besimtar dëshiron që ta arrij imanin e rregullt, ai besimtar është i obliguar ta studiojë shkencën.

*Në Kuran vazhdimisht përsëritet thirrja drejtuar besimtarëve për të kërkuar dituri. Në Kuran janë të paraqitura shumë fenomene natyrore si p.sh. si qiejt, shiu, bimët, kafshët, lindja dhe perëndimi i Diellit, krijimi i universit, procesi i krijimit, planetët, shenjat gjeografike, etj., ku na bënë thirrje në mënyrë të vazhdueshme që t'i eksplorojmë dhe t'i studiojmë. Në shumë ajete, vërehet qartë rëndësia e kërkimit të diturisë dhe përdorimit të intelektit për të kuptuar shenjat – argumentet e Zotit, xh.sh., në Tokë, kudo që janë ato.*

*Në shoqërinë islame asnjëherë nuk mund të këtë ndalesë për marrjen e diturisë për asnjërën gjini. Kërkimi i dijes dhe arsimimi është një e drejtë që nuk i mohohet as burrave dhe as grave të çfarëdo moshe qofshin, si në rastin e diturisë fetare ashtu edhe të asaj shkencore. Për këtë e gjen mbështetjen në shprehjen e qartë të një hadithi që deklaroi se: **“kërkimi i dijes është një detyrë e çdo muslimani”**. Në shprehjen **“çdo musliman”** përfshihen natyrisht edhe gratë. Një tjetër version i të njëjtit hadith vazhdon me fjalët **“për burrat dhe gratë”**.*

Duke u mbështetur në ajetet kuranore dhe hadithet e Pejgamberit, a.s., të cilat nxisin për dije, edhe Fakulteti i Studimeve Islame, si institucion i vetëm në Kosovë i cili ofron studime në fushën e islamistikës, orvatet që të jetë sa më afër studentëve të cilët kanë shprehur interesim për të studiuar dhe t'ju ofrojë atyre mundësi dhe kushte sa më të volitshme.

# Fenomeni i zëvendësimit të një tingulli me një tingull tjetër në gjuhën arabe

---

Mr. Besim Mehmeti

## Abstrakt

Dialektet ndryshojnë në çdo rajon të botës arabe, dhe secili popull i botës arabe dallohet nga dialektet që përdor, pavarësisht se origjina është e njëjtë, dhe se arabishtja si gjuhë është po e njëjta; kur lëvizni nga një vend në tjetrin, ju e vini re këtë ndryshim dhe, në të njëjtën kohë, e zbuloni se ky dialekt mund të përhapet në shumicën e rajoneve, qoftë edhe pa asnjë lidhje midis tyre. Ndryshimi midis dialekteve erdhi në bazë të karakteristikave gjuhësore që përfshijnë, sikurse, për shembull, ndërrimi i shkronjave në vend të njëra-tjetrës, ose duke e zëvendësuar shkronjën me shkronjë, ose duke e shtuar një shkronjë, e kështu me radhë. Shkrimtari egjiptian Mustafa Sadik Al Rafi'i<sup>1</sup> bëri një përpjekje të madhe për ta përmendur dhe studiuar këtë çështje përmes librit të tij "Historia e letërsisë arabe"<sup>2</sup>. Gjithashtu është më së e njohur se gjuha klasike arabe nuk përfaqësohej vetëm nga dialekti ku-

---

<sup>1</sup> Mustafa Sadik Al Rafi'i (1988-1937): Një nga poetët e letërsisë moderne arabe në shekullin e njëzetë, si dhe shkrimtar i poemave, i letërsisë dhe i retorikës në një nivel të lartë; ky i përket shkollës së konservatorëve, një shkollë e poezisë që i përket poezisë klasike.

<sup>2</sup> Er Rafi'i, Mustafa Sadik, "Tarih Adab Al Arab", Mueseset Hindavi 2013, Kairo, f. 114.

rejsh, dhe nuk mund të përshkruhet si dialekt i një fisi të caktuar, por nga një përzierje e disa dialekteve arabe, e që u ngritën për shkak të shumë faktorëve dhe arsyeve.

**Fjalë kyçe:** dialekt, gjuhë arabe, kurejsh, elokuent

### Abstract

Dialects differ in each region of the Arab world, and each people of the Arab world is distinguished by the dialects they use, despite the fact that the origin is the same, and that Arabic as a language is the same; when you move from one country to another, you notice this difference and, at the same time, you find that this dialect can spread in most regions, even without any connection between them. The difference between the dialects came based on the characteristics linguistic ones involving, as, for example, swapping letters for each other, or substituting letter for letter, or adding a letter, and so on. The Egyptian writer Mustafa Sadiq Al Rafi'i made a great effort to mention and study this issue through his book "The History of Arabic Literature". It is also well known that the classical Arabic language was not only represented by the Quraish dialect, and it was not can be described as a dialect of a certain tribe, but from a mixture of several Arabic dialects, which arose due to many factors and reasons.

**Keywords:** Dialect, Arabic language, Quraish, eloquent.

Te studiuesit arabë është nxitur, kohë pas kohë, një debat i gjerë rreth kësaj teme, kryesisht mes atyre që e përkrahin mendimin se dialekti i fisit kurejsh është ai me elokuenti dhe mes atyre që kundërshtojnë këtë mendim. Kështu që, në vijim do t'i sjellim mendimet e dy taboreve rreth kësaj çështjeje:

## Së pari: Dijetarët përkrahës të dialektit kurejsh

### 1) Dijetarët e lashtë-përkrahësit e dialektit kurejsh

Dijetarë e lashtë pothuajse ranë dakord - edhe nëse nuk e mbështetën këtë me dëshmi - se dialekti kurejsh është statusi më i lartë dhe më elokuenti i dialekteve arabe, dhe është ai dialekt që mbizotëronte në Gadishullin Arabik para Islamit. Mendimet se dialekti kurejsh ishte më elokuenti, dominon te shumica e dijetarëve më të vjetër. Ata i citon Es Sujuti<sup>3</sup> në librin e tij El Muzhir<sup>4</sup> siç vijon:

#### **1- Mendimi i Imam El Ferras<sup>5</sup> (shek. II hixhrij:**

“Arabët merrnin pjesë në festivale çdo vit dhe kryenin haxhin në shtëpinë e shenjtë në epokën paraislamike, të njohur ndryshe edhe si “e xhahiljetit”. Këtë mundësi kurejshët e shfrytëzonin duke dëgjuar gjuhët, përkatësisht dialektet e fiseve arabe, e ndërsa flisnin vetë, merrnin atë që u pëlqente nga këto gjuhë e këto dialekte, duke e bërë më elokuent variantin e tyre. Veç tjerash, ata e zhveshën gjuhën nga fjalët e urryera dhe të qortueshme.”

<sup>3</sup> Xhelaludin Abdulrahman bin Ebi Bakr bin Muhamed bin Sabik Ed Din El Khudairi El Sujuti, i njohur më mirë si Xhelal Ed Din El Sujuti, (Kairo 849 H / 1445 g. - Kajro 911 H / 1505 AD ) është imam Hafëz, përkthyes, historian, shkrimtar dhe jurist shafiit. Ai ka rreth 600 libra. Ai u rrit në Kajro si jetim.

<sup>4</sup> As Sujuti, Xhelaludin, “El Muzhir fi ulum El Lughah ve envaiha”, Menshurat El Mektebe Al Asrije, Bejrut, v.I f.211.

<sup>5</sup> Imam Ebu Zakaria Jahja bin Zijad bin Abdullah bin Manzur bin Mervan El Aslami El Dailami El Kufi, mevla i Benu Esadit, i njohur si El Ferra, dhe pseudonimi i tij është “sepse ai fliste lirshëm” me elokuentë. El Ferra lindi në Kufe në vitin 144 hixhri, pastaj u shpërngul në Bagdad dhe banoi pjesën më të madhe të jetës së tij atje.

## **2- Mendimi i Imam Tha'labiut<sup>6</sup> (shek. III hixhri):**

“Kurejshët u ngritën në elokuencën e tyre duke mos përdorur Ana'nen e fisit Tamim, Teltelen e fisit Behra, Keskesën e fisit Rabi'a, dhe Keshkeshen e fisit Havazin, etj.”

## **3- Mendimi i Imam El Farabiut<sup>7</sup> (shek. IV hixhri):**

“Kurejshët ishin më të mirët në mesin e arabëve në zgjedhjen e fjalëve më elokuate, më të lehtat për t'u shqiptuar, më të mirat për t'u dëgjuar dhe më të qartat në artikulimin e asaj që e kishin në shpirt.”

## **4- Mendimi i Imam Ibën Farisit<sup>8</sup> (shek. IV hixhri):**

“Dijetarët tanë janë pajtuar njëzëri me fjalët e arabëve, transmetuesit e poezive të tyre, dhe dijetarët në gjuhët e tyre, ditët dhe vendbanimin e tyre, se kurejshët ishin më elokuentët e arabëve, më të pastër në gjuhë dhe për këtë shkak Allahu i Lartësuar i zgjodhi ata nga të gjithë arabët, e në mesin e të cilëve lindi Profeti i mëshirës Muhamedi, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të.”

## **2) Dijetarët modernistë mbështetësit e dialektit kurejsh:<sup>9</sup>**

Shumica e studiuesve dhe gjuhëtarëve modernë ndoqën rrugën e të parëve, duke preferuar dialektin kurejsh mbi dialektet e tjera arabe dhe e konsiderojnë atë bazën mbi të cilën bazohet arabishtja standarde.

### **1- Mendimi i profesor Mustafa Sadiq Al Rafi'i (1911g.):**

Profesor Mustafa Sadiq Al Rafa'i përmendi në librin e tij (Historia e letërsisë arabe) se gjuha arabe kaloi nëpër tri faza, e fundit prej të cilave

<sup>6</sup> Ebu Is'hak Ahmed bin Muhamed bin Ibrahim Al Thalabi Al Nejsaburi (427h.), është një dijetar dhe mufesir i Kuranit.

<sup>7</sup> Ebu Nasër, emri i tij ishte Muhamed, El Farabi (874g-950g). I lindur në Farab në Kazakistanin e sotshëm, i njohur në Perëndim me emrat Avenasar dhe Al Farabius, ai konsiderohet si Mësues dytë, (Magister secundus) pra menjëherë pas Aristotelit.

<sup>8</sup> Ebu al-Husein Ahmed bin Faris bin Zakarija El Kazvini ar Razi (941 g. 1004 g. ishte një gjuhëtar dhe imam në gjuhë dhe letërsi.

<sup>9</sup> <https://www.startimes.com/?t=17233593>. Shakir Tamimi

ishite puna e kurejshëve dhe është fisi i fundit në historinë e elokuencës, dhe kështu që edhe Kurani famëlartë ka zbritur në gjuhën kurejshe.

### **2- Mendimi i Dr. Ali Abdel Vahed Vafi <sup>10</sup> (1945 g.):**

Dr. Ali Abdel Vahed Vafi deklaroi në librin e tij (Filozofia e Gjuhës) se dialekti kurejsh është dialekti më i mirë, më i lartë dhe më elokuent nga dialektet arabe për shkak të autoritetit të tij fetar të përfaqësuar në Qabënë e Shenjtë dhe autoritetit ekonomik të përfaqësuar në mbizotërimin e pjesës më të madhe të tregtisë nga kurejshët, duke mos e shmangur këtu as autoritetin politik. Arsyeja për këtë ishte liderizmi fetar dhe ekonomik. Për më shumë Dr. Ali Abdel Vahed Vafi shkon edhe më tutje duke thënë se Kurani i Shenjtë është shpallur në dialektin e kurejsh.

### **3- Mendimi i Dr. Taha Husejn <sup>11</sup>:**

Dr. Taha Hussein shkroi në librin e tij “El edeb el Xhahili” rreth letërsisë paraislamike; se kurejshët kishin një autoritet politik në Mekë dhe rrethinat e saj, dhe ky autoritet politik ishte i fuqizuar nga një autoritet i madh ekonomik ku sasia më e madhe e tregtisë ishte në duart e kurejshëve dhe se ky autoritet ishte i fuqizuar edhe me një autoritet të fortë fetar nga arabët e veriut. Kështu që fisi kurejsh mblodhi një autoritet politik, ekonomik dhe fetar dhe e gjithë kjo bëri që ai të impononte dialektin e tij mbi fiset e Hixhazit, diçka që nuk u fitua nga shpata, por më tepër u fitua nga përfitimi i ndërsjellë”. Dr. Taha Hussein beson se dialekti kurejsh është gjuha arabe al fusha me elokuentja.<sup>12</sup>

---

<sup>10</sup> Ali Abdel Vahed Vafi (1901-1991) ishte një pionier egjiptian i sociologjisë arabe. Ai lindi në Omdurman, në Sudan, ku babai i tij ishte mësues. Ai studioi në Al Az'har në Egjipt, mësoi përmendësh Kuranin e Shenjtë dhe u diplomua në Shtëpinë e Shkencave të Larta në vitin 1925. Ai studioi filozofi dhe sociologji në Universitetin Sorbonë në Paris, duke marrë një diplomë bachelor në 1928, pastaj një doktoratë në sociologji nga universiteti i njëjtë në 1931.

<sup>11</sup> Taha Husejn 1889-1973, një shkrimtar dhe mendimtar egjiptian, i konsideruar si një nga figurat e iluminizmit dhe lëvizjes moderne letrare.

<sup>12</sup> Husejn, Taha, “El edeb El Xhahili”, Metbaat Faruk 1933, Kairo, f.79-85.



#### **4- Mendimi i Dr. Ibrahim Enis<sup>13</sup>:**

Dr. Ibrahim Enis beson se dialekti kurejsh kishte epërsi dhe përhapje dhe se ishte më elokuenti nga dialektet arabe, megjithëse ai besonte se Kurani i Shenjtë ishte shpallur në dialektet e arabëve në tërësi, jo vetëm në dialektin e fisit kurejsh.

### **Së dyti: Gjuhëtarët e lashtë dhe modernë që mbështesin idenë e një gjuhe të përbashkët të fiseve arabe:<sup>14</sup>**

#### **1- Mendimi i El Baklani<sup>15</sup> (shek. IV hixhri):**

El Baklani shkoi në përfundimin se gjuha tipike arabe është e zgjedhur në të cilën kanë marrë pjesë të gjitha fiset në formimin e saj, dhe këtë e ka shprehur në librin e tij (El Nuket fi Ixhaz El Kuran).

#### **2- Mendimi i Dr. Abdu Ar Ragjihi<sup>16</sup>:**

Dr. Abdu Ar Ragjihi beson në librin e tij (Dialektet Arabe dhe Leximet Kuranore) se dialekti kurejsh nuk ishte niveli më i lartë elokuent

<sup>13</sup> Ibrahim Enis (1906-1977) pionier i studimeve gjuhësore arabe, studiues gjuhësor, i lindur në Kajro, iu bashkua Shtëpisë së Shkencave të Larta dhe u diplomua në të me një diplomë të lartë në vitin 1930. Ai punoi si mësues në shkollat e mesme. Nga Universiteti i Londrës, ai mori një diplomë bachelor në 1939, pastaj një doktoratë në 1941. Ai u anëtarësua në Akademinë e Gjuhës Arabe në 1961, dhe revistat arabe janë të mbushura me artikuj kërkimor dhe gjuhësor të këtij kolosi.

<sup>14</sup> <https://www.startimes.com/?t=17233593> Shakir Tamimi

<sup>15</sup> El Kadi Ebu Bekr El Baklani (338 h. – 403 h.) është: Muhamed bin El Tajib bin Muhamed bin Xhafer bin El Kasim, i quajtur Shejhu i Sunetit dhe Lisan El Ummeh (gjuha e kombit).

<sup>16</sup> Abdo Ali Ibrahim al Rajhi lindi në tetor 1937 në rajonin e Dakahlia në Egjipt. Ai mori një diplomë Bachelor të Arteve, Departamenti i Gjuhës Arabe, në Universitetin e Aleksandrisë, me notën “shkëlqyeshëm” me nderime në vitin 1959 dhe një Master i Arteve në gjuhësi nga i njëjti universitet në qershor 1963, më pas Doktor i Arteve në shkencat gjuhësore 1967. Ai mbajti gradën asistent mësimdhënës në Departamentin e Arabishtes në Universitetin e Aleksandrisë nga viti 1961, gradën e mësuesit të gjuhësisë nga viti 1967, gradën asistent profesor i gjuhësisë në të nga viti 1972, pastaj gradën profesor i gjuhësisë. nga viti 1977. Puna e tij e fundit ishte profesor me orar të plotë të gjuhësisë, Fakulteti i Arteve - Universiteti i Aleksandrisë.

dhe i elokuencës. Ai beson se Kurani i Shenjtë është shpallur në gjuhën e përbashkët arabe, e cila përbëhet nga të gjitha dialektet arabe, por Dr. Abdu Ar Ragjihi shkon me tutje dhe sheh se të gjitha dialektet arabe janë të barabarta, dhe nuk lejohet preferimi i një dialekti mbi një tjetër.<sup>17</sup>

### Së treti: Një mendim mes dy taborëve:

Dr. Xhaber Kumejhah, në një artikull të botuar në internet<sup>18</sup>, u përpoq të ndiqte një rrugë të mesme midis dy taborëve të përmendura më parë, pasi beson se dallimi rreth së cilës sillet kjo çështje është vetëm një dallim verbal, sepse dialekti i veçantë i kurejshëve përfaqësonte gjuhën e përbashkët të të gjitha fiseve arabe.

Duke pas parasysh se po flasim për një fenomen i cili është i shfaqur në gjuhën arabe dhe i cili ndërlidhet shumë ngushtë me sistemin e artikulimit të tingujve në përgjithësi dhe në gjuhën arabe në veçanti, do të flasim pak për aspektin akustik të tingujve të një gjuhe.

Studiuesi të kësaj fushe kanë shkruar mjaft shumë libra dhe hulumtime të analizuara dhe hulumtuar në laboratorë specifikim duke përdorur edhe metoda dhe mekanizma specifikë.

### Aspekti akustik në studimin e tingujve të gjuhës:<sup>19</sup>

Çdo tingull që shqiptojmë në të folur është një fenomen fizik, një lëvizje lëkundëse e transmetuar përmes një mjedisi elastik (ajri) dhe e perceptuar nga dëgjimi njerëzor. Kjo lëvizje osciluese karakterizohet nga veti të caktuara fizike. Ato studiohen nga një degë e fizikës - akustikës. Prandaj, ky aspekt i fonetikës quhet akustik.

---

<sup>17</sup> Ar Raxhih, Abdu, "El Luga El Arabije ve lehexhatuha", Dar Al Marife Al Xhami'ije, b.1996, Aleksandria f.35-64.

<sup>18</sup> <http://www.gaberkomeha.com>. Xhabir Kumejhah.

<sup>19</sup> <https://optolov.ru/sq/okna-i-otkosy/fonetika-kak-razdEl-yazykoznaniya-predmet-i-zadachi-fonetiki.html>.

Karakteristikat akustike të një tingulli janë forca, toni dhe timbri. Fuqia e zërit varet nga amplituda e dridhjes: sa më i madh të jetë amplituda, aq më i fortë është tingulli.

Toni i tingullit varet nga frekuenca e dridhjeve: sa më e lartë të jetë frekuenca, aq më i lartë është tingulli. Lëkundjet mund të jenë uniforme, periodike dhe pastaj tingulli quhet një ton muzikor (ose thjesht një ton), për shembull: tingulli i një korde violine. Nëse dridhja është e pabarabartë, jo periodike, kemi të bëjmë me zhurmë, për shembull, zhurma e goditjes së një çekiçi. Elementet e tonit dhe zhurmës përdoren gjithashtu në tingujt e gjuhës.

Tingujt e të folurit klasifikohen sipas mbizotërimit të tonit dhe zhurmës (klasifikimi akustik i tingujve).

### Klasifikimi akustik i tingujve<sup>20</sup>

Article I. Zanoret janë tone, bashkëtingëlloret pa zë janë zhurma;

Article II. Bashkëtingëlloret me zë kombinojnë tonin dhe zhurmën;

Në zërin, mbizotëron toni, në zëra të zhurmshëm, mbizotëron zhurma. “Timbri” është ngjyrosja e një tingulli. Timbri i një tingulli varet nga forma e tij valore, e cila ndryshon me numrin e mbitoneve ose harmonikave që janë të pranishme, frekuencat e tyre dhe intensiteti i tyre relativ.<sup>21</sup>

Përveç tonit themelor, i cili krijohet nga dridhjet e kordave vokale në tërësi, tingujt e të folurit përfshijnë ngjyrimet, të cilat krijohen nga dridhjet e pjesëve individuale të kordave vokale. Forca e ngjyrave është e vogël në krahasim me forcën e tonit kryesor, por kur ato kalojnë nëpër gojë ose zgavrën e hundës, disa prej tyre amplifikohen. Kështu që ndodh fenomeni i rezonancës. Forma dhe vëllimi i zgavrës me gojë mund të ndryshojë me shpejtësi dhe të intensifikojë njërin ose tjetrin ngjyrim. Kjo krijon një mori tingujsh në të folurit. Përveç kësaj, zgavrat me gojë dhe hundë janë plotësisht individuale, kështu që zëri i secilit person ka një origjinalitet unik.

<sup>20</sup> Po aty.

<sup>21</sup> <https://www.britannica.com/science/timbre>,

## Aspekti biologjik në studimin e tingujve të gjuhës<sup>22</sup>

Çdo tingull që shqiptojmë në të folur nuk është vetëm një fenomen fizik, por edhe rezultat i një pune të caktuar të trupit të njeriut. Përveç kësaj, tingulli perceptohet nga veshi, i cili gjithashtu shoqërohet me procese të caktuara në organizmin e njeriut.

Konsiderimi i tingujve të gjuhës dhe fjalës nga pikëpamja e proceseve që ndodhin në trup gjatë shqiptimit të këtyre tingujve dhe gjatë perceptimit të tyre, përbën përmbajtjen e aspektit biologjik në studimin e tingujve. Aspekti biologjik ndahet në shqiptues dhe perceptues. Në mënyrë që një person të shqiptojë një tingull të veçantë të të folurit, është i nevojshëm një impuls i caktuar cili dërgohet nga truri. Impulsi vjen nga e ashtuquajtura qendra e të folurit motorik - zona e Broca, dhe ndodhet në Gyrusin e 3 - të frontal të hemisferës së majtë. Impulsi transmetohet përgjatë nervave tek organet që kryejnë këtë komandë. Krijohet një qarullim ajri ku mushkëritë, bronket, si dhe diafragma dhe gjoksi janë të përfshirë në krijimin e tij.

Shumica e tingujve të përdorur në gjuhët e botës normalisht shqiptohen gjatë nxjerrjes, d.m.th. me ndihmën e ajrit të nxjerrë nga mushkëritë. Së bashku me këtë, është e mundur të shqiptoni të njëjtat tinguj gjatë thithjes. Në një numër gjuhësh, ka bashkëtingëllore të veçanta "klikuese", të cilat formohen jo duke marrë frymë, por kur thithet ajri si rezultat i tkurrjes së muskujve të ndryshëm në zgavrën e gojës, si për shembull tingulli C.

Tërësia e punës së aparatit të frymëmarrjes dhe lëvizjet e organeve të shqiptimit, të nevojshme për shqiptimin e tingullit përkatës, quhet artikulum i këtij tingulli.

Duke përmbyllur pjesën akustike të artikulimit të tingujve mund të konstatojmë se ky është një mekanizëm shumë i komplikuar qoftë në aspektin biologjik apo mekanik. Kështu që nga aspekti fetar mund ta

---

<sup>22</sup> <https://optolov.ru/sq/okna-i-otkosy/fonetika-kak-razdEl-yazykoznaninya-predmet-i-zadachi-fonetiki.html>.

vërejmë edhe mrekullinë e krijimit të njeriut nga Krijuesi suprem – Allahu xh.sh., ku veçoi çdo krijesë me veçori të veçanta në artikulumin e tingujve, me zëra dallues. Allahu xh.sh., në një ajet kuranor thotë:

﴿21﴾ وَأَفَلَا تُبْصِرُونَ ﴿20﴾ وَفِي أَنْفُسِكُمْ أَفَلَا تُبْصِرُونَ

*“Edhe në tokë ka argumente për ata të bindurit. Edhe në veten tuaj (ka argumente). A nuk jeni kah e shihni?”<sup>23</sup>*

Çdo gjuhë ka veçoritë e veta në artikulumin e tingujve, kështu që edhe gjuha arabe si një gjuhë e vjetër ka veçoritë e veta, e të cilat në fakt e pasurojnë atë. Arabët flisnin në dialekte të ndryshme, nga të cilat numëroheshin më shumë se njëzet dialekte, gjuhëtarët i studiuuan dhe hulumtuan e si rezultat iu dhanë emra dhe tituj. Disa nga të cilat janë edhe këto që do i cekim më poshtë:

## Disa nga fenomenet të zëvendësimit të një tingulli me një tingull tjetër në Gjuhen Arabe

Së pari: “الكشكشة - Keshkeshah zëvendësimi i tingullit “ ك - kafit” në “ ش - shin”

Duke qenë se kjo dukuri është një nga të ashtuquajturat “كشكشة” zëvendësimi i tingullit “ ك - kafit” në “ ش - shin” në gjuhësi, ishte e nevojshme të trajtohej dhe të përcaktohej kjo temë.

Zëvendësimi i tingullit është një fenomen që gjuhëtarët kanë mendime të ndryshme në përkufizimin e tij, dhe siç thotë profesori Ghaleb Fadel al Muttalib:

“Fenomeni i *kashkashahs* – zëvendësimi të tingullit është ende misterioz dhe se nuk ka asgjë në librat e gjuhës dhe gramatikës që e përkufizon atë shkencërisht.”<sup>24</sup>

<sup>23</sup> Edh Dharijat 20-21.

<sup>24</sup> Al Matlabi Galib Fadi, “Lehxhet Temim ve etheruha fi al arabijeti al muvehade”, Irak, Botim i Ministrisë së Kulturës së Irakut 1978, f.106.

Duke u nisur nga kjo më lartë si dhe duke munduar ta hulumtojmë këtë fenomen ne mund të mbledhim mendimet e gjuhëtarëve në lidhje me fenomenin e “كشكشة – zëvendësimit” si më poshtë:

- 1- Ndër ta janë ata që mbajnë shkollën e mendimit të Sibevejhit<sup>25</sup>, duke e përshkruar atë si zëvendësim të “ك - kafit” në “ش - shin”, ose duke i bashkangjitur një “ش - shin” me të, vetëm në rastin e “وقف” ndalesës.
- 2- Dhe në mesin e tyre ka nga ata që mbajnë të njëjtën shkollë mendimi, vetëm se ajo nuk kërkon rastin e “وقف” ndalesës.
- 3- Disa prej tyre e përshkruan atë si zëvendësim të “ك - kafit” në “ش - shin” vetëm në “وقف” ndalesë.
- 4- Dhe disa prej tyre e përshkruan atë si zëvendësim të “ك - kafit” në “ش - shin” pa e përmendur dhe përcaktuar me “وقف” ndalesë.
- 5- Disa prej tyre ishin të mendimit se ajo përfshinte shtimin e shkronjës “ش - shin” “ك - kafit” në “وقف” ndalesë.<sup>26</sup>

Vërejmë nga sa më sipër se, çështja kufizohet ndërmjet dy rasteve, ose duke i shtuar “ك - kafit” “ش - shin” në “وقف” ndalesë ose tjetër, ose duke e zëvendësuar “ك - kafit” në “ش - shin” në “وقف” ndalesë ose tjetër.

Duke hulumtuar mendimet e gjuhëtarëve rreth këtij fenomeni mund të vërejmë se ata gjithashtu ndryshonin në mendimet e tyre rreth origjinës së këtij fenomeni “كشكشة”, ata këtë fenomen ia atribuuan fiseve apo dialekteve të Tamimit<sup>27</sup>, Asadit<sup>28</sup>, Mudarit dhe Rabias.<sup>29</sup>

<sup>25</sup> Sibevejeh (arabisht: سيبويه) lindi në Shiraz në provincën Fars të Iranit të sotshëm (më 760 dhe vdiq më 796, emri i plotë i të cilit Abu Bishr Amr bin Uthman بن قنبر الحارثي ishte një gramatikan kryesor persian i Basrës dhe autor i librit më të hershëm mbi gramatikën dhe gjuhësinë arabe. Vepra e tij e famshme pa emër, e referuar si Al Kitāb, ose “Libri”, është një libër themelor me pesë vëllime i sintaksës së gjuhës arabe.

<sup>26</sup> Al Gunejm Saliha Rashid Gunejm, “El Lehxhat fi Al Kitab li Sibevejhi esvaten ve bunje”, b1, 1985, Dar Al Medeni, Xheda, Arabia Saudite, f.254.

<sup>27</sup> Benu Tamim është një fis arab që ishte në epokën para islamike dhe islamit të hershem. Ai jeton në Al-Dahna dhe rajonet veriore të Nejd dhe Al Yamamah në Arabinë Saudite, që është shtëpia e tij origjinale. Gjendet gjithashtu në Irak, Kuvajti, Katari dhe Bahreini. Është një nga kafkat kryesore arabe, dhe para Islamit ata ishin banorë të

Në këto pretendime secili prej tyre ka dëshmi nga fjalët e arabëve, dhe poezitë e tyre. “Duke shikuar dëshmitë poetike që përmendën këta gjuhëtarë, ne i gjetëm ato të llojit zëvendësim të “ك - kafit” në “ش - shin”.<sup>30</sup>

Ndër shembujt që ata përmendën se si shndërrohet “ك - kafi” në “ش - shin” në vakëf është thënia e poetit Ru’bës<sup>31</sup>:

*Ajo qesh me mua nëse më sheh duke e ngacmuar*

*Dhe nëse me sheh nga ajo duke larguar,*

*Në një gamë të gjerë në të cilën dallohet plaka e moshuar.*

Këtu në fund të fjalisë për shkak të rimës e shndërroi “كافين-ك” në fund të fjalës “harrek - حرك” në “ش-shin”.

Gjithashtu thënia e tyre në shembullin e radhës: “ويحك ماليش - Vejhake Malesh”<sup>32</sup> ndërsa është “ويحك مالك - Vejhake Ma lek” që do të thotë: “Kujdes çfarë ke?”. Kështu që vërejmë këtu se “ك - kafi” i parë nuk ka ndryshuar, sepse është “kafi” origjinal, dhe sepse është në “وصل - lidhje”, ndërsa “kafi” i dytë ka ndryshuar në shkronjën “shin” sepse është në “وقف” ndalesë.

Ndërsa ata të cilët kanë për mendim zëvendësimin e “ك - kafit” në “ش - shin” në “وصل - lidhje” morën si argument thënien e Mexhnunit

shkretëtirës, me shumë luftëra me shumë beteja, shumica e tyre kundër fisit Bekr bin Vail, si dhe kundër fiseve Hawazin, Medhexh. Ghatafani dhe të tjerët.

<sup>28</sup> Banu Esed është fisi Khandafija i Adnaniyah, dhe është një nga fiset e lashta arabe. Enciklopedia Arabe shkruan: “Beni Esed është një fis i madh nga Al Adnaniyah që i atribuohet Asad bin Khuzeyma bin Madrakah bin Elias bin Mudar bin Nizar. Shtëpia e fisit Asad në epokën para islamike ishte në Nexhd, në perëndim dhe nga Kasimi në lindje të malit T’ai në rajonin Hail të Arabisë Saudite.

<sup>29</sup> Mudarët (arabisht: مضر) janë një nga grupimet më të fuqishme fisnore arabe veriore. Fiset Mudari dhe Rabi’a janë regjistruar në Arabinë Qendrore në historitë arabe të periudhës paraislamike.

<sup>30</sup> Al Gunejm, f.254.

<sup>31</sup> Roba bin Abdullah El Ajaj bin Roba bin Labid bin Sakhr El Basri Al Tamimi al Saadi (65 h/684 g.- 145 h/762 g.) ishte nga shtyllat e Islamit dhe elokuenca e tyre, ai ishte një veteran i shtetet Umevit dhe Abasid. Ai ishte mjeshtër në elokucën e gjuhës, dhe babai i tij kishte dëgjuar nga Ebu Hurejra r.a.

<sup>32</sup> El Lehexhat f. 254.

për Lejlanë<sup>33</sup> duke përshkruar dashurinë e madhe që kishte për të dhe duke e përshkruar dhe ngjasuar atë me simbolin e bukurisë së një gazelleje në shkretëtirë, thotë:

*Sytë e tu janë sytë e saj, qafa jote është qafa e saj  
Përveçse se kocka këmbës është më e hollë nga ti*<sup>34</sup>

Pra në fjalët “عيناك - ajnaki” që do të thotë “sytë e tu” dhe “جيدك - gjiduki” që do të thotë “qafa jote”, si dhe fjalën “منك - minki” që do të thotë “nga ti”, poeti zëvendësoi “ك - kafin” me “ش - shin” edhe pse nuk ishte “وقف” ndalesë pra ishte në “وصل - lidhje”.

### Se dyti: Zëvendësimi i tingullit “ك - kafit” me “ش - ç”

Ky është një fenomen i përhapur, veçanërisht në vendet e Gjirit, ku ndërrojnë kaf-in dhe e shqiptojnë atë “ç”.

Kjo duket qartë në dialektin kuvajtian, për këtë thotë d. Abdul-Aziz Matar:

“Unë arrita ta përkufizoj këtë shqiptim të kaf-it, të cilin ne e quajmë (الكشكشة - zëvendësim) në dialektin kuvajtian, në dy raste:

- Kafi - ك i vetes së dytë për njëjësinë femërore, në të gjitha pozicionet e saj, në mënyrë të qëndrueshme dhe pa përjashtime, ndërsa i paraprinë mbaresa rasore parësore gjithmonë – kasra.
- Kaf në çdo vend, nëse paraprihet dhe pasohet nga një prej tingujve të butë “اللين” ballor, siç e kemi shpjeguar më parë, që është kasra ِ-, ja - ي e zgjatur ose fetha َ-, dhe elif - ا i zgjatur por jo në gjendjen e amplifikimit. Nga kjo përjashtohet kafi - ك cila është në një fjalë të huaj dhe që është e huaj për dialektin, në këtë rast nuk shqiptohet sipas “الكشكشة - kashkashah”, dhe me përjashtim të këtyre dy vendeve, kafi - ك shqipton me një zë të

<sup>33</sup> Mexhnun Lejla (arabisht: مجنون ليلى ('Dashnori i çmendur i Lejlës' është një histori dashurie e vjetër me origjinë arabe, rreth poetit beduin nga Nexhdi të shekullit të 7-të Kays bin al-Mulawwah dhe dashurisë së tij Layla bint Mahdi (e njohur më vonë si Leyla al Aamiriya).

<sup>34</sup> Al Mubrid, Ebu Al Abas bin Jezid Al Mubrid, “Al Kamil”, Dar Nahda Misr, Kairo, v.II, f.223.



fortë, të pëshpëritur, nga skaji i qiellzës, si shqiptimi i zakonshëm arab.”<sup>35</sup>

Shembulli i të parës është: fjala مبارك – mubarek, shqiptohet me kaf të pastër, mirëpo fjala يبارك – jubarik, shqiptohet jubariç sipas الكشكشة - kashkashah” për shkak të kasra َ.

Dhe shembulli i të dytës janë fjalët كذاب – çedhab , كلب – çelb , كبد – çebd, كم – çem, كلمة – çelime, etj. Të gjitha këto fjale shqiptohen sipas “الكشكشة - kashkashah” duke zëvendësuar tingullin “ك - kafit” me “تش - ç” për shkak të fetha َ.

Dhe ky fenomen ka një shpjegim akustik. “Kaf – ك është nga tingujt e qiellzës së sipërme dhe të uvulës dhe është një zë i ashpër, i pëshpëritur. Ajo shqiptohet në dialektin kuvajtian, duke ruajtur këtë karakteristike, përveç rasteve që u specifikuan që është kasra َ, ja - ي e zgjatur ose fetha َ, dhe elifi - ا i zgjatur por jo në gjendje amplifikimi.

Dhe këto lëvizje ballore tërheqin daljen e kaf – ك përpara, dhe ajo del nga mesi i qiellzës, në vend që të dalë nga mesi i qiellzës, dhe mesi i qiellzës është vendi i daljes së tingullit shin - ش dhe ja- ي . Në këtë rast, kaf – ك shqiptohet si tingull midis këtyre tre tingujve, që është ajo që ne e shprehëm si kaf (Kashkashah), që është më afër tingullit xhim persian – الجيم الفارسية ose i gjuhës angleze.”<sup>36</sup>

Duke studiuar dhe hulumtuar fiset të cilët e përdorin këtë fenomen, zbulojmë se ato dikur shtriheshin dhe përhapeshin në rajonet e Gjirit Arabik dhe në Irakun jugor, kështu që këtë fenomen e gjejmë edhe sot në këto vende.

Këtë e thekson edhe dr. Nuajmi ku thotë: “Kështu, fisi Tamim, ishte i shtrirë në Al-Jemameh në Irakun jugor, pastaj edhe në Bahrein dhe Al-Ihsa.”<sup>37</sup>

<sup>35</sup> Al Matar Abdul Azizi, “Hasais El Lehxhe El Kuvajtije”, Metabi Er Risale 1969, Kuvajt, f.39.

<sup>36</sup> Po aty f.42.

<sup>37</sup> Al Nuajmi Husam Seid, “Ed Dirasat El Lehxhije ve Es Sevtije inde bin Xhinni”, Dar Er Reshid 1980,Irak, f.149.

Dhe mund të themi se fenomeni i “Kashkasha” që përmendin gjuhëtarët, i cili është shqiptuar nga disa fise në të kaluarën dhe është përhapur në shumë vende arabe kohët e fundit, si në shtetet e Gjirit dhe në Irakun jugor, ka pasur një zhvillim apo ndryshim në shkronjën cila zëvendësoi shkronjën apo tingulli kaf – ك , dhe për të cilën Ibën El Xhini<sup>38</sup> thotë se:

“Është kaf – ك që është midis kafit - ك dhe xhimit – ح.”<sup>39</sup>

Pra ky tingull ka evoluar në tingullin “ç” e që shqiptohet sot nga njerëzit e Gjirit Arabik, dhe ndoshta arsyeja për këtë është përzierja e ndër-sjellë me gjuhët e tjera në të cilat është i pranishëm ky tingull dhe siç vërtetohet nga gjuhëtarët se gjuha ndikohet dhe preket nga gjuhë të tjera dhe ndoshta ky zhvillim është një ndikim i tillë.

Dhe ajo që vërteton pretendimet tona është edhe ajo që u përmend në librin e dialekteve:

“Ajo që justifikon shtimin e një tingulli tjetër në kaf - ك dhe që ne mendojmë se ajo që dëgjojmë sot në të folmet e bijve të Gjirit, rajonit lindor, pjesës veriore të Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe shkretëtirës (Jordanisë), nga shqiptimi i kaf-it – ك me një tingull të përzier të “t” dhe shin = t sh (ç), është një zgjatim i atij imazhi të (Kashkasha) tek arabët e mëparshëm.

Pra fenomeni (Kashkasha), rrëshqitja nga një tingull në tingull tjetër, në formën e saj është ende e gjallë edhe sot e kësaj dite, por tingujt që dëgjojmë sot nuk janë të kufizuar vetëm në përdorim të kaf-it – ك me gjininë femërore, siç thonë banoret e Gjirit: “تشيف الحال”- çef el hal” do të thotë “si je?” e që në fakt është “كيف الحال” “Kejf elhal”.<sup>40</sup>

<sup>38</sup> Ebu El Fath Othman bin Xhinni, i njohur si “Ibën Xhini”, dijetar i madh gramatikor, i lindur në Mosul në vitin 322 hixhri.

<sup>39</sup> bin Xinni, Ebu El Fath Othman, “Sirr Sinaat Al I’rab”, Dr. Hasen Al Hindavi, b1 Dar Al Kalem, 1985, Damask v.I, f.206.

<sup>40</sup> Al Lehxhat f.256.

### Së treti: "Shensheneh – الشنشنة" zëvendësimi i tingullit " kafit" me " shin"

Ky fenomen "Shensheneh – شنشنة" vjen si rrjedhojë e zëvendësimit të tingullit " kafit" me " Shin" dhe këtë fenomen e gjejmë të përdorur në rajonin e Asirit në Arabinë Saudite, për shembull: "شيف الحال" - shef el hal" do të thotë "si je?" e që në fakt është " كيف الحال " "Kejf el hal" si në zonën e Jemenit dhe Omanit.

Al-Shanshanah në shkencat e gjuhës arabe konsiderohet si një dialektik i veçantë në gjuhën e Jemenit dhe fisit Taghlib<sup>41</sup>.

Ibën Abd Rabbo<sup>42</sup> atribuoi këtë fenomen gjuhësor fisit Taghlib duke cekur se gjatë kryerjes së Haxhit në kodrinën Arafat janë dëgjuar disa haxhilerë nga Jemeni duke thënë telbijen në këtë mënyrë:

"لبيش اللهم لبيش" – Lebejshe Allahume Lebejsh" në vend të "Lebejke Allahume Lebejke".

Pra ky është një dialekt i veçantë i lashtë jemenas, është ende një dukuri fonetike e zakonshme në dialektin Hadrami<sup>43</sup> pra zëvendësimit të tingullit " kafit" me " shin".

<sup>41</sup> Benu Taghlib bin Vael është një fis arab nga Rabia nga Adnan, ka marrë pjesë në luftën El Basous kundër Benu Shejbanit nga pasardhësit e vëllezërve të tyre, fisi Benu Bekr bin Vail, dhe atij i përkasin Kuleib bin Rabiah dhe vëllai i tij Ebu Leila El Muhalhal Udej bin Rabiah dhe poeti i shquar Amr bin Kulthum. Fisi Taglub ishin të krishterë.

<sup>42</sup> bin Abd Rabbih (arabisht: ابن عبد ربه) ose bin Abd Rabbihi (Ahmad bin Muhamed bin Abd Rabbih) (860-940) ishte një shkrimtar dhe poet arab, i njohur gjerësisht si autori i librit të famshëm Al 'Iqd al Farid (Gjerdani unik).

<sup>43</sup> Dialekti Hadrami karakterizohet nga disa karakteristika, duke përfshirë ndrimin e tingullit xhim - ج me ja- ي në disa qytete dhe fshatra të bregdetit. Sa i përket Luginës Doan it dhe disa qyteteve të tjera, tingulli xhim - ج lëshon një tingull të fortë, shpërthyes trokitjeje ose një xhim të etur. Ndërsa tingulli kafi - ق shqiptohet gjithashtu në një tingull të lartë, shpërthyes palatal. Ndërsa sa i përket tingujve Dad - ض dhe El Zaa - ظ, ato u bashkuan në një tingull, që është El Dha'a - ظاء .

### Së katërti: "Keskeseh – الكسكسة" zëvendësimi i tingullit " ك - kafit" me "س – Sin"

Keskeseh është një dukuri e vjetër fonetike dhe gjuhësore, vjen si rrjedhojë e zëvendësimit të tingullit " ك - kafit" të vetes së dytë me "س – Sin" ose i bashkohet "س – Sin".

Prej gjuhëtarëve është përmendur, dhe është ende e dëgjueshme në kohën tonë, veçanërisht në Gadishullin Arabik. Ky fenomen i atribuohet fiseve Bekr bin Uaelit, Havazinit dhe një dege të fisit nga Temimi.

Ky fenomen ka tre forma:

- Duke i bashkangjitur " ك - kafit" të vetes së dytë "س – Sin", p.sh. "مررت بكس" – "Merertu bikes" në vend "مررت بك" "Merertu biki" që do të thotë: "Kam kaluar pranë teje".
- Zëvendësimi i " ك - kafit" të vetes së dytë me "س – Sin", p.sh. "مررت بس" –

"Merertu bis", ky fenomen dëgjohej tek fisi Utejbeh një nga degëzimet e fisit Hevazin.

- Zëvendësimi i " ك - kafit" të vetes së dytë me "س – c"; për shembull "مررت بتس" – "Merertu bic", ky fenomen dëgjohej në dialektin e rajonit Kasimi, Hail si dhe është e përhapur në Nexhd të Arabisë Saudite.

### Së pesti: "Istinta – الاستنطاء", "zëvendësimi i tingullit" ع - ajnit me sukun" me "ن – nun"

Istinta – الاستنطاء është një dukuri e vjetër fonetike dhe gjuhësore që vjen si rrjedhojë e zëvendësimit të tingullit "ع - ajnit me sukun" me "ن – nun". Kështu që në një nga leximet e ajetit Kuranor:

﴿إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ﴾<sup>44</sup>

"Inna A'tajname el Kevther" është lexuar me zëvendësim të "ع - ajnit me sukun" me "ن – nun" duke u lexuar: "Inna Antajname"

Gjithashtu i Dërguari i Allahut, s.a., thotë një dua në një hadith:

<sup>44</sup> Kuran, El Kevther 1.

اللهم لا مانع لما أنطيت، و لا منطي لما منعت<sup>45</sup>

**“O Allah nuk ka kush ndalon atë që jep Ti, e as që jep atë që ndalon Ti”.**

“Allahume la Manie lima Antejt, ve la Muntije lima menate” në këtë lutje në dy fjalë është zëvendësuar ع - ajni me sukun” me “ن - nun; fjala “Aátejte - أعطيت” është lexuar “Antejte - أنطيت” dhe fjala “Muútiye - معطي” është lexuar “Muntije - منطي”.

Gjithashtu i Dërguari i Allahut, s.a., thotë në një hadith tjetër:

اليد المُنطِية خير من اليد السفلى<sup>46</sup>

**“Dora që jep është më e mirë se ajo që shtrihet.”**

“El Jedu El Muntije hajrun minel jed es sufla” në këtë hadith është zëvendësuar ع - ajni me sukun” me “ن - nun në fjalen “Al Muntije - المنطية” është lexuar “Al Mu’utiye - المعطية” dhe fjala “Muútiye - معطي” është lexuar “Muntije - منطي”. Pra kemi hadithe të shumta që është shfaqur ky fenomen, dhe ky përdorim i këtij fenomeni nga i Dërguari i Allahut, s.a., mund të komentohet në dy mënyra:

1. Ose i Dërguari a.s. ka fol në këtë dialekt, duke marrë parasysh bashkëbiseduesin dhe ata të cilëve u drejtohej; Sepse ai a.s., ai u fliste të gjithë fiseve arabe në gjuhën e tyre apo dialektin e tyre.
2. Ose ai që e ka transmetuar këtë hadith ka qenë nga ato fise që kanë pasur dialektin e Istinta - الاستنطاء , dhe e ka transmetuar hadithin në dialektin e tij, jo siç e ka dëgjuar nga i Dërguari i Zotit a.s. i cili fliste në dialektin e kurejshëve.

**Së gjashti: “At Tamtamanije - الطمطمانية”, “zëvendësimi i tingullit” ال - E L të shquarsisë me “م - mim”**

At Tamtamanije - الطمطمانية ose Mim Al-Himjerije është një fenomen i lashtë fonetik dhe gjuhësor që është i përhapur në pjesë të Jemenit, Tihama, Asir dhe Xhazan të Arabisë Saudite. Konsiderohet si një nga

<sup>45</sup> <https://al-maktaba.org/book/33549/1857#p3>

<sup>46</sup> [https://islamarchive.cc/H\\_162134](https://islamarchive.cc/H_162134)

dialektet e gjuhës klasike arabe, me gjithë se disa gjuhëtarë e cilësojnë atë si “defekt gjuhësore”, por në fakt janë dialektet që po rriten e nuk zhduken si shumë sosh.

Dhe për këtë fenomen është shembulli më i famshmen nga i Dërguari a.s., ku transmetohet se një burrë erdhi tek i Dërguari i Zotit a.s., derisa ishte në mesin e shokëve të tij dhe i tha:

“O i Dërguar i Zotit, a ka ndonjë obligim agjërimit në udhëtim?” Ai iu përgjigj: “Nuk është pjesë e obligimit të agjërimit në udhëtim!” Shokët e tij, Allahu qoftë i kënaqur me ta, i thanë: “O i Dërguari i Zotit! çfarë të tha ai dhe çfarë i the atij?; Ai u tha: Tha: “A është mirë të agjërosh në udhëtim?” Unë iu përgjigja: “Nuk është mirë të agjërosh në udhëtim”.<sup>47</sup>

Pra në këtë hadith i Dërguari a.s., u pyet nga një burrë:

“هل من أم بر أم صيام في أم سفر” - “Hel min em bir em sijam fi em sefer” në vend të thoshte: “هل من البر الصيام في السفر” - “Hel min el birri es sijamu fi es sefer”, pra këtu ai “zëvendësoi tingullin” ال - EL të shquarsisë me “م - mim”. Kështu që edhe i Dërguari i Allahut, s.a., iu përgjigj me të njëjtin dialekt duke i thënë:

ليس من أم بر أم صيام في أم سفر - “Lejse min em bir em sijam fi em sefer” në vend të thoshte:

ليس من البر الصيام في السفر - “Lejse min el birri es sijamu fi es sefer”. Dhe nga ky përdorim i këtij dialekti disa nga sahabet e pranishëm nuk e kuptuan këtë bisedë dhe pyetën të Dërguarin rreth saj.

Së shtati: “El Axx’axhe - العججة”, zëvendësimi i tingullit

“ - ja me teshdid, ose ي - ja me sukun me ج - xhim”

“El Axx’axhe - العججة” është një fenomen i lashtë fonetik që i atribuohet përdorimit tek fisi Kuda’ah, që është zëvendësimi i tingullit “ ي - ja me teshdid, ose ي - ja me sukun me ج - xhim”. Ky zëvendësimi i ka lehtësuar bashkimin e tyre në dalje, që është dafina, dhe të dyja janë të

<sup>47</sup> Transmeton Imam Ahmedi në Musnedin e tij v. V, f. 434.

<http://www.saaaid.net/Doat/Zugail/80.htm>

zëshme, dhe ndryshimi midis tyre është se ج - xhimi është shpërthyes, dhe ي - ja është tingull i butë.

### Së teti: "El Je'jeh – الياية " zëvendësimi i tingullit " ج - xhim me ي - ja"

"El Je'jeh – الياية " është një fenomen i lashtë fonetik që i atribuohet përdorimit tek fisi Tamim dhe fenomen i kundërt me fenomenin e mëparshëm "El Axh'axhe – العججة ", zëvendësimi i tingullit " ج - xhim me ي - ja". për shembull, në fjalën " دجاجة - dexhaxheh" tingulli zëvendësohet dhe thuhet "دياية – dejaje" që do të thotë: pulë, ose në fjalë "رجال – rixhal" thuhet: "ريال - rijja" që do të thotë: burrë. Ky fenomen është ende i dëgjueshëm në disa zona të Gjirit Arabik dhe Hadramaut në Jemen, veçanërisht në Kuvajt, Bahrein dhe El-Ihsa në Arabinë Saudite lindore dhe në rajonin Dhofar në jug të Sulltanatit të Omanit.

### Së nënti: Dukuri të përgjithshme gjuhësore të pa titulluara

Në Egjipt dhe në Sham, njerëzit i ndryshojnë fjalët e tyre në të folur në shkronja të tjera, për shkak të ngjashmërisë së daljeve të shqiptimit, që quhet termi "التصحيف - korrigjimi"<sup>48</sup>. Për shembull, në disa vende arabe, veçanërisht në Sham në përgjithësi, Palestinë në veçanti dhe Egjipt, ndryshohet "ق - Käf" e fortë me "ك - kaf" të butë, p.sh. قال thuhet كال . Në disa vende zëvendësohet ث - tha me ت - ta, p.sh. "اثنين - ithnejn" dhe lexohet "اتنين - itnjen". Ose zëvendësimi i tingullit "ذ - dha" me tingullin "د - de" p.sh. "هذا - hadha" shqiptohet me "هادا - hada" etj.

<sup>48</sup> Korrigjimi është shkrimi i një fjale ose leximi i saj ashtu siç nuk është, për shkak të vështirësisë për të dëgjuar një nga shkronjat, tingujt e saj ose për ta shkruar atë në mënyrë që të ngjajë me një shkronjë tjetër.

## Përfundim

Duke u bazuar mbi gjithë çfarë thamë më sipër, mund të konstatojmë se origjina është një, por degët janë të shumta! Kështu që vështirë është të lëvizim nga një shtet arab në tjetër, apo nga një rajon a qytet në tjetrin, e të mos vërejmë dallimet që i shpërfaqin dialektet. Andaj ky ndryshim nuk është vetëm i kohës së tashme dhe nuk kufizohet në dialektet bisedore. Në fakt ndryshimi i dialekteve nga një rajon në tjetrin nuk është një fenomen i kohëve të fundit, por është një fenomen i lashtë që është identifikuar nga studiuesit dhe është kodifikuar prej kur arabët filluan të shkruanin dispozitat e gjuhës “gramatikën - sintaksën” dhe dallimin në dialekte nga një fis në tjetrin. Çdo dialekt ndryshon nga tjetri, në bazë të veçorive gjuhësore që përfshinë, si ndryshimi i një shkronje në një vend tjetër, ose shtimi i një shkronje shtesë, deri tek ndryshimi rrënjësor i fjalës ose foljes. Andaj kjo vetëm sa e pasuron një gjuhë dhe jep mundësi mësimi edhe më shumë. Gjithashtu në këtë punim janë përmendur vetëm disa nga fenomenet e zëvendësimit të disa tingujve në tinguj tjerë, por jo të gjitha.





# Narracioni i fshehur i historisë së letërsisë shqipe

Besnik Jaha PhD (c)

## Abstrakt

Çdo gjë që ndodh e ka historinë e vet. Sepse është në natyrën e historisë të merret me të ndodhurën. Në këtë plan, historia mbetet fusha studimore që më së shumti mund të ketë lidhje me fushat e tjera studimore. Madje, edhe me letërsinë, me të cilën lidhja është shumë komplekse, meqë kjo e fundit nuk merret me të ndodhurën, por me të mundshmen që s'ka ndodhur. Sipas teoricienit anglez, Rene Uelek, deri më sot shumica e historive të letërsisë janë histori të civilizimeve. Pra, mungon vështrimi i historisë së letërsisë si histori e letërsisë si art. Sipas Uelek, historia e letërsisë duhet domosdo të largohet nga historia e letërsisë me shoqërinë (historia e saj sociale). Uelek vë në pah edhe disa faktorë me rëndësi në shkrimin e historisë së letërsisë, si: studimet historike mbi tema e motive letrare; shkrimi i historisë duke i pasur parasysh periudhat; emërtimi i periudhave letrare etj.<sup>1</sup>. E, kur jemi te shkrimi i historisë duke i pasur parasysh periudhat, pastaj edhe emërtimin e periudhave letrare, në historinë e letërsisë

<sup>1</sup> Rene Uelek, Ostin Uoren, "Teoria e letërsisë" (Përktheu: Zejnullah Rrahmani), f. 382-408

shqipe vërehet se shkenca e historisë së letërsisë është bërë me “një sy mbyllur”. Mirëpo, për ta vërejtur këtë më qartë, në këtë punim i kemi hedhur një sy më të thellë historive më të njohura të letërsisë shqipe, që nga inicimet e para e deri te projektet e mëdha institucionale, ndërsa kemi vërejtur elemente tepër me rëndësi për historinë e pashkruar të letërsisë shqipe!

**Fjalët kyçe:** histori e letërsisë, periudhë, emërtim, dokumente, shkrimtarë

## Abstract

Everything that happens has its own story. Because it is the nature of history to deal with what was, what happened. In this plan, history remains the field of study that can most relate to the other fields of study. Even with literature, with which the connection is very complex, because literature does not deal with what was, but with the possibility that did not happen. According to the English theorist, Rene Welek, until today most of the histories of literature are histories of civilizations. So, the view of the history of literature as history of literature as art is missing. According to Welek, the history of literature must necessarily depart from the history of literature with society (its social history). Welek also highlights some important factors in writing the history of literature, such as: historical studies on literary themes and motifs; writing history with periods in mind; the naming of literary periods, etc. And, when we are to the writing of history, need to be attentive for the periods, then also the naming of the literary periods, in our case, the history of Albanian literature, it can be observed that the science of the history of literature was done with "one eye closed". However, to notice this more clearly, in this paper we have taken a deeper

look at the most popular examples of Albanian literature, from the first initiations to the big institutional projects, while we have noticed very important elements for the history unwritten Albanian literature!

**Keywords:** history of literature, period, designation, documents, writers

## I. Pak histori e shkrimit shqip

Sipas Rolan Bartit, “vepra letrare është paradoksale, sepse është njëkohësisht edhe shenjë e një historie, po edhe rezistencë e asaj historie”<sup>2</sup>. Në këtë kontekst, edhe historia e letërsisë, në rastin tonë e letërsisë shqipe, në secilën formë të mundshme të vlerësimit (historizimit), është po kaq paradoksale. Kjo sepse vetë vepra letrare ka një histori që e ndjek pas. Dhe sepse vetë vepra letrare është vazhde e traditës që kultivon akëcilën formë shkrimi, apo e përmbys komplet formën paraprake, duke ofruar më pas një formë krejt të re dhe të panjohur më parë. Megjithatë, në shumicën e rasteve çdo histori e letërsisë nis me historinë e një libri. Në fakt, me historinë e një gjuhe. Apo, më saktë, me historinë e një populli.

Edhe historia e letërsisë shqipe nuk bën përjashtim nga ky rregull. Ajo nis pikërisht me historinë e një libri, “Meshari” (1555), të Gjon Buzukut, që si libër u shkrua rreth 92 vjet pas dokumentit të parë që dëshmon shqipen e shkruar, respektivisht “Formulës së Pagëzimit” (1462). Megjithatë, historia e popullit shqiptar nuk i përgjigjet komplet kësaj skeme, sepse është shumë më e vjetër. Të paktën pesëmbëdhjetë shekuj më shumë. Sipas të dhënave të gjertanishme historike, fjala shqiptar (“Albanian”) për herë të parë përmendet prej Ptolemeut<sup>3</sup> (85-165), gjeograf grek

---

<sup>2</sup> Rolan Barthes, *Oeuvres complètes* II, 2002. Art. *Historie au Littérature*, (f. 177-194), f. 178.

<sup>3</sup> Emri i plotë i Ptolemeut është Claudius Ptolemaeus. Të dhënat historike thonë se lindi në vitin 85. Ptolemeu ishte grek, mirëpo jetonte dhe punonte në Aleksandri të Egjiptit. Mendohet se ai jetoi rreth 80 vjet, dhe vdiq në vitin 165.

që jetonte e punonte në Aleksandri të Egjiptit. Në “Gjeografinë” e tij, me fjalën *Αλβανολ* (Lexo Alvanol!) ai i referohet fiseve të tjera ilire, si dhe qytetit të tyre *Αλβανοπολις* (Lexo Alvanopolis!), e që korrespondon me fshatin e sotëm Zgërdhesh afër qytetit të Krujës.

Megjithatë, pas këtij rasti, nga lufta e fundit iliro-romake, kur ilirët ranë nën sundimin romak, *për gati nëntëqind vjet pas Ptolemeut, një hesh-tje ra mbi shqiptarët*.<sup>4</sup> Ndërkaq, si datë zyrtare prej kur emri *Albani*, (*Albaniae*) njihet në mbarë botën, merret viti 1272, data 21 shkurt, kur Çarlisi i 1-rë i Anjoui e themeloi “Mbretërinë shqiptare” (“Regnum Albania”).

Sidoqoftë, duhet ta themi se, nëse me “Mesharin” e Gjon Buzukut mund ta përcaktojmë fillimin e letërsisë shqipe, e kemi të pamundur ta përcaktojmë fillimin e shkrimit shqip. Kjo për shkak se *janë zhdukur të gjitha shkrimet e para mesit të shekullit XVI*,<sup>5</sup> po edhe për dy fakte të tjera: i pari, për shkak të ndalimit të gjuhëve vulgare, mes të cilave prej romakëve konsiderohej edhe gjuha shqipe, dhe; i dyti: për shkak se në Mesjetë nuk ekzistonte vetëdija kombëtare, ashtu që shqiptarët të këmbëngulnin të shkruanin në shqip (për këtë dëshmon fakti se të gjithë autorët e periudhës së Humanizmit shqiptar nuk e kanë shkruar as edhe një vepër në shqip, por të gjitha i kanë të shkruara në latinisht).

Pavarësisht kësaj, historia e shkrimit shqip domosdo se na çon para vitit 1462, kur Palë Engjëlli e formuloi *Qarkoren* e famshme, në paragrafin e dytë të së cilës dy rreshta përmbanin fjalë shqipe. Dhe nga viti i *Formulës së Pagëzimit* (1462), i *Formulës së Mallkimit* (1483; “*Draburi te clofto gogle*”), pastaj i *Fjalorthit të Arnold von Harffit* (1496), i *Ungjillit të Pashkëve* (shekulli XIV-XV), i “*Mesharit*” të Buzukut (1555), i “*Fjalorit të Teodor Mazrekut*” (1633), i “*Mbishkrimeve të Pejanës*” (1728) etj., shkrimi shqip tanimë ishte nisur rrugës për të vazhduar tutje pa ndalim.

<sup>4</sup> Namik Ressuli, “Albanian literature”, Vatra, Boston Massachushttes, 1987, f. 3.

<sup>5</sup> Po aty, f. 8.

## II. Teoria e historisë së letërsisë

Çdo gjë që ndodh e ka historinë e vet. Sepse është në natyrën e historisë të merret me të ndodhurën. Në këtë plan, historia mbetet fusha studimore që më së shumti mund të ketë lidhje me fushat e tjera studimore. Madje, edhe me letërsinë, me të cilën lidhja është shumë komplekse, meqë kjo e fundit nuk merret me të ndodhurën, por me të mundshmen që s'ka ndodhur.

Si komponentë themelorë të studimit të letërsisë kemi: teorinë e letërsisë; historinë e letërsisë, dhe; kritikën letrare, ndërsa raporti mes të parës dhe të dytës është shumë më i thellë sesa i dy të parave me të fundit, që në fakt ngjan si derivat (mjet) i tyre.

Historia e teorisë së letërsisë nis në antikë, me Platonin dhe Aristotelin. Po atje mund të themi se nis edhe historia e letërsisë. Vlerësimi i veprave letrare dhe tentimi për klasifikime edhe mbi bazë të kohës, "*Poetikën*" e Aristotelit njih si veprën e parë strukturale të teorisë së letërsisë, po edhe si veprën e parë të historisë së letërsisë.

Megjithatë, lidhja e teorisë së letërsisë me historinë e letërsisë është pak më komplekse sesa vetëm kjo. Dhe, jo vetëm se edhe teoria e letërsisë, nëse do ta ndanim edhe nga antika, ka historinë e saj. Mirëpo më shumë edhe për arsyen e natyrës së letërsisë dhe natyrës së historisë.

Derisa teoria e letërsisë merret me konvenca e kodifikime për letërsinë, historia e letërsisë merret me, kushtimisht studimin, pra të veprave letrare në rrjedhën e tyre historike. Dhe, këtu na del në pah edhe natyra, mirëpo edhe funksioni i njërës dhe i tjetrës.

Nëse letërsia flet për diçka që mund të ndodhë, historia flet për diçka që ka ndodhur. Nëse e para ka dy funksione: funksionin shkencor, që e lidh me historinë, dhe funksionin kreativ (fiksional e psikologjik), që e ndan nga historia, e dyta ka vetëm një funksion: të tregojë çfarë ka ndodhur.

Kjo nënkupton se kur letërsia shihet në funksionin e parë, kemi të bëjmë me një histori të funksionit të letërsisë, ndërsa kur letërsia shihet

në funksionin e dytë, atëherë kemi të bëjmë me një histori të krijimit të letërsisë.

Megjithatë, nga antika e deri më sot janë shkruar shumë vepra që tentojnë të përmbledhin historinë e letërsisë. Derisa disa janë orientuar te veprat, disa të tjera janë koncentruar tek autorët, dhe kështu të parat kanë lënë anash mendësinë individuale e kolektive që e ka shtyrë autorin të shkruajë vepra të atilla, lidhjet e autorit me veprat e tij etj., ndërsa të dytat kanë lënë anash teknikat dhe veçoritë me të cilat autori e ka shkruar veprën.

Po sipas Todorov, *historia e letërsisë nuk duhet ta studiojë vetëm gjenезën e veprave, historinë e ndikimit të veprave në shoqëri (raportin historik e letërsisë – histori sociale), apo vetëm studimin e historisë së shkrimit të tekstit letrar sipas një forme në një periudhë letrare. Historia e letërsisë duhet ta studiojë ligjëratën letrare, dhe jo veprat, me çka përkufizohet si pjesë e poetikës.*<sup>6</sup>

Ndërsa, sipas Zherar Zhenet, kemi dy modele të historisë së letërsisë: *një si një rrjedhë e monografive, që nuk mund të krijojë një histori, dhe tjetri si një histori letrare, që propozohet prej Lansonit, dhe që nuk merret me prodhimin letrar, por me tabela letrare, histori të kulturës, me turmat që lexojnë me individët e njohur që shkruajnë: histori letrare e studimit të veprave si dokumente që shprehin ndjeshmëri e ideologji të kohës*<sup>7</sup>. Megjithatë, sipas Zherar Zhenet, historia e letërsisë duhet të jetë *një histori e letërsisë e marrë për vete (e jo në rrethet e veta sociale) dhe për veten (e jo si dokument historik)*<sup>8</sup>.

Në kritikën letrare shqiptare mungojnë vepra të kësaj natyre. Pra, ne na mungojnë madje edhe vepra që trajtojnë kënaqshëm qoftë edhe bashkërisht këto dy disiplina. E vetmja vepër që merret me, të themi, studimin e teorisë dhe të historisë së kritikës letrare shqiptare njëkohësisht,

<sup>6</sup> Oswald Dykro, Cvetan Todorov, "Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit" (Përktheu: Rexhep Ismajli), 1984, f. 208.

<sup>7</sup> Sabri Hamiti, "Albanizma", ASHAK, Prishtinë, 2009, f. 237.

<sup>8</sup> Zherar Zhenet, "Figura" (Përktheu: Sabri Hamiti), 1985, f. 79.

është ajo e Ibrahim Rugovës, “*Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*”<sup>9</sup>.

Sipas teoricienit anglez, Rene Uelek, deri më sot shumica e historive të letërsisë janë histori të civilizimeve. Pra, mungon vështrimi i historisë së letërsisë si histori e letërsisë si art. Sipas Uelek, historia e letërsisë duhet domosdo të largohet nga historia e letërsisë me shoqërinë (historia e saj sociale). Uelek vë në pah edhe disa faktorë me rëndësi në shkrimin e historisë së letërsisë, si: studimet historike mbi tema e motive letrare; shkrimi i historisë duke i pasur parasysh periudhat; emërtimi i periudhave letrare etj.<sup>10</sup>.

E, kur jemi te shkrimi i historisë duke i pasur parasysh periudhat, pastaj edhe emërtimin e periudhave letrare, në historinë e letërsisë shqipe vërehet se shkenca e historisë së letërsisë është bërë me “një sy mbyllur”. Mirëpo, për ta vërejtur këtë më qartë, le t’i hedhim një sy historive më të njohura të letërsisë shqipe, që nga inicimet e para e deri te projektet e mëdha institucionale!

### III. Inicime të historisë së letërsisë shqipe, dhe provat e para për periodizim

Si nisma të para për histori të letërsisë shqipe mund t’i veçojmë tri:

1. Provat e para për shkrimin e një historie të letërsisë shqipe në gjuhën shqipe mund t’i vërejmë në vitin 1925<sup>11</sup>. Më saktë në veprën

---

<sup>9</sup> Kjo është vepra kryesore e një historie të kritikës letrare shqiptare. Vepra është botuar edhe në kompletin e veprave të Ibrahim Rugovës, në vitin 2005, nga Shtëpia Botuese “Faik Konica”, në Prishtinë. Janë të njohura edhe dy vepra të tjera që kanë plotësuar mungesën e studimeve në fushën e kritikës letrare dhe historisë së kritikës letrare shqiptare, e që janë botuar në të njëjtin vit: “*Kritika letrare*” e përpiluar prej Ibrahim Rugovës dhe Sabri Hamitit, mirëpo që kufizohet në kohë (nga De Rada e deri te Migjeni), e botuar nga Rilindja, në Prishtinë, dhe; “*Antologji e mendimit estetik shqiptar 1504-1944*”, e Nasho Jorgaqit, e botuar në Tiranë.

<sup>10</sup> Rene Uelek, Ostin Uoren, “Teoria e letërsisë” (Përktheu: Zejnullah Rrahmani), f. 382-408

<sup>11</sup> Para këtij viti kemi vetëm një vepër që flet për historinë e letërsisë shqipe, apo, për të qenë më i saktë, një manual të letërsisë shqipe, të shkruar dhe të botuar në gjuhën ita-



shkollore të At Justin Rrotës “*Letratyra shqype*”. Libri ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë është me interes për teorinë e letërsisë, sepse trajton elementet e para të teorisë së letërsisë: subjektin e shkrimit, figurat stilistike, stilin, elokucionin, prozën dhe llojet e saj etj. Në pjesën e dytë të librit “*Historija e letratyrës shqype*”, autori përpiqet të japë regjistrin e shkrimtarëve shqiptarë, duke karakterizuar vlerat e tyre me një mbititull “Mbi shkrimtarë mën në shëj të gjuhës shqype”.<sup>12</sup> Këtu autori rendit një varg shkrimtarësh shqiptarë, duke filluar me Gjon Buzukun, për të përfunduar me Fan S. Nolin. Rrota bën edhe një tentim për ta ndarë në grupe letërsinë shqipe, dhe këtë e bën duke u bazuar në disa karakteristika. Kështu, Rrota letërsinë shqipe e grupon si më poshtë:

- Jeronim de Rada e shkrimtarë të tjerë të Kajabrijes;
- Naim Frashëri, e tjerë shkrimtarë toskë, dhe;
- Faik Konica, Fan Noli, e tjerë shkrimtarë të tashëm.

Sipas Rrotës, po që se në librin e tij nuk do të përmendeshin edhe shkrimtarët e gjallë, si Fishta, Mjedja, Konica, Prenushi e Noli, letërsia shqipe do të mbetet shumë e varfër.

2. Në librin e Gaetano Petrotës, “*Populli, gjuha dhe letërsia shqipe*”, të botuar më 1931, mund të vërejmë një tentim më serioz për shkrimin e një historie të letërsisë shqipe. Në këtë libër letërsia shqipe tentohet të shihet në katër pjesë:

1. Dokumente gjuhësore;
2. Letërsia popullore;
3. Letërsia e kultivuar – shkrimtarë shqiptarë: prozatorë dhe poetë;
4. Shtypi periodik – revista dhe gazeta: 1848-1930.

Siç mund ta vërejmë edhe nga ndarja, libri i Petrotës është më tepër një lloj i përmbledhjes së të dhënave (minienciklopedi), sesa një strukturim i letërsisë shqipe. Megjithatë, kapitulli i tretë

---

liane. Vepra është e Alberto Straticos, dhe i takon vitit 1896, dhe mban titullin “*Manuale di Letteratura albanese*”.

<sup>12</sup> Sabri Hamiti, “Albanizma”, ASHAK, Prishtinë, 2009, f. 239.

është me interes të veçantë për historinë e letërsisë shqipe, nga-  
se rendit dhe trajton në mënyrë kronologjike autorët e letërsisë  
shqipe, nga koha e Muhamet Kyçykur-Çamit, e deri te bashkëko-  
horët e asaj kohe: Dhimitër Pasko e Simon Shuteriqi. Ndoshta se  
i njihte më mirë, dhe për shkak se librin e kishte shkruar në itali-  
sht, autorët e letërsisë arbëreshe zënë një vend bukur të veçantë  
në librin e tij, si për nga vëllimi, ashtu edhe për nga trajtimi. Si-  
pas Petrotës, autorët kryesorë të letërsisë shqipe janë: Jeronim  
de Rada, Zef Skiroi dhe Gjergj Fishta. Sipas Petrotës, autorët e le-  
tërsisë filiobliblike nuk bëjnë pjesë në letërsinë e kultivuar shqi-  
pe, prandaj këta autorë i trajton në kapitullin e parë, te “*Doku-  
mente gjuhësore*”.

3. Në këtë periudhë kishte edhe disa nisma për periodizim të historisë  
së letërsisë shqipe, siç mund të vërehen në revistën “Shkëndija” të  
vitit 1940 (lexo numrin 6, f. 23-28!), pastaj në revistën “Drita” (lexo  
numrin 1, konceptin për qarqet letrare të dhënë prej Mithat Fra-  
shërit, të cilin koncept e zhvillon Çabej!).

Në të tri këto nisma vërehet se si fillim i letërsisë shqipe merret pe-  
riudha prej *Buzukut*, eventualisht për shkrimin shqip nga *Dokumentet  
gjuhësore*.

#### IV. Histori të letërsisë shqipe

Në vitin 1936 Eqrem Çabej e botoi veprën “*Elemente të gjuhësisë e të lite-  
raturës shqipe*”. Me këtë vepër edhe Çabej provon të bëjë një histori të  
letërsisë shqipe, duke e ndarë në periudha, dhe duke vënë emërtime herë  
mbi bazë të kohës, e herë mbi bazë të vendit. Kështu, pjesa e dytë e  
veprës së Çabejt, e titulluar “*Literaturë*”, na e jep këtë strukturë të histo-  
risë së letërsisë shqipe:

1. Shkrimtarët e vjetër;
2. Shkrimtarë shqiptarë të Greqisë
3. Shkrimtarë shqiptarë të Italisë
4. Shkrimtarët e shek.. të 19-të dhe të fillimit të shek.. të 20-të.

Vërehet se, për dallim nga Petrota, që me librin e tij do të mbetet si referencë bibliografike, Çabej i konsideron si nismëtarë të letërsisë shqipe shkrimtarët filiobiblikë. Prandaj, këtu e vë të parin Buzukun, ndësa të fundit Theodor Haxhi Filipin (1730-1805).

Libri i Çabejt është i shkruar në formë sintetizuese, ka karakterizime letrare të shkrimtarëve, ide interesante, e që më vonë do të bëhen prodhime, sidomos për Naim Frashërin, Jeronim de Radën, Gjergj Fishtën, Zef Skiroin e Asdrenin.

Megjithatë, duke e ditur se letërsisë shqipe i mungonte një histori e letërsisë, Çabej nuk mjaftohet vetëm me këtë libër. Prandaj, më 1939, në librin *“Për gjenezën e literaturës shqipe”*, në kapitullin *“Literatura”* sikur na e thotë drejtpërdrejt idenë e tij për ndarjen e letërsisë shqipe. Tani, ndoshta i ndikuar pak edhe nga idetë e Lumo Skendos për shikimin e letërsisë shqipe mbi konceptin e qarqeve letrare, për çka ky i fundit kishite shkruar në numrat e parë të revistës *“Drita”*, Çabej thotë se literatura shqipe duhet të dalë nga qarqet kulturore dhe letrare, dhe jo nga periudhat historike. Mbi këtë ide Çabej vëren katër qarqe kulturore e letrare, dhe i emërton si në vijim:

Qarku katolik i Shqipërisë Veriore;

Qarku italo-shqiptar;

Qarku ortodoks i Shqipërisë Jugore, dhe;

Qarku letrar kombëtar, literatura kombëtare e shekullit të 19-të.

Mund ta vërejmë se Çabej rendit tre qarqe si parakombëtare, ndërsa Rilindjen kombëtare shqiptare e veçon si qark më vete.

Si për ta vlerësuar romantizmin shqiptar, si më kualitativin në letërsinë shqipe, Çabej më 1945 shkruan edhe një vepër studimore me karakterin e historisë së letërsisë. Kjo është vepra *“Romantizmi në Evropë lindore e juglindore dhe në literaturën shqiptare”*, që mbyll ciklin e veprave të Çabejt për historinë e letërsisë shqipe dhe periodizimin e saj. Shikuar nga një perspektivë më e largët, Çabej na del i pari që nis nga gjeneza e letërsisë shqipe, të paktën pretendon ta çojë sa më herët. Ndërsa, kërkimi mbi kualitetet letrare më shumë sesa mbi kriterin e kohës dhe vendit

Çabejn e bën autorin që vë themelet e një historie më serioze të letërsisë shqipe. Dëshmi për këtë janë tri veprat e tij të lartcekura për këtë fushë studimore.

Hera e parë që në mënyrë institucionale u provua të shkruhet një histori e letërsisë shqipe është viti 1941. Veprat studimore “*Shkrimtarët shqiptarë 1*”, e Namik Ressulit, dhe “*Shkrimtarët shqiptarë 2*” e Karl Gura-kuqit, siç thuhet në fillim, “*mbledhë e punue nën kujdesin e Ernest Koliqit*”, janë veprat e para që në mënyrë institucionale letërsinë shqipe tentojnë ta sistematizojnë në kohë e hapësirë, nga fillimi e deri në aktualitet. Megjithatë, “fillimi” edhe në këto vepra nuk shkon më herët sesa koha e tashmënjohur e vendosur prej studiuesve pararendës.

Historia e letërsisë shqipe “*Shkrimtarët shqiptarë 1*”, e Namik Ressulit ka shtatë kapitula, e që njëherazi janë emërtime të periudhave të letërsisë shqipe:

1. Dokumentet e para të gjuhës shqipe (me pesë nënkapituj);
  - b) Formula e Pagëzimit (1462)
  - c) Fjalorthi i Arnoldit Von Harff (1497)
  - d) Ungjilli i Pashkvet (shek.. XV)
  - e) Nënshkrimet e Pjanës
  - f) Fjalorthi i Mazrrekut (1633)
2. Shkrimtarë të vjetër të Veriut (me pesë autorë: Gjon Buzukun, Pjetër Budin, Frang Bardhin, Pjetër Bogdanin dhe Gjon Nikollë Kazazin, dhe një letër përcjellëse nga Kuvendi i Arbënit, e vitit 1706 );
3. Shkrimtarë të vjetër të Jugut (me pesë autorë: Theodhor Kavajotin, Mjeshtrin Danjel<sup>13</sup>, Kostë Beratasin, Marko Boçarin dhe Grigor Gjirokastritin);

---

<sup>13</sup> Ky është Dhaskal Danjeli. Mendohet se ishte prej dy-tre autorëve më të vjetër të Jugut. Ishte nga Voskopoja, dhe gati gjithë jetën e kaloi aty. Nuk dihet saktësisht se kur ka lindur dhe kur ka vdekur. Sipas Ilo Mitkë Qafëzezit, Mjeshtri Danjel ka lindur në vitin 1754, ndërsa ka vdekur në vitin 1811.

4. Shkrimtarë të vjetër myslimanë (me nëntë autorë të përmendur, mirëpo vetëm dy të trajtuar më gjerësisht: Muhamet Çamin dhe Nezim Beratin);
5. Prodhimi letrar përpara Lidhjes së Prizrenit (me dhjetë autorë: Theodor Haxhi Filipin, Naum Veqilharxhin, Konstandin Kristoforidhin, Pjetër Zarishin, Engjëll Radojan, Leonard de Martinin, Zef Ndoqillijan, Ndue Bityqin, Thimi Mitkuan dhe Pashk Babin);
6. Prodhimi letrar i Arbreshvet t'Italisë (me gjashtëmbëdhjetë autorë: Lekë Matrangan, Nikollë Figlian, Nikollë Brankatin, Zef Barçën, Jul Varibobën, Gjon Thoma Barbaçin, Nikollë Ketën, Gabriel Darën (Plaku), Andrea Darën, Jeronim de Radën, Anton Santorin, Dhimitër Kamardën, Gabriel Darën (I Riu), Zef Kamardën, Pjetër Kiarën dhe Zef Sermben), dhe;
7. Arbëreshët e Greqis (me dy autorë: Anastas Kullurjotin dhe Panajot Kupitorin)

Në këtë histori të letërsisë shqipe mund të vërejmë se për herë të parë paraqitet edhe ndarja në anë gjeografike, shkrimtarë të Veriut, të Jugut dhe Myslimanë, e që në fakt synohet ndarja në anë fetare, shkrimtarë katolikë të Veriut, ortodoksë të Jugut, dhe Myslimanë.

Më vonë, më 1987, Namik Ressuli do të provojë edhe një herë të bëjë një histori të letërsisë shqipe, mirëpo tani drejtuar një auditori të huaj, atij italian, e për të cilën histori do të bëjmë fjalë më vonë.

Sidoqoftë, e veçanta e veprës “*Shkrimtarët shqiptarë 1*” është se ndarjet dhe periodizimet bëhen mbi bazë të një shumësie kriteresh, si: hapësira gjeografike, koha, rrethanat politike e kulturore etj. Përveçse si regjistrim i autorëve, kjo histori e letërsisë shqipe për herë të parë provon të ngre edhe kriterin e sistematizimit dhe atë të krijimit të historisë së letërsisë mbi bazë të vlerës letrare, megjithëse para kriterit të kualitetit letrar prapë vërehet se mbisundon kriteri i kohës, e i cili prapë nuk shkon më herët sesa koha e *dokumenteve të vjetra*.

Ndërkaq, vepra “*Shkrimtarët shqiptarë 2*” e Karl Gurakuqit, më shumë është një përmbledhje autorësh shqiptarë nga viti i Lidhjes së Prizre-

nit, 1878, e deri më 1966, sesa një histori e letërsisë shqipe. Megjithatë, numri “2” na lë të kuptojmë se vepra nuk mund të qëndrojë në vete pa pjesën e parë, ku përveç autorëve kishim edhe nëntitullin “*Njohtime të përgjithëshme*”, e ku paraqiteshin idetë dhe karakteristikat e përgjithshme të periudhës letrare. Sidoqoftë, kjo vepër përmbledh 28 shkrimtarë shqiptarë, duke filluar me Pashko Vasën, dhe pas tij: Naim Frashërin, Prengë Doçin, Sami Frashërin, Filip Shirokën, Anton Xanonin, Ndoc Nikajn, Andon Çakuan (Çajupin), Ndre Mjedjën, Mati Logorecin, Gaspër Jakova-Merturin, Pashk Bardhin, Gjergj Fishtë, Mihail Gramenon, Aleksandër S. Drenovën, Shtjefën Gjeçovin, Papa Kristo Negovanin, Faik Konicën, Kristo Floqin, Luigj Gurakuqin, Fan S. Nolin, Mid’hat Frashërin (Lumo Skendon), Aleksandër Xhuvanin, Terenc Toçin, Simon Shuteriqin, Ali Asllanin, Hilë Mosin, dhe duke përfunduar me Vinçens Prenushin.

Përveç fragmenteve të shumta nga veprat letrare të autorëve, “*Shkrimtarët shqiptarë 2*” e Karl Gurakuqit më shumë ngjan me një antologji të autorëve të Rilindjes Kombëtare dhe të disa autorëve pas saj, sesa me një histori të letërsisë shqipe.

Viti 1983 është viti që kulturës shqiptare ia sjell një vepër tjetër të historisë së letërsisë shqipe, tani të bërë nga një grup autorësh. “*Historia e letërsisë shqiptare*” është një vepër e botuar nën kujdesin e Dhimitër Shuteriqit, e cila letërsinë shqiptare nga fillimi e deri në kohën para ardhjes së shtetit komunist e ndan në tri periudha:

1. Letërsia e vjetër shqiptare;
2. Letërsia shqiptare e Rilindjes Kombëtare, dhe;
3. Letërsia e periudhës (së shtetit shqiptar të viteve 1912-1939).

Pra, siç edhe mund të vërehet, kjo histori e letërsisë e lë pa e përmendur fare letërsinë bashkëkohore të asaj kohe. Sipas studiuesit Sabri Hamiti, *këtu shohim që ka kritere të ndryshme për emërtimin e secilës periudhë: e para është arbitrare, si letërsi e vjetër; e dyta është kulturore nacionale, si letërsi e Rilindjes; e treta është politike e shtetërore, si letërsi e shtetit shqiptar*<sup>14</sup>.

<sup>14</sup> Sabri Hamiti, “Albanizma”, ASHAK, Prishtinë, 2009, f. 243.

Kjo është historia e parë e letërsisë shqipe e bërë në mënyrë institucionale dhe nga një grup autoresh, si dhe e para histori e letërsisë shqipe që eliminoi autorë të rëndësishëm të letërsisë shqipe (Gjergj Fishtën etj.). Po ashtu, kjo është edhe e para histori e letërsisë shqipe e bërë mbi bazë ideologjike.

Studiuesi dhe historiani i njohur i letërsisë shqipe, Rexhep Qosja, përgjatë gjithë punës së tij shkencore letrare ka sjellë dy skica të periodizimit të letërsisë shqipe. Të parën skicë e paraqet në vitin 1979, në veprën “*Prej tipologjisë deri te periodizimi*”, në studimin “*Periodizimi i letërsisë shqipe*”, ndërsa të dytën në veprën “*Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi I, II, III*”.

Skica e parë e Qosjes për periodizimin e letërsisë shqipe ka këtë formë:

1. Romantizmi (që nis më 1836);
2. Romantizmi-Realizmi-Simbolizmi (që nis më 1902);
3. Letërsia sociale (që nis më 1934), dhe;
4. Realizmi integral (pa një datë të fiksuar të nisjes).

Vërehet se Qosja më shumë sesa kohën dhe hapësirën, në periodizimin e tij synon cilësimin letrar, prandaj historinë e letërsisë shqipe sipas kësaj skice e vendos tepër vonë, në vitin 1836.

Ndërkaq te skica e dytë, te parathënia e veprës “*Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi I, II, III*”, si për ta përmirësuar skicën e parë, Qosja e vendos edhe letërsinë e vjetër shqipe. Prandaj, tani skica e re e historisë së letërsisë shqipe sipas Qosjes na del në këtë formë:

1. Letërsia e vjetër;
2. Romantizmi;
3. Prej romantizmit deri te realizmi;
4. Letërsia sociale, dhe;
5. Letërsia e sotme.

Në të dy skicat e veta Qosja nuk i ka kriteret e njëjta në periodizim. Kjo vërehet sidomos te skica e dytë, kur herë merr kohën si kriter (*Le-*

tërsia e vjetër; *Letërsia e sotme*), herë formacionet stilistike (*Romantizmi; Prej romantizmit deri te realizmi*), e herë edhe kriterin tematik (*Letërsia sociale*).

Vepra “*Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*” e Ibrahim Rugovës, e botuar në vitin 1986, është vepra e parë e historisë së kritikës letrare shqiptare. Vepra është e ndarë në dy pjesë, ndërsa pjesa e dytë ka tri nënpjesë të veçanta. Kjo vepër ka këtë strukturë:

1. Pjesa e parë:

- A. Fillimet e mendimit kritik
- B. Kritika e Rilindjes Kombëtare
- C. Kritika e periudhës 1912-1944

2. Pjesa e dytë:

- A. Kritika bashkëkohore:
  - a. Kritika në Shqipëri
  - b. Kritika shqiptare në Kosovë
  - c. Kritika e arbëreshëve të Italisë

Secili prej kapitujve shoqërohet me nënkapitullin “*Konteksti socio-kulturor*”, ku Rugova shpreh rrethanat socio-kulturore që e kanë karakterizuar periudhën në fjalë. Njësoj si Qosja, edhe Rugova merr për bazë kriteret të ndryshme gjatë emërimit të periudhave të zhvillimit të kritikës letrare shqiptare. Herë e merr kohën si kriter (*Kritika bashkëkohore*), herë kriterin kulturor (*Kritika e Rilindjes Kombëtare*), herë kriterin politik (*Kritika e viteve 1912-1944; Kritika shqiptare në Kosovë*), apo edhe atë gjeografik (*Kritika në Shqipëri; Kritika shqiptare në Kosovë; Kritika e arbëreshëve të Italisë*).

Për gati njëzet vjet me radhë studiuesi Sabri Hamiti bëri disa prova për periodizimin e historisë së letërsisë shqipe. Madje, provat e Sabri Hamiti ishin jo vetëm për periodizimin, por edhe për përkufizimin, identifikimin dhe sistemimin e letërsisë shqipe në kohë e hapësirë. Dhe, këto prova të studiuesit Hamiti kanë rezultuar me disa vepra dhe studime letrare. Në këto vepra vërehen përkufizimet e pavëna re më parë, si: *letërsi biblike, bejtexhinjtë, letërsia e Rilindjes, letërsia moderne*, (te studimi “*Noci-*



one të letërsisë shqipe”, 1989); *letërsi qëllimore, letërsi metaforike, letërsi metonimike*, (te studimi “*Pamje e letërsisë shqipe*”, 1996); *shkolla letrare: filobiblike, romantike, kritike, moderne, soc-realiste, disidente, moderne (Kosovë)*, (te studimi “*Shkollat letrare shqipe*”, 2004). Përveç kontributit në periodizim dhe nocionizim, Hamiti propozon edhe një ndarje të periudhave të letërsisë shqipe. Dhe, këtë e bën duke marrë për bazë një varg kriteresh, dhe mbi të gjitha kriterin e cilësisë letrare, deri tani më shumë se secili autor i historive të letërsisë shqipe. Prandaj, letërsia shqipe sipas Sabri Hamitit i ka këto katër periudha letrare:

1. Letërsia filobiblike
2. Letërsia romantike
3. Letërsia moderne
4. Letërsia bashkëkohore.

Duket qartë se Hamiti përdorimin e kriterëve nuk e përsërit në periodizimin e letërsisë. Prandaj, derisa një herë e merr për kriter temën (*Letërsia filobiblike*), herën tjetër e merr kriterin stilistik (*Letërsia romantike*), për ta marrë më pas kriterin e poetikës (*Letërsia moderne*), që më pas ta përfundojë me kriterin e kohës (*Letërsia bashkëkohore*).

Megjithatë, edhe Sabri Hamiti, sikurse të gjithë studiuesit e gjertanishëm, historinë e letërsisë shqipe nuk e çojnë më herët sesa te koha e Buzukut.

## V. Histori të letërsisë shqipe në gjuhë të huaja

### 1. Alberto Stratico, *Manuale di Letteratura albanese*

E para vepër e historisë së letërsisë shqipe është shkruar në gjuhë të huaj. Ajo është vepra e Alberto Straticos, e shkruar në italisht, dhe e botuar në vitin 1896. Vepra mban titullin “*Manuale di Letteratura albanese*”. Siç mund të vërehet edhe nga vetë titulli, më shumë se një histori e letërsisë, kjo vepër është një manual informativ për letërsinë shqipe. Siç thotë Ibrahim Rugova, *libri ka strukturën e tekstit të historisë së letërsisë në*

*frymën e teksteve të kohës që bëheshin kryesisht në Itali dhe në historinë letrare evropiane*<sup>15</sup>.

Kjo vepër është botuar në Milano, dhe ka një strukturë të përbërë nga katër kapituj. Kapitujt janë të ndarë si në vijim:

- I. Fillohet me origjinën, historinë dhe gjuhën e popullit shqiptar;
- II. Vazhdohet me monumentet e para gjuhësore e letrare shqiptare;
- III. Këtu kemi një vështrim të letërsisë gojore popullore;
- IV. Në kapitullin e katërt kemi një pasqyrim monografik të disa shkrimtarëve shqiptarë, duke nisur me ata të letërsisë së vjetër, për të vazhduar pastaj me ata të Rilindjes.

E veçantë e këtij libri është kapitulli i tretë, që bën klasifikimin e zhanreve të letërsisë gojore. Për shembull: Stratico këngët popullore i ndan në: këngët e dashurisë, këngët e martesës, këngë të ndryshme dhe të shtëpisë, këngët e vdekjes (funebre), këngët e mërgimit (kurbetit), ndërsa nuk lë pa përmendur edhe novelat (tregimet) popullore, respektivisht prozën gojore. Përndryshe, ky klasifikim është i pari i këtij lloji në historinë e letërsisë shqipe, e që si i tillë vërehet edhe më vënë në tekstet e historisë së letërsisë shqipe. Libri i ka 280 faqe, dhe është bazë e historisë së letërsisë shqipe.

## 2. Stuart E. Man, *Albanian literature an Outline of Prose, Poetry, and Drama*

Pas botimit të veprave të historisë së letërsisë shqipe nën kujdesin e Ernest Kolilqit, në vitin 1955 studiuesi i njohur britanik i gjuhës dhe letërsisë shqipe, Stuart E. Mann, duke qenë i përkushtuar kryesisht në gjuhën shqipe, dhe pas botimit të dy veprave për gjuhën dhe kulturën shqipe, botoi veprën “*Albanian literature an Outline of Prose, Poetry and Drama*”. Vepra u botua në Londër.

Libri, përveç ndarjes gjeografike që ia bën letërsisë shqipe, karakterizohet edhe me disa kategorizime zhanrore. Në fillim, pas përmendjes së

---

<sup>15</sup> Ibrahim Rugova, “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”, Faik Konica, Prishtinë, 2005, f. 57.

*dokumenteve të para të shkrimit shqip*, nën titullin *The Catholic Tradition in Northern Albania, Matranga*, libri prezanton autorët e vjetër filiobibli-kë, si: Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Pjetër Mazreku, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, për ta përfunduar me Lekë Matrangën, ndërsa më pas kalon drejt në shekullin e 18-të, respektivisht tek autorët e vjetër arbëreshë dhe tek autorët e vjetër bejtexhinj. Ndikimi i madh i kulturës katolike në letërsinë shqipe në këtë libër prezantohet edhe në një kapitull të veçantë, të titulluar *The Bible Tradition*.

Në kapitullin e katërt, ndër më të gjatët e këtij libri, kemi autorët dhe letërsinë shqipe të shekullit të 19-të, thënë më saktë poetët e Italisë e të Sicilisë. Pas këtij kapitulli kemi letërsinë shqipe pas Lidhjes së Prizrenit dhe letërsinë shqipe në diasporë, për të vazhduar më pas me kapitullin e Rilindjes Kombëtare.

Në këtë libër, nën kapitullin *The Albanian of Egypt*, për herë të parë si të veçantë në historitë e letërsisë shqipe na paraqiten edhe autorët shqiptarë të qarkut të Egjiptit, si: Thimi Mitko, Spiro Dine, Shtjefën Zurani e Anton Çako (Çajupi). Përveç kësaj, këtu na vijnë të ndarë në kapituj edhe autorët që botuan në Sofie dhe ata që botuan në Bukuresht. Ndërsa, pas kapitullit që flet për letërsinë e Shkodrës kemi një ndarje zhanrore si: *The Drama*, *The Novel* dhe *The Essay, Literary Criticism*, për të përfunduar me një përshkrim të autorëve që letërsinë e tyre e kanë krijuar mbi ngjarje historike, si: Ndoc Nikaj, Stefan Kosta Gjeçovi, Fan Noli, Aleksandër Xhuvani, Konstantin Çekrezi, Ilo Mitkë Qafëzezi, Mati Logoreci e Sali Hallakondi. Ky libër që në total ka rreth 122 faqe, dhe jep një përmbledhje të shkurtë të studiuësve të gjuhës, të folklorit, dhe të përkthyesve, ndërkaq në fund përmbillet me një përshkrim po ashtu të shkurtër për zhvillimet moderne të asaj kohe, respektivisht të periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore.

### 3. Giuseppe Schiro (i Riu), *Storia della Letteratura albanese*

Vetëm katër vjet pas Stuart E. Man, në vitin 1959, Giuseppe Schiro (i Riu), shkruan dhe e boton në italisht veprën "*Storia della Letteratura*

*albanese*". Kjo vepër e historisë së letërsisë shqipe paraqet periudhat e historisë së letërsisë shqipe, të ndara në gjashtë pjesë:

1. Letërsia e vjetër shqipe
2. Letërsia shqipe orientale
3. Letërsia shqipe e riorganizmit kombëtar
4. Letërsia shqipe e pavarësisë
5. Letërsia shqipe e luftës antifashiste
6. Letërsia shqipe e realizmit socialist

Kjo është vepra e parë që letërsinë shqipe orientale e ka vënë pranë letërsisë së vjetër shqipe, apo, më saktë, që letërsinë e vjetër shqipe nuk e emërton sipas domimancës fetare katolike.

#### 4. Robert Elsie, *History of Albanian literature*

Robert Elsie pa dyshim se është autori i historisë më të plotë të letërsisë shqipe në gjuhë të huaj. Vepra e tij "*History of Albanian literature*", e botuar në vitin 1995, dhe e ribotuar disa herë dhe në versione të ndryshme, sot është vepra më e konsultuar për historinë e letërsisë shqipe në botën përtejshqiptare. I determinuar nga gjuha, përveç njohurive letrare, Elsie e plotëson tekstin e tij edhe me një varg të dhënash historike e bibliografike, të cilat të dhëna një të huaji ia japin një pasqyrë edhe më të plotë të lëndës. 13 kapitujt e "*History of Albanian literature*" të Robert Elsie karakterizohen me tituj të ndryshëm, herë politikë, herë kulturorë, herë-herë historikë a letrarë, varësisht nga materiali i trajtuar brenda kapitullit.

## VI. Një histori e letërsisë shqipe nën hijen e ideve të Ernest Koliqit

Më sipër e përmendëm se në vitin 1987 Namik Ressuli vjen edhe me një vepër tjetër për historinë e letërsisë shqipe. Këtë vepër e kemi ndarë nga historitë e letërsisë shqipe për arsye se nuk është shkruar në shqip, dhe nuk e kemi përmendur në grupin e historive të letërsisë shqipe në gjuhë të huaja për disa arsye, se: 1. Kjo është historia e dytë e letërsisë shqipe e

shkruar prej Namik Ressulit, mirëpo tani për një auditor të huaj; 2. Sepse kjo është botuar dy vjet pas vdekjes së autorit; 3. Sepse është përkthyer nga italishtja në anglisht, dhe ende nuk është e përkthyer në shqip; 4. Sepse provon ta periodizojë letërsinë shqipe mbi bazë të kualiteteve letrare, dhe; 5. Sepse bëhet një lloj pasqyre mjaft përmbledhëse e shkruar prej një autori shqiptar që do t'ia prezantojë letërsinë shqipe një auditoriumi të huaj. Pra, edhe Namik Ressuli provoi dy herë të bëjë histori të letërsisë shqipe. Hera e parë ishte vepra “*Shkrimtarët shqiptarë 1*”, të cilën e bëri nën kujdesin e Ernest Koliqit, ndërsa hera e dytë ishte me veprën “*Albanian Literature*”, të cilën e bëri nën hijen e ideve të Ernest Koliqit. Kjo vepër e Ressulit u botua në italisht. Ndërkaq, dy vjet pas vdekjes së tij, Eduard Liço, duke e përmbushur dëshirën e autorit, e përktheu dhe e botoi në anglisht.

Në këtë vepër të Ressulit do t'i gjejmë 18 kapituj, të titulluar me tendencë të periodizimit të letërsisë shqipe, e herë-herë edhe me tendencë të emërtimit të qarqeve kulturore letrare. Pas paraqitjes së të dhënave historike që dokumentojnë shqipen e shkruar, Ressuli vazhdon me ndarjen e periudhave të letërsisë shqipe. Sipas Ressulit, pas letërsisë popullore shqipe menjëherë vjen letërsia para Rilindjes Kombëtare, e cila në vete mban tre qarqe letrare:

1. Letërsinë katolike – Gegë
2. Letërsinë ortodokse – Toskë
3. Letërsinë islame

Mund ta vërejmë se dallimi mes “*Shkrimtarët shqiptarë 1*” dhe “*Albanian Literature*” deri këtu është krejt i vogël. Përveç ndryshimit të orientimit gjeografik, Veri-Jug në Gegë-Toskë, deri tani nuk kemi asnjë dallim tjetër.

Ndërsa, autorët e Rilindjes Kombëtare i ndan në dy grupe:

1. Pararendësit, ku përmend katër autorë, dhe;
2. Nga Lidhja e Prizrenit e pas, ku i trajton 8 autorë, ndërsa 14 vetëm i përmend vetëm me emër.

Namik Ressuli një kapitull të veçantë ia kushton letërsisë së Shkodrës. Madje edhe titullin ia vë po ashtu. Ndërkaq, letërsinë pas pavarësisë

(1912) e deri para komunizmit (1943), i shtyrë nga rrethanat historike e politike, e titullon pikërisht kështu “*Nga 1912 deri më 1943*”. Ndërsa, periudhën pas vitin 1934 e quan “*Letërsia e pasluftës*”, për t’u kthyer pastaj tek arbëreshët e Italisë (“*Letërsia italo-shqiptare*”).

Në veprën “*Albanian literature*” Namik Ressuli bën edhe një ndarje të autorëve më të mëdhenj të letërsisë shqipe, duke krijuar edhe katër pozita, tabanë të kulturave-qarqeve letrare. Kështu, ai veçon Naim Frashërin, Gjergj Fishtën dhe Fan S. Nolin. Një ndarje si kjo Ressuli vërehet se e ka bërë i ndikuar nga Ernest Koliqi, respektivisht shkrimi “*Tre poetët më të mëdhaj të Shqipërisë*”, ku Koliqi rendit Jeronim de Radën, Naim Frashërin dhe Gjergj Fishtën si poetët më të mëdhenj të Shqipërisë.<sup>16</sup>

Mirëpo, ky do të tingëllojë më përmbledhës (të mbetet vetëm brenda gjeografisë së Shqipërisë), prandaj në vend të Jeronim de Radës, që është matanë detit (në Itali, dhe që nuk shkeli kurrë në Shqipëri), e vë Fan Nolin, që për një kohë vepron në Shqipëri. Heqjen e De Radës ia kërkon edhe orientimi gjeografik, Jugu, dhe, për më tepër Noli i përgjigjet plotësisht kërkesës së tij. Pra, e heq një arbëresh, dhe e vë një shqiptarë të Jugut. Edhe dominanca fetare te të dy i del e njëjtë, pra ortodokse. Dhe, për dallim nga Koliqi, Ressuli merr edhe një autor më shumë. Sepse dominanca tek autori i katërt nuk është fetare, siç është te të tre të sipërpërmendurit: Naim Frashëri – mysliman, Fan Noli – ortodoks, dhe; Gjergj Fishta – katolik. Tani e merr Faik Konicën, që është autor që Resselit i del tamam i pastër letrarisht. Kjo ngase letërsia, edhe nëse mund të burojë nga feja, nuk duron të sundohet nga ajo. Prandaj Konica i del model më vete, dhe në veprën e Resselit zë një vend të veçantë. Pikërisht si fenomen letrar.

---

<sup>16</sup> Për këtë më gjerësisht lexo: Ernest Koliqi, “*Vepra 4*”, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 84.

## VII. Letërsia e Shkodrës dhe letërsia e Kosovës

Ndikimi i Ernest Koliqit të Namik Ressuli vërehet edhe në krijimin e qarkut të Shkodrës, ku Koliqi zë një hapësirë mjaft të madhe dhe përshkruhet me epitetet më të larta. Fundja, vetë Koliqi, pas marrjes së pushtetit nga komunistët, thotë se substanca letrare shqiptare tashmë ik në Kosovë, dhe gjersa deri atëherë i takonte Shkodrës, tani e pas i takon Kosovës. Kjo substancë letrar shkodrane do ta ketë shtyrë Ressulin që të krijojë një qark letrar shkodran, e i cili pa dyshim se ngjan shumë me atë të Kosovës. Dhe, është interesant të shikohet lidhja e letërsisë së Shkodrës me atë të Kosovës. Dhe kjo për disa arsye: Pas ardhjes së substancës letrare shkodrane në Kosovë, dhe pas një kultivimi disavjeçar të saj, në Kosovë dalin autorë si: Martin Camaj, Adem Demaçi, Nazmi Rrahmani, Din Mehemeti, Ali Podrimja (sidomos me shprehjen e elementit nacional), Anton Pashku, Azem Shkreli (megjithëse ky vërehet se ka një talent më të madh në poezi, prandaj edhe dallon; ndoshta edhe se ndikimin e tij përveç prej Koliqit e ka pasur edhe prej poetit serb Vasko Popa) etj., e që veprat e tyre vërehet qartë se kanë një hije koliqiane. Për shembull: krahasojeni tregimin “Gjaku” nga përmbledhja me tregime “Hija e maleve” të Ernest Koliqit, me romanin “Gjarpinjtë e gjakut të Adem Demaçit!; ose tregimin “Se qofsh pleqnosh” nga po e njëjta përmbledhje e Koliqit, me romanin “Malësorja” të Nazmi Rrahmanit! Ngjashmëritë do t’i vëreni fare qartë.

Prandaj, duke e parë thellë, mendojmë se, gati-gati, ashtu si Namik Resuli qëndron nën hijen e ideve të Ernest Koliqit, ashtu edhe letërsia e Kosovës rri nën letërsinë e Ernest Koliqit. Ndoshta është pikërisht kjo arsyeja që Kosova ka nxjerrë, jo vetëm në kuantitet, më shumë emra të letërsisë sesa Shqipëria.

Ndërkaq, sa i përket shkrimit të një historie të plotë të letërsisë shqipe, pavarësisht tentimeve të gjertanishme, ajo ende nuk është realizuar. Megjithatë, një histori siç duhet të jetë për letërsinë shqipe tashmë është e domosdoshme. Dhe, ajo duhet t’i përfshijë edhe autorët shqiptarë të letërsisë që krijuan letërsi e kulturë të shkrimit shqip në alfabet arab qysh

në shekullin XV, siç ishin Mesih Prishtinaliu (1470-1512, që shkroi tri vepra, mes të cilave edhe një *Divan*), Suzi Çelebiu (që vdiq në vitin 1524, dhe që njihet për veprën *Beharije* dhe për një poemë epike me titull *Gazavatnam Mihaloğlu*), Mevlana Mustafa Shemi nga Prizreni (që vdiq pas vitit 1600, autori i një *Divani*-përmbledhjeje me poezi), Ashik Çelebiu (1520-1572, i cili ishte poet dhe përkthyes i njohur, i cili e shkroi një vepër në vitin 1568, e cila vepër fliste për ndjenjat e poetëve), Ibrahim Shahidi Deden (nga Mugla, i cili vdiq më 1550, e i cili më 1514 kishte përpiluar një fjalor me mijëra fjalë, të titulluar “*Tyhfei Shahidi*” – *Dhurata e Shahidit*), si dhe shumë e shumë të tjerë. Këta janë emra që sot nuk i gjejmë në asnjërën nga skicat e historive të letërsisë shqipe. Madje as nuk përmenden në listën e autorëve të historisë letërsisë së vjetër shqipe, e mos të flasim për tekstet shkollore të Gjuhës dhe Letërsisë. Pse, vallë, historia e letërsisë shqipe, shkenca e historisë së letërsisë shqipe, është bërë me “një sy mbyllur” ndaj gjithë këtyre figurave shqiptare që krijuan kulturë letrare qoftë edhe në gjuhë të huaj? Një periodizim standard i historisë së letërsisë shqipe që qarkullon nëpër tekstet shkollore të Gjuhës dhe të Letërsisë, historinë e letërsisë shqipe e ndan në tri periudha: 1. Humanizmi shqiptar (shekulli XV); 2. Letërsia filiobiblike (XVI-XVII), dhe; 3. Letërsia e bejtexhinjve (shekulli XVIII). Mirëpo, nëse veprat e shkruara prej humanistëve shqiptarë nuk qenë të shkruara në shqip, po ishin në latinisht, për shembull, veprat e Gjon Gazullit (1400-1465), Andera Aleksit (1425-1505), Marin Beçikemit (1428-1526) Dhimitër Frëngut (1443-1525), Marin Barletit (1450-1513), Leonik Tomeos (1456-1531) etj., pse veprat e Suzi Çelebiut, Mevlana Mustafa Shemiut, Mesih Prishtinaliut e Ashik Çelebiut nuk na qenkan të vlefshme për kulturën shqiptare?! Madje, kjo mosvleftësi e tyre është konstatuar fare pa i përfillur, meqë si tekste ende nuk janë botuar në shqip. Po, pse ky narracion i fshehur i historisë së letërsisë shqipe?! Dhe, siç e pamë nga skicat e historive të prezantuara gjer më sot, secila është e tepërndikuar nga tjetra, mirëpo pa i përfillur fare emrat e “filokuanorëve të hershëm”. Pra, pse është fshehur narracioni i vërtetë i historisë së letërsisë shqipe?! A kaq



“kastrues” të pamëshirshëm të kulturës sonë qenkëshim?! A kaq shumë vetëmohuese na paskësh bërë ideologjia anorientale dhe komuniste?! Sa kështu ndërtuam një narracion të rrejshëm kulturor vetëm nga urrejtja ndaj Islamit?! Ndaj çdo gjëje islame! Edhe alfabetit të tekstit sakral islam-Kuranit! Pavarësisht nëse do ta dëshmonte shkrimin shqip dhe kulturën letrare shqipe edhe shekuj më parë sesa viti i “*Mesharit*” të Buzukut (1555)?!

# RECENSIONE



# Libri shkencë Ilmul Kelami – parimet bazë, studim i nevojshëm për trojet tona

Dr. Bahri Hoxha

Libri "**Shkencë e Ilmul Kelamit – parimet bazë**" i autorit-Myftiut Mr. Naim Tërnavë, paraqet një studim serioz dhe shumë të nevojshëm në lëmin e besimit islam.

Autori e ndan librin në katër kapituj, dhe secili nga kapitujt përfshin një studim të tematikave që historikisht janë studiuar dhe interpretuar prej dijetarëve islamë në shkencën e besimit, apo, siç quhet në origjinal, Ilmul Kelam. Struktura e kapitujve në libër paraprihet nga një hyrje, në të cilën shpjegohet qëllimi dhe përmbajtja tematike e librit.

Në anën përmbajtësore libri fillon me trajtimin e dy segmenteve të rëndësishme në të kuptuarit e Fesë; Shpalljes si entitet hyjnor dhe mendjes si një kapacitet njerëzor me bazë hyjnore po ashtu. Ky trajtim aludon haptas dhe pa ngurrim, në atë që i tërë Ehli Suneti është në pajtim,



se Shpallja e Zotit dhe mendja e pastër njerëzore, nuk ka mundësi që të bien ndesh, ose të kundërshtohen në realitet. Kështu për t'i dhënë fund keqinterpretimit të një pjese që është kyçur në ligjërimin fetar përmes së cilit, është munduar padrejtësisht të krijohet jo vetëm një distancë e madhe, por edhe një lloj armiqësie në mes tekstit fetar dhe realiteteve racionale.

Në kapitujt vijues, libri flet për zhvillimin e shkollave të Ehli Sunetit në lëmin e Akaidit. Fillon me shkollën e Imam Ebu Mensur El Maturidiut, pastaj vijon me shkollën e Imam Ebil Hasen El Eshariut dhe në fund përmbillet me një shpjegim të shkurtër të hadithologut të shquar Ebu Xhafer Tahaviut.

Një fillim i tillë, lexuesit i ofron një qasje më të përafërt në renditjen e tematikave me karakter besimor, duke filluar nga gjeneza e fesë, për të shpjeguar pastaj bazat e besimit islam si dhe për të vazhduar tutje me shtjellimin e kuptimit të drejtë dhe të zhdrejtë të këtyre tematikave

Qysh nga fillimi i librit gjejmë shpjegimin dhe trajtimin e relacionit njeri – besim, gjegjësisht nevojës njerëzore për të besuar në Zotin një. Këtu autori trajton konceptin e shpalljes, nga e cila rrjedh thirrja për besim. Shpallja si forma e veçantë e kontaktit në mes të hyjtores dhe njerëzores, në libër trajtohet si koncept që ndërlidh rolin e pejgamberisë në iluminimin e njerëzimit, kur ajo paraqitet si rrugë që në bazë të lirisë së përzgjedhjes, njeriu shpreh vullnetin e vet, të jetë i rreshtuar konform urdhrave të Zotit Krijues, drejt rrugës së amshueshmërisë. Shpallja e fundit paraqet edhe mesazhin përmbyllës hyjnor me të cilin përfundon vargu pejgamberik.

Definimi i relacionit mendje – shpallje hyjnore, dhe komponimi i mirëfilltë në mes këtyre dy konspekteve, rezulton me shfaqjen në skenë të shkencave islame në përgjithësi. Në kuadër të këtyre shkencave, shfaqet edhe shkenca e mirëparashtrimit të besimit dhe mirargumentimit të parimeve besimore, si shkencë prijatare në definimin e bazave të besimit. Kjo është shkenca e Akaidit, apo Ilmul kelami, siç quhet ndryshe në terminologjinë fetare. Përkufizimin e kësaj shkence, autori e sjell, pas paraqitjes së një mori definicionesh të dhëna në libër, prej autorëve të

famshëm botërorë, sikurse ishin Ibën Halduni, Adud El Ixhij, Imam Teftazani etj., i cili në kuptimin e thjeshtë del të ofrohet, si: "shkenca që shpjegon besimin dhe demanton keqkuptimet". Të dy këta krahë të kësaj shkence, i mbulon argumentimi fetar i bazuar si në Kuran e Sunet, po ashtu dhe në atë logjik dhe racional.

Dijetarët islamë të këtij lëmi, bukur artikulojnë të dy këto aspekte të Ilm El Kelamit përball mendimit njerëzor të kohës. Kjo u bë si në aspektin e parashtrimit dhe shpjegimit të akides islame, po ashtu edhe në demantimin e çdo mëdyshjeje që eventualisht i adresohet kësaj kredoje, ose një pjese të saj. Në këtë kontekst, ky libër mendoj se kontribuon në parashtrimin e mirëfilltë të shpjegimeve të akaidit islam, në kontekstin e ruajtjes së një qasjeje e cila bazohet bukur në Kuranin Famëlartë dhe Sunetin e të dërguarit a.s. në njërin anë, dhe të një shpjegimi të konsoliduar logjik në anën tjetër.

Ky mendim i pjekur fetar, siç e cek edhe autori, nisi dhe u zhvillua nëpër kohë në mesin e shkencëtarëve islamë të çdo gjenerate, duke dhënë një shembull të mirë për të gjithë mendimtarët botëror. Një kontribut i tillë, siç paraqitet edhe në libër, realizohet përmes zhvillimit të shkollave islame, kryesisht dy shkollave të Ehli Sunetit, si shumicë përfaqësuese e mendimit autokton dhe autentik fetar; shkollës Esharite dhe Maturidite, të cilat në fakt përfaqësojnë një formë të unifikuar të mendimit islam duke ndarë ndërmjet vete vetëm disa divergjenca dytësore që nuk prekin kompaktësinë dhe unitetin në parimet bazë.

Historiku i shkencës, bukur lidhet dhe shpjegohet duke i dhënë autenticitetin e vet, me trajtimin që i bënë dijetarët e hershëm të Islamit, në krye të të cilëve, pa dyshim qëndron Imam Ebu Hanife En Numani, si dijetar më i famshëm i kohës së tabiinjve.

Nxënësit u qëndruan besnikë mësimëve të katër imamëve, Ebu Hanifes, Malikut, Shafiut dhe Ahmed ibn Hanbelit, por në skenën e atëhershme islame pati edhe keqkuptime të disa shpjegimeve fetare, në raport me mësimet autentike islame. Autori arrin bukur t'i definojë ato keqkuptime dhe të shpjegojë se mbështetja e tyre në argumentimin islam ishte partikulare dhe jo e plotë. Shfaqja e fraksioneve në këtë kohë, si: Xhehmizmi

dhe Teshbihizmi bëri që tematika islame deri atëherë të qarta dhe të kuptueshme, të shndërrohen në pika ndarëse në mes të kuptimit të drejtë të që përfaqësonte shumica islame (Ehli Suneti) dhe atij jo të drejtë të parimeve besimore, sidomos në temat që kanë të bëjnë me Zotin Fuqplotë.

Një aspekt tjetër që përfshin libri është edhe definimi i faktit se në çështjet e akaidit- besimit dijetarët islamë janë më unaninë, dhe se ndasitë janë më të pakta, për shkakun se akideja islame nuk toleron mejdan të gjerë rrugësh dhe shpjegimesh, për dallim nga shkencat e praktikës fetare, siç është Fikhu. Kjo bën që të katër medhhebet e njohura të fikhut islam, të participojnë, gati njëjloj, në pasimin e këtyre shpjegimeve esharite-maturidite në Akaid.

Dijetarët e fushave të tjera islame, si dijetarët e hadithit, tefsirit, fikhut, etj., si dhe masat e gjera, përqaftuan këto shpjegime të këtyre shkollave, të cilat me kalimin e kohës, u njohën si shpjegimet e Ehli Sunetit dhe Xhematit, që në shqip ka kuptimin: "pasuesit e Sunetit dhe Shumica Islame". Me po këtë formë, edhe sot e asaj dite shumica islame mbeti në aplikim të mësimëve profetike në lëmin e besimit dhe në praktikat e ndryshme fetare.

Në mesin e të dhënave standarde, të cilat i ofron ky botim, përfshihen edhe referencat kryesore dhe shpjeguesit më të njohur të shkollave të shumicës islame, siç janë shpjeguesit që i përkasin shkollës maturidite, si: Semerkandi, Bezdeviu, Nesefiu, Kemal bin Himami, etj. Pastaj vazhdon me dijetarët e shkollës Esharite, si Imam El Bakilani, Imamul haremejn El Xhurvejni, Imam Gazali, Rrazi, Zerkeshiu, Zejleiu, Adud El Ixhij, Teftazani etj. Dijetarët e shumicës islame që u takojnë këtyre shpjegimeve, është e pamundur t'i përfshijë një studim si ky apo edhe më i gjerë duke pasur parasysh se ata janë të shumtë dhe shumica e secilës gjeneratë në Umetin islam.

Tematikat që më së shumti kanë nxitur debat, në këtë shkencë, ose thënë ndryshe, tematikat që më së shumti iu janë imponuar debatit akaidologjik, janë ato tematika që nxitën përngjasim të Zotit me krijesat, ose ato që mohuan cilësitë e Zotit. Përgjegjësinë për të demantuar këto

keqkuptime, morën dijetarët islamë të prirë prej Imam Maturidiut në Transaksoni, Imam Eshariu në Bagdad, si dhe Imam Tahaviu në Egjipt.

Në këtë studim, këta tre kolosë tregohen si imamët e dalluar të Ehli Sunetit, rreth shpjegimeve të të cilëve, u rreshtua i gjithë spektri i dijetarëve dhe veprimtarëve të natyrave të ndryshme në shoqërinë islame nëpër shekuj.

Dijetarët që u morën me këtë shkencë, në historiografisë islame njihen si elita e studiuesve islamë, që në fakt posedonin informacione enciklopedike në shumicën e shkencave të fesë islame, gjuhës arabe, filozofisë, logjikës, shkencave natyrore, por edhe të feve dhe grupeve të ndryshme. Ky fakt ka ndikuar direkt që shpjegimet e tyre prej një niveli elitari, të jenë bukur të komplikuar, duke qenë të ngarkuara me terminologji të cilat tejkalojnë njohuritë e zakonshme të spektrit praktikues islam. Si rrjedhojë, me kalimin e kohës, shpjegime të këtilla, deri diku mbesin me pak shpjegues, saqë vërehet në periudhat e mëvonshme të dekadencës së dijes islame edhe një zbrazëtim në mes tyre dhe shpjegimeve adekuate kelamiste që në fakt paraqesin bazament të fortë shpjegimesh, nga të cilat përfituan studiues në Lindje dhe në Perëndim, myslimanë dhe jomyslimanë.

Libri duket se ka arritur qëllimin e vet me shpjegimin e esencës së temave studimore, të cilat i ofron për një nivel mesatar të studiuesve islamë, siç janë studentët e FSI, por që shumë mirë do të vlenë dhe shërbente, edhe për ata që, pak ose fare, nuk kanë njohuri për natyrën e shpjegimeve fetare në lëmin e besimit.

Libri paraqet një studim nga të paktët në gjuhën shqipe që thjeshtëson terminologjinë, dhe e bën atë më të lehtë për studentët si dhe lexuesit, për dallim nga literatura e Akaidit që ishte përkthyer në vitet e pasluftës. Prandaj, mund të themi se arrin qëllimin edhe në ofrimin e informacioneve si besimore, po ashtu edhe ato të nivelit shkencor, përmes një gjuhe të lehtë, të qartë dhe shpjeguese, nga e cila përfitojnë besimtarët në këto troje dhe me gjerë.